Fahredin Shehu

MAKADAMI I SMAGRADTË

Ese, kolumne, recensione, kumtesa, artikuj, intervista...

Rahovec- Prizren- Prishtinë
2012

Ese, kolumne, recensione, kumtesa, trajtesa, artikuj...
© Iniciativa Pozitive, 2012
© Fahredin Shehu

Titulli: **Makadami i smagradtë**
Autor& Editor: **Fahredin Shehu**
Redaktura teknike: **Tahir Hoxha**
Botues: **Iniciativa Pozitive, Rahovec**
Sponsorë: **KK Prishtinë, KK Rahovec**
Drejta Autoriale: **Botimi i parë, 2012 © Iniciativa Pozitive**

Informacionet gjenerale

"Makadami i Smagradtë "
Fahredin Shehu
Botimi i parë: Mars, 2012

Ky botim është i mbrojtur me të drejtën autoriale, si "koleksion esesh, kolumnesh, recensionesh, artikujsh, trajtesash". Të gjitha të drejtat i takojnë Autorit, si pronë ntelektuale individuale. Asnjë pjesëe këtij publikimi nuk mund të kopjohet, transformohet në cilën do formë, pa pëlqimin ME SHKRIM, të Autorit apo edhe përfaqësuesit të tij ligjor; Iniciativa Pozitive.

Cila do kërkesë lidhur me këtë botim duhet t'i adresohet botuesit të këtij publikimi.

Të dhënat e botuesit:
Iniciativa Pozitive
E- mail: iniciativa.pozitive@gmail.com
Telefon: 049 784 551

Ky publikim është i mbrojtur me ligjet e aplikueshme të Kosovës
Copyright: © Iniciativa Pozitive, 2012
© Fahredin Shehu

MIRËNJOHJET

Falënderime të veçanta u adresoj sponsorëve dhe botuesëve në vijim:

- KK Prishtinë,
- KK Rahovec,
- Logos- A, Shkup, Maqedoni,
- Ronin Press - London, Mbretëria e Bashkuar,
- Nadwah Press - Hong Kong
- Corpos Editora, Porto, Portugali
- Gunu & Akademia e Arteve dhe Poezisë - Ulaan Baator, Mongoli
- Inner Child Press- NewYork, SHBA

Falënderime shtesë për përkrahje të parezervë të punës sime kreative, letrare dhe hulumtuese, në dhjetëvjeçarin e fundit, shkojnë për personat në vijim:

Feti Mehdiu, Nexhmije Pagarusha, Daut Demaku, Skender Boshtrakaj, Migjen Kelmendi, Milazim Krasniqi, Basri Çapriqi, Radije Hoxha, Evliana Berani, Ilire Zajmi, Tahir Hoxha, Kujtim Paçaku (Kosovë), Sejfedin Prekazi, Branko Cegec (Kroaci), Sabahudin Hadzialic (Bosnjë dhe Hercegovinë), William S. Peters, Phillip Larimore (SHBA), Owen Clivert (Mbretëria e Bashkuar), Anders Dahlgren (Suedi), Christian Wikborg Wisse (Danimarkë), Sonja Smolec (Belgjikë), Marc Delouze, Patrik Cintas, Marc Galan dhe Athanase Vantchev de Thracy (France),

Antonio Bertoli, Pepino Riso, Graziella Ardia dhe Mario Rigli (Itali), Thomas O' Carthaig (Irlandë), Fernando Sabido Sanchez (Spanjë), Ex Ricardo Pinx Terreira (Portugali), Gunsel Djemal (Qipro), Ali Caglar, Omer Dincsoy, Ayse Zisan Furat dhe Attila Elustun (Turqi), Muhamed Ali Yousfi II (Tunisi), Ismail Fakhi, Abdel Karim Kassem Al Arnaout (Liban), Muhamed Iqbal Harb (Arabi Saudike), Yael Globerman (Izrael), Zhang Zhi Yi (Kinë), Seyed Gouda (Hong Kong), Dev Bhadwadj (Indi), G. Mend Ooyo, Tumenolzii Erdenetsogt dhe Hadaa Sendo (Mongoli), Andreas Cruchaga (Salvador), Luis Arias Manzo, Anders Morales (Kil), Hector Zabala (Argjentinë), Zeilton A. Feitosa (Brazil), Chika Onyenezi (Niger).

Dedikimi
dhe në kujtim
të Prindit,

babait tim të ndjerë; Behajdin Shehut,
i cili në trashëgimi më la një bibliotekë të begatë librash,
që i mori zjarri i gjenocidit Serb.

PARAFJALA E AUTORIT

Këto pjesë janë shkruar për një periudhë më të gjatë, se dhjetëvjeçare pa marrë parasysh gjatësinë e ditës dhe orët e errëta të natës, pa rrymë dhe me të ndonjëherë. Këtu kemi një përpjekje, që të transmetohet dija dhe përvoja e akumuluar, observimet e mia, diskutimet me intelektualë dhe shkëmbimet e letrave, që janë transformuar në fjalë, në dobi të lexuesit.

Në rast se do të haset ndonjë perceptim për mbikualifikimin e vetës, paraprakisht kërkoj ndjesë, por meqë nga Vetja askush nuk ka mundur të ikë, dhe Vetja me Vetëvetinë e saj manifestohet në cilëndo formë, ndodh, që mund të jetë më e dukshme, se sa ishte qëllimi fillestar.

Ju faleminderit
Fahredin Shehu

PARATHËNIA

Ky libër paraqet punën disavjeçare në prozë, ca të botuara nëpër gazeta e revista, kurse pjesa dërrmuese botohet për herë të parë.

Përzgjedhja është bazuar kryesisht në qasjen dhe observimet e Fahredin Shehut, përkitazi me problemet me, të cilat ballafaqohet një individ, besimtar, lexues, artist, shkencëtar, publicist.

Ca punime janë tipike shkencore, kurse të tjerat më shumë publicistike, si refleks të njohurive të akumuluara dhe vullnetit për të shërbyer. Lexuesi mund të hasë në gabime të paqëllimshme për çka autori është plotësisht i vetëdijshëm, se mund t'i ndodhin secilit gjatë procesit të punës.

Ta kujtojmë Nietzsche-n *"...çdoherë ai, i cili e ka kulluar politikën në kafe ka qenë më i mençur, se burrështeti dhe çdoherë ai, që as gishtin e vogël nuk e ka lëvizur, ka kritikuar atë që punon"*.

Ka edhe lëshime të qëllimshme, që lihen për të nxitur debate dhe për ta mbajtur librin të gjallë, interaktiv, jo një testament letrar, por fjalë të gjallë, dinamike.

Është e natyrshme, se secila epokë i ka tiparet e veta dhe e gjithë liria kreative kufizohet me mure të epokës përkatëse, prandaj, secila çasje, mbetet relative në kuitesencën e sajë.

Nga tendenca më e pastër, për ta transmetuar, filtruar, manifestuar e debatuar rreth një nocioni, koncepti apo entiteti epistemologjik në formën më të artikuluar janë, pikërisht, shkrimet në relacion: ART- FE- DASHURI, si trinom i pandashëm, i cili

shtrihet përgjatë të gjitha germave të këtyre trajtesave, prandaj edhe trajtesat kanë herë-herë konotacion poetik (kur për këtë ndjehet nevoja, respektivisht në ...*mungesë të vokabularit adekuat tokësor për çështje qiellore* - siç thotë autori), herë-herë trajtesa fillon me poezi. Gjë, që në këtë kontekst po e dallon librin si vepër unike nga aspekti i zhanrit.

As fotografia a ndonjë diagram i mundshëm nuk e ngarkojnë, por janë pjesë komplementare të buqetës.

Po të kishte mundësi ta orkestronte këtë libër, apo t'i fusë edhe tinguj dhe aroma edhe këtë do ta bënte, por për një libër të tillë të dëshiruar duhet të presim edhe ndonjë dekadë shkencoro-teknologjike, për të pasur transformimin e idesë në multimedia dhe më shumë se kaq, nëpërmjet artit të të shkruarit, që të arrijmë në një reflektim sa më të plotë kreativ.

"Makadami i smagradtë", është një titull më poetik, se sa publicistik e shkencor dhe pikërisht, kjo i jep notën e epërme, të mesme dhe notën bazë poetike, të gjitha trajtesave të tubuara në këtë buqetë, sikur tek një parfum cilësor.

"Makadami i smagradtë", për ne, simbolizon rrugën nëpër, të cilën rrallë kalohet. Ne dijmë për Makadamët e përhimtë nga gurët e thjeshtë. Ky i yni është i shtruar me Smagrad është rrugë e dijes dhe kërkimit.

Në kalimin nëpër këtë libër, vërehet freskia në shputat e këmbëve, të cilat ndjejnë vesën/perlat, feksjen e hënës dhe vetimin e diellit/rrezes.

Po e përsërisim siç kishte bërë edhe vetë Autori, për të satën herë, Goethe-n: *"Del, se shumica e librave janë shkruar që të tregojnë sa di autori, e pak libra janë shkruar ta mësojnë lexuesin"*.

"Makadami i smagradtë", krahas, që është shkruar, që ta mësoj diç lexuesin me poetikën e tij... do ta do ta ekscitojë dhe emocionojë atë.

Visar Korenica
Janar 2012, Rahovec

MAKADAM I SMAGRADTË

Kalova nëpër
Kanionet e ngushta të trurit,
derisa dëgjoja odet e qelizave të moshuara;
ngadalë duke vibruar.
...dhe rrëshira e freskët e pishës, likeneve dhe
ozoni i pastër fryen flokët e mi.
brenda hundës
Mbushën alveolet e gatshmë që të shpërthejnë
nga kënaqësia e papërshkrueshme.
Dëgova tinguj të pikëlimit të gjakut
nga shputat e mia të lënduara,
duke lënë gjurmë të shpirtit të etur…
për
Dije, Urtësi, Përndritje,
Ngadalë tek përkulet para Perendisë
Vetëm nga ne të quajtur DASHURI
Na makadamin e smagradtë të udhërrëfej
procesionit përcjellës të krijesave.
Nga Oktavat Gurdijeffiane
Të cilat si fiku i artë lulojnë nga brendia.
Ti mund ta quash derdhje pasioni
dhe nuk gabohesh .
Mund të më quash lanolin i ekastraktuar nga merino
dhe nuk do të gabohesh.

Mund të më quash ushtar i thyer i porcelanit
dhe nuk do të gabohesh.
Mund të më quash bletë, e cila thith nektarin
nga mijëra trëndafila
dhe nuk do të gabohesh.
Mund të më quash topaz i verdhë;
fëmijë karboni,
dhe nuk do të gabohesh.
Mund të më quash petale e rënë
e trëndafilit të bardhë
dhe nuk do të gabohesh
Mund të më quash besimtar, i cili lutet
për mëkatet e shumësisë humane
dhe nuk do të gabohesh.
Mund të më quash njeri, i cili përzihet me engjëj;
i pavetëdijshëm për pafajshmërinë e vet
dhe nuk do të gabohesh,
por unë di!
E di se shpirti nuk ka gjini.
Erës i mungon ngjyra.
Bari ngjyroset me të gjelbërta nga shiu i pabojë.
Alkimia është transformimi i qumështit të nënës në gjak.
Parajsa është natyrë, njeriu është Ferri,
por nëna është zot në Tokë dhe në Qiell.
Kështu mezi jam njeri.


GJËRA
TË DUKSHME
DHE
TË PADUKSHME

LEUKEMIA E FLUIDIT KREATIV

Arti i lejon të vërtëtës të gufojë

Teurgjia i lejon të vërtetës, ta shfaq madhështinë e bukurisë së realitetit kosmik.

Në literaturën hermetike, janë shumë të njohura; Tabula Smaragdina (Rrasa të smagradit) dhe ka disa edicione të Tabu-



Tabula Smaragdina (Rrasa të smagradit)

lave. Tek unë kanë mbërritur disa dhe më i përshtatshëm për mua është edicioni i Idries Shah.

Pas shumë vitesh, Fluidi i shëndoshë kreativ sajoi Tabulat e NUN-it.

Nun-i është fillimi i procesit kreativ, i cili do të shpaloset në trajta të ndryshme, është emri i inteligjencës kosmike, hija Jungiane në planin terrestrial i manifestuar tek ne.

Rrasa Smagradi të NUN-it

Lindja është fillimi i panumërt.
Qielli flet në gjuhën e Dashnorit.
Dashuria është lart, poshtë, përpara, pas dhe fle në zemër.
Ti je fillimi.
Çdogjë ekziston çdogjë që mendja e merr të gatshme.
Dhimbja shpërblehet me Dashuri.
Lumturia është SEX i përndritur.
Gënjeshtra e zhvesh të vërtetën si dhëndrri nusen.
Transformimi i qumështit në gjak është Alkimi më reale.
Poezia çel në zemër dhe flet si engjëll, si ngjyra e zezë në të bardhën.
Zoti të flet vetëm me Akt.

...sepse NUN-i ka më së shumti të drejtë të flas, me tone të tilla, që stimulojnë indet e lëmueshme të miokardit, që vibrojnë, duke prodhuar infra-akustikë.

Në Perëndim nga Aristoteli e deri tek De Bono, nuk kishte logjikë multidimensionale apo pentaklore. Tek Gurdijjeff hasim në Oktava dhe dështimin e Kantit, respektivisht dioptrisë së dobët, që t'i vërejë oktavat e tij; sipas Ouspensky-t nuk ka tonalitet.

Ashtu si prej Aristotelit deri tek Bertold Brecht nuk kishte Dramë asimpatike.

Solomon Renak vëren dy lloje të ndryshme të qasjeve, dy tendenca të ndryshme. Derisa Egjiptasit e vjetër përgatiten për

botën nëntokësore, pas vdekjes, të krishterët në epokën Gotike ngriten, ekzaltohen shpirtërisht kah qielli.

Tek ne nuk ka mjellma të Islandës, Bella Hamvasz sakaq më goditi me këto.

"Në Islandë jetojnë një lloj specifik i mjellmave, të cilat në mënyrë enigmatike, në periudha të caktuara kohore fillojnë të këndojnë – para vdekjes së tyre – thuhet së vdesin duke kënduar.

Çobanët Islandez konsiderojnë, se ai, i cili i dëgjon këto mjellma, do të dijë krejt çka nuk ka ditur dhe do t'i harroj të gjithat, që i ka ditur".

Fakti se nuk kemi libra edicion xhepi flet si kambanat; shumë zëshëm, fakti se lulet kanë çelur e nuk i erëmojmë se jemi ftohur, fakti se reziduumi kreativ të djeg njëlloj si afrimi i tepërt kah dielli, fakti se makulatura letrare si leukocitet e stërprodhuara e ngulfatin gjakun, flet hapshëm për dhunimin e produktivitetit masiv, agresiv.

Një vrushkull i tillë i krijimtarisë kancerogjene, rezulton në shuarjen e dinamikës, bukurisë, harmonisë, dhe shëndetit të tërësisë artistike, e si mund të krijohet pa dashuri?

Pa dashuri arti degradohet në zanat.

Si mund të krijohet pa dashuri, çiltërsi, sinqeritet?

Me deficit të këtyre, arti jeton jetën e mizës, shijon ëmbëlsinë vetëm në cipën e sipërisë.

"Të gjithë e dijmë se, personi i mirë mund të jetë artist i keq, por askush nuk do të jetë artist i vërtetë, nëse nuk është qenie njerëzore e mrekullueshme dhe poashtu e mirë"- Marc Chagall.

Dhe kjo e Chagall-it, na shpie tek Peit Mondrian: *"Secili artist kërkon të arrijë harmoninë nëpërmjet balancit të marrëdhënieve mes vijës, ngjyrës dhe planit. Por vetëm në mënyrën më të pastër dhe më të fuqishme".*

Qëllimisht i përdor thëniet e piktorëve, sepse piktura në formën më vizuele reflekton idenë dhe nuk të lë të hamendesh si muzika apo poezia.

Vetëm me dashuri arti krijon harmoni dhe mbishtreson në harmoninë kosmike. Arti krijon një harmoni mbi tjetrën, në tendencën e rutinës, që të krijojë kaos.

Sepse, njeriu është çdogjë, pos asaj me të cilën manifestohet. Në artin objektiv, spjegon Osho, njeriu ejakulon çiltërsinë më të madhe spermatozoidin kreativ, njëlloj si spermatozoidi është qelizë më fisnike e trupit të njeriut; Animus tipik i Jung-ut, i cili furishëm kërkon Anima-n, për ta formuar Zigotin, njëlloj si vepra (Animus), e cila furishëm e kërkon receptuesin (Anima), për t'u bashkuar në Zigot, që përkthehet si balanc, harmoni, satisfakcion, vazhdim i llojit.

Pikërisht shija e receptuesit krijon elementalin e ri, diçka kosmike, Pëlqimin, diçka me domethënie kryesisht të re, tërësisht virtuale.

Për gjithë këtë duhet të ketë sikronicitet dhe impuls kosmik.

Një pemë e emancipuar, lulet e saja janë hermaphrodite, të kompozuara nga dy sekset; poleni (mashkullore)dhe stigma (femërore). Impuls në këtë rast është esenca /parfumi, të cilin e liron lulja për të tërhequr receptuesin, insektin, shpendin (kolibri), që t'i shkund polenët për të rënë në stigmë, e për ta krijuar zigotin (frytin) dhe pas kalbjes së tij edhe farën - vuajtjen - dhimbjen, për ta vazhduar llojin, entitetin e ri.

Në Afrikë natyra e pajisi një lloj specifik të bimës, e cila për t'i tërhequr kondorët, që ta polenizojnë, ajo kundërmon në mërshë (mishë të kalbur) - impulsi këtu është kundërmimi.

Në shumë raste tek artistët fama ose paraja (bruimi i fuqisë),bëhet impuls për të krijuar. Kjo ndodh në art, por jo edhe në Teurgji. Për Teurgjinë nga Iamblichus (njëri nga katër banorët e shpellës- shih: Kur'an, Drama e Teufik Al Hakim-it, Danillo Kish), e deri tek Berdjajev, nuk kishte kontinuitet të krijimtarisë apo estetikës teurgjike.

Arti duhet të emancipohet në Teurgji. Është koha. Njerëzimi arriti fazën e pjekurisë.

Se, a do të ushqehemi me farë (fëstëk, lajthia, nugat, kikiriki), në 1000 vite të ardhshme, mbetet të shihet.

Se, a do ta emancipojmë Artin në Teurgji, ashtu si e emancipuam zanatin në Art, mbetet të shihet.

Se, a do të shërohemi nga leukemia e fluidit kreativ, do të mbetet të shihet.

Përgjigje në pyetje të tilla mund të jep vetëm Revelata, kështu të përmbyll një cikël, ta bëj një plotëni. Një cikël të ZEN-it.

Apo katërkëndëshin, erekcionin e vërtetë në art, jo kopie naïve të natyrës dhe deformim; sipas Kasimir Malevich.

MBI LIBRIN

Nuk e kam qëllimin ta definoj librin. Për këtë ka shumë mendime dhe rëndësia e tij, fatkeqësisht, tek ne po bie dhe as që ta shkruaj historikun e tij.

Unë librin e shoh si bankë për deponimin e përvojës, situatave jetësore, dhe krejt çka njerëzimi ka bërë, e ruan në libër.

Libri është trashigimi dhe pajë e shtrenjtë, të cilën e përcjellim nga gjenerata në gjeneratë.

Po pse flas për librin në këtë libër është çështje tjetër.

Koncepti Islam i librit kosmik në, të cilin janë të shkruara të gjithat, që kanë ndodhur, që po ndodhin dhe që do të ndodhin (krahaso me filmin "Matrix") është i njohur si Lehvi Mahfudh - apo "pllaka e ruajtur mirë".

Kësaj teme do t'i kthehem më vonë. Çfarë rëndësie ka libri për shpirtni.

Janë shumë të njohura Hagiografitë (përshkrimi i jetës së të shenjtëve në krishterimin e hershëm), të cilat shfrytëzohen si mostra të shkëlqyeshme për zhvillimin shpirtëror, si dhe thëniet e etërve krishterë të shkretëtirës së Egjiptit, shkrimet Kopte.

Thomas Merton - "Urtësia e Shkretëtirës", njëri nga të shenjtit e Amerikës bashkëkohore, i ka përmbledhur thëniet e etërve kishtar të shkretëtirës, të cilët në mënyrën eremite të jetës, me devotshmëri dhe moral të lartë dhe shpirt të pastruar, japin shembuj më të mirë të shpirtnisë krishtere.

Shejh Attar-i i Persisë, para disa shekujsh ka bërë një përmbledhje të shkëlqyeshme të urtësisë Islame duke përshkruar jetën, fjalët, veprat e 22 evlijave (të shënjtëve) Islam në librin Tadhkirat al Avvliya - Përkujtimet e Evlijave.

Librat e këtillë duhet t'i lexojë secili aspirant në rrugën e përsosjes shpirtërore. Involucionit.

Vetë Rumiu deklaron se librat e Attarit kanë ndikuar në të, pra në asnjë mënyrë nuk duhet të tejkalohet Mesnevija e tij, e cila pas Kur'anit dhe Hadithit, në Islam zë vendin e tretë për kah lexueshmëria.

Në Perëndim, R. A. Nicholson, orientalisti anglez e bën përkthimin e Mesnevisë në gjuhën Angleze dhe në këtë mënyrë e popullarizon atë.

Libri i Romain Roland - Jeta e Sri Ramakrishnës - është një libër i shkëlqyeshëm që të kuptohet rruga ose Shkolla Hinduse e Bhaktas, apo arritjes së Realitetit abstrakt, nëpërmjet Dashurisë, që tek në është e njohur si Dashuri Platonike.

Pra Ramakrishna është një Bhakta tipik, prandaj Osho Rajneesh; Ramakrishnën e vendos në zonën e zemrës, kurse Buddhan, në zonën e Plexus Solaris.

Taoistët i vendos në zonën e shputës, kurse vetën në Kokë.

Osho assesi nuk duhet të tejkalohet, sepse në fjalimet e tij të përmbledhura në mëse 700 libra, aspiranti kupton krejt dinamikën e mendjes për një mbi-burim për mileniumin e ri, ku dituria intelektuale dhe ajo intuitive, paraqesin dy krahë të balancuar mirë, për të arritur unifikim me rendin kosmik.

Të kuptuarit solid të urtësisë së lashtë TAO, më së miri arrihet duke lexuar Lao Tze dhe librin; Misteri i lules së art.

Kurse për problematikën dhe dilemën e vdekjes, duhet doemos të lexohet Libri Tibetan i të vdekurve. Libri, i cili më se 2000 vjet nuk ishte shkruar, por është përcjellur gojarisht; ngjashëm me poezinë klasike arabe të periudhës para Islame.

Për ta kuptuar botën e shpirtnisë Induse, pashmangshëm, duhet të lexohet Bhagavad Gita, ndërsa për shpirtnin Egjiptase, opusi i Sir Wallis Budge, paraqet thesar të vërtetë.

Shpirti i Persisë së lashtë është ruajtur bukur në Avestën, e cila i përshkruhet Zarathustrës, kurse atë të krishtere, në Librat e Balthazar Gracian, San Juan de la Cruz, Maister Eckhart dhe Emanuel Swedenborg.

Sa i përket Islamit, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim, të gjithë hulumtuesit shpirtnor pajtohen, se Ibn Arabi paraqet kulmin e asaj, që ka mundur të ruhet në libër.

Është shumë me interes edhe Urtësia e dritës nga Suhrawardi dhe Picatrix nga Maslama Al Magritti, i fundit, më shumë është libër grimuar (libër formulash) dhe më shumë kalon në anën e komunikimit supranatyral dhe atë paralel.

Për gjithë traditën hebreje, veprat e Gerschom Scholem dhe Abraham Joshua Herschel, janë të patejkalueshme.

Mbi Lehvi Mahfudh (pllaka e ruajtur mirë apo Libri i formave)

Sipas dijetarëve - mistikëve Islam, ekzistojnë katër pllaka (Lehv), e ato janë:

Lehv- i Kaza - ku janë të regjistruara çdo gjë, që duhet të ndodhë. Kjo pllakë quhet edhe Kaza-i Sabika, ose përcaktimi i parë dhe Akl-i Kul- ose Mendje Absolute, Hakikat-i Muhammedijje, ose Esenca e Muhamedit, Kalemi Eala - ose Penda më e lartë dhe Ummet-ul Kitab - ose Libri Amzë.

Të gjitha këto pesë emërtime kanë të bëjnë me përcaktimin e parë dhe bazohen në hadithin e Muhamedit, i cili thotë:

"E para, që Allahu krijoi është Mendja, në pajtim me paramendimin e të padukshmes".

E para, që Allahu krijoi është Nur - Drita, në pajtim me krijimin në përgjithësi,

E para, që Allahu krijoi është Ruh - Shpirti, në pajtim me manifestimet në jetë.

Pas asaj, që është shkruar dhe gdhendur në Përcaktimin e parë, nuk mund të ndodhin kurrfarë ndryshimesh.

Lehv-i Kader - Pllaka e fuqisë. Gjërat, të cilat janë regjistruar në përcaktimin eparë, këtu janë përshkruar dhe prezantuar më detajisht. Kjo pllakë i ka edhe dy emra tjerë e ato janë: Lehvi Mahvudh- Pllaka e ruajtur dhe Nefs-i Natika- ose Fryma, e cila flet.

Lehv-i Nufus - Pllaka e statistikës. Këtu janë paraqitur sasitë, cilësitë dhe modalitetet. Çdogjë këtu paraqitet në form tredimensionale.

Lehv-i Hujela - Pllaka e përshtatshmërisë dhe aftësisë, ku tregohet, sa është individi në gjendje të mbajë dhe durojë. Atë që harfi (fytyra e tij) mund ta durojë. Lehvi i katërt i takon Alemi Shehadetit apo Botës së dukshme, kurse tre Lehva të parë i takojnë Alemi Gajbit - apo botës së fshehtë.

Lehvi i parë është si shpirti, i dyti si zemra, i treti është si truri, kurse i katërti është si funksionet e organeve të trupit.

Germat janë si enët e gjakut, kurse domethëniet janë si si uji në enë.

Krejt kosmosi është si fjalët, të cilat janë të përbërë nga germat.

Zoti vetëm thotë bëhet dhe ajo ndodh deri në saktësinë më të madhe.

Po, këtë po e vënë poezinë "Behët", e cila botohet në përmbledhjen time poetike "Kun" të Botuar nga Logos-A Shkup.

Bëhet

Larg të kam
Kujtimi më vie si dritë ylli
Shurjen e të cilit
Dot s'e besoj
Kështu më ka bota
Të hutuar
Tek pres flladi
Ta freskoj
Vesa

Këtë trup zemre të huajsuar
Këtë buzë që thahet
Kur e thotë atë emër të bukur
Gjuha thahet
Ajo çahet
Balsam është vetëm prania si epifani
Por larg edhe nga kjo
Ajo çka gjuha dot s›e thotë
Ajo është
Kjo do të bëhet
Mrekulli e përherëshme
Fjalë e Perëndisë
Kur thuhet BËHET
Ajo bëhet
Unë
Bëhem
Ajo
Dhe nuk më ka

***

Në momente të caktuara të kësaj rruge të gjatë dhe të mundimshme, libri vetvetiu tejkalohet dhe mësimet, instrukcionet mirren verbalisht në komunikim të drejtëpërdrejtë nga instruktori, ku do që, ai të ndodhet dhe pa marrë parasysh nga cili burim vjen ai, sepse në tërësi burimi është Një, ai primordial dhe e ka qëllimin dhe destinacionin e njëjtë.

Si shembull për këtë në botën bashkëkohore po e cek rastin e Pir Ziya Inayat Khan, i cili është njëri nga mësuesit më prominent shpirtëror në Amerikë. Është i biri i Hazrat Inayat Khan-it, Sufiut më të famshëm të shekullit XX.

Pir Ziya, instrukcionet i merr edhe nga Dalai Lama i fundit, krahas mësimeve të shkencës Sufi të babait të vet.

Pastaj rasti i Alister Crowley, i cili është inicuar tek një shejh në Marok, rasti i Çedomil Veljaçiq, i inicuar në Budizëm.

Në kërkim të rrugës së Absolutit, njeriu kërkon në traditën e caktuar shpirtërore varësisht nga afiniteti i tij dhe këtu nuk guxon të ketë mospajtime, sepse kjo është edukim i llojit të veçantë; Andragogjik.

Rasti i Rumiut, i cili ishte musliman dhe arriti kulmin e asaj që mund të arrijë njeriu modest - rrugën e tij Sufi e përfundoi në rahmetin e Isaut a.s., sepse kishte afinitet të këtillë.

Meqenëse kjo është teme në vete po e përfundoj me kaq.

MBI SIMBOLET

As jam i pari e as i fundit, që flas për simbolet. Ekziston drejtimi në letërsi i njohur si; Simbolizmi, për simbolet është folur, shkruar dhe menduar shumë.

Çështja e simboleve në rrafshin shpirtëror është problem, i cili më preokupon në këtë shkrim.

Ne jemi rrethuar me simbole dhe një jetë pa simbole; do të ishte e pamundur si në të kaluarën, ashtu edhe tani.

Më parë kam folur për të folurit dhe aty është spjeguar mjaft, por pa simbole një mendim, një ide, një përvojë nuk do të ishte e mundur të transmetohet, qoftë me fjalë, e cila është e përbërë nga germat - simbolet, qoftë me imazh - prapë simbol, i cili ruan kuptimin e idesë, ndodhisë, përvojës.

Edhe gjatë të folurit, shpesh përdoren simbolet për ta arritur komunikimin më të mirë dhe më kuptimplotë, e shpesh simbolet përdoren për ta fshehur një domethënie nga masa e gjerë.

Suma Summarum, simbolet burojnë nga Sakralja, pra, pothuaj të gjithat, po me kohë, sakralja profanizohet pastaj njerëzit i kategorizojnë ato në simbole: sakrale, profane, shkencore, gjuhësore, metafizike, psikologjike dhe të gjitha emërtimet e mundshme, që gjatë historisë i ka zbuluar evolucioi intelektual i njeriut.

Ajo, që sot është mistike, nesër bëhet shkencore, ajo, që sot është sakrale, nesër bëhet profane.

Natyra e simbolit është ta burgosë, ta konzervojë idenë dhe si i tillë, në perceptimin tonë ai ngjallet po qe se e kuptojmë idenë, e cila në të është e kristalizuar.

I kemi të njohura ideogramet kineze, simbolet e shkrimit egjiptas - hieroglifet egjiptase, piktogramet e Escher- it, Arabeskat, Runet, Simbolet e planeteve për astronominë e hershme, simbolet alkimike, simbolet kromatike, simbolet e Tarotit, simbolet kimike, simbolet e sistemit binar-digjital, simbolet fetare ato të organizatave sekrete, pastaj simbolet kombëtare, shtetërore, topografike, teologjike, telekomunikuese e shumë e shumë të tjera pa të cilat i gjithë sistemi i vlerave dhe të arriturave intelektuale dhe shpirtërore të njerëzimit, do të çrregulloheshin.

Natyra e simboleve është provokuese dhe ato paraqesin idenë e kompresuar në një hapsirë të vogël, në një imazh, i cili shfrytëzohet për ta ringjallur kujtesën; për proceset e vetëdijes, ndërdijes, arketipeve, të vetëdijes kosmike etj.

Natyra e simboleve është infrasonike, si ajo e ëndrrës. Për ëndrrën do të flas në një trajtesë tjetër, të veçantë.

Atë çka ne e shprehim me fjalë, simboli na flet me imazh.

Gjuha e simbolit është piktografike është ëndërrore, derisa jemi esull.

Kënga si simbol.Tani, secili shtet krahas objekteve simbolike si: monedha, flamuri dhe ngjyrat e tij, stema etj., doemos e ka edhe himnin shtetëror me të cilin identifikohet.

Dikur himnet ishin këngë, të cilat u kushtoheshin perëndive, pra diçka që, dikur ishte sakrale, tani është profane.

Pastaj këngë të caktuara, kur popullarizohen, bëhen simbol i një gjenerate të caktuar, lëvizjeje shoqërore të caktuar p.sh. kënga "Imagine" e John Lenon-it për gjeneratën Beat dhe Internacionalja për idealin komunist apo Ezani si simbol melodik i Islamit.

Monedha si simbol. Çdo monedhë paraqet simbol të shtetit të caktuar, e tani një monedhë e caktuar, merr përmasa edhe të një kontinenti.

Secila monedhë paraqet objekt të ngurtë simbolik të një shteti të caktuar, e cila është e përbërë nga simbolet dhe imazhet e figurave emblematike të atij shteti.

Shumë monedha përmbajnë simbole sakrale dhe profane, të cilat varirojnë në sasi dhe cilësi. Rasti i dollarit Amerikan është, pothuaj, unik më përmbajtje mistike, me simbole sekrete të shoqërive sekrete të traditës Judeo-Kristiane.

Talismani si simbol. Është term me prejardhje arabe nga Tilsim dhe paraqet imazhin me efekt suprasenzibil.

Talismani po ashtu është term, i cili asocon në shpirtëroren, i cili është i kompouar me mjeshtri, për të zgjuar një efekt të natyrës së panjohur (Lexo: Magjike).

Pothuaj të gjitha kulturat shpirtëore i kanë zhilluar talismanet e veta. Thuhet se për herë të parë, ato janë përdorur në Egjiptin e lashtë, por ato janë përdorur edhe në Greqi, Kinë, Indi, Judea, Arabi etj.

Talismani punohet në letër, pergamen, kristal, metale të ndryshme, eshtra të shtazëve etj.

Ekzistojnë teknika dhe mjeshtri të ndryshme për përpunimin e talismanve si:

- Talismanet duke përdorë katrorë magjik me numrat që barazohen,
- Talismanet në mëndafsh, ku shkruhen shifrat - vulat engjëllore me ngjyra me prejardhje bimore, shtazore dhe sekretet njerëzore.
- Talismanet të drurit, duke përdorur figura të dyllit, ku shkruhen shenja të ndryshme - simbolet. Një talisman të këtillë e punoi Aristoteli, mësuesi i Aleksandrit të Madh. Në betejat e ndryshme Aleksandri i Madh natën e vendoste këtë kuti prej druri në dhé dhe ai territor shumë lehtë okupohej nga ushtria e tij.
- Talismanet në metale të ndryshme ku gdhenden simbolet e caktuara, pra Talismanet janë simbole tredimensionale për dallim nga simboli-imazh".

MBI ËNDRRAT

Roli i ëndrrës në psikologjinë personale

Duke e përcjellë produktivitetin e shpirtënisë humane, që nga kohërat e lashta e deri më sot, hasim në shumë korrespondenca dhe pothuaj asnjëra nuk është në kundërthënie me njera tjetrën, madje shpesh njëra-tjetrën e plotësojnë, apo e mbindërtojnë.

Në këtë kontekst ëndrrat paraqesin kurs të rëndësishëm të emancipimit shpirtëror individual, "Ëndrrat janë një e dyzeta pjesë e profecisë"- Hadith, dhe ekzistojnë procedurat e mirëfillta, që udhëzojnë hap pas hapi regjistrimin e ëndrrave dhe dokumentimin e tyre në ditarë, që më pastaj të bëhen analiza të mirefillta të progresin në fushën e arritjes shpirtërore.

Jo vetëm ëndrrat, por edhe vizionet në zhgëndërr regjistrohen, që më pastaj të reflektohet mbi domethënien dhe progresin potencial të individit.

Ashtu si nuk ka njeri, i cili nuk konsumon ushqim po ashtu edhe nuk ka njeri, i cili nuk ëndrron, dhe kjo është pjesë e pandashme dhe ekzistenciale e tij. Ky fenomen, në shumë raste e luan rolin e balancit edhe rolin shpëtues, për frustrimet dhe për dëshirat e parealizuara, andaj ato e meritojnë një tretman më të denjë.

Zakonisht problemet hasen në të kuptuarit e tyre, që e ka si pasojë mosnjohjen e vetes dhe dëshirave të fjetura, të cilat shtresohen në ndërdijen tonë.

Ashtu si për çdo derë nevojitet një çelës, ashtu si për çdo pasqyre nevojitet lustrimi për ta reflektuar pamjen, ashtu si për çdo punë nevojitet vegla, po ashtu edhe ëndrra kërkon mjeshtrinë e interpetimit dhe njohjes së kodeve, të cilat do ta dekodojnë një mister, i cili shkencërisht vështirë që mund të përkthehet në gjuhën e kuptueshme.

Shkenca e sotme ka arritur të regjistrojë momentin kritik, REM, të ëndrrimit, i cili zgjat disa çaste para zgjimit, pavarësisht a është në mëngjes apo në çfarë do kohe të zgjimit, por jo edhe vetë ëndrrën, atë duhet ta rrëfejë ëndrruesi dhe kjo në varshmëri sa është në gjendje ta memorizojë.

Në ëndërr çdo gjë është e mundur, çdo formë dhe trajtë, çdo ngjyrë dhe vibrim, pra ajo është plotësim i asaj, që inkibohet në zhgëndërr dhe asaj, që nuk mund të realizohet në momentin e zgjimit, duke mos dashur ta analizojmë këtu zgjimin, të cilin ne e njohim e për të cilin Gurdijjeff thotë se është gjysmë-gjumë dhe për zgjim të vërtetë duhet një shok, një tronditje më e madhe, një zgjim real.

Impakti i ëndrrës në organizimin shoqëror ka qenë i madh dhe ende vazhdon të jetë, por gjërat e tilla shpesh janë të heshtura. Mos të harrojmë, se Ajnshtajni në moshën 19 vjeçare e deklaroi Teorinë e Relativitetit, formulën e, së cilës e kishte parë në ëndërr, po ashtu nga temat Biblike, shih Librin e Danielit dhe ëndrrën e mbretit Nabukodonozor, pastaj Interpretuesi i ëndrrave ishte edhe profeti Jozef në pallatin e Faraonit Egjiptian, ku ëndrrën e tij e pikturon për mrekulli Vincent Van Gogh, me yjet, që simbolizojnë vëllezërit e Profetit Jozef.

Korpusi psikoanalitik

Askush deri më tani nuk e vuri në dilemë fondin e Frojdit, por askush deri më tani nuk u pyet për burimin e koncepteve frojdiane.

E gjithë trashëgimia frojdiane sumarizohet në një koncept, në atë të Phallus-it, i cili është konsumuar me shekuj, si në kulturat Perëndimore, e veçanërisht në ato Lindore. Krejt Tantrizmi si produkt i arealit Hindus, përqëndrohet në YONI dhe LINGAM, pra në Vaginë dhe Penis, si simbol i krijimit. Andaj dëshirat e parealizuara seksuale, më së lehti realizohen në të ashtuquajtura ëndrra të qullta. Për një realizim të tillë seksual, janë zhvilluar teknikat dhe pozat nga më të llojllojshme, të cilat na i zbulojnë Kaliyana në Kama Sutra dhe Vatsyayana në Anangaranga, të cilat për kulturat tjera mund t'i takojnë domenit ëndërror.

Ne kemi gjetur korrespondencat në librin e intrepretimit të ëndrrave të Frojdit me atë të Ibn Sirrinit, i cili ishte Abir apo interpretues i ëndrrave, dy gjenerata pas Muhamedit, profetit të Islamit. Ajo çka mendojmë, se është e rëndësishme të ceket, se po ky koncept i Phallusit është evident si tek Frojdi ashtu edhe tek Ibn Sirrin, pra objektet si Lapsi, Shpata, Shigjeta, Karrota, Trangulli, janë simbole të Phallusit.

Si Frojdi, ashtu edhe Jungu, dëgjuan shumë njerëz/pacientë dhe i regjistruan ëndrrat e tyre, për t'i analizuar ato më vonë dhe për ta formuar një vokabular ëndrrash, që më vonë do t'i shfrytëzojnë si kode për dekodimin e domethënies së ëndrrave më të shpeshta.

Në interpretimin e ëndrrave, rëndësi të madhe i është kushtuar gjendjes së ëndrruesit, stinës së vitit, pastaj mbi të gjitha simbolet, trajtat, perceptimet e ëndrruesit gjatë ëndrrimit, ngjyrat, numrat, shtazët, krijesat inekzistente etj.

Ëndrrat në arte

Në krijimtarinë njerëzore, ëndrrat gjithmonë kanë luajtur rol krucial, në Letërsi e veçanërisht në Pikturë dhe Arkitekturë.

Interpretime të ëndrrës në trajtë letrare i hasim në letërsi, të Blake, Rumi, Defoe, në pikturë të Hieronimus Bosch, Salvador Dali, Pablo Picasso, Vincent Van Gogh etj, në arkitekturë tek Reem Koolhas, Zaha Hadid e kështu me rradhë.

Emrat, që i përmendëm janë dëshmuar në fushat e tyre të artit, duke e shfrytëzuar mediumin e tyre artistik më së miri, për ta materializuar ëndrrën e tyre.

Duke krijuar, kështu, harmoninë në mes të reales dhe ëndrrores, ne i lexojmë librat apo shikojmë objektet, të cilat burimin e kanë në një lloj specifik të gjendjes psikike, të cilën e kemi emërtuar ËNDRRA.

Konkluzion

Ky ishte një vështrim më i shkurtër i mundshëm, që t'i hidhet një tufë dritë një fenomeni me të cilin po ballafaqohemi çdo ditë (nëse flejmë gjatë ditës), dhe çdo natë, respektivisht.

Çdo paragraf i këtij vështrimi, kërkon një përpunim më të zgjeruar dhe më spjegues dhe meritor, mbi këtë fenomen të pandashëm ontologjik human.

Me sipër kemi përmendur, se nuk ka njeri, i cili nuk sheh ëndrra, andaj qoftë ai besimtar apo jobesimtarë, ai ballafaqohet me diçka të paspjegueshme dhe kërkesat e parealizuara ëndrrore për, të cilat nuk jemi të vetëdijshëm e, të cilat nuk i plotësojmë, nga jeta jonë, krijojnë tapiceri shumëbojëshe dhe lënë zbrazëtira të paarnuara të individualitetit tonë.

MBI LINDJEN DHE JETËN

Profesor Namkhai Norbu Rinpoqe- Tibet

Trëndafili i hapur pos, se është i bukur, është edhe i këndshëm duke të dehur me aromën qiellore, qetë duke ta pështpëritur fshehtësinë.

Fahredin Shehu

Hapja ndaj kulturave dhe traditave tjera është çast fillimisht kurreshtjeje, magjepsjeje, argëtimi dhe kompromisi. Më ra në dorë një libërth i mrekullueshëm i Profesor Namkhai Norbu Rinpoqe, i cili flet për lindjen, zhvillimin e fetusit, kujdesin e nënës dhe krejt traditën Tibetane për kujdesin holistik, organik dhe shpirtëror të njeriut. Libri doli me rastin e Kongresit të Parë Ndërkombëtar mbi Mjekësinë Tibetane, të mbajtur ne Venedik më 26-30 prill 1983.

Namkhai Norbu Rinpoqe është mësues shpirtëror (Lhama) i traditës së lashtë tibetane, të njohur si Dzogchen ose Atiyoga. Më 1960 Orientalisti Italian Guissepe Tucci e ftoi në Romë, që bashkarisht të punojnë në Institutin për hulumtime të Lindjes së Afërme dhe të Largët (ISMEO). Vazhdon të ligjëroj në Institutin e Orientalistikës në Napoli .

Libri mbi Lindjen dhe Jetën ka dal si përgjigje e kërkesave të Perendimorëve, për t'u njohur me traditën e lashtë të mjekësisë Tibetane. Në bazë të kësaj tradite, profesor Norbu transmeton se, periudha më e përshtatshme për fekondim është 9 ditë pas

ndërprerjes së menstruacioneve dhe zgjat 12 ditë pas, së cilës uterusi mbyllet dhe vështirë vjen deri të fekondimi.

Indikacionet, se ka ndodh fekondimi janë: sapo ovumi është fekonduar, gruaja ndjen se trupi i është rënduar, ndjen nevojën për gjumë dhe ka një ritëm të përshpejtuar të rrahjeve të zemrës. Pastaj menstruacionet ndërpriten dhe pas 30 ose 40 ditë, gruaja fillon të ndjejë mundim apo të ndjejë sulme të vjelljes.

Në gojë i shtohet pështyma dhe paraqitet apetiti për ushqim të thartë dhe të pazakonshëm. Fillon të ndjejë neveri ndaj ushqimit të yndyrshëm, ndjehet e lodhur, i flihet, gjinjtë i fryhen, rriten sekretet vaginale, kurse pulsi rreh më fuqishëm.

Pastaj, Profesor Norbu shkruan mbi mënyrën e zhvillimit të embrionit, por njëri nga kapitujt, i cili më tërhoqi vëmendjen e veçantë, është ai, i cili spjegon për gjininë e femijës dhe çka e përcakton atë.

Tekstet Tibetane të mjekësisë tradicionale pohojnë, se gjinia mashkullore predominon nëse faktori mashkullor është predominant dhe e kundërta, nëse predominon ovumi atëherë lind fëmija femër. Që d.m.th., nëse gjatë marrëdhënies mashkulli ka qenë më i vrullshëm, do të lindet djali dhe nëse femra ka qenë më e vrullshme dhe më epshore, gjatë marrëdhënies do të lind vjaza.

Disa tekste Tantrike rrëfejnë, se gjinia e fetusit varet po ashtu edhe prej faktorëve tjerë të jashtëm, për shembull, nëse çifti ka marrëdhënie në gjysmën e parë të muajit, pra dy javë pas hënës së re është mundësi e madhe, që fëmija të jetë djalë, e nëse fekondimi ndodh në gjysmën e dytë të muajit, mundësia më e madhe është që të lindet vajzë.

Metoda tjetër bazohet në ditët çift dhe tek të kalendarit lunar, dita e 15-të llogaritet si hëna e plotë, dita e 30-të pa hënë, fekondimi në ditët tek; 1,3,5,7, etj., rrit mundësinë që të lind djali, kursë në ditët çift; 2,4,6,8 etj., rrit mundësinë, që të lindet vajzë.

Tekstet Tibetane, në detaje, përshkruajnë edhe stilin dhe mënyrën e të ushqyerit të gruas së mbarsur.

Ata ushqimin e kategorizojnë në tre tipe; i fortë, i qulltë dhe pijet.

Nga ushqimi i fortë, absolutisht duhet të shmanget mishi i pulës, sepse ai forcon ashtin e legenit (Pelvikës), çka, ndikon në lindje me vështirësi dhe dhimbje të madhe. Po ashtu duhet shmangur frute të papjekura.

Vera, rakia dhe të gjitha pijet alkoolike, ndikojnë në shëndetin e nënës dhe direkt edhe në zhvillimin e embrionit.

Shujtat duhet të jenë të rregullta dhe sasia e ushqimit të jetë normale. Në mbrëmje duhet të shmanget ngrënia e djathit, jogurtit dhe çdo ushqimi që rrit thartirën në lukth.

Preferohen lëvizjet elegante jo të shpejta, sheti buzë lumit, në pyll, në kopsht dhe sa më shumë t'i ekspozohet ajrit të pastër.

Që nga muaji i pestë të shtatëzanisë duhet shmangur nga marrëdhëniet seksuale, por të flejë rregullisht, 8 orë. Duhet t'i shmanget fjalosjeve dhe ngritjes së zërit, sa më shumë që është e mundur, të jetë në shoqëri, ku bisedat janë të këndshme dhe të shmangen temat dhe bisedat, të cilat nxisin neuroza, urrejtje, mllef apo vuajtje.

Të shmanget nga vendet me shurmë, por të dëgjoj muzikë të lehtë dhe të qetë.

Dhoma ku rri shatëzëna duhet të jetë e ajrosur, sepse ajri i ndotur mund të ndikojë më negativisht se ushqimi apo pija e keqe. Pra, nëse nëna merr ajër të ndotur me tym; gjaku, eshtrat dhe organet e fëmijës mund të dëmtohen. Shtatëzëna nuk guxon të vuajë, të frikohet, të ketë ngarkesa dhe strese. Ajo duhet të përpiqet të jetë e lumtur e qetë në mendje dhe në shpirt.

Pra edhe stilin jetësor tekstet Tibetane e kategorizojnë në tre etapa;

- sjellja e trupit
- sjellja e zërit
- sjellja e vetëdijes.

Llogaritja e kohës së lindjes

Sipas parimit të përgjithshëm, shtatëzënia zgjat 9 muaj e dhjetë ditë, pra prej momentit të fekondimit deri tek lindja janë

40 javë ose 280 ditë. Llogaritja duhet të fillojë prej momentit kur janë ndërprerë menstruacionet.

Nëse fëmija i palindur është djalë, ana e djathtë e barkut të nënës do të jetë më e ngritur, trupi i saj është i lehtë, do të flasë shumë dhe sheh ëndrra të qarta. Qumështi do t'i vijë së pari në gjirin e djathtë.

Nëse fëmija është vajzë, barku i nënës është i ngritur në anën e majtë, nëna dëshiron të luajë dhe këndojë, do stolitë dhe dëshiron të jetë në shoqëri me meshkujt. Qumështi fillon së pari t'i kullojë në gjirin e majtë.

Nëse shtatëzëna mban bineq, dy anë të barkut i ka të ngritura dhe do të ketë një thellim të cekët në mes të barkut.

Kur vjen muaji i lindjes, uterusi zbret për disa cm. më poshtë, shtatzëna ndjen se barkun e ka më të lehtë, merr frymë më lehtë, apetiti rritet, kurse pjesa e poshtme e barkut i rëndohet, fillon të ecë me vështirësi, ka më shumë ngarkesë në këmbë dhe muskuj.

Lagështia e trupit i rritet si dhe sekretet vaginale dhe shpesh shkon të urinojë.

Pas lindjes foshnja duhet të jetë sa më afër trupit të nënës, me çka i rritet guximi, do të jetë më e shëndoshë dhe mbajtja e foshnjës në gji, ndikon në rritjen e karakterit të foshnjës.

Foshnja duhet të mëkohet 6 herë në ditë, më vonë doza mund të zvogëlohet në 5 apo edhe 4 herë në ditë. Gjatë periudhës së gjidhënies, nëna duhet të ketë kujdes në ushqim dhe stilin e jetës, ajo duhet të jetë e balancuar.

Ishin këto disa nga dijet për Lindjen dhe Jetën sipas teksteve tradicionale Tibetane, të prezantuara nga Profesor Namkhai Norbu Rinpoqe; dijet, të cilat shumë më vonë mjekësia konvencionale do t'i zbulojë dhe implementojë deri sot.

Përparimi i çdo civilizimi, kulture ndodh vetëm atëherë, kur ajo hapet, kur pranon, absorbon, adopton, adapton, dhe e rafinon për nevojat e veta. Kështu janë zhvilluar Arabët në periudhën abaside dhe arritën kulmin e rritjes, kështu vazhdon edhe civilizimi Faustian edhe sot.

FENOMENOLOGJIA E GËNJESHTRËS

Veçanërisht, kur e merr një libër dhe në të nuk gjen asgjë, has në një recension, i cili e hymnizon poezinë, e cila mezi është…

Recenca të tilla ka kohë, që paguhen për ta ushqyer egon e viktimës fiktive, sepse poeti është vertët viktimë e vërtët; ai poet i vërtetë, kur ka poezi dhe në asnjë mënyrë tjetër.

Zhveshja e poezisë në "mezi poezi", në Estradë është përpjekje progresive, që të ngulfatet hapsira e atyre, të cilët vërtetë kanë çka të thonë, por e pamundëson kjo gumëzhim. Kaq për gënjeshtrën e recencës.

Të gjitha komplotet botërore të njohura dhe të panjohura deri më tani, historia i ka regjistruar si fakte, por ne, të cilët faktin e thyem në guraleca dhe nga ai ndërtuam skulptura reale, zbulojmë bukurinë e gënjeshtrës kuintesencën e sajë. Artin e gënjeshtrës.

Erazmo Roterdami, ka shkruar lavd çmendisë, por në mënyrë më të bukur artin e gënjeshtrës e definon Dobrica Çosiq- *"Gënjejmë për ta mashtruar veten dhe për ta ngushëlluar tjetrin; gënjejmë nga mëshira, që të mos kemi frikë, të inkurajojmë, ta fshehim mjerimin tonë dhe të huaj, gënjejmë nga sinqeriteti, gënjejmë nga liria, gënjeshtra është formë e patriotizmit tonë dhe argument i inteligjencës sonë të lindur, gënjejmë në mënyrë kreative, imagjinative, inventive"*.

Së pari gënjejmë duke mashtruar vetën. Këtë e përsërisim dhe në izolimet tona duke mos komunikuar me njeri, fillojmë

t'i besojmë kësaj. Pastaj gënjejmë për ta ngushëlluar tjetrin. Një gënjeshtër e tillë është shpëtimtare, e bukur dhe e kënaqëshme, rehatuese dhe mëshiruese, gënjejmë për ta mëshiruar dikë.

Gënjejmë, që të mos kemi frikë dhe që të mos i frikësojmë të tjerët. Ka shembuj të shumtë, që nga Politika e deri te Arti.

Gënjejmë për ta mbuluar mjerimin tonë dhe mjerimin e të tjerëve.

Gënjejmë për ta kënaqur vetën dhe për ta gjymtuar dikë. Doemos duhet të gjymtohet dikush, të ngarkohet, t'i hypet në qafë për të fituar, për të dalur në pah.

Doemos duhet gënjyer pastaj okupuar aura e dikujt, që të shëmbëllej e jona si feksje e hënës.

Gënjejmë më mirë, kur jemi më inteligjent, gënjejmë me kreativitet, në mënyrë inventive, virtuoze.

Kështu pihet gjaku duke i shndërruar të gjitha këto në fjalë.

Fenomeni është i moshës së njeriut. Që nga zanafilla dhe do ta përcjell atë, si hije duke i dalur herë para e herë pas.

Madje edhe ideja e krijimit të një shoqërie pa gënjeshtër është e dështuar, që në fillim. Ushqim shpirtërormaterializohet me suksesin. Njeriu është substrati më i pëlleshëm.

Kultivimi i gënjeshtrës tërheq me vete vargun, procesionin e gënjeshtrës, perin, që kurrë nuk këputet. Edhe kur kjo zbulohet dhe e vërteta fillon të shpaloset, gënjeshtra përcjell taktin e vet dhe e okupon, simfonia e sajë është magjepsëse deri në sadizëm, durimi i të gënjyerit është magjepsës deri na mazokizëm.

Vepra, fryti i gënjeshtrës, çdoherë, lë farë, e cila me zell kultivohet nga gjenerata në gjeneratë.

Gënjeshtrat, që vijën e mëkojnë foshnjën, e ushqejnë, e shpërlajnë, e rrisin, e martojnë për t'u shumuar sërish dhe për ta vazhduar llojin.

Fillimisht njerëzit kanë gënjyer duke thënë se e kanë çpikur Zotin. Edhe po të mos ekziston ky duhet të çpiket, për ta ushqyer vetën me frikë.

Pastaj janë sjellur si Zot duke gënjyer të tjerët, pastaj janë unifikuar me Zotin janë tretur në esencën e Tij, pastaj kanë thënë se

kosmosi është trupi i zotit pastaj janë fodulluar dhe Zotin u lanë primitivëve, sepse u bënë antropologë.

Jungu mbindërton Frojdin, Osho qeshë me të dy dhe flet për nivele tjera, për plus katër tjera.

Gurdijjeff mashtronte turmat, Ouspensky matematikisht llogariste iluzionin e kozmosit.

Ibn Arabi na flet për realen tonë të rrejshme, Vedat hinduse për Maya, iluzionin, se po jetojmë në realitet.

Zen-i na flet për fluturën ëndërrimtare dhe njeriun, i cili harroi se a ishte flutur apo njeri. Gazetat fitojnë shuma milionëshe, vetëm duke gënjyer.

Poetët flasin për procesin e krijimit të poezisë dhe poezinë e bëjnë lavd të gënjeshtrës. Piktorët, abstrakcionet dhe etiketat i komentojnë si fallin dhe çdoherë duke harruar gënjeshtrën paraprake. Filozofia e Worhol-it, prej A deri B apo jo? Sepse, asnjëherë nuk gënjehet njësoj, veçanërisht kur ke memorien e dobët.

Moda çdo sezonë paketon gënjeshtrën e re, e multiplikon duke pohuar se ngjyra, vija, materiali, prerja; janë prej sodit në modë- sepse unë dizajner i kësaj gënjeshtre them kështu!!!

Njeriu, asnjëherë nuk e ka shpikur Zotin, Zoti asnjëherë nuk e rikrijoi botën për gjashtë ditë, alienët asnjëherë nuk dolën më të civilizuar, se njeriu, sistemi diellor ka më shumë planete se sa ato që i numërojmë, engjejtë asnjëherë nuk kanë pasur krahë, xhindët asnjëherë nuk zbuluan misterin e Perendisë, Demonët asnjëherë nuk ishin jashtë nesh. Kolombi asnjëherë nuk e zbuloi Indinë - Sepse unë them kështu!!!

Substanca e gënjeshtrës në fund të fundit mbetet e vërteta e paemancipuar.

Po të ishte dielli Zot, si do ta kryqëzonin? Po të ishte hëna Zot, si do ta thenin atë pasqyrë diellore. Po të ishte njeriu Zot, si do ta shpiknin.

Vetëm, se nuk mund ta gënjej vetën ndryshe njeriu loz, shpik lojra, shpik robotë, shpik vepra që i quan Art - sepse ka nevojë të vetëgënjehet.

ASSIMIL I SHPIRTNISË SË PASHKRUAR SHQIP

Neve na mungon vokabulari tokësor për çështje qiellore

Fahredin Shehu

Mbi përkthimin e së vërtetës në gjuhën e kuptueshme

Për herë të parë, vetën e citova në librin tim të dytë "Shumësi e Padukshme", kur isha në një krizë për gjetjen e terminologjisë adekuate, për ta shkruar heshtjen në gjuhën e kuptueshme.

Duke kontempluar më tutje, dita ditës kjo krizë rritej e shtohej, andaj nuk jam në gjendje t'i shmangem citimit të Fahredin Shehut.

E di se nuk jam emër, nuk jam emër në letërsinë shqipe për shumë arsye. Më shumë më lexojnë të tjerët, se sa shqiptarët, ndasht. Shpesh më dhemb këmba e shqiptarit të rëndë dhe e ndjej vetën si bimë, e cila është ilaç për atë, i cili e shkel këtë fare duke mos ditur se është ilaç për të. Ndasht!!!, sepse, Fahredin Shehu është mësuar të dojë dhe e ka vështirë të ç'mësohet.

Pse më lexojnë të tjerët?

Sepse, konceptet, që i zhvilloj, ata i kanë pak a shumë të njohura, e konceptin që po e kultivoj nuk është zbulim i flakës, e të frikohen nga ndonjë fis mos ta na e vjedhë.

Konceptin, të cilin e kultivoj, nuk është patent i imi, më tepër është një Arbor Vitae (pemë e jetës) dhe vaktile e kam quajtur Dashuria, sepse u ka munguar vokabulari.

Zgjimi i vertetë i vetëdijes, ndodh atëherë kur dashurojmë dhe kur në të tretemi, unifikohemi me Krijuesin, me Absolutin, atëherë jemi pika e cila iu bashkangjit oqeanit.

Në shkrimet e mëhershme e kam përmendur shkollën Induse të Bhaktës, Shkolla e dashurisë për realizimin - vetërealizimin nëpërmjet dashurisë, si do që ta quajmë këtë, Bhakta (Sanskrit), Amor (Latinisht), Agape (Greqisht), Muahaba (Arabisht), Divine Love (Anglisht).

Arsyeja e dytë pse e citoj vetën është dashuria ndaj VETVETISË. (Vetvetia - koncept, i cili dallon nga Vetvetja në aspektin cilësor dhe sasior - Vetvetia ka ngjyrime sublime kosmike nga Vetvetja Egoiste. Ndaj Vetvetisë së filtruar nëpër prizmin kosmik duke defraktuar rrezen e pastër në disa ngjyra, me cilësi të ndryshme optike dhe emocionale.

Kjo është UN-i, egoja e pastruar, e zhveshur nga oportunizmi, por UN-i i filtruar nëpër flakën - afshin e dashurisë dhe unifikimit me Absolutin.

Duke e dashur Vetvetinë e vet,unifikohesh me Qenien "Absolute Divine".

Dashuria këtu shërben si urë, Kinvat-i përmendur në Avestën e lashtë iraniane, Zoroastriane, Sirat Qypri, si urë e zbuluar në tokë, e cila të lidh me qiellin, sepse e do Vetvetinë, krijesën e avancuar të Absolutit.

Arsyeja e tretë pse e citoj veten është se kështu e stimuloj dertlinë (ai, i cili ka brengën e vetës, pastrimit të saj, kultivimit të vetës) për të kërkuar shqip atë, që nuk mund ta lexoj, mësoj, dëgjoj në ndonjë gjuhë, që nuk e njeh.

Kështu që, kjo i shërben si shortcut (rrugë e shkurtë), në desktopin e kompjuterit tënd.

Më poshtë do të jap disa shortcuts, për ata, që kanë interesim të kuptojnë kodet e një realiteti, të cilin po e sajoj në gjuhën shqipe.

Nëse dëshiron të kuptosh rreth Rebelimit, kërko në Shumësi e Padukshme - mbi lulen dhe degën.

Nëse dëshiron të kuptosh për atdhetarinë tonë, respektivisht mentalitetit antik dhe mesjetar, lexo bisedën e Flamurit me Jovanën në Nektarina.

Nëse dëshiron të kuptosh për mbivlerësimin e vetës, në ambientin e ngushtë të jetës, lexo bisdenë e Troftës dhe të Ngjalës në librin Elemental 99.

Nëse dëshiron të kuptosh domethënien e Masotherisë (mësimit të mesit) konceptin e Aristotelit - Terminus Medius, të Buddha-s - Majjim Nikhaja, të Muhamedit - Wasat-ul Tariq, lexoje komplet Shumësi e Padukshme, se është tipik mësim Mesotherik.

Nëse dëshiron të kuptosh burimin dhe prejardhjen e shkrimit si dhe krejt Matriksin e krijimtarisë së Fahredin Shehut lexo poezinë "Pas heshtjes së gjatë", në librin Nun.

Arsyeja pse Vetvetia ime ofron shortcuts, është respekti ndaj lexuesit, dashuria ndaj tij dhe vetë hapja e këtillë ofron dëshmi të mjaftueshme për këtë, sepse një entitet i formuar njerëzor, në këtë mënyrë, dëshiron të japë. (Më vonë do të flas për dhënien).

Pasi, që jetojmë në një kohë të ngutshme dhe lexuesi në aeroplan nuk do që të humb kohë së lexuari 40 faqe përshkrim të kasit të kalit apo shikojë film 160 minutësh, ku plot 100 minuta bie shiu.

E dyta arsye është se, shortcuts dhe fjalët e pakta tregojnë po ashtu respekt për nivelin e pjekurisë së lexuesit, i cili nuk do që të ofendohet me përshkrime banale dhe primitive sepse po e zëmë një Nano-poezi e botuar në Nun:

POEZIA

Farë

E tejkalon metrin e haikut, stilin dhe destinimin, ajo i dedikohet lexuesit Metanoia-ik (shpirtërisht të pjekur), i cili kupton

se Poezia është vepër artistike në vete, një e vetme poezi është roman në vete, e ruan kodin gjenetik të një krijese të tërë letrare, ashtu si fara e ruan kodin gjenetik të krejt bimës.

Në farë ruhet misteri dhe imazhi i bimës. Nga fara shumë e imët rritet Sekuoja gjigante, bima me e madhe e njohur në planetin tonë.

Secilin liber, që do ta shkruaj, do të jetë Poezi-farë, për të cilat duhet të përkujdesen gjeneratat e ardhshme, për ta kultivuar e rritur si një Sekuo.

Secili libër e ka kahjen/drejtimin, hap shtegun, tregon rrugën për kënaqësi të reja në krijimtarinë e të shkruarit, sepse të shkruarit është dashuri e sojit të veçantë, është mënyra më e mirë për të ruajtur gjurmën e identitetit, të entitetit të caktuar etnik, fetar, politik apo ndonjë tjetër

E vërteta kalon nëpër tre faza thotë Schopenhauer:

1. së pari është e përqeshur;
2. pastaj është vrazhdësisht e refuzuar;
3. pranohet si e qartë.

MBI DHËNIEN

Se, sa jemi larguar nga natyra e Natyrës, më së miri manfestohet në depërtimin e natyrës së Egos, e cila prezantohet me forma të llojllojshme.

Natyra na flet me gjuhët e ndryshme, me tinguj dhe pa to. Vetëm po ta vështrojmë atë, do ta kuptonim më së miri se çka po na flet dhe çfarë mesazhe na emiton. Njeriu për të dhënë argument më të fortë dhe më bindës, shfrytëzon analogji dhe në të shumtën e rasteve, shembujt më të mirë i gjen në natyrë.

Kisha zakon të dilja në natyrë e ta shkel tërfilin e njomur me vesë dhe pa vetëdije, kokëdhimbjet më kalonin. Më vonë zbulova, se në ato momente shelgu kishte çelë dhe e gjithë kjo ndikonte në gjendjen time shpirtërore dhe fizike. Pakëz më tej e gjej një këmetë. Isha i preokupuar me dhënien dhe e vështroja këmetën. Njerëzit më thonin se ai, i cili jep është si këneta…dhe natyrisht, këmetën e shikoja me sy sipërfaqësor, njëlloj si ata.

U ndala tek këneta dhe fillova ta vështroj. Pashë se këneta nuk rrjedh. Pashë se këneta ishte një Ekosistem në vete. Ajo jep shumë dhe në disa nivele.

Patave të egra u jepte kënaqësi dhe ushqim, insektet e ndryshme gumëzhinin, ndonjë puhi kur fryente i valëvitëte gjethet e shavareve, shumë gjallesa tjera jetojnë në ujë si Daphnia Pulex për shembull, bretkosat e shumta, të cilat dikur i mblidhja për dekapitim dhe hulumtimin e veprimit të indit ischiadik dhe punën e zemrës së kryekëmborëve (Amphibia).

Ajo çka m'u dha të kuptoj, se në kohën e vapës më të madhe në fund të korrikut dhe fillim të gushit, këneta thahet, por çka ajo jep pas vetes është një substrat plot humus dhe në pranverë nga ajo tokë del bereqeti shumë cilësor.

Me një vështrim të këtillë kuptova se këneta vetë thahet për të dhënë më shumë, se sa mund të shihet me sy sipërfaqësor dhe një analogji, se lumi jep, sepse vazhdimisht rrjedh, me kënetën, e cila qëndron dhe nuk rrjedh fare nuk qëndron.

Ajo çka është me rëndësi, këtu është dhënia qofsh si lumë apo si kënetë ose jep duke qarkulluar ose duke pritur atë, i cili kërkon.

Jeta është fenomen më ekstraordiner për të cilën mund të vetëdijësohemi. Përcjellja e fazave të zhvillimit tonë përbën krejt mjeshtrinë e vetëdijësimit për jetën dhe formën tonë të ekzistencës.

Janë dy kahje të vështrimit të këtij evolucioni:

Kahja e jashtme, Inspekcioni- që ndërlidhet me vështrimin, vëzhgimin, hulumtimin dhe vlerësimin e fenomeneve të jashtme në natyrë. Këtu mund të ceket edhe Magjia Rituale ku simbolet, rekuizitat, objektet e ndryshme janë shëmbëllime të gjithë asaj, që kemi brenda mikrokosmosit tonë, të shfaqura me simbole;

Kahja e brendshme, Introspekcioni - që ndërlidhet me vështrimin, vëzhgimin, hulumtimin dhe vlerësimin e fenomeneve të brendshme të natyrës njerëzore. Këtu mund të ceket Yoga, veçanërisht Raja Yoga, ose Yoga mbretërore, sistemi i Vivekanandës dhe Zikri Hafi, apo Zikri i brendshëm, sipas sistemit Nakshibendi, ku të gjitha simbolet, elementet, ngjyrat, teknika e frymëmarrjes janë shembuj të gjithë asaj që është brenda makrokosmosit.

Shikuar nga kjo perspektivë, e gjithë kjo paraqet fazën e akumulimit të dijes - fuqi, të dijes - dritë, e cila duhet të kalojë nëpër prizmin kosmik - në këtë rast mentori, i cili të udhëzon - për t'u filtruar dhe për të qenë i gatshëm të japë.

Natyrisht, këtu nënkuptohet se nuk flas për dhënien e lëmoshës, pasurisë apo diçkasë, që jemi materialisht të lidhur më

të. Unë flas për dhënien e një vlere të panjohur për psikologjinë e masës, por vetëm për psikologjinë e individit.

"njerëzve asgjë nuk u kërkova
prandaj borxh askujt nuk i kam"

Dhënia është një virtyt i njerëzve të dëlirë dhe thënia e mësipërme është përvojë e llojit të veçantë.

Të keshë aq sa t'i plotësosh nevojat elementare dhe të japësh çdo gjë që është e tepërt, ta dhurosh atë që e konsideron tepricë, e tepricë në këtë rast është ajo që ti më së shumti e do.

Këtu, me kujdes duhet të rregullohet sistemi i vlerësimit të nevojës elementare - pra, aq sa të mos kesh nevojë të kërkosh.

Shembulli i Xhunejd Bagdadiut na mëson për kënaqësinë e asaj çka posedojmë.

Me siguri emri i Xhunejdit në mesin e sufinjve meriton respekt të veçantë. Vdiq në Bagdad më 298 hixhri.

Dikush i dha Xhunejdit 500 dinarë
"A ke më shumë – e pyeti Xhunejdi
Kam shumë më shumë – iu përgjigj dhuruesi
A ke nevojë për këto 500 dinarë– pyeti Xhunejdi
Po, më duhen– iu përgjigj
Merr këto para, ti ke nevojë më shumë, se unë, sepse unë nuk kam asgjë, por nuk kam nevojë për asgjë".

Një shembull tjetër po e sjell për dhënien e energjisë shpirtërore. Është fjala për Meher Baba:

Hazret Babaxhan ishte një grua e shtyer në moshë, e cila meditonte nën hijen e një lisi të madh, në Indi. Ajo një kohë të gjatë priste ta takojë një person, të cilit do t'i japë. Por çka?

Shumë vite kaluan e ajo e vazhdoi meditimin, derisa në atë qytet kaloi një fëmijë nëntëvjeçar, i cili që në fëmijëri filluan t'i shfaqen mrekullitë.

Meher Baba atëherë ishte vetëm 9 vjeçar dhe plaka Hazret Babaxhan e parandjeu se personi të cilin e priste për t'i dhënë po i afrohej. Ajo duke e ndërprerë meditimin u ngrit në këmbë dhe e puth në ballë fëmiun 9 vjeçar. Fëmiut i ra të fiktë dhe për disa ditë mbeti në gjendje komatike.

Për një kohë shumë të shkurtër Hazret Babaxhan ndërroi jetë, kurse pas shumë vitesh mjeshtri Meher Baba, rrëfen çka përjetoi për ato ditë, që ishte në koma.

Që nga ajo kohë ai përjetoi transformime të mëdha shpirtërore dhe arriti kulmin e asaj, që në esoteri quhet Intelekti i adeptit, shkalla më e lartë e zhvillimit të intelektit.

Ishin këto dy shembuj të të dy llojeve të dhënies, ndikimit që ajo ka dhe shumëzimi i mëshirës së burimit.

MOSBËRJA

Mbi meditimin

Koncepti, përgjithësisht i njohur si Meditim, në jetën tonë të përditshme ka përdorim të gjerë dhe përdoret edhe aty ku nuk e ka vendin dhe kështu keqkuptohet.

Shumë tradita shpirtërore kanë zhvilluar teknika të ndryshme të meditimit, të cilat ndryshojnë në trajtë, qëllim dhe cilësi.

Vetëm tradita Hindu ka qindra teknika, madje meditimi mbetet element kryesor dhe më i popullarizuar, i cili gjen aplikim të madh në jetën e përditshme.

Përgjigjia adekuate në pyetjen çka është Meditimi mund të ipet me analogjinë e softuerëve të cilët i organizojnë të dhënat në atë mënyrë, që të fragmentohen dhe defragmentohen, për rregullimin e fajllave brenda sistemit kompjuterik.

Sistemi ynë nervor është fryt i Inteligjencës kosmike dhe si i tillë, është më i përsosur në planetin tonë.

Një kompjuter sado i përsosur ngarkohet me imazhe, fajlla në formë të muzikës dhe programe të ndryshme. Sa më i ngarkuar, që është një kompjuter, aq më shumë, efikasiteti i tij ngadalësohet. Sistemi ynë, krahas që deponon të dhëna në formë imazhesh, ne jemi në gjendje t'i mbajmë edhe bisedat dhe lëvizjet, kohën, stinën dhe krejt çka lidhet me një situatë të caktuar. Plus mban kontrollin e sistemit hormonal për funksionimin normal

të organeve të caktuara, si dhe i gjithë kosmosi në miniaturë, të cilin Inteligjenca Kosmike e koncentron në diçka, që ne e quajmë organizëm.

Me një seancë meditimi, ne arrijmë që të balancojmë një organizëm të ngarkuar me të dhëna të shumëta, të cilat futen në tru me ose pa vetëdije.

Prandaj, për prejardhjen Hindu të Meditimit këtu vend nuk ka, që të diskutohet, sepse meditimi është proces natyror i nevojshëm për balancin trup-shpirt dhe është i njohur në secilën traditë shpirtërore.

Marrja e pozitës së caktuar, mantrat (formulat) teknikat e frymëmarrjes, koncentrimi në një ide të caktuar, përdorimi i parfumeve, muzikës etj., në asnjë mënyrë nuk janë qëllime, por mjete lehtësuese e disa edhe esenciale (varet nga kapaciteti i medituesit), për kalim nga një gjendje e vetëdijes/shpirtërore në tjetrën.

Dy janë tipa kryesor të meditimit, meditimi i vetëdijshëm dhe meditimi i pavetëdijshëm.

Rrahja e zemrës, sistemi termorregullativ, qarkullimi i gjakut tek njeriu,

Kënga e karkalecave, vak-vaket e bretkocave, dritat e xixëllonjave tek shtazët,

Polenizimi i luleve, luhatjet e kallinjve etj tek bimët. Të rreshurat, erërat, vetëtimat në atmosferë - të gjitha këto i takojnë meditimit të pavetëdijshëm.

Unë fillova këtë shkrim për të folur mbi meditimin me vetëdije që është tipar i yni.

Tema është shumë e gjerë dhe unë nuk do të përpiqem t'i vë në pikë të Pafundmes, sepse nuk kam kapacitet dhe jo vetëm unë por të gjithë njohësit/praktikuesit meditimit, të bashkohen, nuk do të ishin në gjendje ta bëjnë këtë, sepse meditimi mbetet një nga misteret e paspjegueshme sa edhe vetë jeta.

Meditimi me vetëdije i kërkon disa parakushte për të filluar këtë proces. Them proces, sepse përvoja rritet dhe kur e arrin pikën e vlimit si uji, avullon. Aty përgjumësia jonë, si e quan G.I.

Gurdijjeff, këtë gjendje të vetëdijes, që e posedojmë dhe të cilën e njohim, si normale, kalon nëpër faza të zgjimit deri te esullia totale, deri te unifikimi me ndodhitë kosmike.

Njëri nga parakushtet është higjena personale, e cila duhet të jetë e vetëdijshme dhe e cila me këtë vetëdije ka impakt në pastërtinë shpirtërore.

Parakushti i dytë është ambienti i pastër, i qetë, pa vibrime negative.

Qëllimi i krijimit të këtyre parakushteve është që parafaza për meditim, ajo e arritjes së kontemplacionit dhe kuietizmit të arrihet më shpejtë dhe më lehtë.

Praktikuesit e shkathtë të meditimit këto parafaza, i arrijnë më lehtë dhe më shpejtë.

Mashtrimi kryesor ndodh kur medituesi prêt mrekulli nga meditimi dhe instruktori i dobët i ushqen me iluzione, se nëpërmjet meditimit mund të arrihet shumëçka.

E vërteta është se arritja e shumëçka-së është proces i gjatë dhe mrekullia ndodh spontanisht…

Meditimi i vërtetë ndodh kur nuk bëhet asgjë. Mosbërje totale. Vetë tendenca për t'u përqëndruar në një koncept e ka për qëllim që të arrihet deri tek zhdukja e këtij të vetmit koncept, gjë që është një punë goxha e madhe.

Meditimi fillon pikërisht kur relaksimi arrin pikën kulminante dhe spontanisht kapërcehet në mosmendim.

Vetë tendenca për t'u përqëndruar në një koncept d.m.th. – bërje, kurse meditim d.m.th., mosbërje totale.

Njëri nga mjeshtrit e Meditimit, Osho Rajneesh ka zbuluar teknikat e ndryshme të meditimit, por teknika e tij më e popullarizuar dhe mjaft e vështirë, është e njohur si Meditimi dinamik.

Koncepti, Meditimi Dinamik është në kontradiktë me vetveten, sepse kuptimi tradicional i meditimit është statik, moslëvizje, qetësi, kurse Meditimi Dinamik është e kundërta e gjithë kësaj. Rrënjët e këtij Meditimi janë shumë më të vjetra se Osho. Meditimi tipik Dinamik është Namazi - i njohur si lutje

Islame, ku konteplacioni dhe kalimi nga një gjendje e vetëdijes në tjetrën ndodh me lëvizje - pra dinamik.

Po ashtu edhe Semaja - ose meditimi i Sufinjve Mevlevi të Rumiut nga Konia e Turqisë, është Meditim tipik Dinamik. Gjenialiteti i Rumiut dhe inteligjenca intuitive e tij na la trashëgimi Sema-në ose Vallen Qiellore. (Më gjerë për Sema-në shih: Semaja Semazeni dhe Arti i Rumiut, si punim të veçantë në këtë libër).

Në Tesavvuff apo Misticizëm Islam, Zikri (përkujtimi) përmendja e përsëritshme e Emrave të Allahut Esmaul Husna, të derivuara nga Kur'ani, manifestohet në trajta të shumta varësisht nga tradita, respektivisht shkolla e caktuar e psikologjisë personale në popull më e njohur si rradhë dervishe.

Secila shkollë e ka mënyrën e vetë të Zikrit ose meditimit, por kryesisht janë të njohura dy tipe gjenerale të Zikrit, e ato janë Zikri Haf. Kalb-i ose Zikri i brendshëm, zikri i zemrës dhe Zikri Xheli/ lisani apo zikri me gjuhë; Zikri i jashtëm shpeshherë duke përdorur rruaza (Tespih). Në meditime/Zikre të këtilla, së pari kërkohet pendimi, pastaj Tesbih - apo Lavd të Allahut, Tehmid - apo Falënderim Allahut dhe Tekbir - apo Madhërim të Allahut.

Mjeshtrit Sufi Chishti rekomandojnë që në laprën e djathtë të veshit mbi zgavrën e veshit, aty ku tubohen gangliet apo tufa prej pesë përfundimesh nervore, të vendoset një copë e pambukut e lagur në parfum - esenca e Jaseminit - parfumi i preferuar i Isaut a.s. dhe i Rumiut.

Moschus-i është esencë e preferuar e Muhamedit a.s. apo esenca e mentës, për të arritur qetësinë dhe balancin nervor, para se të fillohet meditimi. Indusët për shembull, djegin esenca (Incense), shkopinjë me aroma të ndryshme, por pothuaj, në secilën është dominant Cinammon/Kanella dhe Sandali. Të krishterët e preferojnë Temjanin dhe Kamforin.

ROJTARËT E MISTERIT TË HARMONISË

1.

Sa herë që më shkon mendja tek bletët, mahnitem me bukurinë e tyre, bukurinë e organizimit të kopesë së tyre, instinktin, mjeshtrinë, precizitetin, harmoninë e shumë e shumë atribute tjera që ato i posedojnë.

Një zgjua mesatar i ka 5-7 mbretëresha, të cilat jetojnë shumë më gjatë se sa bletët tjera luftëtare apo punëtore.

Bletët prodhojnë një substancë e njohur si Royal Jelly (qumështi i bletës), me të cilin ushqehen vetëm mbretëreshat dhe kjo u jep jetëgjatësi.

Preciziteti filigranik i ndërtimit të hojeve është mbresëlënës. Ato i punojnë prej këndeve kah mesi dhe takohen aty, secili gjashtëkëndësh është i njejtë.

Padyshim nëse planeti ynë do të binte në kontakt me ndonjë qytetërim tjetër, atëherë duhet ta jap mostrën e bletës, ama në çdo aspekt.

2.

Reciklimi i rrëfimit për bletën më duket i domosdoshëm, çdoherë kur e paramendoj parregullsinë e organizimit njerëzor. Në kontekstin tonë, kjo duhet të aplikohet disafish.

Ende jetojmë me fuqinë e muskulit dhe krejt derisa paguhet muskuli, e jo truri, do të jemi larg një organizimi të tillë, sikur të bletëve.

"Secili mund të bëhet lider, sepse secili mund të shërbejë"- thotë, Martin Luther King.

Sa shërbejmë ne, është dëshmuar dhe po dëshmohet, prandaj nuk kemi lider dhe krejt derisa nuk shërbejmë, e në vend të shërbimit tregojmë muskuj, nuk do të kemi lider.

"Dikur lideri ka pas domethënien e muskulit, kurse tani është ballafaqimi me njerëz" thoshte Indira Ghandi

Ballafaqimi me njerëz, dita ditës po bëhet gjithnjë e më i vështirë. Ndoshta, pse dijmë të flasim dhe nuk e kuptojmë njëri tjetrin, jo pse nuk e dijmë gjuhën e tij, por pse nuk e dëgjojmë, sepse në garën për t'iu përgjigjur e huqim kontekstin e bisedës, qëllimit dhe rezultatit.

3.

Nuk është zbulim i ujit të nxehtë, por vetëm përkujtim, nëse thuhet se *"Muzika është arti më abstrakt, që ka ditur ta krijojë njeriu"*.- Vassily Kandinsky, duke dashur të argumentojë dhe krahasojë pikturën e tij abstrakte.

Një vepër muzikore, e cila krijon kënaqësi dhe drithërimë emocionesh ka më vetë harmoninë, e cila i përgjigjet vibrimeve të qenies sonë, në pajtim me nivelin dhe sinkronicitetin, që e arrin me ato vibrime.

Larg qëndron Estetika (nëse ashtu mund të quhet dërdëllisja për Artin) orientale, (në Orient, Arti bëhet "këtu" dhe "tash", për të nuk filozofohet) nga estetika Perëndimore.

Dhe krejt këtë po e përmbledh në një fjali të vetme të Swami Govindës *"Çdo gjë është muzikë"*.

Muzika krijohet me çdo lëvizje të trupave qiellorë, e deri te ato molekularë, atomikë; nano, piko, ato, femto dimensione. Dhe të gjitha këto vibrime janë të harmonizuara.

Zgjohu o vëlla Njeri- Ka diçka që na mungon. HARMONIA (sic!)

4.

Në kohën e acarit të madh, bletët lëvizin më shumë brenda zgjoit, për ta ngrohur atë e për të mos u ngrirë. Pra, për ta ndryshuar mikroklimën në mënyrë artificiale brenda zgjoit.

Kush i mësoi këto gjallesa të imëta dhe inteligjente? A mund t'i thuhet kësaj inspirim? Po, natyrisht inspirim hyjnor, se nga njeriu, bleta nuk ka çka të mësojë, ama asgjë.

Jeta këtu sërish shfaqet si një nga fenomenet më ekstravagante, se çdo gjë tjetër. Jeta e bletëve duket, se është art në të cilin duhet të reflektojmë.

Nuk është e kotë që në Kur'an flitet për bletën. Ajo është për të na rikujtuar, nëse veç në natyrë nuk e kemi vërejtur, se si mund të organizohemi.

Rend, harmoni, përkujdesje, punë e palodhshme, kierarki, organizim ushatarak, hulumtues të terreneve të ushqimit, shkëmbim informatash, precizitet, etj. Janë këto atribute, të cilat e cilësojnë një zgjua.

E tash njeriu mund të flasë për lidership, për rend të ri botëror, për harmoni…pak si zor!!!

5.

Pyetja jetime... pa përgjigje, e marrë… çka është demokracia? Nuk e gjen vetëm në këtë hallakamë botërore. Mua më duket se demokracisë i vie era Darvinizëm dhe ka një konotacion muskulor, ku më i forti fiton, ku fiton shumica. Kështu jemi programuar, që një kohë të gjatë dhe po këtë nuk jemi në gjendje ta realizojmë e lere më diç më tepër, më të avancuar, më të rafinuar, më të sublimuar.

Po të ishim në gjendje ashtu si nuk jemi, ta transcendojmë vetën dhe ta tjetërsojmë këtë formë jetësore, duke mos e kërkuar në kosmos apo përtej galaktikës sonë, por këtu dhe tash duke e marr mostrëne bletës apo duke kërkuar ndonjë shembull tjetër, po nga natyra, jam i bindur se krejt rrjedha e historisë do të ndryshonte.

Këtu e kishim nisur ardhmërinë, këtu e kishim mbjellur farën e një qytetërimi të vërtetë global.

Dikur fiset kanë luftuar për puse me ujë, sot shtetet për ato të naftës. Shpenzimet enorme në armatim e lënë në hije nevojën për ekzistencën e të ndryshmes, të cilën shumë pak e njohim.

E pamë si u zhdukën popujt, fiset indiane në Amerikën Veriore, e pamë si u zhduk shpendi Dodo, po e shohim se si zhduket Tigri i Siberisë, Balenat, Pandat, dhe shumë e shumë lloje shtazore.

Krejt e kam hallin se, si do të na shikojnë gjeneratat e ardhshme, le të themi, pas 300 vitesh.

A do t'i përjetojmë ne grupet e mutantëve, të cilët në aspektin mendor, disafish do të jenë më të avancuar e të na përbuzin… Ju Homo Sapiensa të fëlliqtë.

Natyrisht, që do të na shikojnë me përbuzje, assesi si bletët, jo assesi.

Ajo çka natyra e ka krijuar si të bukur ne veç jemi duke e shkatërruar. Ka mbetur edhe ajo çka njeriu ka krijuar të bukur, ta shkatërrojmë e t'i evokojmë shpirtërat në shkretëtirë.

GLORIFIKIMI I IMAZHIT HYJNOR II

Para disa vitesh e obligova veten të shkruaj një ese të shkurtë për një artist/piktor Kosovar; Artan Balaj. Eseu kishte titull të njëjtë si ky, andaj detyrohem tani të hartoj këtë si pjesë të dytë të të njejtit fenomen, por observuar nga një perspektivë tjetër.

Këtë herë flas për librin e Paulo Coelhos "Shtriga e Portobelos", ku ai pikturon imazhet në ekranin tim mental nga i gjithë rrëfimi gjë, që në gjuhën e kuptueshme do të thoshte/tigëllonte si: Narracion artistik i argumenteve shkencore.

Në tymnin e opusit të Mircea Eliades, veçmas të veprës **Mefistofales dhe Androgin**- i referohem segmentit për kërthizën, Coelho end me mjeshtri/artistikisht, romanin e tij, që të promovoj filozofinë e WICCA-s, të cilën e lidh tek personazhi Deidre O'Nill, e njohur si Eda, me të kaluarën Druide si substrat për WICCA.

Çka më impresionon në artin e muzikantes kanadeze; Loreena Mc Kennitt është krijimii simbiozës muzikore të Orientit dhe Oksidentit, veçmas e ndikuar në kolekcionin e saj, " The Night Across the Caucasus", nga filozofia e Murat Yagan, plakut të fundit të traditës Ahmsta Kebzeh ose Yoga e Kavkazirt, Coelho bën të njejtën me librin e tij, hapur duke shfaqur ndikimin nga Khalil Gibran nga Libani, që ta simuloj këtë në personazhin kryesor karizmatik Sherina Khalil (lexo: Lindje) e njohur si Athina (Perëndesha e gjithëdijëshme-lexo: Perë ndim).

Që të dy; Mc Kennitt me muzikën e sajë dhe Coelho me librin e tij, projektojnë produktin amalgam Orient/Occident, jo si mallkim, por si bekim, kështu fuqishëm, thellësisht duke kundërshtuar konceptin Ndeshja e qytetërimeve.

Gnosisi i Pistis Sophia dhe Traditës na sjellin tek Rene Guenon dhe qëllimisht ai (Coelho), romanin e fillon me Luka 11, 33 duke treguar vetën si (gr.) Daduchos- ose bartës i pishtarit (dritës). Me sukses arrin t'i hedh dritë materialit më pak të njohur (në tërësi) dhe në veçanti, festivalit të një fshati francez Sanites Maries De la Mer, që ta celebrojnë perëndeshën e errët Hindu; Kali ose Shën Sara ose Sara Kali ose Sara e zezë, perëndeshë, e cila unifikon të gjithë romët e botës që obligohen që njëherë në jetë ta pelegrinojnë varrin e sajë. Ta celebrojnë nënën e krijimit quaje (Hin.) Kali, (Heb.) Shekina, (Gr.)Gaia ose Shën Sara që të gjithat të lidhin me WICCA.

Nëpërmjet këtij romani Coelho, sërish veton urtësinë e tij dhe i ofron lexuesit një paletë metafizike jo vetëm të spektrit, por gjithashtuedhe dimensionet nën dhe mbi të (spektrit) respektivisht infra të kuqe dhe ultravjollce.

Ky libër i është dedikuar të gjitha shpirtërave të purifikuar, të shpërlarë nga të gjitha papastërtitë e paragjykimeve dhe stereotipeve.

Një lexim i shëndoshë për trup dhe shpirt. Të jeshë shkrimtar i mirë duhet të kesh dije dhe urtësi; Coelho i posedon të dyja këto.

MËKATET E VETMISË

Se si tek ne lexohet më pak se kudo tjetër, fenomeni i moslexim it mund të gëlltiste faqe, vëllime dhe kolane të tëra punimesh me trajtim psikologjik dhe etik.

Në vrushkullin e botimeve, në vorbullën e temave, në mjegullnajën e vlerave, vështirë, që mund të të feks një libër i cili do të pulsonte nga brendia e nga jashtë shëmbëllente tahikardinë e emanacionit të quajtur **talent**.

Ai që shikon një parti shahu duket se vëren më mirë dhe çdoherë gjen alternativë për lëvizje tjera, ashtu si edhe në jetë. Një lexim të një potezi të tillë alternativ e bëra më një frymë e cila zgjati një kohë.

Libri si ky i Xhevat Mustafës m'i evokoi dhimbjet e paluara latente, sikur mezi presin ta gjejnë vaktin e duhur për të eruptuar. Ne, që ishim në Kosovë para gjatë dhe pas luftës, jo se e kuptojnë më mirë, por tundimi nga rrjeshtat e murr-uara në frymën tradicionale të narracionit artistik të ndërtimit të piramidës së romanit e cila i ruan sakramentet dhe sarkofagun e dhimbjes sonë, që të na nemit për një kohë, e të na paaftësoj, ta ndërtojmë ne Pandorat e shek. XXI, kutinë, të cilën nuk guxojmë ta hapim.

Po lexove dialogjet e personazheve do të të duken dërdëllisje në krahasim me dhimbjen dhe emocionet, që shkojnë deri në kufirin kulmor të dhimbjes.

Një kosovar lë gruan me dy fëmijë dhe prindërit e moshuar e vendoset në Zvicërr për të fituar bukën. Pronarja e restoranit;

Zvicrrania, të cilës nuk i kaluan pa u provuar burrat e ballkanit dhe të tjerë joshjes së sajë nuk i iku as Skenderi; kamarier dhe më shumë se kaq…, i Kristinës.

Familja e tij në Prishtinë, lëngon nga mungesa e tij. Babai i shtrirë për vdekje dhe kjo e mbrrin pa u takuar për së gjalli me të birin, falë intrigave dhe kthetrave të Kristinës.

Besa; gruaja e tij, pasqyrim i një femre moderne, të moralshme, por edhe të brishtë, viktimë e përdhunimit nga një doktor dhe një oficer policor serb, do ta vuaj barrën e turpit, anktheve në ëndërr dhe zgjëndërr dhe abortit të farës së pistë të armikut dhe fisnike të sajë.

As Skenderi e as Besa nuk ishin në gjendje të luftojnë me vetminë, e cila në vete tërheq tundime të shumëta. Tradhëtia e Skenderit dhe mungesa e tij për një kohë, e tundoi Besën më shumë nga paaftësia për t'u përballur me epshin, se sa si shenjë hakmarrjeje duke i shtuar kësaj edhe përdhunimin, librin e bën emocionalisht të tejngarkuar.

Dhimbje më të madhe më shkaktoi përshkrimi i detajizuar i përdhunimit të Besës; segmenti, i cili ushqen urrejtjen ndaj armikut dhe mban gjallë memorien e krimit sistematik të ushtruar ndaj Kosovarëve, por edhe të pamundëson t'i kthehesh realitetit të reanimuar të Kosovës.

Njohja e mirë e rrethanave, fakteve dhe tragjedisë kosovare i mundësoi autorit, që tasajoj një prozë të shkëlqyeshme estetikisht, por edhe skajshëmrisht të trishtueshme, e trishtueshme për ne, të cilët u dogjëm nga po këto…

METAFIZIKA DHE METASIMFONIA E VEPRIMIT ARTISTIK

Arti i lejon të vërtetës të gufojë

Teurgjia i lejon të vërtetës ta shfaq madhështinë e bukurisë së realitetit kosmik.

Si të fillohet? Si të vazhdohet? dhe si të lëhet procesi, të cilin dijmë ta emërtojmë krijimtari e pastaj ta rinisim sërish të njejtën vuajtje me hezitim? Janë mendimet të cilat dikur i artikuloi Balzac.

Natyrisht mendime të tilla i kishte dhe i ka çdo kush, që mëton të krijoj!?. botën elementale paraleletë degraduar pa vetëdije nga Teurgjia në Art. Veprën artistike me, të cilën mund të fascinohet një pakicë apo një koloni entitetesh humane, por një vepër e tillë e ka të garantuar supertemporalitetin, si; Homeri, Shakespeare, Hafezi, Rumi në letërsi apo Mozart, Wagner, Beethoven etj.

Paralelisht veprat e mëdha sikur janë në safari të kodit komunkues të një *Lingua Franca*, por pa fjalë dhe rrokje në këtë rast *per se*.

Kundra veprat, të cilat nuk lexohen nga kopertina por në substancë, në tulin e saj, vetëm qiellin e kanë kufi.

Për të tilla vepra koha nuk ekziston dhe bazuar në kuantikën e gjërave dhe manifestimeve, as nuk kanë shpejtësi të dritës, që ta absorbojnë kohën e as janë statike për t'u konsideruar mejit

(kufomë, e cila prêt të dekompozohet) deri në masën, që të mos jemi në gjendje ta identifikojmë kodin e tyre gjenetik; ADN e vlerave supertemporale.

Në mësimet e trashigimisë antike hindu, sikur në mënyrën më të mirë, manifestohet dukuria artistike sakrale, nëse kështu edhe mund të emërtohet. Vallëzimi i Shiva Nataraj, krijon çdo gjallesë, kurse vallëzimi është produkt i Meta-Simfonisë kosmike, të Meta- Muzikës primordiale.

Definitivisht nuk ka sqarim më të mirë artistiko- sakral.

E gjithë kjo në rrafshin Meta-galaktik.

Vallëzimi Shaman; produkt i muzikës objektive e nxjerr nga eonet dhe hapsirat shumëdimensionale të ndërdijes, përcjell atë traditë të fshehur duke krijuar trajta të dukshme dinamike, të cilat në mungesë të vokabularit adekuat duke përdorur analogji të pavetëdijëshme, respektivisht duke aplikuar matrikset nga manifestimet e dukshme dhe të padukshme, që t'i përafrohemi perceptimit të një manifestimi të ri dhe duke e emërtuar Vallëzim, balet apo ndonjë koncept, që tek pritet të zbulohet, këtu lëhet e hapur mundësia për emërtime dhe për t'i dhënë ekzistencë diçkasë së rafinuar menatle, frymore apo astrale me qëllim, që tek më vonë receptuesi apo konsumuesi i kreativitetit të fascinohet me kreativitetin, gjenialitetin, ekstravagancën e kush e di çka tjetër të krijuesit monden, paraqet Fuqinë e Krijuesit dhe Madhështinë e Tij, që vet krijesa Njeri të jetë në gjendje të krijoj diçka të prekshme, të dukshme të ndjeshme etj. pra shqisore.

Nga vallëzime të tilla,janë krijuar lëvizjet terestriale, si shëmbëllim të dinamikës celestiale. Përkryeshmërinë e një manifestimi të tillë në planin terrestrial e arrin SEMA (për Sema-në, më gjerë shih punimin tim të mëhershëm Semaja, Semazeni dhe Arti i Rumiut)

Në sytë e receptuesit observimet e tilla, spjegohen si nxitje për ta transmetuar në fjalë një manifestim që paraqitet si kombinim i dëgjimit, harmonisë, lëvizjeve trupore, muzikës veshëmbathjes, që të gjitha këto specifike, për të rezultuar në ekstazë apo unifi-

kim me kosmosin apo me të pavetëdijshmen kolektive të Jung-ut.

Pothuaj, çdo herë faktori i jashtëm e kufizon ose thënë më mirë, determinon manifestimin e një produkti të tillë teurgjik (artistiko-sakral) dhe tendenca, që ky produkt të degradohet; është prezistente me qëllim, që të absorbohet më lehtë. Kjo katalizë psikike mund të mos jetë e dashakeqe, por që në anën tjetër të rritet afiniteti, respektivisht forca absorbuese jo fortë e fuqishme e dekodifikimit të universales së pakuptueshme deri në atë çast.

Për tretman të tillë kreativ, për krijimin e trajtave të reja (në çdo dimension, fushë, veprim), domosdo individin e shndërron në Asket dhe pasi që Askeza është magjike, individi, shtrenjtë e paguan Mallimin për t'u kthyer nga vetmia në shumësi të dukshme, në mesin e masës është shumë i lartë dhe tek kur të kthehet në këtë të dytën e kupton çmimin që e ka paguar. Për hirë të çmimit të paguar atë, që e zbulon në askezë e gjallëron i jep ekzistencë duke e emërtuar.

Kërkime të tilla doemos, që kufizohen në një fjalë (këtu flas për të gjitha llojet e kreativitetit), sepse hapsira ngushtohet, që mbingarkesa e elementeve e ngulfat harmoninë, andaj thuhet shumë e kuptohet pak, pak ka domethënie andaj që të arrihet deri tek germa primordiale arketipore duhet të arrihet deri te emri, nocioni.

Zbrazja e tillë e pasionit është produkt i vetdisciplinës. Ndoshta një arritje e tillë maniofestohet tek Yves Clein në pikturë dhe Simfoni njëtonëshe. Ndoshta mjafton një ton, vetëm një ton i vetëm, të krijoj Simfoninë, Magjinë e egos.

Po zgjohemi (sidoqoftë) zhytemi shpëtohemi nga barra të tilla jemi të okupuar me Metasimfoninë infra-akustike dhe ndodhja e saj pa ne, me ne, para, pas, lartë, posht, në ne, jashtë neshë; është dëshmi e mossuksesit tonë që simultanisht të jemi në Gestalt dhe në sinkronicitet, me Pleromën kreative të sferave të larta.

Ndalja për një çast na çon në meditim, në deautomatizim të veprimeve rutonire, zhytja në meditim na gëlltit dhe pas kthimit

gjërave/ manifestimeve u japim, asgjë tjetër pos domethënies së re.

Në veprimtarinë kreative poetike zgjidhjet duhet të gjinden tek evokacionet e arketipeve letrare të ngarkuara me pamje tona dhe aroma nostalgjike në kornukopinë e manifestimeve vizuele dhe të zhveshura në fluide të dukshme, instant imazheve agresive.

Largimi nga masa, shkrimi i veprave eternale pa autorësi, të pabotuara, të cilat përfundojnë në flakët e skamjes shpirtërore tani, pothuaj është i pamundur. Domeos, masa duhet ta kërkoj poezinë. Ajo shkruhet për të, nuk duhet autori ta gjej kodin e komunikuimit, masa duhet të komunikoj me autorin, masa duhet të begatohet,ta begatoj shijen e vet me frytin e izolimit dhe të vuajtjes së autorit. Nuk ka lindje pa dhimbje. Frika nga vdekja është frika prej lindjes së re, e cila është e dhimbëshme.

Poeti i oborrit mbretëror, Poeti profet, Poeti i shenjtë, Poeti i klubeve poetike- letrare, Poeti i salloneve diplomatike, Poeti i izoluar, Poeti ideologjik, Poeti historik, ka vdekur.

"**Njohja e poetikës vlen shumë pak nëse mungon dhuntia poetike. Njohja e poetikës nga ai, i cili nuk ka dhunti, është njejtë si bujaria e të varfërit, mjeshtria luftarake frikacakut, dhe më shumë se kaq,**

As është mëkat e as ndëshkuese të mos jeshë poet, por të jeshë poet i dobët është e barabartë me vdekje". Thotë kritiku dhe poeti Indian i shek XIII, Bhamaha.

Masa nuk do të lexoj testamentet letrare, masa nuk ka kohë, para, energji. Zgjimi i masës e varrosi poezinë, liria e shprehjes; kanalet ku rrjedh liria e shprehjes, e kanë krijuar shtratin ku rrjedh kjo. Tani duhet më tepër Numinositet.

Accent religieux- u shnëdrrua në Science fiction, Filozofia në Socilogji, Religjioni në Psikologji, Arti në Estetikë, Politika në Kulturë urbane, Misticizmi në Ritual, Rituali në Lojë.

Njeriu i kthehet fëmijërisë me tendëncë të përherëshme për lojë, derisa të arrijë tek Qeshja e shenjtë. **Unë të qeshurit e shpalla të shenjtë; o ju njerëzit e lartësuar më mësoni të qeshë**-thotë Nietzche në Zarathustra.

Më shumë, se tendenca për ndryshim, Arti sakral vepron për ta krijuar të bukurën si Qenie, sepse gjërat që nuk ndryshojnë gjatë të gjitha epokave njerëzore janë; zemra, dashuria njerëzore për të gjithë dhe tendenca për arritje hyjnore dhe sa bukur e vëren Chagall:

"**Çdogjë mund të ndryshohet në botën tonë të demoralizuar përpos zemrës, dashurisë njerëzore dhe tendencave të tij**, që ta njoh hyjnoren. Piktura ashtu si edhe e tërë poezia është pjesë e hyjnores; sot këtë njerëzit e përjetojnë njëlloj sikur atëbotë", thotë Marc Chagall.

Nuk është vonë dhe ndoshta tamam të thuhet, se koncepti i Rudolf Otto-s, Numinositeti është dinamika, e cila i nevojitet krijuesit të kohës sonë, qoftë në Letërsi, Pikturë, Instalacion, Modë etj. Për Numinositet, duhet të kihet më shumë liri individuale dhe kolektive. Kandinsky në një vend thotë; **Secilës epokë i është dhuruar sasia individuale e lirisë artistike, dhe as gjeniu më kreativ nuk mund ta tejkaloj kufirin e asaj lirie**.

Prandaj veprimi në suaza të kësaj lirie merr një tipar tjetër involutiv, të domosdoshëm për kohën tonë të pjekurisë intelektuale, artistike dhe shpirtërore të njerëzimit, respektivisht të zhvillimit të brendshëm shpirtëror, i cili emiton spektrin si produkt i kreativitetit sakral.


NJERIU NDËRMJET…

Nëse kishim me gjetë vetëm një përgjigje, në mijëra pyetje, nuk do të na bënte më të çiltër, mëmendjemprehtë, e as do ishim në gjendje ta shpallim manifestin e zbulimit tonë.

Karen Armstrong ka shkruar një libër, si bletë, duke i mbledhur mijëra shkrime dhe mijëra ide për aventurën më të lashtë njerëzore, atë të kërkimittë Perendisë. Dhe, vetëm për 6000 vite të fundit. Çka para dhe çka pas, na mbetet neve. Kush jemi ne?

Dhe, saherë e kam parashtruar këtë pyetje, përgjigjen e gjeja vetëm tek vetja dhe tek askush tjetër, sepse njerëzit disi hezitojnë të flasin duke ta bërë me dije/ironi, se ata këtë e dinë. Nuk do të ishte zbulim i madhnëse do të prezentoheshin disa fakte, tashmë të njohura, më mirë kishte me qenë të themi, mee zhvesh vellon e diçkasë që tashmë është e njohur, ose me u afru kah diçka, që ndoshta na ka kaluar pa u vërejtur. Nuk mund të numëroj sa herë isha në mës dy mendimesh, dy opcionesh, dy zgjidhjesh, dyzgjedhjesh, dy konfliktesh… Nërininë e hershme zbulova Yogën, nëpërmjet Drago Pleçkos dha Jasmina Puljo (flas për vitet 1986-88).

Fillova ta ushtroj Hatha Yogën dhe zgjimin e KUNDALINIT, dhe gjithë asaj që i vinte pas, dhe ajo që mëvinte ndërmend në fillim ishte dyshimi mos po i përziej dy tradita, dy koncepte dhe dy doktrina të ndryshme,që në esencë dukense burojnë nga një gurrë primordiale e njohjes, ate Hinduse dhe Islame.



Edhe pse Yoga në esencë është metafizike, me shumë disciplinat e saj në Perendim, e ndoshta edhe te ne, konsiderohet lloj sporti. Po, është një lloj specifik i Sportit Metafizik. Andaj, Yoga mund të adaptohet në secilën traditë shpirtërore dhe nuk kri-

jon konflikt. Ajo konsiderohet hapi i parë në zotërimin e vetës. Yoga paralelisht mund të adaptohet mirë vetën me cilëndo rrugë, thotë Mircea Eliade në YOGA, "Imortality and Freedom". Eliade thotë se Yoga, edhe pse ka dalur nga matriksi i botës Hinduse, daton më herët, në parahistori, te Shamanizmi. Autori Francez; Jean Dechant - katolik, shkroi librin "Christian Yoga" (New York: Harper, 1960). Ashraf F. Nizami shkroi "Namaz, the Yoga of Islam" (Bombay: D.B. Taraporevala, 1977), dhe këtë e bënë në dritën e kompatibilitetit, komparativitetit dhe analogjisë së traditave përkatëse.

Para se ta filloj t'i spjegojpozicionet, shih foton ku qëndrimet në Namaz janë identike me shkronjat arabe "Alif", "Dal", "Mim", që e sajojnë emrin - ADEM - që domethënë – Njeri.

Lutja Islame, arabisht e njohur si "Salat", apo persisht si "Namaz", korrespondon me pozicionet "ASANA" të Yogës. "Salat", domethënë lakimi i shpinës, ngjashëmsikur te Hatha Yoga, ndërsa persianët e përkthyen në "Namaz", që domethënë Lakim, që ka rrënjën, etimologjinë, nga sanskrishtja – "Namaste". Ekzistojnë mijëra pozita "Asana" në Yoga, mirëpo gjenialiteti Islam në mënyrë shumë funkcionale i përmbledhtë gjitha këto pozita në ato më efikase dhe më të dobishme dhe të lehta, në mënyrë që secili të mund t'i aplikojë.

Qëndrimi në këmbë "Qiyyam", pozita e malit (Ta Dasana) në Yoga, dhe "Kthimi në mal të Tai Chi Chuan-it", janë themeli i çdo qëndrimi. Ky qëndrim i vë në funksion shputat, këmbët dhe kurrizin. Dobitë e trupit janë të shumëta, mendja vehet në kontroll gjatë relaksimit në këtë pozitë, shikimi përforcohet duke u fokusuar në dysheme, muskujt e epërm dhe të poshtëm të shpinës çlirohen.

Qendrat e epërme dhe të ulëta të trurit unifikohen, duke i shërbyer të njëjtit qëllim. Me këmbë në tokë dhe kokën kah qielli, kjo tregon për rëndësinë sakrale të njeriut, ndërsa vija vertikale është esencë e çdo religjioni.

Qëndrimi "Ruku", i njohur si lakimi i shpinës (shih. Pozitën e dytë, që korrespondon me germën arabe "Dal" - D). Me një

lakim të këtillë, pasi të gjitha nervat janë ta kanalizuara nëpërmjet kurrizit, nëse ky është i shëndoshë, atëherë i tërë trupi dhe shpirti është i shëndoshë. Pas lakimit të mirë, gjaku pompohet në torzon e epërme, çliron muskujt e stomakut, abdomenit dhe veshkët.

Me praktikimin e kësaj pozite, përmirësohet edhe personaliteti, duke gjeneruar butësi dhe harmoni të brendshme. Pozita në Islam, e njohur si "Sujud" apo "Sir Sasana" në Yoga, duke e zbritur kokën përfundi zemrës, sjell gjak të oksigjenizuar në tru, sy, veshë, hundë dhe mushkëri, dhe të gjitha toksinet e trurit pastrohen me gjakun e freskët. Mirëmbanë pozitën adekuate të fetusit te femrat, zvoglon shtypjen e lartë të gjakut, krijon energji të madhe për tërë trupin, ngrit durimin dhe mbështetjen te Perendia. Pozita e ulur në namaz e njohur si "Jalsah",nëmYoga e njohur i "Vajrasana", apo pozita "Zazen" e japonezëve.

Kjo pozitë ndihmon detoksifikimin e mëlçisë dhe stimulon aktivitetin perstaltik. Kur arrihet relaksimi në këtë pozitë, kjo i ndihmon tretjes, duke e shtyer përmbajtjen e stomakut te poshtë. Gjatë kësaj pozite te muslimanët gishti tregues i dorës së djathtë ngritet, duke formuar numrin 1 dhe duke simbolizuar Njëshmërinë e Perendisë, ndërsa në Yoga gishti i mesëm, puthet me gishtin e madh, të parin, duke formuar 0, ku 1 dhe 0 dëshmojnë simbolizmin Tantrik, ndërsa paraqesin sistemin binar 1 dhe 0 të shkencës kompjuterike.

Gjatë kësaj pozite bëhet edhe lakimi i kurrizit, në Islam i njohur si: "Selam" apo paqe, faza përfundimtare e relaksimit, ndërsa në Yoga si: "Ardha matsyendrasana", kah ana e djathtë dhe ajo e majtë. Kjo i ndihmon kurrizit ta relaksojë dhe ta vë balancin, si dhe i ndihmon qafës që të jetë më fleksibile.

FRYMËMARRJA - është një shkencë dhe art në vete te Yoga dhe Namazi. I gjithë veprimi i dimensionit shpirtëror, varret nga frymëmarrja. Fjala arabe "Ruh" do të thotë "shpirt", ndërsa ajo hinduse "Atman", që vjen nga rrënja indo-europiane "Atem", domethënë "Frymëmarrje".

Hazrat Inayat Khan, njëri nga Sufi-të më të mëdhenj të kohës sonë, thotë: "**Shëndeti dhe frymëzimi i njeriut varren nga frymëmarrja dhe për ta ruajtur këtë zgavrrat e hundës dhe të gjitha kanalet e frymëmarrjes duhet të mbahen të pastërta.**" Tek Yoga Kriya është e njohur praktika e "Jala neti" (praktika e pastrimit të një zgavrre të hundës, duke e vënë ujin në njërën dhe duke kaluar nëpër sinuse dhe dalur në zgavrrën tjetër.) Kur muslimanët marrin abdest, apo arabisht "Ëudu", po ashtu duhet uji të tërhiqet deri në sinuse dhe kjo quhet "istinsha".

USHQIMI - principet e mjekësisë tradicionale hinduse, të njohura si "Ayurveda", si dhe hadithet e Muhamedit, nuk janë aspak në kundërshtim dhe pajtohen, që qumështi dhe "Ghee" (tlyni i pastruar – i shkrirë), janë të dobishëm për shëndet dhe të dy rekomandojnë mosngrënien e tepërt të qepës dhe hudhrës. Zengjefili, arabisht "zanjabil", sanskritisht "sringivera" nga proto Dravdianishtja Cinci ver, është shumë i dobishëm për jetën shpirtërore. (I përmendur në Qur'an 76:17)

Edhe "Ayurveda" edhe hadithet e Muhamedit rekomandojnë Nanën. "Tulasi" (Mentha e thënë në sanskritisht), ndihmon Yoga dhe Islami në frymëzim, pastrimin e mendjes dhe arritjen e koncentrimit në meditim; ndërsa në Qur'an (55:12) përmendet "Reyhan" si bimë e xhenetit dhe fjala "Reyhan" rrënjën e ka nga "Ruh" domethënë "Shpirt".

6 PIKA

1.

Nuk mund të numëroj, se për të satën herë kam thënë dhe shkruar se; **nuk mirrem me politikë, por ajo mirret me mua**, prandaj detyrohem të shkruaj edhe për tema të tilla, sepse kjo po më imponohet.

Krejt marifeti i kritizimit të Qeverisë po del, se krijon armiqësi, por sa jemi ne në gjendje ta pranojmë kritikën si faktor korrektues, po rezulton me një shumë minore. Shoqëria Civile edhe këtë herë po del, se është jo vetëm faktor korrektues, por edhe suportues më relevant i çështjes kombëtare dhe nga ajo këkohet ta kryej misionin e vetë vetëm atëhëre kur punët janë pisk, si atëherë kur shkrova se "**çasti çdoherë është më i shpejt se mendja, prandaj atë e kuptojmë kur ai na lë**" dhe një tjetër sentencë, që i fle kësaj situate më mirë, se cilado tjetër; "**në asnjë mënyrë nuk mund të matet një gojë që dërdëllis me një gojë të heshtur, sepse kjo e fundit mbyllet kur vërtet ka të thotë diçka të rëndësishme**"dhe e gjithë kjo më lejon të pohoj se; "**koprracia e fatit asnjëherë nuk krijoi një humnerë ku do të treteshin të gjitha ëndrrat dhe shpresat tona**".

Për mendime të këtilla nuk druaj se nuk kemi mend, por jam i bindur, se na mungon veprimi.

Se si secila fjalë e gjen veshin e vetë kjo është dëshmuar disa herë dhe në këtë rast më shumë se sa është e nevojshme. Neve nuk na mjaftonte alarmi i Albin Kurtit, Veton Surroit, Avni Zogianit apo edhe të Igballe Rugoves, që në këtë shoqëri diçka radikale duhet të ndrrohet. Druaj, se këta sot kanë shumë armiqë , por jam i bindur dhe e perceptoj, se janë krenar që vizionet e tyre tek sot reflektojnë pikërisht atë mungesë të veprimit për, të cilin fola më lartë dhe në të njejtën kohë ndjejnë keqardhje për ne, që nuk i kuptuam me kohë.

2.

Shumë herë jam befasuar, se si në pamundësinë tonë për të qeshur me veprimet e Serbisë, sepse na detyron të qajmë, Evropa nuk qesh, paramendo Serbia, e cila luftën e filloi në Slloveni dhe e përfundoi në Kosovë, na gjykon në Hagë, i gjuhet edhe Kroacisë, Bosnjës dhe Evropa po i ofron stabilizim asocim, që duhet të ndodhte e kundërta që të sulmuarit ta akuzojnë Serbinë për të gjithat që i bëri në 10-20 vitet e fundit, të kërkohet nga ajo që të kërkoj falje ashtu si i kërkuan falje gjermanët popullit hebre. Po ska si të pendohet Serbia kur në vend, që të ndëshkohet ajo akuzon, përfiton koncesione, Schengenin, madje edhe i propozon Kombeve të Bashkuara disa pika që KB po i merr parasyshë dhe po këto KB po e mohojnë Ahtisarin dhe përpjekjen e tij, që në gjuhën e kuptueshme d.m.th., përpjekjen e vetë Kombeve të Bashkuara. Ne ka qenë dashur ta kuptojmë këtë shumë më herët, se kemi pas një Travel Document (dokument udhëtimi) të lëshuar nga UN dhe askush nga anëtaret e Kombeve të bashkuara nuk e pranoi atë dokument që e lëshon UN. Paradoks apo jo???

Po t'i kishim mbi 50 shtete islamike, që do ta pranonin Kosovën mesiguri kjo nuk kishte ndodh. Po të kishim përkrahjen e Vatikanit, mesiguri kjo nuk kishte ndodh, po të kishim Qeverinë më proaktive, mësiguri kjo nuk kishte ndodh, po të ishim ne si popull më të ndërgjegjëshëm, mesiguri kjo nuk kishte ndodh. Janë këto pak nga shumë hamendjet, të cilat përsëriten në ndejat e përditshme kosovare.

Dhe për të gjitha këto unë më së shumëti e kisha fajësuar Akademine e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, kisha kërkuar nga ata si strukturë akademike tëdalin me një plan strategjik zhvillimor proaktiv, jo gjenocidial si Akademia e Serbisë, por një plan të detajizuar, se ku do të shkoj ky vend... të themi në 20 vitet e ardhëshme, një plan, të cilin do ta implementonte Qeveria, cilado, që do të vinte në pushtet, pastaj do t'i mbyllej goja secilit, që akuzon se, Qeveria nuk ka njerëz profesionist, Qeveria është e korruptuar, aty ka nepotizëm e më tha e të thasheve të shumëta???!!!. Sepse Akademia i ka demek kokat më të mëdha të kombit dhe po, që se plani nuk do të ishte i mirë, atëherë do të dihej sakt, kush është fajtor apo kush e çon këtë popull përpara e kush e merr atë në qafë.

Bashkësia Islame dhe Kisha Katolike duhet të krijonin një sinergji më të madhe dhe më proaktive, që t'i kundërvihen kishës ortodokse Serbe, e cila me aq këmbëngulje lufton për mbrojtjen e monumenteve të kulturës dhe trashigimisë, dhe këto të tonat sikur nuk e kanë as monumentet e as kulturë n. I kemi edhe ne sa për të rikujtuar.

Konsideroj, që duhet urgjentisht të organizohet një forum i dy komuniteteve tona fetare dhe të hartojnë edhe këta një strategji kombetare për t'i dhën xhevap kishës ortodokse e cila i harton politikat okupuese të Qevreisë së Serbisë, e cila po e ka vështirë të dal nga ai mentalitet.

3.

Evropa do të duhet ta rishikoj qëndrimin e vetë…, po Spanja e para t'i jap të drejta Katalonasve nëse këtë neve na e fut si standard dhe respektimin e pakicave, pastaj Serbisë, disi Hungaria e ka lënë anash çështjen e hungarezëve apo jo? E shumë e shumë gjëra tjera.

Serbisë mund t'i ndihmoj vetëm Evropa që ta bëj dekontaminimin e mentalititetit okupues, dhe të aktrimit të viktimës, këtë dekontaminim nuk mund ta bëj Vladimir Arsenijeviq me OJQ-në e tij të vogël në Beograd, këtë mund ta bëj vetëm Ev-

ropa duke kërkuar nga Sërbia të paguaj për të bëmat e saj. Tash ata për çdo akuzë nga Koroacia apo Bosnia pohojnë, se në ato vite ishte Jugoslavia, e jo Serbia ajo, që i bëri gjenocidet, nëse është kështu atëherë pse automatikisht edhe Federata Mali i Zi dhe Serbia është pranuar në OKB si trashigimtare e Jugoslavisë, dhe të gjitha asetet e Jugoslavisë i trashëgoi Serbia, si Ambasadat, lidhjet diplomatike, ekonomike, madje shkojnë më shumë në histori edhe ne Ligën e të painkuadruarve etj.

Fatëkeqësisht standardet tek ne janë kuptuar si vetëm për kënaqjen e pakicave, e kryesisht serbëve dhe infrastrukturës rrugore, standard është edhe Spitali dhe për këtë do të flas më posht.

4.

Katër pikat e propozuara të Qeverisë sonë, po e dëshmojnë se Qeveria po e kalon testin dhe është për këtë popull, është përgjegjëse për veprimet e veta në rafshin politik, por jo edhe në atë strategjik, ekonomik, social etj. Na duhet më shumë angazhime për pranimin e shtëtësisë sonë në botë, që të mund ta zëmë një vend në Kombet e Bashkuara.

Targeti duhet të jetë Bota Islame, e cila ka një gatishmëri të shprehur për të na pranuar, por duhet ne të lëvizim në drejtim të Lindjes, për momentin.

Vatikani është shprehur haptas se nuk do ta prish raportin ekumenik me kishën ortodokse Serbe. Po që se do të jemi në gjendje ta bindim Vatikanin do ta kemi mbarë kontinentin e Amerikës latine, dhe në Lindje, po që se e bindim Arabinë Saudike dhe Iranin, do ta kemi mbarë kontinentin e Afrikës dhe pjesën e madhe të Azisë, pastaj Samarxhiqi nuk do të mund të dal me pikat që do ta cenonin qenësinë e Kosovës me apo pa aprovim të Ban Ki Moon-it apo Brukselit.

Dhe Qeveria duhet të kuptoj njëherë e përgjithmonë, se kemi të bëjmë me qasje të ndryshme, se kjo punë nuk është e lehtë dhe mospunën duhet ta ndëshkoj (ashtu si e ndëshkon krimin në Shëndetësi dhe assesi në atë mënyrë e tash presim ta shohim

ndoshta edhe ndonjë profesor universiteti apo ministër) dhe duhet pak të qaj foshnja që nëna ta mëkoj apo jo?

5.

Mitrovica-aq sa duhet fajësuar KFOR-in francez për ngjarjet në Mitrovicë në gati një dekadë, po aq duhet fajësuar edhe krerët lokal politik dhe vetë popullatën e Mitrovicës.

Me ardhjen e NATO-s në Kosovë kontigjenti rus ka qenë i ndaluar që të hyj në Rahovec dhe të gjithëve u kujtohen ato protesta të qytetarëve të kësaj komune, që nuk i prnaojnë Rusët që të jenë me kontigjentin e vetë në Rahovec sëbashku me Gjermanët dhe Holandezët.

Njerëzit atje i kanë bllokuar të gjitha hyrjet në qytet madje nuk kanë lejuar as konvojet humanitare, sepse njherë janë djegur nga rusët dhe tash po i fryejnë edhe kosit. Mesazhi i dërguar e ka arritur qëllimin që të tregohet gatishmëria dhe uniteti i popullatës për ta shfaqur pakënaqësin dhe kjo ka rezultuar me sukses.

Edhe atje ka dy lokalitete me serb, por asnjherë nuk kanë lejuar që të enklavizohet ajo ashtu siç është bërë në Mitrovicë. Kësaj i ka ndihmuar edhe KFOR-i holandez, i cili dy apo tri herë ka marrë iniciativa, që të mbledh armë si nga Shqiptarët poashtu edhe nga Serbët. Kjo i kontriboi shumë, që për një kohë kaq të gjatë të mos ketë konflikte ndëretnike atje.

Mitrovica, natyrisht, që është ndryshe, sepse është shumë afër kufirit me Serbinë, por atje ka qenë dashur të jetë KFOR-i francez, që të punoj në çarmatimin e Serbeve, jo vetëm në kontekstin e armëve per se, por edhe të kontrabandës dhe moskontrollit të pikave doganore, që të mos vij situate në këtë gjendje si është sot.

Dhe ai burri i dheut nga Mitrovica, i cili këmbëngul ta ndërtoj shtëpinë e vet dhe rrefuzon të marr para nga ofertat e qeverisë Serbe tregojnë heroizëm, por më duket se ai është i vetmuar dhe për këtë duhet të reflektoj jo vetëm Mitrovica, por e tërë populata e Kosovës.

6.

Heronjët e Kosovës- shpesh dëgjoj zërat, se dora e shtetit duhet të shtrihet në të gjitha fushat dhe me këtë plotësisht pajtohem. Po më shumë kisha dashur, që të shtrihet në Emergjencën e kosovës, në QKUK, ku ka pak kushte, që i plotësojnë standardet. Mund t'i këmi asfaltet si të Suedisë dhe Finlandës, por jo edhe Shkollat dhe Spitalet. Edhe kjo është standard.

Dhe nëse flasim për Intenziven në QKUK, kur mbi 2.000.000 banorë të Kosovës i drejtohen në raste më të tmerrshme, atëherë po ju them se 8 shtretër me pajisje për trajtim intenziv nuk mjaftojnë. Në asnjë mënyrë!!!

Dhe ata humanistë, që punojnë në atë intensive, mendoj se e kanë shumë vështirë në çdo aspekt, ata nuk guxojnë ta këpusin një furnizim me oksigjen për shembull për ta zëvendësuar më një pacient, i cili erdh më taze dhe i cili duhet të prêt derisa të vdes dikush nga ai repart e pastaj të marr pakëz oksigjen.

Për mua hero i Kosovës është doktori Adem Jaha në Emergjencë dhe Burbuqe Bruqi në Intenzive. I përmenda vetëm dy emra këtu, se këta i njoh personalisht, por janë edhe shumë të tjerë që nuk i njoh, por e mirënjoh dhe i përkulem punës së tyre herioke.

SI SHKRUHET DHEMBJA

"Qeniet njerëzore janë të gjithë pjesë të një trupi
Ata janë krijuar nga esenca e njejtë
Kur një pjesë ka dhimbje
Të tjerët nuk janë të qetë
Nëse nuk brengosesh për dhimbjen e tjetrit
Ti nuk meriton të quhesh qenie njerëzore".

Mosleh al-Din Saadi Shirazi

(Poet Persian i shek. 13, nga Shirazi)

Njeriu i mençur hesht atëherë kur ka të thotë diçka të rëndësishme

Debati fetar gjithësesi është i nevojshëm. Dialogu është ende më shumë i nevojshëm. Jemi dëshmitar të një fenomeni të padurimit të njëri tjetrit dhe kjo u shpreh në kohën e fundit me ato, që i tha Imami Shefqet Krasniqi për Nëna Terezen, posaqërisht.

Thonë se atë, që ai ka thënë ka dal jashtë kontekstit….thonë se, ai ka kërkuar falje, janë prononcuar edhe përfaqësues të institucioneve tona politike, BIK-u etj…

Parashtrohet pyetja çka përfitohet prej prononcimeve?

Sigurisht, se si individ nuk të lë të qetë kjo, që pohohet të ketë thënë Hoxha. Gjykohet, se Gazeta Express po shantazhon komunitetin Islam në Kosovë? Edhe për këtë ka ilaç; është Komisioni i Pavarur për Media dhe Gjykatat. Edhe nëse e ka thënë… Hoxha nuk është i pagabueshëm…dhe thonë, se ka kërkuar falje nëse është keqkuptuar. Edhe MUSA (Mojsiu) ka vrarë dhe Zoti i ka fal.

Ekzistojnë njerëzit, që kanë dhënë shumë çështjes kombëtare dhe për, të cilët duhet të flitet me maturi apo të mos flitet fare. Skenderbeu, Nëna Tereze, Adem Jashari, Ibrahim Rugova, Adem Demaqi e shumë të tjerë. Të flitet për këta njerëz në nënyrë çfarë dëgjuam, vertet nuk na lë të qetë, posaçërisht kur flitet për një person të vdekur, për një grua dhë për një humaniste e Nobeliste.

Nuk është në kulturë të Islamit të ofendoj, as nuk është në kulturë të Islamit, që për njerëzit e Librit (të Krishterët dhe Hebrenjët) të flitet me përçmim, sepse ekziston imperativi Islam, që më njerëzit e librit duhet të flitet me mirësjellje. Nuk është në kulturë të Islamit as të duroj tiraninë.

Ta shikosh Islamin me sy të daltonistit vërtetë është dobësi. Është shumë lehtë të nxirren disa citate e të vendosen jashtë kontekstit. Kështu veproi Geert Wilders në Holandë, por atje gjykata e dha fjalën e vetë.

Po ashtu nuk duhet të hallakatemi me konceptin Liri e Shprehjes, sepse Liria e shprehjes nuk është ofendim, por shprehje e vetës dhe mendimit të vetë. Mos të na ndodh Revolti i masës (Ortega y Gasset), Bojkoti i ndodhisë (Jean Baudrillard) apo Dhuna (Slavoj Zizek). E vërteta është; se e gjithë kjo na ka ndodh.

Sulmet ndaj Islamit janë bërë përditshmëri, prandaj edhe askush nuk befasohet…dhe nëse muslimanët reagojnë, kjo cilësohet si është më keq. Sulmet ndaj Krishterimit ndodhin çdo ditë, dhe më shumë nga Krishterët, se sa nga Muslimanët, prandaj kjo perceptohet keq. Po të shikoheshin këto manifestime si ajo thënia më lartë e Saadi Shirazit problemet vërtetë do të zhdukeshin dhe për këtë ekziston mundësia.

Po të ishte konsultuar me mua Hoxha i nderuar e kisha këshilluar, që të loboj në vendet Islame do të ishte më mirë se të ndaj fetëa se kush ku e ka vendin. E kisha këshilluar edhe të loboj në Qeveri të kosovës, që të siguroj më shumë vend për besimtarët, sepse falen në podrumin e Novi Dom-it dhe në rrugë në Dardani e gjetkë, por të ndërtohet një Xhami e madhe ku besimtarët do të faleshin me dinjitet, e kisha këshilluar, që të angazhohej edhe për ndërtimin enjë Sinagoge për hebrenjët nga komuniteti ndërkobëtar…ky imazh (dhe jo vetëm imazh, por realitet) i duhet Kosovës, një vend për të gjithë.

Vizioni im i Kosovës është ai manifestim, të cilin e shkatërroi Spanja mesjetare…atje ka ekzistuar Convivencia- një bashkëpunim i përkryer i dijetarëve Islam, Krishterë dhe Hebrenjë …që të përkthejnë dijen e huaj në gjuhën e kuptueshme, që ta krijojnë një qytetërim, i cili shkëlqente. Kosova e ka këtë mudësi, sepse po jetojmë në rrethana kur kjo është mëse e mundëshme…jemi shtet multietnik, multifetar dhe vertet demokratik dhe për një gjë të tillë tani janë kushte ideale. Krejt çka duhet është të punojmë. Dhe tash po e kuptoj më mirë Eqrem Kryeziun, vërtet na duhet një Ministri për çështje fetare, e cila do ta rregullonte këtë.

Më shumë kisha pas dëshirë ta kem në gjuhën shqipe Ibn Arabiun, San Juan De la Cruz-in, Maister Eckhart, Roesenbroeck, Hildegard Von Bingen, Rabia Al Adevia, Evelyn Underhill, Moshe Maimonides, Yuda Ha Levi, Francis Assisi etj., sesa të determinojmë kush ku e ka vendin…Zoti na urdhëron të mësojmë jo të ofendojmë, Zoti na urdhëron ta respektojmë kohën, sepse ai betohet në kohën…Zoti na urdhëron të njihemi më mirë …**.kam krijuar popujt që të njihen më mirë mes veti**…

Po del se nuk e njohim mirë njëri tjetrin dhe këtë duhet ta bëjmë sa më shpejt.

Ndjej empati për pjesë të lënduar të trupit, nuk jam i qetë, sepse jam njeri.

REMINISHENCAT

Sot nuk di pse u zgjova me kujtimin për Egjiptin. Ndoshta pse mbrëmë isha duke e lexuar librin e Otto F. A. Meinardus, MONKS AND MONASTERIES OF THE EGYPTIAN DESERTS (Murgjit dhe manastiret e shkretëtirave të Egjiptit).Ja këtë efekt e ka ëndrra. Atë që momentalisht nuk mund ta plotësojmë me këtë realitet (Zgjendërr) e kompenzojmë në udhëtime astrale (në Ëndërr) dhe natyrisht mesazhin e kuptojmë apo dekodojmë në gjuhën e kuptueshme duke e ditur kodin ëndërror.

Dhe kujtoj mjerisht, se në universitetet tona ende ligjërohet psikologjia në nivelin e eksperiminetit të Pavlovit dhe thonë së Intuita është **koncept iluziv**. Tragjedia qëndron aty se profesorët e importuar nga vendet me trashigimi psikologjike kolektive, të kazaneve ku të gjithë proletarët hanë me një vend dhe iluzionet, pikërisht koncepte dhe të bërat më bizarre sadiste ndaj popullit të vet. Kjo është pasoja, që lë gjurmë si gdhendja në gur.

Libri i Otto F. A. Meinardus, MONKS AND MONASTERIES OF THE EGYPTIAN DESERTS, flet për historinë e sakrificës në rrugën e Zotit, të njerëzve, të cilët me shekuj e kanë ruajtur traditën e krishterë, për të arrituarat e tyre shpirtërore dhe rrugën e Metanoies, pjekurisë shpirtërore, për themelimin e vendbanimeve, dhe luftën vetëmbrojtëse nga sulmet e Beduinëve.

Kisha Kopte Ortodokse e Shën Marisë Ikona e fluturimit në Egjipt, 14, Massarra street. Cairo, Kisha Al Muallaqah, Kajroja e vjetër, EGYPT.

Ekziston një histori e regjistruar në shkrimet e ruajtësve të kësaj trashigimie dhe thuhet, që Hally ishte i martuar me një grua dhe vdiç duke mos lënë pasardhës.

Në bazë të ligjit hebre, vëllau i tij Jakobi e martoi gruan e tij dhe u lind Jozefi. Ky i fundit në Bibël ndonjëherë quhet i biri i Jakobit, dhe në bazë të ligjit natyror dhe në kohë tjera i biri i Hallyt, në bazë të ligjit hebre, i cili urdhëron, që nëse njeriu martohet dhe nuk ka fëmijë, vëllau i tij e marton gruan e tij, që të ketë trashigimtarpër vëllaun e vdekur.

I lindur i parë bëhet fëmijë i ligjshëm i vëllaut të vdekur dhe i atribohet atij. Jozefi i cekur më lartë është i fejuari i Shën Mërisë. Shën Maria kishte një motër po ashtu, tëquajtur Maria. Ajo është gruaja e Klooba-së dhe të Lusit, Simonit, Jakobit dhe Judës- dhe të gjithë janë përmendur në Bibël si vëllëzërit e Jezusit (në bazë të marrëdhënieve fizike Jezusit i bijnë kushëri).

Shën Maria u deklarua që të mbetet e virgjër dhe qëndroi në Tempull deri në moshën 12 vjeçare. Pastaj ajo u fejua me Jozefin





me urdhërin e engjëllit të Zotit,i cili i urdhëroi të gjithë që të mbledhin shkopinjë dhe të shkruajnë secili emrin e vetë në shkopin e vetë dhe t'i vendosin nëAltar. Shkopi i Jozefit mbiu. Dhe ai e pranoi Virgjëreshën dhe e çoi në shtëpi. Gjithashtu thuhet që pëllubmi u paraqit në shkopin e Jozefit pastaj fluturoi dhe u vendos në kokën e tij.

Në muajin e gjashtë, Zoti dërgoi engjëllin Gabriel si lajmëtër i lajmit të madh për Shën Marinë duke i thënë: «Përshëndetje, puna jote është e plëqyer dhe Zoti është me ty…puna jote në mesin e grave është e bekuar.... Ti do të mbarsesh dhedhe do të lindësh djalin me emrin Jezus.»Gjashtë muaj kaluan që kur engjëlli i Zotit,Gabrieli e priti Zacharian me lajmin e mirë, se gruaja e tijElisabeta do t'i lind atij një djal dhe ai do të quhet Gjon. Kë shtu që Gjoni është gjashtë muaj më i vjetër se Jezusi.

Shën Maria vdiç më21 Touba1 (muaj kopt) në moshën 58 vjet, 8 muaj dhe 3 ditë.Kisha e feston ditëlindjen e saj më 1 Pashons, hyrja e saj në Tempulme 3Koiak, dhe vdekja e saj me 21 Touba. Më1 qershor (24 Pashons) kisha e feston përvjetorin e arritjes së familjes së shenjtë në Egjipt.. Dihet se Familja e Shenjtë arriti në El Ferma në kufirin verilindor të Egjiptit (vendi sot i quajtur Port Fouad). Pastaj kaluan në Tal Basta (sot qyteti Zagazig)- atje arritën më 24 Pashonss. Kështu, Zoti e bekoi tokën tonë dhe të gjitha idolete vjetra egjiptiane u shndërruan në copëza që të kuptojnë qëndrimin në Bibël: " Atë ditë do të ketë në mes të vendit të Egjiptit një altar kushtuar Zotit, dhe një shtyllë të ngritur për Zotin pranë kufirit të tij. (Isaiah 19:19).

Shën Maria u ul nën hijen e një lisi. Jozefi e preku tokën me shufrën prej çeliku dhe aty buroi uji. Thuhet se njeriu i quajtur

1 THOUT, i cili është prej 11 shtatorit deri 10 tetor, PAOPIi cili është prej 11 tetorit deri 10 nëntor, HATHOR, prej 10 nëntorit deri 9 dhjetor, KOIAK, 10 dhjetor deri 8 Janar, TOBI prej 9 janarit deri 7 shkurt, MESHIR, prej 8 shkurtit deri 9 mars, PAREMAT prej 10 marsit deri më 8 prill, PAREMOUDE prej 9 prillit deri 8 maj, PASHONS prej 9 majit deri 7 qershor, PAONI është prej 8 qershorit deri 7 korrik, EPIPO është prej 8 korrikut deri 6 gusht, MESORI është prej 7 gushtit deri 5 shtator, PI KOGI ENAVOT është muaji I trembëdhjet dhe I fundit I kalendarit kopt dhe është prej 6 shtatorit deri 10 shtator.

Kalloum u befasua me atë çka ka parë. Ai e ftoi Familjen e shenjtë në shtëpinë e tij, ku më parë kishte zakon me iu lut idolëve.. Idoli u thye pjesë pjesë. Pastajpriftërinjtë pagan kërkuan vdekjen e Jezusit.

Pastaj Familja e shënjtë kaloi nëpër Belbeis dhe vazhduan për Menyat Genah afër qytetit të sotëm Sammanoud. Atje Jezusi bëri që të del burimi i ujit. Është ndërtuar një kishë në atë vend e quajtur Beekha Isous, ose i Froni i Krishtit; kurse tani është e njohur si Manastiri i El Maghtas-it.

Familja e shënjtë kaloi nëpër luginën El Natroun dhe Zoti e bekoi atë vend dhe e mbushi me manastire dhe e populloi me murgj. Pastaj Familja e shënjtë kaloi në Ein Shams dhe El Matterya. Jozefi e kishte një shkop, të cilin Jezusi e mbodhi dhe në atë vend uji buroi kurse shkopi u rrit në lis. Lisi El Matterya akoma jeton dhe ka më shumë se 2000 vjet.


Familja e shenjtë kaloi nëpër vendin, ku tani është e vendosur kisha Abou Serga në Kajron e vjetër.

Pastaj Familja e shënjtë kaloi në Egjipin e epërm afër Samalout-it duke kaluar nëpërEl Ashmouneen, malin Kiskam, Meir dhe malin Drinka në Assyout. Manastiri El Moharik ka një kishë antike në anën e shpëllës ku qëndroi Familja e shenjtë.

Të gjitha këto rrëfime sot i kujtoj me një ndjejë krejt tjetër, që të bëj një krahasim me forcën e mendjes së njeriut dhe fuqit, që ka a ashtuquajtura psikologjia personale.

Otto F. A. Meinardus, MONKS AND MONASTERIES OF THE EGYPTIAN DESERTS (Murgjit dhe manastiret e shkretëtirave të Egjiptit), flet për Charismaticus apo njeri, i cili ka dhunti të hirit ngjashëm me Nurin e Sufi mjeshtërve dhe përderisa fenomenet të jashtëzakonshm tëMurgjëve Kopt Egjiptian, janë të njohura si Thaumaturgi, tek sufinjtë mrekullitë e tilla janë të njohura si Keramet. Dhe ajo çka është e rëndësishme të ceket, se nuk është regjistruar asnjë duel të Kerametit dhe Thaumaturgisë, nëse veçohet ajo e Mensur Hallaj në shek IX me priftërinjtë e Bagdadit, si në historinë e dueleve të nxënësit dhe mësuesit, Alistair Croëley dhe MC Gregor Mathers, dhe gruas

së MC Gregor Mathers me Dione Fortune në shekullin XX, gjë që mund të jetë temë për Reminishencën II.



Otto F. A. Meinardus, MONKS AND MONASTERIES OF THE EGYPTIAN DESERTS (Murgjit dhe manastiret e shkretëtirave të Egjiptit). **American University in Cairo Press**

NEBAL[2]

Përballë në largësi ajrore 400 metra në vijen ajrore, dukej një gungë pembe e lisave të porsaçelur. Në këtë distancë, era, direkt e mbante në krihët e ndonjë puhize dedikuar, që të udhëtoj në zgavrat e hundëve të të zgjuarve, aromat e para që të rrenqëthin lekurrën, e ajo të duket si grihet

Vendosa të shkoj atje e t'i pluhros qepallet me pollen të artë tek lëvizte përfytyronte, se si i këndon këngën Përendisë. Paramendo Davidin e trieliumit, që në vend të Nebal-it i bie këngës laserike nga Sony minidisc dhe paisjet përcjellese . Natyrisht të incizuar kishte Vollenëeider-in "Peachtree valley" dhe qëndrontë nën hijen e kurorave pjeshkave të çelura ku projekton kë naqësinë shekullore në momentinpër të; mëtë lumtur. Fliste me pjeshkat e çelura dhe u premtoi, se do të vi çdo fundjavë, që ta zbraz dashurinë dha ta absorboj atë nga ato kuptohet me nuancat e tyre florale. Meditimi i këtillë i sjell shërimin tërë qënies duke filluar nga elementet, akashën, magjinë e shpirtit.

Paralelisht e këndoi psalmin e Davidit URATA E DAVIDIT 3[3]
SHIKO ZEMRËN TIME EJA NATËN
ME ZJARR ME SPROVO
POR TEK UNË NUK GJEN DOT PAUDHESI

2 Nebal instrument i vjetër hebrej me tela që lozej me dy duar si harpë.

3 Psalmet – Urata e Davidit 3 Psalmi 17(10) faqe 278 përkth. Konstantin Kristoforidhi, Vehap Shita

Dhe psalmin e vetë 99
SHIKO QENIEN TIME ÇDOHERË
ME UJË ZJARR TOKË E AJËR MË SPROVO
TE UNË GJEN ÇDOGJENË TËNDE
TE UNË GJEN ASGJËN NË ÇDOGJE

Ndërsa tingullin e Nebalit të tij e dëgjonte vetëm ai, ashtu pastër nga paisja elektronike, ndërsa të metamorfozuar e vibronte për pemishten epjeshkës dhe sistemin ekologjik, që bashkarisht me të nuhatte aromën e trileniumit dhe aromën e kënaqësisë, që frymon me plotësinë e epokës.

VAZHDON

MBI ELEMENTALIN

Në praktikën e inicimit sakral, ekziston një mjeshtri e veçantë kreative. Për ta arritur këtë shkallë të inicimit dhe për ta përvetësuar këtë mjeshtri, duhet potëncial i artikuluar në nivel të lartë, ashtu sikur edhe kreativitet, durim,fuqi guximore dhe që, të gjitha këto në kohë të caktuar, të përputhur në nivelin evolutiv shpirtëtor. Mjështërit e lashtë dhe të mëdhenjë e kanë quajtur TEKNIKA E KRIJIMIT TË ELEMENTALEVE

Fluturimthi kam përmendur disa herë termin ELEMENTAL, por asnjëherë nuk jam detajizuar, që ta rrumbullaksoj përshkrimin e domethënies së elementalit. Në fakt Elemental është krijesë subtile e krijuar nga Teurgu, që drejtëpërsedrejti merr pjesëe në procesin kreatriv kosmik. Forma e tij varet nga kreativiteti i Teurgut. Këtu isha ndalur sëpërshkruari vetëm e vetëm, që të mos e kaloj kufirin e MEZOTERISË, pra, që ta mos e kaloj kufirin e saj.

Një gjë që guxoj të shtoj është se këto janë në shërbimin e tij deri në afat të caktuar.

Procesin e krijimit të Elementaleve e kam filluar qysh herët. Toka në, të cilën jetoja ma mundësoi këtë. Në konsultim me filozofët edhe më skeptik nga ata na tha; Hume", që kjo tokë (imagjinata) është një lloj i aftsisë magjike të shpirtit, e cila tek gjenitë është çdoherë e përkryer dhe mund të thuhet, që kjo është ajo, që quhet -gjeni".

Fillova t'i thithi nektaret nga lulet më të ndryshme tek vonë klitha:

BLETË
Unë
Jam

Gjë, që ishte një shembull më tipik i poezisë ekstra të shkurtë, që atëherë titullova NANOPOEZIA.

Në bisedë me Bimën (nga slajdi MASKA në pjesën e tij të fundit të quajtur TAKIMI I FUNDIT, aty ku flitej për metamorfozën dhe përfundoi deri të Imago, rrefeva për elementalet nëpërmjet analogjisë me ikonat kompjuterike dhe mendoj, që është shembull me briliantë për ta kuptuar natyrën e Elementalit.

Shtresa e vjetër pakez me thellë, që po sikur edhe ajo paraprake e ka humnerën e vet është RREFIMI PËR SLAJDET- Për këto është folur aq shumë sa, që konsideroj, që këtu nuk ka nevojë të detajizohem në përshkrim të rrumbullaksuar të domethënies për slajdet. Për slajdet kam folur me infratingull në Eonin NUN, por në menyrë të artikuluar fola në eonin SHUMËSI E PADUKSHME dhe atë për herë të parë pas shumë proceseve metamorfozike, që janë në zhvillim e sipër. Në eonët FRYTI E FAR-Abëhej transmetimi i drejtpërdrejtë, që quhet derdhje direkte apo rrëshqitje pa vetëdije në botën e tekstit.

Krijimi i kosmosit letrar është një proces shumë i nderlikuar.Ajo çka mundet të thuhet këtu, është vetëm shtresë nga të shumëtat të mundëshme. Ndërsa koha e krijimtarisë është diçka që mundet vetëm të imagjinohet.

Kufizimet e çdo lloji/niveli kanë domethënien vetëm në raport me fuqinë kreative të atij që e filloi ta krijoj. Në fjalorin tim haset si LITTERASPACE dhe LITTERAETHER dhe nuk do të thotë, se kështu duhet të mbetët. Sa i përket mundesisë dhe mënyres së krijimit mund të diskutohet në ndonjë rast me të volitshëm.

MBI HAZARËT

Nuk do të mirresha fare me Hazarët po të mos më lidhte nyja e gjurmëve për Nektarinën. Për Hazarët do tëflas shumë shkurt mos ta ngarkoj qëllimin, sepse ai është nisur në rrugë për të gjetur pikërishtatë më të nëvojshmen për vete.

Në përpjekjen e vet që t'i referohet TOKES REALE për çdo hap shkoi dhe siguroi një ATANOR ku shpreson, se në mënyrë alkimike do ta gatuaj atë pllakë, që e quajnë GURI FILOZOFIK (pllake smagradi).

Ndërsa tani mëpërcjell me kujdes:

Hazarët i takojnë grupit të fiseve turke, të cilët në shekullin e VI themeluan mbretërinë e madhe, e cila përfshinte territorin e sotëm të Rusisë Evropiane Juglindore. Në fillim të shek VII ata u pavarsuan nga mbretëria Turke dhe u ballafaquan me një seri luftërash me Arabët. Kështu me 661 Arabët i detyruan ta lëshojnë Darbentin. Ndërsa në vitin 720 Arabët dhe Hazarët luftuan në betejën direktë në Armeni. Në vitin 737 ata themeluan kryeqytetin ITIL, që ishte i vendosur buzëlumit, Volga ndërsa malet e Kavkazit i pranuan si kufi i tyre verior.

Në shekullin VIII arritën kulmin e civilizimit të vetë, që shtrihej përgjatë bregut Verior të Detit të Zi nga Volga e ulët dhe Deti Kaspik në Lindje, në lumin Dniepër në Përendim.

Nën sundimi e vetë i kishin Allanët dhe popujt tjerë të Kavkazit verior ndërmjet maleve dhe lumit Kuba. Magyarët (Hungarezët) që i banonin trevat e lumit Donët. Gotët, kolonitë greke

të Krimesë, Volga, Bullgarët dhe një numër të madh të fiseve sllave.

Udhëheqësi shtëtëror me karakter gjysmëreligjioz quhej Khagan. Kthesë në pushtet dhe klasa udhëheqëse kaluan në Judaizëm. Kështu Hazarët u bënë paraardhesit e Hebrenjëve Evropian dhe Rus. Se si kaluan në Judaizëm askush saktësisht nuk mund të tregoj.

Ndikimi i tyre ishte shumë i madh në atë kohë, vecanërisht në Bizant. Kështu argumentohet me faktin se Justiniani II (704) dhe Konstantini V (732) kanë pasur gra Hazare. Ngjashem si Sollomoni, që kishte gruan nga familja e Faraonëve dhe ndikimi egjiptas ishte i dukshem në Judenë e asaj kohë.

Ligjdhënësi i Kijevit Svjatosllavi në vitin 965 e mundi fuqinë ushtarake të Hazareve dhe roli i tyre politik në vendet Veriore të Detit të Zi u shua.

Dokumentet historike dëshmojnë civilizimin e tyre dhe kryesisht këto janë dokumentët arabe dhe bizantine, e sa i përket gjuhës hazare, nuk ka mbetur pothuaj asnjë gjurmë.

. . .

Hazarët ishin të njohur për kultivimin e rrushit. Këtë e deshmon ky varg,që sipas një versioni është pjesë e Nektarinës në gjuhën Hazare. Vargu e ka këtë përmbajtje:

PELCET SI RRUSHI I PJEKUR NGA MALLI PËR TË DASHUR

Që të plotësohet boshlleku i qëllimit të këtij rrefimi për Hazarët, do të cek se kur në vitin 720 Arabët dhe Hazarët luftuan, një luftëtar Hazar ishte zënë rob nga Arabët. Në traditën arabe, që një rob mund të lirohet po, që se i mëson shkrimin ose gjuhen e tij, sëpaku 10 Arab, ky Hazar duke konvertuar në Islam dhe përkthyer Nektarinën në gjuhën Arabe, ai u natyralizua dhe jetoi duke u kënaqur në jetën e begatshme të civilizimit të atëhershëm arab. Ky është edhe një variant i hulumtimit të prejardhjes së Nektarinës dhe si ajo erdhi në gjuhën arabe.

PROFECIA E BARDHË PËR DITË TË ZEZA

Hapshëm presim secilin lajm rreth statusit përfundimtar të kosovës. Çka do që do të thotë Ahtisari, Janusz Bugajski, Daniel Server, ngjashëm si në kohën e bombardimeve të NATO-s, pritnim çka thoshte Jeamie Shea, BBC, CNN DWetj. Tani e gjithë kjo po na vjen si përsëritje e etheve të luftës ku nuk na dihet fati.

Kosova ashtu si është diqysh, do të bëhet një vend me status diqysh, sepse edhe ne jemi diqysh.

Që në fillim të UNMIK-ut ashtu edhe në mbarim të tij, u manifestuan fenomenet, që për herë të parë ndodhën në botë, prandaj edhe satatusin do ta kemi ashtu si nuk e ka askush në botë.

Veç të reflektojmë rreth UNMIK Travel Document, të cilin ne kemi zakon me i thënë pasaport, do të kuptojmë lekcionin, të cilin na e dhanë. Një dokument legal, që e lëshon organizata botërore,nuk pranohet në asnjë vend anëtar i po kësaj organizate. Ne po përpiqemi ta zëm një vend në këtë organizatë, por çka nëse e fitojmë? Cili prej shteteve do të na pranoj.

Ne jemi dëshmitar si të paaftë për të udhëhequr, që në fillim të UNMIK-ut. Edhe tani po e vazhdojmë këtë.

I lexuam lajmet për veturat e shtrenjta të ministrave, të telefonatave të shtrenjta të shoferave të tyre, pastaj KEK-u, tenderat dhe shumë e shumë probleme tjera si 17 marsi 2004, tevona ai farë decentralizimi, i cili po na vjen absolutisht në kundërshtim

më atë vizionin KOSOVA MULTIETNIKE, kurse ai po na del monoetnik, njëfarë autonomie dhe krejt kjo derisa populli bën sehir, tërësisht i hutuar si jetim në kërkim të mbështetjes.

E ku? Në cilin skut me u ul?

Në rastin e shpalljes së pavarësisë, sërbët do ta inskenojnë egzodin masiv, për të dalur në tituj kryesor të mediave botërore, duke u arsyetuar për mungesë të të drejtave të pakicave, lirisë së lëvizjes etj. Mund të ikin edhe turqit edhe boshnjakët, jo për mungesë të drejtash, por për shkaqe ekonomike, ashtu si kanë ikur shqipëtarët gjatë viteve të 90-ta, edhe tani mund të ikin, sepse niveli i korrupsionit, mungesa e vizionit për zhvillim ekonomik, mungesa e resurseve tjera, do të jenë faktorë te migrimeve. Po ku të shkojnë shqiptarët kur veç në Zvicërr janë, menjëherë pas gjermanëve, francezëve dhe italianëve, apo këtu bashkangjiten pesë million shqiptarë të asimiluar në Turqi, 600 000 shqiptarëve të asimiluar ne Greqi, apo t'u bashkangjiten atyre në Ukrainë. Çka nëse mërgata shqiptare kthehet në Kosovë në numrin e lartëcekur, këtë nuk do të na e lejojnë kurse sërbët flasin për 250 000 serbë të ikur nga Kosova pas përfundimit të luftës. Sa prej tyre ishin milicia, paramilitarë dhe ushtria e Jugosllavisë së parafundit?

Dhe kur u flet Ahtisari për krimi-trashigiminë e tyre botërisht të njohur, grupi i tyre negociues, kisha ngrisin zërin, ofendohen, në vend që, të pendohen dhe të kërkojnë falje. Gjermania ende i vuan pasojat e nazizmit. Rasti i Gunther Grass-it p.sh. njeriu shkruan autobiografi dhe pendohet, që ishte i rekrutuar pa dëshirën e tij nëSS, kurse Sërbët po i sheh bota se si e inicuan 17 marsin, me vrasjen e fëmijëve shqiptarë dhe askush nuk i ndëshkon, por i shpërblen me koncesione. Ndoshta kjo është ajo, që ata i mban të forte.

Dy Hebrenjë rrahen nëSërbi nuk ka reagime për antisemitizëm, kurse dy hebrenj të kidnapuar në Lindjen e Mesme, nxisin një luftë të përgjakshme. Absolutisht nuk e përkrah Hezbollahun njëlloj si nuk i përkrah veprimet e qeverisë së Izraelit për vrasjen e civilëve Libanezë.

Njerëzit thjeshtë pyeten si është i mundur Tajvani, Kuvajti, Liternshtajni, San Marino, e Kosova nuk është e mundur.

Njerëzit pyeten pse një figure fetare si Artemije përzihet në politikë dhe e shfrytëzon vakuumin e prijësëve tjerë fetarë ne Kosovë dhe ende luan me letra, se po e mbron krishterimin ne Evropë.

Se çfarë muslimanë janë kosovarët, e di më mirë Evropa dhe Amerika se sa vetë kosovarët. Unë nuk e kuptoj për çfarë krishterizëm flet Artemije kur priftërinjët e tij i bekonin tigrat e Arkanit për vrasje të fëmijëve shqiptarë në Kosovë ashtu si nuk i kuptoj kamikëzët e Hamasit dhe grupeve të tjera për çfarë islam flasin.

Për çka ka nevojë Kosova?

Kosova ka nevojë për Kosovën, për kosovarët, Kosova ka nevojë për popull dhe të pushojë së ekzistuari si fis, kosova ka nevojë për lidership moral,› i cili nuk do ta pijë gjakun e popullit, i cili nuk do t'i thajë gjepat e popullit, i cili duhet t'i vijë turp se e punon atë që nuk e di, i cili duhet të përkulet për gjakun e dëshmorëve, i cili duhet t'u shtrijë dorë të varfërve, t'u shtrijë dorën minoriteteve, jo pse bashkësia nderkombëtare ua imponon këtë po, pse janë njerëz dhe kanë gjak dhe të njejtën ajër e të njejtat rrezet e diellit i marrin, pse kështu në pozitë e kthejnë nderin e mikëpritjes dhe bujarisë shqiptare, e cila mbahet në mendë vetëm si emër.

Kosovës i duhet feja e jo ketmanet, Kosovës i duhet edebi (edukata tradicionale familjare), Kosovës i duhet arsimi bashkohorë, Kosovës i duhen njerëz të NDERSHËM (me germa të mëdha), Kosovës i duhet flakja e paragjykimeve, Kosovës i duhet rrinia, e cila pëlcet nga origjinaliteti si rrushi i pjekur, Kosovës i duhet arti, i cili buron nga zemra e artisitit e jo ai me t'nime e me t'pame, Kosovës i duhen nënat, të cilat u qesin fëmijëve të tyre guraleca në këpuca për t'i trajnuar dhe për t'i testuar, nëse nuk janë për vete nuk janë edhe për të tjetrë, kosovës i duhet sinqeriteti e jo hamendje e të qenit të sinqertë, Kosovës i duhet

dashuria, sepse dashuria nuk është më kat edhe pse me kot përpiqen ta bëjnë, Kosovës i duhet nëna t'i tregojë, që të pregatitet për menstruacionet, Kosovës i duhet baba, që ta mësojë para se tëhyjë dhëndër, Kosovës i duhet femija që u nis me hënën e plotë dhe krejt në fund kosovës i duhet i zoti i shtëpisë, i cili nuk lun kumon e nuk pi deri sa familja hanë bukë të përvlume me çaj, dhe në fund të krejt-it; Kosovës i duhet mëngjesi dhe uji i ftohët sytë me i shpërla, Kosova po e dëshmon se vështirë është me qenë popull, sepse këtë e ka huq në shek. e XIX-të.

Çka pas?

Në rast të dramës së ekzodit masiv të Sërbëve, Shqiptarët më së pakti duhet të gezohen, ndërsa një ngjarje e tillë nuk është larg mendësh, sepse Sërbët e kosovës, aq shumë janë të manipuluar nga Beogradi sa s'bën.

Zyrtarët e qendrës për koordinim të Kosovës dhe Metohisë, paguhen 3-4 fish më shumë se profesorët e universitetit në Beograd dhe shërbejnë si agjentë për të krijuar klimën e pakënaqësisë tek popullata sërbe e kosovës. Dhe të gjithë këta janë krahu i Koshtunicës, i cili ende jeton në remenishencat e lavdisë së Sërbisë së viteve të90-ta dhe zëri i imët i demokracisë sërbe tek Tadiqi, dhe Qedomir Jovanoniq, pothuajse; është i padëgjueshëm nga mazhoranca sërbe, e cila ushqehet me predikimet e kishës mediale millosheviqiane të RTS-it.

Është paradoksal fakti, se guximi demokratik në Sërbi është shumë feminin (Biljana Kovaçeviq-Vuço, Sonja Biserko, Natasha Kandiq) dhe një i ri si Qedomir Jovanoviq. Po të ishte gjallë Millosheviqi do ta kishte likuiduar, ashtu si e likuidoi mikun familiar Quruviën, por mos likuidimi i zërit demokratik femëror, dëshmon se mentaliteti i ballkanit, femrën nuk e bën hesap dhe si e tillë ajo mbieton për t'u kërcënuar tani kur është uji i turbullt.

Në Zllatibor është i vendosur fshati Kremna dhe në Sërbi disa ribotime të profecive të Kremnës dolën në shesh. Familja Tarabiq nga Kremna, dha dy parashikues, të cilët përjetuan vizione të asaj çka po ndodh sot, si; zbulimi i trenit telefonit,

sërbisë së vogël, e cila do të jetë aq, sa të gjithe sërbët do të tubohen nën një dardhë, humbja e Kosovës, lufta e tretë botërore etj, etj. Shumica e Sërbëve ishin skeptikë për profecitë e Tarabiqëve të shek. –XIX-të, por shumica e profecive u realizua.Meqë po del kështu dhe prej 99-tës, Kosovën nuk e qeverisë Sërbia dhe Kosova po kalon nëpër urën e demokracisë globale, është e natyrshme, se vështirësitë, të cilat po i përjetojmë janë tepër të rënda, e para: sepse nuk kemi traditë shtetëformuese, mentaliteti i strukturave udhëheqëse nuk është në raport me trendin e zhvillimeve demokratike, përvoja e pakët institucionale dhe trashigimia tradicionale e lidershipit patrenalistikë, pastajresurse të pashfrytëzuara njerëzore dhe natyrore, mungesa e vizionit për një të ardhme të shëndoshë dhe stabile, mungesa e përvojës për ndërtimin e strategjisë zhvillimore në çdo nivel, për një afat kohor prej dekadash etj.

Bëhu ti ndryshimi, të cilin dëshiron ta shohësh në botëthotë Mahatma Gandi.

Ne mjaftë kemi ndryshuar ,por nuk guxojmë të mbesim në mes të rrugës.

GLORIFIKIMI I IMAZHIT HYJNOR I



Ajo çka dëshiron të na thotë me gjuhën e tij të ngjyrave dhe kreativitetit, kur kumbon heshtëshëm me vale infrazanore dhe imazhe nga mbrendësia e e projektuar në pëlurë, Artan Balaj na vjen në kohën kur arti pamor në Kosovëoscilon ndërmjet të dukshmes dhe të padukshmes, letargjisë dhe rebelimit të mirëfillët, ndërmjet asaj, që jemi mësuar t'i themi tradicionale dhe bashkëkohore me vulen e tij duke vënë theks të veçantë, në vizatimin e transformuar nga klasicizmi, në trajtën dhe mediumin e kombinuar, të cilin me sukes e konsumon për ta artikuluar mjeshtrinë dhe frymëzimin në formën reale, surreale e deri te abstrakcioni okult, gjë që atëe dallon nga artistët tjerë në kuintesencë, e dallon edhe për kah lirika transcendetnatle dhe angazhimi urban për iluminimin e artitit të tij dhe të ngjajshëm në heshtjen dhe paralizën aktuale kulturore.

Prej gjithë asaj, që mund të vërej një pëlqyes arti, është dimensioni sakral esoterik, në të mundshmen e prezantimit të një realiteti të heshtur, duke na i shfaqur vibrimet infra dhe ultra-

zanore në formë të vizatimit elektromagnetik të valeve të zërit, të cilat na flasin me gjuhën e këmbanës, për të na zgjuar nga letargjia, pastaj nëpërmjet refleksioneve (efektit të Albedos), të frikës, realitetit dhe një meta-realiteti, i cili si perdet e teatros, tërhiqet dhe e thotë tërë shfaqjen në gjuhën e rafinuar artistike, e manifeston heshtjen kolektive për fenomenet e ndryshme të natyrës biologjike (spermatozoidet dhe vezorët), të natyrës fizike (zërat dhe format), të natyrës shpirtërore (frikën, errësirën dhe dritën) dhe të asaj optike (ngjyra, nuanca dhe perspektiva), që del si shtresë e parë materiale, e dukshme, e manifestuar në pëlhurë.

Ajo, që për mua, Artan Balajn e bën të veçantë, është mjeshtria kombinatorike e stileve, mediumeve, teknikave, liria individuale artistike, guximi dhe lirika e kësaj shprehjeje dhe siguria në kreativitetin e vetë, e cila hap shtigje dhe jep opcione gjeneratave më të reja, jo si themelues i diçkasë së re, por si proklamues i diçkasë ndryshe, duke e parë hapsirën e mjaftueshme në qiellin artistik, për ta iluminuar edhe një yll dhe për ta madhështuar atë imazh Divin.

INTIFADA KULTURORE

Kush do ta fillojë në Kosovë?

Paramendoni gratë, të cilat i kanë burrat në gyrbet dhe mallin e fëmijëve për prindin mashkull, paramendoni jetimin, i cili mendon se i është kthyer babai dhe me vrap të sulet në prehër, paramendoni Penolopën kosovare, e cila sapo thurr tymnin e shkatërron atë dhe mbetet besinke e iluzionit të saj, paramendoni diçka, që ndodh për nime e nuk e shohim apo jemi aq indiferent si Jezusi ndaj vdekjes e, që i thonë indiferencë e shenjtë. Edhe kjo ndodh. Edhe kjo na ndodh dhe duket, se do të vazhdoj kështu.

Ndërmjet mjerimit dhe argëtimit në të, ndërmjet mjerimit dhe lumturisë, ndërmjet urrejtjes dhe dashurisë, ndërmjet mallit dhe Të Madhit, pushon dhe puson pika meditative, e cila neutralizon çdo provokim dhe mungesa e provokimit pjell monotoninë, se kush ka mend ka edhe humor si kompenzim, si shpërblim i pavetëdijshëm, si ilaç kundër lodhjes së trurit. Paramendoni sa aksidente ka në paraqitjen mjegullës. Mjegulla ka shumë aksidente këtu, shumë libra janë shkruar nga dikush tjetër dhe shumë janë nënshkruar nga dikush tjetër, shumë këngë janë komponuar nga dikush tjetër, dhe janë kënduar nga dikush tjëtër, shumë piktura janë pikturuar nga dikush tjetër dhe nga po këta janë nënshkruar dhe çka? Asgjë e re nën këtë qiell, bojkot i ndodhisë, si kishte thënë Baudrillard.

Problemi është se, misteri është këtu dhe fshehtësia është e fshehur në dritë, por ne ende si duket nuk e kemi zbuluar. Se vetë krijimtaria është mister ashtu si vazhon të thotë Berdjajevi:

Krijimtaria është – mister.
Misteri i krijimtarisë është misteri i lirisë.
Misteri i lirisë është i pakufishjëm dhe i paartikulueshëm.
Nikolai Berdjajev

Prej krijimtarisë e deri te paaftësia për ta thënë atë, për ta artikuluar atë është rrugë e gjatë dhe në këtë rrugë ka shumë labirinte, të cilat po na hutojnë dhe në këtë rrugë nuk niset pa udhërrëfyes. Pak janë ata, të cilët e kanë guximin me u nis vetë në rrugë, sepse frikohen nga vdekja kurse vdekja nuk është gjë tjetër, pos diçkas së panjohur dhe çdogjë e panjohur krijon frikë, lind tërheqjen dhe dorëheqjen, lind shukatjen dhe frikën se mos po gabojmë, dhe zgjimi i vërtetë ndodh kur kalohet në anën e rebelimit, si lulja kur rebelohet nga kursi i degës dhe aty e shfaq bukurinë e vet, si aroma kur avullohet nga lulja, si populli kur rebelohet nga padrejtësia e pushtetarëve dhe ky popull është fitimtar, ndërsa ai popull i cili toleron hajninë e pushtetarëve dhe ashpër e ndëshkon hajnin e pazarit ai popull është i ndëshkuar me humbje.

Dhe shikoni rininë, të cilën po e shkelni si barin e njomë vetëm, se ju jeni shkelur si fletët e qepës mbi dhe, për ta formuar dhe zgjeruar kokën nën dhe, e prodhuar heterozide të cilat tani na i fërgojnë sytë, dhe shikojeni rinin, e cila po thotë diçka pa e mendu, sepse atë po e bën, dhe shikojeni rininë, të cilës në veshë i pëshpëritet cilin hap ta ndërmarr, dhe shikojeni rininë , e cila është mllefosur dhe nuk lexon apollogjitë e viteve tetëdhjeta, por është në safari të identitetit të ri, dhe shikojeni rininë, e cila po heq dorë nga ju, sepse ja u keni sosur lirinë, misterin e paartikuluar, shikojeni potencën e tyre, e cila hallakatet nëpër botë me e gjetë vetën në pusin e trashiguar.

Kush nuk është pshurr në gjumë, pshuret tani dhe jo vetëm poshtë , por i pshurrë edhe sytë, eh sa gjynah…

Reçeta për Mollotov kulturor.

1. Një shishe njeri
2. Shpirti si lëndë djegëse,
3. Vepra si fitil
4. Pasioni si shkrepsë
5. Liria si hedhje e lirë
6. Intifada kultutore si qëllim
7. Dhe
8. Boom
9. E pastaj shohim çka ndodh?

A ekziston mafia kulturore në Kosovë?

Ekziston potenciali i kibernuar i njerëzve, të cilët janë në krye të kulturës, ekzistojnë sharlatanët, të cilët paguajnë shuma të majme për t'u nënshkruar me nje libër, që nuk e kanë shkruar vet dhe një i ri në Kosovë mund të thotë se… **me sendin e huaj nuk mundesh me hy dhondër** dhe Lidhja e shkrimtarëve ju e dini sa janë…? nuk bën asgjë për ditën ndërkombëtare të librit, dhe PEN Qendra e Kosovës, e cila nuk bën asgjë për librin, dhe Ministria e Kulturës, që i ka ra pishmanit se e ka bo jë projekt për librin, dhe botuesi, i cili të thotë: ke botuar librin???!!! Fshehe mos po të rreh dikush… dhe intelektualët, që garojnë se kush ma shumë pinë çaj të rusit me ose pa limon …dhe të tjerët, që prësin një herë në muaj me ardh plaku me plis të bardhëdhe me musteqe të përhimta prej Rahovecit me bidona me i sjell raki, që ata që e pijnë i thonë; të rrushit, e ajo asht e hardhisë… dhe

Ministria e Arsimit, e cila nuk bën asgjë për librin dhe e lë në mëshirën e botuesit, i cili një libër të gjuhës angleze e shet 7 €, vëtem se nxënësi duhet pa tjetër me e ble, se mësuesi i anglishtës e përze nga ora… dhe botuesi, i cili nuk i shet librat në librari po në tezgë të Grandi…dhe ekspozitat e të rinjëve, që nuk i sheh askush, as vetë të rinjët dhe ekspozitat e pikturave të pleqve, që nuk dijnë a janë piktor a janë poet… dhe deputet, që janë hutuar se janë poetë , e në shtepi i shërojnë plagët e vjetra…dhe gazetat, që botojnë kulturë dhe me to bëjn fishek për gështenja, shitësit,

që i pjekin gështenjat në rrugë, dhe Televizionet, që shesin kulturë duke marr emisione të huaja dhe duke mos e cekur burimin…dhe bllogët e ëebfaqet, që shkëmbejnë mes veti shkrimet e njerëzve, që nuk kanë pas mundësi me u afirmu n'zaman t'Titës dhe tani janë mbrojtës të kauzës kombëtare…dhe më në fund nuk ka Mafi kulturore…natyrisht jo.

Kush nuk ka qajtë deri tani, mundet me qajt dhe me e fitu titullin e budallës…deri sa ta kthejnë …a mos e pate Kosovën çikë të tezës, që po të dhimbet?

THE RIPENESS IS ALL!

Në kohërat e lashta pjekuria ka qenë çdo gjë, derisa Shekspiri nuk e ka thënë… the ripeness is all, e deri sot ende vlen jo vetëm ta kujtojmë apo ta rishkruajmë, por ta bëjmë. Neve na parashtrohet problemi, si ta parashtrojmë pyetjen apo si ta ngrisim çështjen e pjekurisë, në kohën kur jemi hutuar se, jemi në fazën e pjekurisë. Njerëzimi në përgjithësi është larg nga kjo fazë dhe kjo është njëra nga shumë pikat, ku nuk pajtohem me Bahaullahun, themeluesin e fesë Baha'i. Ne jetojmë në një botë përplotë dhunë dhe në secilin qytetërim kanë dalur zërat e dijetarëve, të cilët kanë thënë se së shpëjti do t'i vie fund botës, për shkak të tiranisë, amoralitetit, korrupcionit, sëmundjeve. Çdo qytetërim i ka pasë këto sëmundje dhe asnjë qytetërim nuk ka arritur ta gjej ilaçin …Ajo çka ka arritur secili qytetërim është; ta sofistikoj secilën nga këto sëmundje, duke ia dhënë trajtën tjetër .

Babai i historisë, Ibn Halduni, bukur e ka vërejtur, që secili qytetërim ka fazat e veta të zhvillimit dhe e ka kohëzgjatjen e caktuar. Dhe krejtë çka ka ndodhur në histori është që një qytetërim të rrëzohet nga tjetri në hijet e, të cilit do të ngritet nje tjetër, më i mirë??? Ndoshta !!!???

Derisa atje përjashta dëgjohen detonimet, krismat, helmimet, vdekjet …lulet çelin, bilbilat këndojnë, xixëllonjat kopulojnë, në kohën e vetë duke kaluar nëpër të gjithafazat e zhvillimit, në kokat e njerëzve vdesin të vjetrat dhe lindin hipokrizi të reja. Ekzistojnë me mijëra e miliona krijesa, familie të bimëve dhe të

shtazëve raca dhe sorte të ndryshme natyrore dhe ato, që i ka hibridizuar e klonuar njeriu dhe sa dhimbshëm është që po ky njeri nuk mësoi nga mjeshtria e huaj dhe mjeshtria e vetë. Si nuk mësoi vetë të transformohet, më mirë të piqet, …the ripeness is all.

Që të arrijmë deri tek dallimi më i madh ndoshta duhet të kalojmë nga gjendja e egër shpirtërore në atë të butë, sepse … **pemës së egër i vie era lule, kurse pemës së butë i vie era frut**thotë Novalis.

Shpesh jemi të mashtruar nga zhvillimi i teknologjisë, bëjmë lodra më të sofistikuara për t'u krekosur më shumë sikur ato lodra na bëjnë më të mirë. Teknikisht asnjëherë njerëzimi nuk ka qenë më i zhvilluar, por shpirtërisht asnjehërë më mbrapa nuk ka mbet. Asnjëherë në histori nuk ka pas më shumë pasuri e asnjëherë më shumë nuk kanë vdekur nga uria.Ajo çka më së shumëti më irriton është heshtja e intelektualëve musliman. Atje ku më së shumti pritet sa I përket Islamit, atje më së paku del moral islam dhe kot u paska fol Muhamedi arabisht … nuk është me ne ai, i cili në gjumë bie i ngopur e komshiun s'e ze gjumi nga uria.

Më duket se më shumë e kuptojmë ne në Evropë. Nuk mundem assesi ta marr me mend se një princ Saudik posedon 27 miliardë dollar e fqinjët i ka po aty afër në Afrikë, të cilët po vdesin nga uria. Absolutisht nuk e kuptoj ndërtimin e një xhamie të artë, me margaritatrë e xhevahire e gurë të shumtë të çmuar kur aty do të luten njerëzit, të cilët kanë më shumë konkubine se sa gishtrinjët në këmbë e duar bashkë. Po njerëz janë ata, njerëz jemi edhe ne, por dallimi është si ai mes baltës dhe hallvës.

Ne kemi nda pogaçen me komshinjët, ne kemi pi shurup mani së bashku, rrushin e kemi shtrydh bashkë, grurin e kemi korrë bashkë dhe kemi lënë pakëz në ara për fazanat, kumrijat e galat, shtogun e kemi mbledh për mehlem për plagë dhe me lulet e tij për kemi shuar etjen udhëtarit, ullirin kemi shtrydh dritë shpirtit me i dhënë, fikun kemi mbjell kah Jugu, fshehtësinë për t'na e ruajtur, arrën kemi ngrënë në vena të na qarkuloj gjaku i

lashtë, kamomillë kemi pi, çdo plagë të jashtme dhe të mbrendshme kemi shëruar.

Dallimin mund ta shihni, është sikur në mes të baltës dhe hallvës, edhepse ju duken se janë të njejtë. Sepse, ne e kemi shartu vetën sepse ne e kemi punuar tokën e bari vendeli ia lëshoi vendi misrti mysafirë, i cili në çdo farë tramaku jep 3-4 tramakë tjerë, sepse pemëve tona nuk u vie era lule, por frut, sepse fruti ynë është i pjekur si thotë; Shekspiri…**the ripeness is all**.

Në kohën e Musës ka jetuar Karuni, një pasanik shumë i madhë dhe thuhet, se ka pasë 70 shoshe me çelësa të thesareve të tij dhe mbahet në mend vetëm si një koprrac i tmerrshëm.

Harrun ar Rashid mbahet në mend si një halifa shumë i pasur, por mbahet në mend si një person që ka arrit pjekurinë, hapi shkolla, universitete, biblioteka, investoi në kulturë. Kësaj i them pjekje, transformim, të bëhurit më serioz- Metanoia.

Princi Siddharta (Buddha), princi Ibrahim Edhem i Horasanit dhanë/lanë krejt mbretërinë. Kjo është shpëtimi, kjo është vetshpëtimi, faza më e lartësuar e pjekurisë, e Metanoia-s, kjo është Autosoteria.

Asnjeherë nuk kam dashur të shkruaj për problemet me tematikë politike edhe pse i di, m'i mësoi jeta, sepse kurrë nuk jam marrë me politikë, por ajo është marr me mua, në mënyrë shumë të vrazhdë dhe unë assesi nuk po kuptoj pse njerezit si shkenctarë, artistët, shkrimtarët…, përzihen në punët, të cilët shumë pakëz i marrin veshë, asgjë nuk iu desht Noam Chomsky-t me i dal në krah Sërbeve, që na qenkan viktima të demokracisë, e pamë çka i ndodhi Peter Handkes, pse Chomsky nuk ka marrë mësim prej tij, duke e ditur, se i ka të gjithat përpos gjithëdijshmërisë,

Nëse i ka thënë dikush, se është i gjthëdijëshëm e kanë gënjyer, por nëse vetë është bind se është i tillë qenka hutuar, ndoshta kjo është shenjë e senilitetit dhe mosarritjes së pjekurisë së duhur shpirtërore, definitivisht. Nëse, ai e di se është i mirë në Linguistikë edhe ne po këtë e dijmë, kush i tha se Linguistika është Politikë.

Çështja e kosovës është propblem politik e jo linguistikë. Nëse krejtë bota e pa ekzodin shqiptar, apartheidin dhe gjenocdin së rb, jo vetem ndaj shqiptarëve, në cilën gropë të botës paska jetuar Chomsky, i cili nuk i paska pa këto pamje kur CNN, BBC, Reuters, Associated Press dhe shumë e shumë të tjerë kanë raportuar.

Nëse e arsyeton gjenocidin së rb, i cili të ka ndodhë para hundëve duhet ta arsyetosh edhe holokaustin, i cili ka ndodh shumë më herët, dhe ne të gjithë e dijmë, se ata që arsyetojnë vrasjen dhe gjenocidin, të çfarë soji njerëzor janë, ja këtu duket dallimi si ai në mes të baltës dhe hallvës.

The ripeness is all, my friend.

INICIMI MAGJIK NË DASHURI

Të gjithë ne kemi qasje të barabartë në bibliotekën universale, e cila posedon informata të rëndësishme dhe plotë domethënie. Për ta lexuar atë, ne vetëm duhet ta dëgjojmë zemrën tonë, e ajo mesiguri ka çka thotë. Dëgjimi është çelësi i të mësuarit dhe komunikimit të shëndoshë. Nuk është e kotë që Fahredin Shehu deshi ta hap, SHKOLLËN E DËGJIMIT, në Kosovë. Me këtë çmendi mund të matet vetëm çmendia e dashurisë, e cila, pothuaj, çdoherë ia kalon.

Janë katër nivele të të dëgjuarit:

1. Mosdëgjimi - kur me sy e shikojmë dhe projektojmë idenë tonë në bazë të fjalës së fundit të folësit.
2. Dëgjimi me injorim - kur dëgjojmë duke injoruar dhe duke i lënë anash idetë e folësit;
3. Dëgjimi aktiv - kur dëgjojmë plotësisht, kuptojmë dhe asgjë nuk ndërmarrim; dhe
4. Dëgjimi empatik - kur dëgjojmë në mënyrë aktive dhe bashkëndjehemi, kur e vëmë vetën në lëkurën e folësit. Për ta arritur këtë shkallë, duhet koncentrim i madh, kontemplacion dhe dashuri, dashuri të paanëshme. Sugjeroj të lexohet shkrimi MË DËGJONI MADJE NJËHERË në ëëë.horizonti.com . Ka aty diçka dhe për diçka që duhet të mendohet.

Në moshën 37 vjeçare, të shtunën, më 28 nëntor 1244, Meëlana Xhelaluddin Rumi - ndër poetët më të mëdhej mistik të të gjitha kohërave, e takon Shemsuddin Tabrizin, një dervish ravgues për, të cilin dihet nëpërmjet Rumiut, ashtu siç dihet për Sokratin nëpërmjet Platonit. Në këtë kohë tek Rumi ndodhë revolucioni, plotësisht ndryshon dhe e përjeton involucionin. Praktikisht, ndodhë Supernova.

Falë dëgjimit empatik, dy javë kanë bërë muhabet (bisedë e përzemërt) vetëm me ujë dhe me pakëz rrush të thatë. Falë dëgjimit empatik është krijuar simpatia platonike, saqë Shemsuddin Tabrizi detyrohet të ikë nga Konya (Turqi), gjë që lind telashe të shumëta. Ndoshta ia ka vlejtë kjo sakrificë, se pas kësaj do të lindë DIËAN SHEMSI TABRIZ, një kompendium i mrekullueshëm poezish, normal…mistike. Kështu ndodhë kur dëgjohet zemra, kur kjo hapet si syth për ta liruar parfumin e vet.

Dikur lexoja me kënaqësi të madhe librat e Franz Bardonit dhe njëri prej librave të mrekullueshëm të tij, INICIMI NË HERMETIZËM, libër ky, i cili bukur do telashe m'i kishte nxjerrë për ta absorbuar si duhet. (Natyrisht, nuk është lehtë të lexohet shkrimi i mjeshtrit më të madh të Kabballës së shekullit të kaluar), krijoi asi shtytje për meditim, sa që ndjeja se diçka do të eksplodojë. Këtu dhe kështu këtë shkrim po e emërtoj INICIMI MAGJIK NË DASHURI, sepse ka njëfarë magjie gjatë inicimit, ka edhe njëfarë magjie në dashuri, dhe ka edhe njëfarë magjie tjetër gjatë dëgjimit.

Vargjet në fillim të këtij shkrimi janë shkruar në vitin 1991, kur e lexoja historinë e M.M. Sharifit, ku kisha zbuluar besimin arab paraislam. Allah edhe ishte perendi i cili adhurohej vetëm në brenga të mëdha. Si perendi supreme, atij i drejtoheshin vetëm në raste tepër të rënda, kurse Al Lat, Al Uza dhe Al Mannat ishin për nevojat e ndryshme. I gjithë ky paganizëm m'u dukë si pazarllëk dhe jo vetëm ky paganizëm, por paganizmat e të gjitha llojeve. Darka e Lamës për shembull.

Pastaj thuhet… t'u kthehemi rrënjëve, ndërsa çdo vrojtues i kujdesshëm doemos e vëren, se nuk janë vetëm rrënjët, është

edhe dega, gjethet, substrati, kushtet klimatike, etj.Për këtë arsye jam proponent i kontemplacionit të gruas më të famshme të Misticizmit Islam, Rabiya Al Adaëiya.

Dhe, u rastisa unë në Kajro në korrik të këtij viti (2005), në xhaminë me plotë vizitorë të Rabiyas, të cilën e çmojnë pothuaj të gjithë muslimanët dhe derivatet e Islamit. Atje i fala dy rekkate nafile (lexo: lutje vullnetare) dhe u luta me lutjen e saj …**O Zot , nëse të lutem nga frika e ferrit, ferrin ma dhuro, nëse të adhuroj nga shpresa e parajsës, parajsën ma privo, të lutem, sepse të dua, të lutem, sepse jam robi Yt**.

Kështu ajo e zbuloi bukurinë/mrekullinë/misterin e lutjes. Nuk ka bukuri nëse ajo nuk është e mbuluar - thotë Hazrat Inayat Khan, një nga sufitë më të mëdhej të kohës sonë. Këtu qëndron kuintesenca e dallimit mes Matematikës dhe Ekzistencës, sepse në Matematikë një plus një është baraz me dy, ndërsa në Jetë një prind plus një tjetër është baraz me Familie. Andaj thotë Muhammedi a.s. "**Të gjitha krijesat e Zotit janë një familie, më i miri prej jush është ai i cili i bën më së shumti të mira kësaj familjeje**".

Dituria dhe Dashuria janë sandale kosmike për rrugën e shenjtë, e cila është e shtruar me gjemba. Prapë, po e përsërisë, se po na mungon vokabulari tokësor për çështje qiellore. Pra, duhet ta presim një gjeni, i cili do ta krijojë këtë vokabular…**kur në botë paraqitet gjeniu, do ta dini, sepse të gjithë budallenjtë do të bashkohen kundër tij** - thotë Kung Fu Tze.

Nëse e takoni gjeniun mos e vritni, se ai me siguri ka çka të thotë. Uroj, që folësi i këtij shkrimi, t'iu flas me tinguj infrasonik, të hapen dyert e bibliotekës univerzale, për t'i dëgjuar pëshpëritjet, vibrimet e zemrës, e cila me siguri ka çka të thotë dhe e cila me siguri diçka do të thotë, e pastaj le ta aprovojë ligjin e dashurisë – Puthni këtë ligj, sepse thotë Rudaki-u…**të puthësh është si ujin e detit ta pishë, sa më shumë që e pi, aq më shumë të pihet**.

SUMNAKUNI PHURT

("URA E ARTË", KUJTIM PAÇAKU)

As në qosh t'mendjes nuk e kam me e luejt rolin e Kusturicës për çashtjen rome e me fitue lavd e dekorata, demek, me u pasunue me taksiratin e dikujt. Veç po du me shkrue p'ej bindjes dhe p'ej borxhit, që e kam ma s'pari si insan, e tevona edhe si shair.

Kujtim Paçaku, autor rom nga Prizreni. Asht ky shkrim i parë, qi po e baj n'Geg, sepse asht nji diçka qi m'shtyn nga brendia, si diçka qi po don me pëlcit si nari i pjekun, e me diftue inci t'kuqe me shijen, e cila e knell fikirin.

Asht Kujtim Paçaku, Rom nga Prizreni, i cilli asht ka lufton deri te fryma e fundit me e ruejt, me e begatue, me e mbajt gjallë e krejt n'fund, me krijue art në guhën, e cila si gacë e m'lueme e Vedave me mija vite po pulson dhe hala po e ruen at hikmet t'fituem me vuejtje e të përcjellun amanet p'ej Gangut deri n'Ballkan e ma tej n'Europë. Asht Kujtimi, të cillin e njoh ka kohë, por nëpërmjet librit të tij të fundit, sikur po don me na u manifestue në sahillëkun e ri t'Kosovës me nji poezi të kullueme, natyrale dhe me tan kyvetin e tij p'ej shairi, sikur po don me na dhanë ders se si kullohet vuejtja, syrgjynllëku, dashnia dhe zanati në torkullin e tij kreativ.

Me kijafet t'madh e nis librin, tue na diftue për historinë rome dhe po më duket se po na thotë …

"O jermi, moti jam këtu e tek tash po du me ju zgjue e me jau hjek duvakun e gafletit. Të gjallë jena edhe na, bile këtu n' Ballkan jena moti, ka 1000 vjet … hiq ma larg se 100 kilometra p'ej Prishtine…

"Gjuha…gjuha që vdekjes i ka dal përballë
Këngën duke mos e ndalur kurrë…gjuha ime Rome
Ende është e gjallë
Kujtimi shkruen edhe për jetën dhe sikur po e merr n'supe t'veta tanë dhembjen e popullit t'vet, jetën e randë t'popullit t'vet:
O jetë, dëgjomë
Je tepër e vocërr ndaj dhembjes sime!

Tevona i kena edhe disa gjysëmbejte shumë t' forta kur i knon urisë:

… nuk më kujtohet
Kur për herë të fundit
E kam shijuar kafshatën
E bukës vale
Që në çerep e piqte e imja nënë

Ata ma s'miri e dijnë kimetin e pranverës dhe i knojnë me të madhe, kurse fmitë i pyesin kur vjen Shën Gjergji:

…është dimer
Këngët tona treten në bore
Ndërsa fëmijët pyesin Gjyshin e vet;
O, babagjysh
Edhe sa ditë do të vijë
Hedrelezi

Fusha e gjanë e zemërgjansisë së shairit e ka nji andërr të cilën e knon si me kullue rrëshina në vapën e gushtit

…të isha ujë i madh
T'i ngopja të gjitha fushat e botës
Plot drith
Që së bashku të ham bukë

Edhe unë edhe ti…
Më i fortë për një vdekje…
lotët nuk rrjedhin nga frika
Por nga pikëllimi
Që vdekja ndodh pa ritualin e zakonshëm

Na drejtohet neve qi jena kah e harrojmë nanën natyrë, e gjanë asht ajo, ka vend për secillin:

…nëse ke harruar
Të ecësh nëpër pyjet e dendura
Të bësh gjum përskaj lumenjëve të mëdhenj
T'i zgjohesh dhe t'i gëzohesh agimit të ri
Nëse ke harruar
Të këndosh edhe kur të qahet
Të vallëzosh edhe me këmbë të thyera
Të japësh dashuri edhe kur nuk të kthehet
Nëse të gjitha këto i ke harruar
Atëherë eja me ne
Bëhu si ne
Bëhu ne…

Na jena mahlukat - krijesa t'dobëta - këte tana here e kam dijtë dhe se Zoti nuk ban asnji ndamje, kurse Kujtimi na thotë:

…përse frikohesh
Përse fshehesh
Të vie turp nga ngjyra e lëkurës tënde
O njeri
Neve na ka krijuar Zoti
Si ty
Si mua
Si edhe ata
Nën ngjyrën e lëkurës tëndefshehur e ke një ylber
Mu brenda shpirtit tënd…

Me e ndie veten t'përuzun e din vetëm ai, qi asht i përbuzun dhe i lan m'anash, mahsus kur e ndien se ka ngjyrën tjetër e mos me folë kur mendon ndryshe, ma mirë, ma nalt, ma me përkushtim, me mendjen e lame, tahret sikur me i ba trupit e shpirtit para lutjes. Kam edhe nji send me e thanë para se, me përfundue.

Me kangë të Kujtim Paçakut koxha jam eglendis dhe i tanë ky kyvet, qi ai me disa fjalë, me vetëm disa vjersha, me e thanë shpirtin e krejt popullit, vallahi asht ma'arifet, e bashka, qi kam mësue se ishim aq afër njani me tjetrin e une bosh p'ej dijes për romët. Njajt si dy kallamet e Rumit.

Shënimet biografike:

Kujtim Paçaku u lind në Prizren, më 12. 04. 1959 Gjuhët: Rome, Shqipe, Serbe, Turke, Boshnjako& Serbe, Agleze, Frenge,

Shkollimi i kryer: Akademia e Arteve Muzikore. Grupi: Pedagogjiko-Artistik1980-1986 / Ka punuar si mësimdhënës në shkollën fillore Duhël- Bllacë, Therandë. Nga viti 1986- redaktor-gazetar në gjuhën rome, Radio Prizren. Korrespondent në shumë media rome dhe evropiane

1986 - regjisor dhe autor i dramave rome në Prizren.

Drama: "O kamipe na puæhela» ("Dashuria nuk pyet"), 1987 - autor regjisor, komedia: "O Špiuni" ("Spiuni"),

Pjesëmarës ne shumë festivale muzikore të Kosovës, si kompozitor dhe këngëtar.

1990 - pjesëmarrës i Kongresit të Romëve në Poloni.1994 - mësimdhënës në "Shkollat Verore" të Romëve nga Europa. Pjesëmarës në Konferencën Ndërkombëtare në Bukurest, organizuar nga PER- SHBA1994 - vendi i parë në Festivalin Ndërkombëtar në Poezi, "Amrico Rom"1995 - anëtar i OJQ-së Eurpiane "Romano kris"1995 - Diploma Meritore për poezi dhe njohje e gjuhës rome nga festivali "Amico-Rom", Itali 1995 - kooautor i teksteve parashkollore për fëmijët romë 1997 - vendi i parë në Festivalin Ndërkombëter në Poezi "Amrico Rom", Francë.

Pjesëmarrës në Antologjinë e poezive rome në Itali dhe Spanjë

Pjesëmarrës në festivalin artistik të romëve ma karakter europian "Amico Rom", Itali, (1994 dhe 1997 - shpërbilimi i parë)," Plaketa e artë" - Rominterpres Europa, për gazetari rome2000 Mbrëmjet e poezive rome në Parisë-Francë.

2001 Asistent në Katedrën e Romologjisë pranë Universitetit Inalco& amp; Sorbona në Paris 2001

Mbrëmje të poezive Franko-Rome-Frenge në qendra kulturore të ambasadave dhe univesiteteve të Parisit, 2001,

Udhëheqës i emisioneve rome: Radio Roma-Paris 2001, Redaktor në Radio multietnik "Radio Protestant-Paris", 2003 Redaktor i redaksisë rome në Radio "Jeni Dynem"2003 Organizator i projektit "Rruga e shkollës", ide për shtypjen e broshurave dhe pankarta2003

Diplomimi në Akademinë Mobile të artit skenik, kl. Prof. Faruk Begolli 2003

Pjesëmarës në filmin "Kufomat", regjia Luan KryeziuPjesëmarrës në antologjinë e poezive rome në gjuhën fringe 2004

Ligjerues në "Shkollën verore të romëve në Kosovë", organizuar nga MASHTI-i dhe OSBE, 2003, "Mbrëmjet e poezive rome në Kosovë", 2004, Autor i parë i fjalorit në gjashtë gjuhë "Lavustikorri", 2005, Autori i librit me poezi "Sumnakuni phurt", 2005 Redator i redaksisë rome në TV "Jeni Dynem"

ATA DHE ATA

Të fillosh me Rumin, çdoherë është kënaqësi, sepse në mënyrë më natyrore dyvargëshi (bejti) i Rumit dëfton ngjashmërinë dhe dallimin në të njejtën kohë. Natyrisht dhe natyrshëm kuptojmë, se ai flet për njeriun. Nivelet njerëzore ishin, janë dhe do të jenë të ndryshme.

Pata folur në shkrimet e mëparshme për Homo Gnosticus-ose njeri gnostik, i cili dallon nga Homo Sapiens, si tek kallamet e Rumit, ashtu edhe të Homo Faber dhe Homo Neandertalis. Kur jemi tek Homo Gnosticus (ky është termi im për Irfanin e Tesavvuffit- Sufizmit apo misticizmit Islam), në mënyrë të shkëlqyer flet Ibn Arabi i Spanjës Mesjetare, ajo Spanjë, e cila e krijoi Europën multietnike, multikulturore, diçka që, Europa e sotme mund të ëndrrojë dhe vështirë, që do ta arrijë ta bëjë këtë bile, me gjithë xenophobia-n, që ka për të ndryshmen (lexo: Islame).

Shih, se si bën mjeshtri:

Fytyra e religjionit

Herë më thonë çoban i gazeleve të shkretëtirës
Herë prift i krishterë
Herë ithar i Zaratustrës
Të dashur janë Tre, e prap janë Një
Ashtu si tre me të vërtetë janë Një
(Ibn Arabi shek. XIII Spanjë)

Pastaj kemi Vangelis-in, „The conquest of Paradise“ (Pushtimi i Parajsës), një mrekulli prej arti muzikor. Më mirë kishte me qenë po ta emërtonte „The devastation of Paradise“ (Shkatërrimi i Parajsës) - është fjala për Spanjën, jo për Amerikën.

Sepse, në atë kohë shumë muslimanë janë vrarë vetëm, se ishin muslimanë dhe shumica të asimiluar, pastaj mbi 600 000 Safardi hebrejë, janë dëbuar dhe kjo hije e errët e Isabellës dhe Ferdinandit po e përcjell edhe sot Europën. (Fallaci, për shembull, apo Kohl kur i thotë studentit gjerman Mesut Yilmaz, se nuk po e njeh gjeografinë).

Ja edhe një mjeshtër të madh:

Njerëzit asnjëherë nuk bëjnë ndonjë krim në mënyrë aq të përkryer dhe me aq dëfrim, si atëherë kur e bëjnë nga bindja fetare.

(Blaise Pascal 1623-1662)

Shekulli XX, si edhe shekujt e kaluar, do të mbahen mend po duke iu referuar Pascal-it. E ke Aushvicin, Hiroshimën, Nagasakin, Srebrenicën dhe për pak edhe Kosovën, kur xenophobia patologjike-gjenetike serbe ndaj shqiptarëve, donte edhe shqiptarët t'i rradhisë në fundamentalistët islamikë.

Do ta rrëfej një ndodhi nga viti 1999, të cilën e kisha përjetuar. Diaconi Everts, i cili shërbente si major i KFOR-it holandez, më ftoi në një udhëtim nëpër Kosovë për t'i vizituar objektet sakrale. U nisëm për në veri të Mitrovicës, në Manastirin Sokolica. Nuk kisha telashe me serbishten. Atje arritëm edhe me një ushtar holandez (kroat me prejardhje). Na priti murgesha kryesore Makaria. Manastiri i Sokolicës është i njohur për ikonat e mrekullueshme, ku japin garancion se qëndrojnë deri në 600 vjet? Makaria nisi t'i fyej shqiptarët, duke i quajtur fundamentalistë islamikë dhe se, Serbët po e ruakan Europën nga terroristët fundamentalistë islamikë.

Majori Everts më tha: nuk mund të besoj se një i krishterë mund të gënjej kështu. Unë di se shqiptarët janë të shquar për tolerancë fetare dhe kjo nuk është e vërtetë çka thotë Makaria. Unë shërbej Meshën të dieleve në Kishën e Bishtazhinit.

Kurse unë i thashë: Bukur është zotëri, që ju e thuani këtë, sepse po ta kisha thënë unë këtë në fillim të rrugës sonë, nuk më kishit besuar.

Pasi i pamë punëtoritë, bibliotekën e begatshme dhe dhomën e pritjes ku na gostitën me pije, ikëm nga ky vend shumë i bukur. Tani gjithnjë e më shumë më pëlqen kur më flet Swift-i: "**Mjaft jemi religjiozë për ta urrejtur njëri tjetrin, por jo mjaft religjiozë për ta dashur njëri tjetrin**" (Jonathan Swift, 1667-1745).

Pasi e tejkalova librin erdha tek njeriu, i cili gjithnjë e më shumë është duke më dëshpëruar. Hajt e duroje këtë torturë, e tash banu burrë e hesht.

Jeta na ftoi që të jetojmë në Kosovë, si nikoqiri në dasëm kur të fton. Hëngre apo nuk hëngre, njësoj të llogaritet, je i ftuar. Edhe këtu fole apo nuk fole, njësoj të llogaritet, sepse gjuha e kandarit nuk lëviz as kah tasi i majtë e as kah ai i djathtë, prandaj BUZËT E URTËSISË JANË TË HESHTURA, POS PËR VESHËT E MIRËKUPTIMIT - thuhet në Kybalion.

Ejani të dëgjohemi! Ejani të mirëkuptohemi! Kjo mund të realizohet vetëm me dashuri. "**I Dashuri lidh konopin rreth qafës sime e më çon kah Ai**"- (Hafez Shirazi, shek. XIV).

E çka të them për Hafezin kur Goethe e konsideronte për mësues të vetin, Gertuda Bell e krahason jetën reale të Dantes në Firencë dhe gazeleve të Hafezit nga Shirazi, ku fare pak është prezente koha, derisa ai jetoi në kryeqytet dhe derisa u ndërruan 5 mbretër. Henry Clarke Wilbeforce, Anglezi, i cili është i vetmi që përktheu „Divanin" komplet të Hafezit thotë: *Në Divanin e Hafezit mund të gjeshë jetën private të Persisë, gjendjen e tij shpirtërore, mendimet dhe preokupimet*.. Rrallë kanë ekzistuar gjenitë e tillë në botë. Ekscentrizmi është cilësi e të urtëve dhe e miqëve të gjenive. Hafezi ka qenë aq ekscentrik sa njerëzit kanë menduar se ka qenë i frymëzuar nga Zoti...Charles Stewart shkruan:...*bashkëvendasit e Hafezit e konsiderojnë si të frymëzuar nga Zoti, ndërsa „Divani" i tij është inferior vetëm ndaj Kur'anit*.

Hafezi ka qenë i shquar si njohës i gjuhës së fshehtë ose Lisan-ul Gayb dhe thonë se këtë e pranoi dhuratë.

Thuhet se një sabah në xhami i pa 14 melekë, të cilët e patën pyetur, a dëshiron Nazar-i Basiret (shikimin e zemrës) apo Lisan-ul Gayb (gjuhën e fshehtësisë). Ai u përgjigjë se dëshiron shikimin e zemrës dhe shikoi përreth me sytë e zemrës, u trishtua sepse përreth tij ishin njerëzit me pamje shtazore. Shpejt u kthye në xhami dhe kërkoi që kjo t'i hiqet dhe në vend të shikimit të zemrës kërkoi gjuhën e fshehtësisë. Dëshira iu plotësua dhe ai mori gjuhën e botës së padukshme. Edhe një poet persian me famë Hakim Xhami e quan Hafezin Lisan-ul Gayb (Njohës i gjuhës së fshehtësisë). Hafezi u emërtua kështu se qysh në rini të hershme e dinte Kur'anin përmendësh dhe thuhet se e ka inerpretuar në 14 variante. Krahas Kur'anit përmendësh i dinte edhe shumë vepra të sufive të atëhershëm si ato të Attar-it, Saad-it, Nizami-t, Rumi-t, etj.

Pse fola për Hafezin është, se e ndërpreva heshtjen, fole apo nuk fole njësoj të llogaritet, inshallah jo edhe këtë herë. BUZËT E URTËSISË JANË TË HESHTURA POS PËR VESHËT E MIRËKUPTIMIT- thuhet në Kybalion.

Hafezi shkruan, mos gabo ti që nuk i njeh fshehtësitë e zemrave njerëzore e ta konsiderosh gjuhën e ashikut (ai që do) si të gabuar.

PUTHJA E RUBINTË

Pas përfundimit të ELEMENTALIT në vitin 1999, ishte kohë e rehabilitimit biologjik, material dhe shpirtëror, kohë e pasluftës, si çdo luftë tjetër… e tmerrshme, në momentet e përjetimit të ekstazës në krijimtari dhe reflektimit, i cili është stad më i lartë i të menduarit racional, hasa në (gr.) Hesychia - Heshtje kontemplative, si zbulim më fitimprurës, si patent epokal në planin personal, për një periudhë, që e shihja se do të sjellte ekstravagancë (lexo: ekstremizëm) në atë, që gnostikët e quajnë Njeri eksterior.

Isha i lumtur, se aty shkruaja për shkrimin/tekstin se është tymën ku i thurr fijet për ta krijuar një tablo. Në po atë vit për së dyti, pas një kohe të gjatë e përlota librin. Herën e parë, në shkollën fillore me romanin „Malsorja“ të Nazmi Rrahmanit, kur nëna e lë të birin Aliun, dhe herën e dytë në vitin 1998, gjatë ballafaqimit me JETA E SRI RAMAKRISHNËS nga Romain Roland, por tani ndryshe, ndryshe nga hera e parë, tani nga dashuria hyjnore. Se, si teksti me të vërtetë është endje, ma konfirmoi Roland Barthes në KËNAQËSIA NË TEKST, me, të cilin u ballafaqova tek në vitin 2005, versioni kroat, botim i shtëpisë botuese MEANDER, të mikut tim Branko Çegec nga Zagrebi.

Pastaj shkrova: "Asnjëherë nuk kam besuar, se çdo gjë është thënë në art, sepse askush nuk ishte unë, ndërsa unë shkruaj". Zatën, këtu edhe qëndron dallimi mes asaj, që Roland Barthes shkroi për tekstin dhe tekstin që e bëj, tekstin si medium, si fyell ku do të kaloj fryma e Idioritmikut Urban të Kosovës. Çdoherë

ka ekzistuar njëfarë (gr.) PISTIS, njëfarë besimi se ende mund të thuhet, madje edhe ngjashëm, por prapëseprapë ndryshe në trajtë, në kohë, në hapësirë, qoftë ajo Telurike apo Magjike. Dhe, pikërisht kjo krijon Golemin e ri, i cili do të përjetojë mirakulin ekzistencial të fenomenit JETA. Jeta, e cila ka nevojnë për (heb.) TIKUN, meremetim, rregullsi harmonike nga furtuna e (heb.) SH'VIRA-s, çrregullimit. Nëse dikujt i duhet…atëherë ne jemi ata, të cilët duhet ta krijojmë një HOMUNCULUS, por jo si Paracelzusi me gjak, spermë dhe urinë, por një homunculus i krijuar me dashuri, sinqeritet dhe bujari. Një lloj bujari i ngjashëm me FJALORIN, i cili do të jetë i plotë, por i heshtur .

Sa herë, që e marr ndonjë fjalor, ndjehem disi i turpëruar, sepse nga ai marr një apo dy fjalë dhe e lë, duke mos lexuar asnjëherë nga fillimi deri në fund. Prandaj fjalorët kanë heshtjen, qetësinë e oqeanit.

Sa më i gjerë, që është aq më i qetë bëhet. Dhe ky homunculus, padyshim se me buzë të përgjakshme, me BUZË TË RUBINTË do ta puth mirakulin, epifaninë në çdo gjë, që merr dhe që nuk merr frymë. Homunculus, i cili do të ketë tri qendra themelore për funkcionimin e personalitetit:

- Qendrën motorike; shqisat, aftësin e akumulimit të energjisë;
- Qendrën emocionale; ndijimet, sensacionet e rafinuara dhe pasionet;
- Qendrën intelektuale; regjistrimet, mendimet, llogaritjet, kombinimet, hulumtimet etj.

E pas gjithë kësaj, duhet ta zhvillojë atë që Rene Guenon e emërton si Inteligjenca intuitive. Navigatorëve serioz u rekomandoj librin GNOSIS (Study and Commentaries on the Esoteric Tradition of Eastern Orthodoxy), nga autori Kopt, Boris Mouravieff; Arabia for Printing & Publishing, 2005, Cairo, Egypt.

Nuk fliste Bela Hamvas për tendencën e tij të madhe për t'u bërë njeri Normal, është njohja e Njeriut Interior, i cili jeton brenda nesh.

Njohja e vullnetit tonë të vërtetë, njohja e maksimës së Magut më të madh Irlandez, Alistair CroWley, "**Bëj çka të duash, ky le të jetë ligji yt**".Ligj, i cili është më i vjetër se ai romak dhe ligj i Hamurabit, ligj më i vjetër se të gjitha revelatat të sjellura në tokë. Flas për ligjin/librin e Adamit, të cilin ia dhuroi arkangjeli Raziel, librin, të cilin Adami e varrosi, por e gjeti Henok me, të cilin drejtëpërsëdrejti njoftohet me atë çka ka ndodhur në parajsë. Kërkimi Jashtë dhe Brenda, në të njejtën kohë është goxha zahmet dhe një balanc (gjetja e këtij), nuk është e kollajshme. Duhet të mësohemi të dëgjojmë, pastaj të pyesim. Pastaj duhet të mësohemi të veprojmë dhe të gjitha këto me një harmoni natyrore. Heronjëve si Sokrati, Jezusi, Imam Ali, Giordano Bruno, Mensur Hallaj, u shkoi koka, sepse flisnin për (Hal), gjendjen e tyre shpirtërore në gjuhën e vet, jo me gjuhën e atyre që i dëgjuan. Ja këtu lind trishtimi i Bela Hamvas. Këtu edhe është dallimi mes gjuhës së Heroit (Filozofi, i shenjti, poeti, shkencëtari) dhe Profetit.

Profeti flet ashtu si duan ta dëgjojnë dhe asnjëherë në kundërshtim me ligjin të cilin po e sjell.

Ku janë ato gërshërë që e prenë Biblën dhe plotësisht i mungojnë 17 vjet të ravgimit të Jezusit në Ladakh, Kashmir dhe Tibet. Ke 13 vjet, pastaj 17 vjet zbrazëtirë, pastaj i gjen 3 vjet të fundit të ilustruara bukur, dhe njeriu shkoi. Ia humbën fërkemin. Fundamentalistët. Të rrezikshëm janë ata (fetar, politikë, dogmatikë). Nuk janë ata në gjendje ta pastrojnë pluhurin nga pasqyra e zemrës. Nuk shohin ata si Mikelangjelo, Jezusin dhe Marinë në mramor, nuk shohin ata Sekuojën gjigante në farën shumë të imtë. Nëse në jemi Heronjë-(Mramori), duhet ta shohim edhe Jezusin dhe Marinë, duhet ta shohim Njeriun Normal të Bela Hamvas, duhet ta shohim Galithean e Pygmalionit, duhet ta shohim Avatarin e Meher Babës, duhet ta shohim Hakkun e Hallaxhit. Për kësi lloj HOMUNKULUS flas unë. Ai që është në gjendje të pyes, të dëgjojë, të veprojë dhe të shoh. Shoh vetën në Ty Të dua- Dhe ky është mëkati im

BULË MALLKIMI

Natyra e njeriut është e tillë, që çdoherë kërkon zëvëndësim për të paaritshmen. A nuk është Estetika zëvendësim për përvojën fetare? (Feja këtu duhet të lexohet, përvojë shpirtërore). Dhe, sadoqë plaket njeiu, një lodër të fëmijërisë e zëvendëson me një tjetër, të adultërisë. Dikur luanim me aeroplan, kamion, kukulla, tani luajmë me paragjykime, projektime, sugjestione, sex, cigare, art, ritual, meditim. Ajo që sot është mistike, nesër bëhet shkencë.A kanë ditur egjiptasit e lashtë për klonimin (Sfinksi)-kloni transgjenetik, apo e kanë ëndërruar realitetin tonë. Lexo Bibla (Libri 2 i Mojsoiut, 7:14- 12:32) e tash vjen kjo;

NILI DHE UJËRAT TJERA SHNDËRROHEN NË GJAK, Zoti i Nilit, HAPI u nënçmua nga JAHVE.

BRETKOCAT- Perëndesha – bretkocë HEKET paaftësohet që ta parandaloj këtë fatkeqësi.

PLUHURI- i shndërruar në mushkonja- Zoti i magjisë THOT-i nuk qe në gjendje t'i ndihmojë magjistarëve egjiptas;

MURRELËT- përhapen nëpër tërë Egjiptin, përpos në Goshen ku jetonin hebrenjtë. Asnjë zot nuk mund ta parandalonte - as PTAH - krijuesi i kosmosit e as THOT- i, zoti i magjisë.

NGORDHJA E GJEDHËVE - Perëndesha-lopë HATOR, dhe Zoti Kau - APIS nuk ishin në gjendje ta parandalojnë këtë fatkeqësi;

LYTHAT- perënditë mjek, THOT-i, IZIDA dhe PTAH nuk ishin në gjendje ta parandalojnë këtë fatkeqësi, e as të ndikojnë gjë;

VETËTIMAT DHE PËRLESHJET- dëshmuan paaftësinë e perendive RESHEF - i cili komandonte me vetëtima dhe THOTi - zoti i shiut dhe vetëtimës;

KARKALECAT- Zoti MINU i paaftë t'i parandalojë. MINU ishte zot i pëlleshmërisë dhe mbrojtjes së të korave;

3 DITË RRESHT ERRËSIRË - e nënçmoi zotin diell, RA dhe zotin solar HORUS;

VDEKJA E FËMIJËVE TË PARË - ndër ta edhe fëmija i Faraonit, i cili ishte mishërim i perendisë. AMON-RA, zotidiell, nuk ishte në gjendje ta parandalojë këtë fatkeqësi .

Kjo ndodhi në shekullin XVI p.e.s. Në shekullin XX po nga Orienti me prejardhje, shkroi për realitetin tonë në SHBA. Sikur e ëndërroi atë. Khalil Gibran, Maronit (arab katolik) nga Bshara e Libanit shkroi:

- I mjerë është ai popull, i cili nuk end atë që veshë, nuk mbjell atë që ha, dhe nuk shtrydh verën, që e pi;
- I mjerë është ai popull, i cili shkëlqimin e fituesit e sheh si përkryeshmëri të virtytit dhe në sytë e, të cilit shëmtia e fituesit është bukuri;
- I mjerë është ai popull, i cili lufton të ligat e veta vetëm në ëndërr, por i nënshtrohet së ligës kur është esull;
- I mjerë është ai popull, i cili nuk e ngrit zërin përpos në funeral, i cili tregon respekt vetëm tek varri, i cili pret të rebelohet vetëm kur i vie shpata nën gushë;
- I mjerë është ai popull, politika e, të cilit është dinakëri, filozofia e, të cilit është vegim, industria e, të cilit është arrnim;
- I mjerë është ai popull, i cili fituesin e pret me fyell dhe tupana, pastaj i fishkëllon, për ta përshëndetur fituesin tjetër me këngë e buria;
- I mjerë është ai popull, i urti i, të cilit zë nuk ka, prijësi i, të cilit është i verbër, avokati i, të cilit është propagator;

- I mjerë është ai popull tek, i cili çdo fis dëshiron të jetë komb.

Për kë shkruantë Gibrani?- një amalgam i patriotit, profet endacak, filozof, poet - poezia e, të cilit dridh secilën zemër njeriu, përpos të atij, i cili në vend të zemrës, mban kubë graniti në krahëror.

Ai bartte litarin primordial të SOPHIA-s së përhershme, pikërisht si titulli i këtij shkrimi, i cili është titull i një libri të një të urti të madh Hun; Bela Hamvasz, i cili SOPHIA PERENNIS e trashëgoi nëpërmjet Rene Guenonit, Fritjof Schoun e deri tek Seyyed Hossein Nasr.

Do të shohim nëse Enes Kariq do ta merr këtë stafetë në dorë. Prej kur dija është mëkat? Prej Ademit a.s., prej Giordano Bruno-s apo prej Reshid Hafizoviq, njohësit më të mirë të filozofisë më komplekse të Sufizmit, asaj të Ibn Arebiut nga Andaluzia. Ndodhi, që Dr. Hafizoviæ, duke folur për Muhammedin a.s. si figurë avangarde, tha: Po të ishte i gjallë Pejgamberi i Islamit, do të vishte rrobat e VERSACE-it" dhe për këtë intervistë të botuar, ata që dijen e konsiderojnë mëkat, gjuajtën bombën në qendrën kulturore DAMAT të Novi Pazarit, e cila ishte botuese e kësaj interviste.

Ndërsa, herën tjetër do t'iu flas për VISSARION-in, Jezusin e gjallë të Siberisë dhe veshjen e tij.

Dot nuk më flitet për mallkimin, por le të jetë ky shkrim një shok, i GURDIJEFF-it , për të na zgjuar nga gjysmëpërgjumësia, nga inercia, nga letargjia e përditshmërisë, për të na stimuluar për meditim.

Ishte meditimi temë e diskutimit në Programin e Qendrës për Mendim Pozitiv të themeluar nga Z. Daut Demaku, të mbajtur në programin e Radio Kosovës më 26. 11. 2005, në Prishtinë. Aty u shpalos ajo dije si mëkat, mbi meditimin dhe isha shumë i lumtur, që u dha hapsirë në një radio publike, sepse meditimi në Kosovë nuk na qenka tabu. Dhe çka nuk u tha aty është kjo: Meditimi është unifikim më kosmosin, me ekzistencën. Medit-

imi është çlirim, liri dhe fillon nga zemra e përhapet në gjithësi. Liria fillon nga individi.

Meditimi është dija për vetvetën. Dija për vetvetën është rruga për gjithësi…"**I dituri është si dyqani i parfumeve, plot erë që të joshë, i padituri është si daullja e luftëtarit që zënë e ka të lartë e brenda është bosh**" - thotë Saadi Shirazi, në Gjylistanin e tij. (Shih përkthimin e mrekullueshëm nga persishtja, të Vexhi Buharasë). Meditimi është leximi i vetës me kode kosmike. Ani le të jetë ashtu. Për të mirën tonë - thotë Fahredin Shehu në "NUN". Unë sot sërish e hapa derën e Mesotherisë pas pesë vitesh, nga botimi i SHUMËSI E PADUKSHME. Unë sot të solla tek dera, Ti vetë… duhet të hysh

SHPIRTI NË LETËR

Pas shkrimit të fundit krahasimtar të Namazit dhe Yogës, "Njeriu ndërmjet", të botuar në gazetën "Java", shkrimin, të cilin disa e kanë keqkuptuar (po e them këtë, sepse i mora disa komente kuturu), kanë ndodhur shumë gjëra, të cilat ndoshta i kam merituar t'i përjetoj. Në jetë ndodhin gjërat, të cilat shpesh nuk jemi në gjendje t'u japim spjegim e lëre më domethënie. Edhe njëherë po e them se JETA është fenomen më i jashtëzakonshëm, i cili po ndodh, i cili po manifestohet me ndërrime slajdesh katër a pesë dimensionale, të cilat herë i regjistrojmë, e herë nuk i regjistrojmë, por pamëdyshje ato janë aty, të fjetura, të paketuara, apo zipuara, ta përdorim cyber zhargonin, diku në shtresat e thella të ekzistencës.

Neve na duket, se e njohim jetën vetëm se jemi duke e bërë atë, tmerr për tjetrin dhe po këtë tmerr po e bartim me vete në anën tjetër, duke mos qenë të vetëdijshëm. Kujto: "Kjo botë është tregu në, të cilin blihet bota tjetër", thotë Hasan El Basri.

Këtë e kemi përmendur disa herë. Këtu jetohet me frikë dhe kjo frikë disi po ia jep hijen mrekullisë, e cila na është e njohur si JETA.

Entiteti kosmik i njohur si VDEKJA na duket se ndodhet atje, përtej gardhit.Na duket si diçka e papërjetuar, si zbulim.Faj është përgjumësia jonë, se në çdo shtatë vjet vdesim, çdo shtatë vjet trupi ynë komplet jeton me qeliza të reja. Por, ne nuk marrim mësim. Lukmani i urtë ka thënë (këtë e kam konsumuar

në SHUMËSI E PADUKSHME), "*Kam dëgjuar çka kanë thënë 8000 profetë dhe prej tyre i kam mbajtur në mend 8 fjali, e ato janë:*

KUR TË JESH NË SHTËPI TË HUAJ RUAJI SYTË
KUR TË JESH NË NDONJË TUBIM RUAJE GJUHËN
KUR TË JESH DUKE NGRËNË RUAJE FYTIN
KUR TË JESH NË LUTJE RUAJE ZEMRËN
dy gjëra duhet gjithmonë t'i harrosh
NJË TË MIRË QË IA KE BËRË DIKUJT
NJË TË KEQE QË TA KA BËRË DIKUSH
dy gjëra gjithmonë duhet t'i mbash në mend
VDEKJEN DHE ZOTIN".

Ndoshta reciklimi i rrëfimit të Llukmanit, nuk do t'i bëj dëm këtij diskursi, sepse lufta, e cila, po zhvillohet brenda nesh, assesi nuk mund ta gjejë një negociator, i cili do t'i pajtonte dy anë aq të afërta, dy anë aq të largëta në të njejtën kohë.

Gjithë këtë po e evokoj në këto ditë të Ramazanit, muajit më të vlefshëm se shumë ditë e muaj, sepse në po këtë muaj zbriti shpallja e fundit, e cila do të qarkullojë me shekuj në frymat dhe gjaqet e miliona të devotshmëve. Është muaji i mëshirës dhe dashurisë së Perëndisë ndaj njeriut:I dashurisë së engjëjve për njeriun. I dashurisë së njeriut për njeriun. Dhe pa frikë e turp duhet të themi DUA, sepse kjo fjalë veçanërisht tek ne është bërë turp të thuhet…DUA DHE KY ËSHTË MËKATI IM… a ka mëkat më të mirë se ky.

Në Kur'an thuhet …LEJLETUL KADR HAJRUN MIN ELFI SHEHRIN--- Nata e Kadrit është më e vlefshme se 1000 muaj. A nuk është mirë ta themi dhe jo vetëm ta themi, por edhe ta bëjmë këtë fjalë, në ditën, e cila është më e vlefshme se 1000 muaj, dhe në muajin, i cili është i vlefshëm më shumë, se vetë jeta jonë. Asgjë në këtë muaj nuk është e kthyer kah asgjësimi ynë, por vetëm për të mirën tonë qoftë ajo dobi organike e qoftë ajo shpirtërore.

Një mik shumë i mirë imi, dikur deputet, më pat thënë, se Fahredin Shehu po mundohet me e qit shpirtin në letër. Një kohë të gjatë kjo më hutonte dhe hutia rrjedhte me elegancë si;

rrëshirë pishe në vapën e verës. Pastaj lindi pyetja… A ka përpjekje më të mirë se kjo?

Nëse dikush do të arrinte ta botoj atllasin e shpirtit, për mua do të ishte ai, i cili meriton të gjitha çmimet, apo nëse asgjë tjetër, atëherë vëtëm t'i thuhet; TË DUA, sepse nuk ka njeriu si e blen ndryshe këtë thesar. Sepse, këtu nuk ka rast tjetër, nuk ka kohë për tregti.

Gibrani thotë: **Dashuria nuk humb nga dashuria, ajo jep veç nga vetja**. Sikur një qiri i ndezur, që nuk humb dritë kur e përndrit tjetrin, por e zmadhon shkëlqimin.

Jemi duke e pritur statusin final të Kosovës dhe krejt çka vjen pas tij dhe më duket disi po jetojmë me shpirtin e huazuar. Tani kur politika edhe nëse nuk dëshirojmë të mirremi me të, ajo po merret me ne, dhe na është bërë lëkur, pyetem çka do të na bëhet fjalë, çka zemër, e çka frymë?

Janë dy popuj tani në botë, të cilët vuajnë shkaku, se po e marrin shpirtin hua, d.m.th. nuk kanë lider, e ata janë: Shqiptarët dhe Kurdët. (Sic!).

Prej të gjithë shitësve të fjalëve dhe çmimit të tyre falco, falja e fjalëve duket, se është një biznes i dështuar, ndërsa bërja e fjalës, veçmas fjalës DUA, më duket, se është një biznes i padefinuar, i cili ende nuk po e gjen poligonin vet. Unë po them se tregu duhet të jetë mes lëkurës dhe zemrës sate. Në nervaturën kosmike të entitetit kosmik të njohur, pa vetëdije, e të quajtur NJERI.

Natyrisht, **Poezia nuk mësohet nga njeriu; Ajo është dhunti e Perëndisë dhe Vjen nga mëshira e Tij**.

Gjithë këtë po e evokoj në këto ditë të Ramazanit, muajit më të vlefshëm, se shumë ditë e muaj, sepse në po këtë muaj zbriti shpallja e fundit, e cila do të qarkullojë me shekuj në frymat dhe gjaqet e miliona të devotshmëve. Është muaji i mëshirës dhe dashurisë së Perëndisë ndaj njeriut: I dashurisë së engjëjve për njeriun. I dashurisë së njeriut për njeriun.

Dhe pa frikë e turp duhet të themi DUA, sepse kjo fjalë veçanërisht tek ne është bërë turp të thuhet…DUA DHE KY ËSHTË MËKATI IM… a ka mëkat më të mirë se ky. Në Kur'an

thuhet …LEJLETUL KADR HAJRUN MIN ELFI SHEHRIN--- Nata e Kadrit është më e vlefshme se 1000 muaj. A nuk është mirë ta themi dhe jo vetëm ta themi, por edhe ta bëjmë këtë fjalë, në ditën e cila është më e vlefshme se 1000 muaj, dhe në muajin i cili është i vlefshëm më shumë se vetë jeta jonë. Asgjë në këtë muaj nuk është e kthyer kah asgjësimi ynë, por vetëm për të mirën tonë qoftë ajo dobi organike e qoftë ajo shpirtërore.

MË DËGJONI MADJE NJËHERË

Tani me shekuj të tërë çkado, që ishte Islame qe përkthyer në gjuhën latine nga shkaku, që të kuptohet më mirë ajo më thelbësore, me efekt që të mos mirret hëpërhë vlera burimore Islame në origjinal, ndërsa dobia nga po ky burim shfrytëzohet në jetën e përditëshme perëndimore dhe bëhet pjesë e identitetit perëndimor.

I gjithë ky kompozicin fjalësh ka për nijet, një sebeb për ta hapur këtë muhabet të nxitur nga një afsh sa poetik aq edhe estetik, sa rutinor aq edhe ontologjik.

Kur flitet për vlerën, më me qejf flas për vlera islame (lexo globale jo globaliste), sepse Islami nuk ka njohur asgjë njerëzore si të huaj. Nëse Ibrahimi A.S. Babilonas, Idrisi A.S. Pellazg, Musa A.S. Hebre, Muhamedi A.S. Arab, e të gjithë musliman i pranojnë këta si mysliman, vetëm pse ishin nënshtruar vullnetit të Perendisë, atëherë nuk ka dilemë, përse neve na erdhën nëpërmjet Kur'anit në gjuhën arabe dhe ne i pranuam ashtu të përkthyer, në gjuhën arabe dhe e pamë historikisht, sa larg shkoi islami në shkencë. Krijoi bazën për shkencën moderne dhe metodën eksperimentale. Dituria u përcoll si stafetë nga Lindja në Perëndim.

Derisa ne Meraga u hap observatoriumi për vëzhgimin e yjeve, në Perendim (lexo: Sorbone-Francë), nxënësit lexonin në kashtë, sepse ajo ishte shtroje e vetme, kurse ne Ispahan endeshin dhe thureshin qilimat nga më të llojllojshëm sa, që disa me ma-

nipulimin e xhinëve edhe fluturonin. Kjo ishte shkencë, e cila tash po merr hov të madh në Perëndim.

Prap nuk dua,, që ky krahasim të konsiderohet si garë se kush çka ishte, por le të jetë ilustrim sa për zgjim nga letargjia, nga heshtja, e cila e kaploi botën Islame.

Nëse fillojmë nga teza se, e tërë bota do të jetë Amerikë në shekullin e ardhshëm (paragjykimi se në çdo vend të botës ka baza amerikane e në Amerikë nuk ka asnjë bazë të huaj- thotë nobelisti Jose Saramago), atëherë duhet të presim një transformim të vetëdijes globale, e cila tenton kah ajo globaliste. Ku jemi ne në këtë vorbull? Çfarë fitojmë ne e çfarë humbim?

Për këtë kam shkruar në librin tim të dytë SHUMËSI E PADUKSHME – se "…jetoj në një popullacion ketmanësh, të cilët e ndrrojnë fenë për një darkë". Disa më kritikuan, se isha tepër kritik, por qysh atëherë Allahu xheleshanuhu më dha disa vizione gjatë përsiatjeve të gjata dhe lutjeve të tilla, se diçka apokaliptike do të ndodh. Dhe çka po ndodh?

Atë që viteve të 60-ta të shekjullit të kaluar regjimi i ish Jugosllavisë u përpoq që t'i zhduk shamiat, tani në mënyrë më perfide, me media dhe një art bashkëkohor (kontemporan), si i thonë këta të gegënishtes së re, e tërë trashigimia Islame, po shuhet si mjegulla para diellit.

Kritikat këtu u drejtohen institucioneve Islame që janë në letargji, që nuk botojnë libra artistik Islam: ne nuk kemi përmbledhje poetike islame, as pikturë islame, as shfaqje teatrale islame etj. E si t'i ofrohesh rinisë, kur mosha e adoloshencës është e prirur dhe e nxitur për ta artikuluar vetën, ndërsa mediumi më i mirë (psikologjikishte e vërtetuar) është arti.

Pse nuk ka shkollë për kaligrafi? Pse nuk ka shkollë për Ebru? Pse nuk ka shfaqje teatrale. Unë di, por e pyes lexuesin. Them se lexuesi mendon, se këto janë punë të kota. Ndoshta për lexuesin e moshuar, por jo edhe për të riun. I riu kërkon ta demonstroj fuqinë, potencialin kreativ, inteligjencën pikërisht, si filozofi kurreshtar, artisti i lënë anash të hulumtoj në botën e imagjinatës.

Nëse grafisiti holandez hebrej, Mauritz Cornelius Escher ka mundur të inspirohet nga arabeskat e Alhambras dhe të krijoj vepra marrëmendës arti, përse një musliman nuk mund të inspirohet nga dramat e Teufik Al Hakimit, apo nga Profeti i Khalil Gibranit, apo nga Kasidat e Imr ul- Kaisit, apo nga Ilahitë e Yunus Emres?

Gjënë e parë, që e kisha dashur ta bëj është ta hap një shkollë për dëgjim. Një shkollë mësojmë të lexojmë, të shkruajmë, të mësojmë, por askush nuk na mëson si të dëgjojmë. Dhe nëse dëgjojmë ne marrim informata të panjohura, sepse kjo nuk na është dhënë në gjuhën e kuptueshme. Ja përse Ibna Arabi ka qenë Doctor Maximus, Ibn Rushd ka qenë Averroës, përse Hayy ibn Yaqzan i Ibn Tufaylit u transformua në Robinson Crusso të Daniel Defoes, përse e tërë eskatologjia Islame dhe sistemi numerologjik Xhefr u transformua në Komedinë Huyjnore të Dante Alighierit etj. Pra, sepse janë përkthyer në gjuhën e kuptueshme.

Nëse të dëgjoj, por nuk të kuptoj është problem. Nëse nuk të dëgjoj e të kuptoj, por nuk je atraktiv problemi është prap i yti. Nëse u duam të mirën tjetrit, atëherë duhet të kuptjomë se janë të tepërt dhe duhet të flasin ashtu si kërkohet "…folju njerëzve sipas nivelit të tyre të të kuptuarit":- thotë Muhamedi A.S.

Nëse donë shfaqje, ofroju, nëse donë ligjeratë teologjike, ofroju, nëse donë pikture, ofroju pikturë

Nëse e kuptojmë realitetin si diçka, që çdoherë e tejkalon vizionin tonë, atëherë e kuptojmë më së miri.

Nëse vetëm pak ndalemi dhe i monitoriojmë mediet tona, cilatdo, do të vërejmë se, secili e kritikon tjetrin dhe shumë pak shihet se, dikush e lavdëron dike. Nga kjo mund të konkudojmë, se vërtet jemi në një krizë morale.

Dhe para çdo kërkese të mësimbesimit nëpër shkolla, të cilën e konsiderojnë tendencioz, kisha propozuar, që në shkolla të futet lënda ETIKË DHE MORAL. Prap edhe kjo të jetë në gjuhën e kuptueshme. Prap edhe kjo të jetë në metoda të të dëgjuarit e drejtë.

PARFUMI

Në kohërat e lashta, esencat natyrale janë përdorur më shumë për nevoja terapeutike se, sa si element i rëndësishëm i toaletës personale.

Egjiptasit antik kanë lënë gjurma materiale dhe të dukshme si në të shkruar, ashtu edhe shishe alabastri me esencë jasemini mbi 3000 vjeçare, të cilat janë gjetur pas mihjeve nëpër shkretëtirë, nëpër sarkofagë. Mesopotamia, Persia, Roma, Etruria, po ashtu lanë gjurmë të përdorimit të parfumeve.

Edhe kulturat tjera si ajo hinduse me mjekësinë e sajë tradicionale te njohur si: Ayurveda, dëshmon për një paletë të gjerë, të përdorimit të esencave si për toaletë, ashtu edhe për terapi, më saktë, për aroma- terapi.

Përdorimi i parfumeve nëpër shekuj dhe kultura të ndryshëm, shpesh mëton ta identifikoj atë kulturë. Në mesjetën evropiane, Arabia ishte e njohur si; vendi i aromave, por vet Arabët kanë ditur burimin se, ai vend është Jemeni. Këtu flasim për Oud.

Kimisti arab Al Kindi (shek. IX) shkroi librin: Libri kimik i parfumeve dhe distilimit, i cili përmbante më se 100 receta të prodhimit të parfumeve. Në Evropë recetat e murgjve të Firencës 1221, të Santa Maria Novella, pastaj në Hungari 1337, pastaj koleksionet e Catherine d'Medici etj.

Nëse jemi tek kulturat sakrale është e njohur se, Jezu Krishti preferonte Jaseminin, po ashtu edhe Rumiu, ndërsa profeti Muhamed, preferonte Moshusin apo Miskun.

Në shërbesat fetare të krishtera përdoret Temjani, kurse në orient Temjani, Kamfori, Sandali, janë substanca, të cilat janë përdorur edhe për aromatizimin e ambientit, gjegjësisht dhomave gjatë vapës. Nostradamusi përpunonte esencat dhe i kombinonte ato, duke i përforcuar me misk.

Tek më vonë Franca bëhet qendër kulturore botërore dhe parfumi merr domethënie të re, përdorim luksoz, prestigj e deri tek komercializimi i tyre.

Përpunuesit e aromave për Coco Chanel, prodhuan 20 kombinime mahnitëse të aromave, por Coco kërkonte formulë unike, diçka që do ti vie era Chanel. Duke i erëmuar mostrat ajo, ndalet tek kombinimi NR. 5, që më vonë të bëhet vulë e Chanel dhe e shekullit. Chanel No 5 mbetet koncept aromatik, i cili shumë më vonë do të vazhdoj edhe sot, të jetë shenjë e autenticitetit, markës dhe prestigjit.

Hermes, Guerlain, Boucheron deri tek Cartier, frymëzohen me notat orientale të mëlmesave aziatike; sandal, oud, ambergris, trëndafil, iris.

Prodhimi i një kombinimi inspirativ kërkon kohë, mjeshtri, njohje të strukturës piramidale të esencave; baza, mesi dhe nota kulmore, prejardhja bimore, shtazore dhe mineralogjike, që krejt në fund të krijohet identiteti.

Për prodhimin e një mililitri esence duhen së paku 1500 lule, apo të pritet kalbja e tuberëve të luleshpatës (Iris Germanica) për shtatë vjet me radhë, që të krijohen esencat, të cilat kalojnë nëpër fazat laboratorike si macerimi, pluhurizimi, tretja, distilimi etj.

Veç e thamë më sipër, se përbërësit janë me prejardhje bimore: Sandal, Kedër libanez, jasmin, trëndafil, vjollcë, luleshpatë, neroli, ylang ylang, patchouli, mushqet e bungut, lulet e protokallit dhe paleta e gjerë e substancave eterike, si përbërës bimor si; bergamot, kumarin, lavantë etj. Pastaj ato me prejardhje shtazore: Moshus (Moschus Mosciferus nga gjëndrat e këtij kaprolli, Civet (lloj mace e egër), Ambergris (sperma e koaguluar e balenave), lëkurat e maceruara të shtazëve etj. Dhe ato mineralogjike, si

Amber, Urea etj. Si dhe ato artificiale si Calone e zbuluar më 1966, si përbërës themelor i "Dune" të Christian Dior.

Nevojitet mjeshtri e rrallë, që të kombinohen substancat e prejardhjeve të ndryshme.

Bulgari ka notën bazë shumë të dallueshme, kurse nuancat sipërore dallojnë. Kenzo promovon kulturën bimore të prejardhjes së tij në përdorimin e bambusit, Armani pjepri, mentolli dhe baza e trëndafilit e kështu me radhë. Rifat Ozbek shishen e disenjon në formë minareje të xhamisë dhe kombinim i trëndafilit dhe tulipanit, që në njëfarë mënyre të dokumentoj prejardhjen e tij, për ta sjellur Stambollin në; fillimisht në Paris e pastaje edhe në vende të ndryshme të botës.

Clive Christian vendos kurorën e Mbretëreshës Angleze, për ta dëshmuar mbretëroren, sharmin dhe luksin ekstrem. Thiery Mugler na fascinon si me aromë ashtu edhe me shishet, se na sjell nga bota ekstraterestriale, me serinë Angel, Alien etj.

Pacco Rabanne, Dolce& Gabanna, Calvin Clein prodhojnë parfum Unisex, i cili është për të dy gjini, sepse gjatë kohës është bërë edhe ndarja gjinore e parfumeve, kështu parfumet me prejardhje bimore të kombinuara me ato mineralogjike, janë femërore, kurse ato me prejardhje shtazore me kombinime mineralogjike mbesin parfumet mashkullore. Pastaj janë ndarë edhe në aspektin kohor dhe sezonal, parfumet glamuroze, ato më të lehta për ditë dhe tjerat për mbrëmje.

Zambaku blu i Nilit apo viagra egjiptiane është produkt i përdorur në kozmetikë, aromaterapi, detergjente dhe mbetet baza themelore e ujërave tualeti.

Trëndafili i Bulgarisë, Oudi i Jemenit, Sandali Hindus, Kedri Libanez, Jasemini i imët i Algjerit, Ylang Ylang i Indokinës, Vanila e pyjeve tropikale; mbesin esencat, të cilat identifikojnë një territor të caktuar.

Ndërsa mjeshtërve u mbetet, që të krijojnë kombinime duke i kategorizuar ato nga të lehta në më të rënda varësisht nga baza esenciale yndyrore e kombinimit. Kështu dallojmë: Parfume extract që janë 40% e përbërjes aromatike, Esprit de Parfum deri

në 30%, Eu de Parfum 10-20% e përbërjes aromatike, Eu de toalette 5-15%, Eu de Cologne 3-8% me përbërës joalkoolik, Perfume mist po ashtu 3-8% dhe Splash dhe After Shave 1-3% të përbërësit aromatik.

Parfumet yndyrore qoftë si esenca individuale si Attar apo baza yndyrore e kombinuar shpesh deri në tetë sosh, si okatvë muzikore si kombinimi i njohur Janat al Firdeus.

SILENTIUM II

Pas vitit 2005, me të kthyer nga takimet ndërkombëtare të poezisë në Sarajevë, shumëçka ndryshoi në raport me atë, çka ne e emërtonim letërsi, sepse një iluzion më pak kisha, sepse kuptova sa larg ishim dhe sa shtrenjtë na kushtoi izolimi. Nuk do ta fajësoj UNMIK-un, as luftën, por po e fajësoj mungesën e lirisë shpirtërore, atë që Berdjajevi e tejçmonte. Po e fajësoj edhe mungesën e guximit për me e pa vetën në pasqyrën e huaj.

Mjaft vite na ndajnë nga koha kur Berdjajevi fliste për lirinë. Mjaftë vite po na ndajnë edhe me ata njerëz, të cilët krijojnë ndryshe nga ne, jo më mirë, por më ndryshe.

Josip Osti nga Sllovenia më pyet nëse e njoh Radije Hoxhën? Branko Çegec, krijues dhe botues nga Zagrebi, më pyet kush është kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve në Kosovë. I zbulova dhe u trishtua, sepse ai dot nuk e perceptonte se, si Adem Demaçi, politikan, të jetë në krye të shkrimtarëve. Pastaj, Dara Sekuliq më pyet për Teki Dervishin, Axhem Hajdareviq për Ali Podrimen, Luka Paljetak me thotë: koleg, më vjen shumë mirë që në Kosovë kultivohet një poezi e këtillë; (ishte poezia "Pas heshtjes së gjatë", nga përmbledhja ime NUN), me Evan Reil nga SHBA folëm për Gurdijeffin për Rrugën e katërt, Gustav Mejrink dhe legjendën e Golemit të Pragës. Roza Alice Branko nga Portugalia as, që dinte ku është Kosova.

Në një kafe orientale në Mostar, shumë afër urës së renovuar, që dukej kukull në krahasim me atë, që ishte para se ta bom-

bardonin kroatët, kafen BOSANSKA dhe shumë tym duhani shkëmbeva me Shaban Sharenkapiq nga Novi Pazari dhe Radivoj Shajtinac nga Zrenjanini, i cili më tregoi se si ishte burgosur tre muaj gjatë regjimit të Millosheviqit vetëm se vendlindjen e tij, Zrenjaninin, e quante në origjinal - Beçkerek.

Edhe pse Kodi i Da Vinçit ishte hit në Kosovë, ata nuk deshën as të hynë në atë temë, por flisnin për Orhan Pamukun, Saramagon dhe Coetzeen.

Natyrisht, nga Sarajeva u ktheva me shumë libra, veçmas ato të botuara në Zagreb të Bela Hamvasz. Bota letrare atje ishte e njoftuar me tregimin e veçantë të Bela Hamvasz për Silentiumin, një term, të cilin e farkëtoi vet Hamvasz, për konceptin për mua më të njohur si Quietizëm.

Edhe si nocion edhe si përmbajtje do të ishtë një praktikë më e dobishme për secilin, e veçmas për hipersenzitivët që bezdisen kush çka tha? Dhe kush ku shkoi? Për çështjen madhore kombëtare.

Në rrëfimin për procesin e Silentiumit, Bela Hamvasz zbulon mënyrën se, si ai e filloi dhe sa zgjati heshtja dhe izolimi i tij. Përgatitja për një përvojë të këtillë, nuk do shumë paisje apo angazhim. Në kohërat e lashta ka ndodhur në mënyra të ndryshme, nga askeza totale me celibate, e deri te ato periodike, mujore, apo disa ditore.

Tek Bela Hamvasz zgjat njëzetekatër orë; dhe gjithë kjo e përcjellur me dietë totale me vetëm pakëz ujë me limon.

Të flitet për rëndësinë e këtij eksperimenti ka mjaft hapësirë, por sa prej njerëzve sot e praktikojnë këtë, mund të numërohen në gishta tek ne, madje as aq.

Procesi i introspekcionit, një doënload total i kujtesave, një pauzë nga rutina, mprehje shqisore dhe përjetim më cilësor i fenomeneve rutinore, janë vetëm disa nga dukuritë që rezultojnë nga Silentiumi.

Ngadalsimi i metabolizmit dhe hektikës së përditshme që ndikojnë edhe në zgjatjen e jetës. Për këtë duhet të mendohet. Rreth asaj sesa rëndësi i japim vetvetës reflektohet më së miri në

raportet ndërnjerëzore, sepse ai që nuk kujdeset për shëndetin psikofizik dhe trajtimin etik të vetes, nuk kujdeset as për të tjerët dhe s'ka si ta bëjë këtë, sepse nuk njeh rëndësinë e këtij shëndeti.

Natyrisht, me Evan Reil as me Radivoj Shajtinac, e as me askë këtu në Prishtinë nuk fola për fenomenin e Silentimumit. Thjesht, e heshta nga droja se, po e kontaminoj sistemin e mendimit, shkatërroj iluzionin e tjetrit, apo hutoj dikë.

Pse pikërisht tani shkruja për Silentiumin është, se kam motivacion për ta zbuluar një diçka të dobishme për individin dhe di, se fare pak do t'i interesoj dikujt.

DILEMA

Gjuha me, të cilën flasin sot, banorët e kosovës i ngjan gjuhës së personit të reanimuar pas një shoku të rendë. Shokun, të cilin po e përjeton Kosova një kohë bukur të gjatë i ngjan atyre rrefimeve transcendentale të mjështërve të Zenit që, një flutur kujton se dikur ka qenë njeri dhe kur vdes si flutur dhe bëhet njeri e kujton se dikur ka qenë flutur dhe tani në këtë moment nuk di çka me të vertete është. Kësaj i thonë; Reinkarnim.

Krahas gjithë trazirave, vuajtjeve, varfërisë, spastrimit etnik, deri të gjeocidi, dhe formave nga më të ndryshme të shaurjes sistematike dhe të programuar, të amputimit të një pjese të Shqipërisë, e cila nuk është i dimensionit sakral, por ontologjik i saj, të Shqiperisë, e cila nuk beson se, po digjet dhe në kllapi hapëron si maçorri përtac dhe nuk e çel gojën, duke i pasur të gjitha strukturat shtetërore për të reaguar, avokuar dhe madje edhe kuruar një pjesë të saj të anestezuar për një kohë bukur të gjatë, dhe nuk di ta mbroj të vetën, derisa Serbia diçka që, ka vjedhur e sakralizon deri në përmasa galaktike, me diligjencë më të madhe, Kosova po mbetet si… as në tokë e as në qiell, dhe cili është ai i marrë, i cili kërkon fajtorin këtu.

Gjërat dukenprej reve dhe mbi to, prej aeroplani sa, që edhe zogjët na përqeshin. Ajo që më së shumti po më dhemb është profecia e Sheshelit… edhe po t'ju japim pavarësinë atyre, nuk do të dijnë ta mbajnë. Kosovarët janë duke e mbajtur një diçka

të padefinuar dhe vetë nuk dijnë ta emërtojnë, por dilema është si po e mbajnë këtë?

T'i keshë dy akademi të shkencave e Historinë të ta shkruaj një Anglez? A nuk tregon kjo diçka? Duke ditur se, në këto akademi numri i doktorave të shkencave më shumë janë historian dhe gjuhëtarë, dhe shih si heshtin këta. Shih sa tmerr që ende nuk e kanë bë një Encyclopaedia Albanica, kur ka Britanica, Judaica, etj. etj. A janë duke pritur që Albin Kurti apo familja Jasharaj ta bëj edhe këtë?

Dhe populli hesht, derisa e kanë torturuar të huajt shekuj me rradhë, dhe tani, të vetët duke e plaçkitur, rrymë nuk kemi ketë e dijmë, punë nuk kemi dhe populli hesht, dhe nuk ka askund në botë, që kriminieli të lirohet (rumunët e UNMIK-ut) e viktima të burgoset.

O temopra o mores!!! Dhe gazetat nuk guxojnë të botojnë, që është më e keqja atë, që duhet dhe atë, që e mendojnë, se bëhën horr, e pastaj na mbahen trajnime për gazetarë për lirinë e shprehjes. Nuk guxojmë të shkruajmë dhe të mendojmë për padrejtësitë, që na ushtrohen derisa gazetat në botë provokojnë me ofendime ndaj një kulture të madhe Islame dhe atë e cilësojnë si liri të shprehjes dhe shpërblehen për këto ofendime.

Ky popull ka me heshtë edhe me vendimin, i cili nuk ka me qenë final i Statusit të Kosovës, populli u lodhë dhe nuk ka takat për festat euforike, se ka edhe shumë për t'u bërë, se nuk sheh dritë në fund të tunelit, se e konsumon vetëm ajrin dhe mbahet gjallë nga produkëtët e natyrës. Dhe pastaj Zgjedhjet, kush do të dal në votime, kë ta votosh? Dhe cili prind i ri tani dëshiron të ketë fëmijë; kur nuk di në duart e kujt ka me u rrit, në çfarë ambienti ka me u rrit një gjeneratë e re.

Dilema se, çka jemi dhe nga vijmë vazhdon të jetoj në frymë-marrjen tonë, dhe ne do të vazhdojmë të heshtim. Deri kur?

MATRIKSET E ZEZA

Ata, të cilët e njohin veprën e Khalil Gibran-it me siguri kanë hasur në vargje të tij:

- *I mjerë është ai popull, i cili nuk end atë që veshë, nuk mbjell atë që ha, dhe nuk shtrydh verën, që e pi;*
- *I mjerë është ai popull, i cili shkëlqimin e fituesit e sheh si përkryeshmëri të virtytit dhe në sytë e, të cilit shëmtia e fituesit është bukuri;*
- *I mjerë është ai popull, i cili lufton të ligat e veta vetëm në ëndërr, por i nënshtrohet së ligës kur është esull;*
- *I mjerë është ai popull, i cili nuk e ngrit zërin përpos në funeral, i cili tregon respekt vetëm tek varri, i cili pret të rebelohet vetëm kur i vie shpata nën gushë;*
- *I mjerë është ai popull, politika e, të cilit është dinakëri, filozofia e, të cilit është vegim, industria e, të cilit është arrnim;*
- *I mjerë është ai popull, i cili fituesin e pret me fyell dhe tupana, pastaj i fishkëllon, për ta përshëndetur fituesin tjetër me këngë e buria;*
- *I mjerë është ai popull, i urti i, të cilit zë nuk ka, prijësi i, të cilit është i verbër, avokati i, të cilit është propagator;*
- *I mjerë është ai popull tek, i cili çdo fis dëshiron të jetë komb.*

Për, të cilat kam shkruarmë herët, se po thuaj i ka shkruar për ne duke ma pamundësuar që as të shtoj e as të heq gjë.

Letërsia jonë me duket, se është e vetme, e cila në historinë e sajë të amputuar dhunshëm, përpiqet ta harroj një grup autorësh, të cilët shkruan edhe në burgje edhe në manastire edhe në kasha edhe në xhami edhe në teqe… ka shumë prej bejtexhinjëve e deri te Arshi Pipa, Fredrik Rreshpja e më tej.

Mediet tona tani e bëjnë të njëjtën gjë, duke amputuare artin me promovimin e politikës siluetë.

Mospasja e Universitetit shkencor është një dëshmi se prodhimi i kuadros edukative nuk e ndërton një shoqëri.Natyrisht nuk flas për cilësinë e kuadrove.

Fakti që me një temë magjistrature dhjetra individë magjistrojnë, kumbon më zëshëm se, sa të pajtohesh me mjerimin e ky ndosh vetëm atëherë, kur pajtohesh me injorancën dhe këtë e mbulon me zë.

Injorantët janë të zëshëm duke artikuluar mendimet e huaja si të vetat, mirë, zëshëm, me entuziazëm dhe pasion.

Kjo stimulon pasthirrmat, ato të zëshme natyrisht shumë të zëshme. Kuku kuku kuku!!! " injorantë, të lumit ju, gjatë jetoni të liruar nga barra e dijes. Nga prangat e përgjegjësisë, të cilat krijohen nga kjo dije"

Kush ia ndali volumin e zërit intelektualëve? Pse ata vdesin urie? Pse ata heshtin? Ku janë këta? Thonë se, u duhet një mjeshtri. Mjeshtri menaxhuese.

"Menaxhimi i vërtetë i vetës intelektuale, arrihet çdoherë duke krijuar alternativë, simultanisht me njëtrajtshmërinë jetësore, në njëtrajtshmërinë e karierës intelektuale".

Intelektualët flasin, idhujtaria bashkëkohore e okupoi shpirtin e njerëzimit. Tash nuk ka Zeus, Brahma, Amon Ra, Shamash, Uzzat, Adonai, Shang Di, Omikami Amateratsu, dhe lista vazhdon në pambarim, tani ka kredit kartelë, telefon mobil, kompjuterë, qenë dhe maca nën sqetull. Njeriu beson tani në kulte të reja. Vetë i krijoi.

Moda, Muzika, Inxhinjeringu gjenetik, pesticidet, herbicidet, homocidet, gazetat, librat komplotiste, anti-age kozmetika, preparate kundër obesitetit; këto gjernerojnë krye-Perendinë, në kierarkinë pagane bashkëkohore, Paranë.

Del, se njeriu i çdo epoke në kunitesencën e tij është pagan, sepse e ka më lehtë nga cytja e mbrendëshme utilitare – instinkt bazë- ta absorboj një atribut të Njëshmërisë. Edhe kur ka të bëj me Zotin e vërtetë- ta admiroj si Zot.

Në ambient të këtillë agresiv, intelektualit i këshillohet durimi. Po ka dy lloje të durimit. Durimi i dhunshëm dhe durimi i vullnetshëm.

Këto dallojnë në substancë; në të parin, mbretëron shpresa e ashpër, e pamëshirëshme, në të dytin, shpresa e dyshuar në vete. E gjithë kjo është segment i jetës-segment i pandashëm-ekstremitet i sajë- nëpër jetë kalohet me këmbën e durimit dhe shpresës- pak janë ata, të cilët jetojnë në "Tash".

Jeta ec drejt dështimit- regresit dhe drejt suksesit- progresit pamëshirshëm- nuk të prêt të mendohesh, çasti vlen sa jeta. Jeta është proces çasti- aty fshihet kodi gjenetik i jetës- në çast.

Kur kam shkruar "Nibiru"- Fragmente nga libri i zi, në formë poetike- kam menduar që hija e zezë, e cila gufon nga matrikset e zeza të secilit individ, të reflektohet në qenien e lexuesit- apo t'i shërbej si pasqyrë, ku mund të shikohet qenia e tyre si shikohet dielli në pasqyrën e hënës.

Vetëm ballafaqimi me hijen e vet na mëson për vetën ato lekcione, të cilat nuk i gjejmë dot në libra, tek njeriu apo cilado gjallësë me e ulët se gjitarët.

Ai, i cili është në gjendje të ballafaqohet me hijen e vet, ai as që lodhet ta bëj këtë - çdoherë "Nesër", bëhet shpresa e pambarimtë. Ai mendon së pari vetën, pastaj çastin, pastaj të tjerët, bëhet i zëshëm dhe model i keq për gjeneratën pasuese. Vetëm me zë mund ta mbuloj heshtjen – urtësia flen në heshtje, heshtja flen në zemër dhe e përkund dashurinë në djepin e sajë.

As gatuhet një vepër e as ndërtohet një kështjellë pa dashuri.

"Të gjitha krijesat e Zotiti janë një fmailje…më i miri prej jushë është ai, i cili më së shumti i sjell dobi kësaj familjeje"- Hadith.

Kush është mësuar të dashuroj- vështirë e ka të ç'mësohet

Vetëm kështu buron drita nga matrikset e bardha, por edhe nga ato të zeza.

VUAJTJA E MËNDAFSHTË

Asnjëherë nuk kam parë një plantacion të organizuar, të trungjeve të manit, tek tuk nga një pemë me shtrirje të madhe degësh.

Fletët e ngopura me gjelbërsinë, e cila u vie nga shiu transparent janë të dobishme dhe të thara ato janë çaj i shijshëm. Frutet pa u pjekur nuk biejnë. Sipas formës duhet të janë më se të doishme për gratë para dhe mbas mbarsimit. Lëvorja e mesme e trungut, nëse thahet dhe përgatitet si çaj është e dobishme kundër diabetit. Kultivimi i pupave të mëndafshit është i pamundur pa gjethe të manit, sepse këto janë ushqim i vetëm.

Kaluan shumë vite. Unë ende i mbaj këto kujtesa, të cilat simultanisht me gëzime, dije, dëshprime, krizat e të gjitha bojave etj., u mbështollën spiralisht duke sajuar pejtë eterik, të cilët koordinojnë lëvizjen time në shtratin e lumit të rrëmbyeshëm e të pamëshirëshëm herë herë, të cilin e quajmë Jeta.

Ekzistojnë kafshime të lehta erotike, që lënë gjurmë në qenie dhe ledhatime të lehta, freskuese, mendafshore të vuajtjeve procesion, të lidhura, zinxhir i padukshëm.

Po e zëmë guri në veshka, gëzimin e urologëve të cilët gëzohen se u krijohet punë, gurët janë të fshehura dhe pjesa dërmuese e popullatës, i ka ato duke e ditur apo duke mos e ditur këtë.

Ato të përcjellin mjeshtërisht dhe të befasojnë profesionalisht.

Pastaj uthulla e mollës; një mrekulli shumë lënë pas dore.

Rumiu në Mesnevinë e tij flet, se uthulla në kombinim me mjaltin është kurra më e mirë kundër epilepsisë. Unë nuk takoj shpesh raste epileptike, por ato skizofenike. Kjo është polarizim total i vetës në dy pole.

Fenomeni i zhveshur, i pamundur të maskohet- Hipokrizia; dispersion total i vetës në të gjitha kahjet e mundëshme. Dinakëria; një nxënëse e zellëshme e hipokrizisë- si dija, që është nxënëse e mosdijes, e okupuar, e rrethuar nga planktoni, nektoni dhe bentosi i Mosdijes.

Dijes i duhet Libido- Maskulinitet, pasion, fuqi që, t'i kaloj të gjitha këto shtresa gjallesash në oqeanin e mosdijes që të jetë në gjendje të ushqehet nga ato gjallesa, e të krijoj fuqi tektonike, akuatike dhe aeriale, e të përndrisë Turbë-n Natën e errët të shpirtit.

Shpirti- krijesë me qindra membrane stelare dhe eterike. Cipat e tij qërohen me vuajtje, qofshin ato sadiste, qofshin ato penetrime të dhunëshme deri në kloakën/ zgavrën e errët të tij, qofshin aato të muslinta apo mëndafshta.

Damasti i vuajtjes thith djersën e lë damga në torzon muskulore, stratosfera erotike e, të cilit dëftohet në epshndjellëse kur mbulohet me Devore.

Kështu kalojnë vitet duke u zhveshur cipë më cipë kur nga këto cipa thurr pejtë, t'i ve në tymnin astral, në vekun kosmik e, ta mbështjell me elegancë rulen-topin e Muslinit të purport.

Muslin i Purpurt do ta mbështjell Anima-n, do ta vesh me petkun e shpirtnisë.

PORTOKALLI I SHTRYDHUR ËSHTË I HIDHËT

"Dita ishte e bukur dhe një trung pjeshke përplotë me fruta të lëngshëm, donte t›i thyej degët e holla». Kjo jep një pamje të një ëndrre ose të fillimit të një vargu portik. Sa jemi ne poetik është parë dhe po shihet dhe kriza të cilën po ia gjuajnë lexuesit se, nuk lexon, shkrimtaret e sotit (... o ku jeni burra ...?) ka vetëm një kahje. Vallahi duhet me e pyet vetën sa janë shkrimtarët në krizë kreativiteti?, dhe jo vetëm shkrimtarët...

Një shenjë e fuqishme e dekadencës së madhe është kritika e tepërt e secilit kundër secilit andaj edhe ky llaf nuk ka mundur t›i ik kritikës kundër kritikës. Kjo na u paska bërë fenotip. Një kulturë e komunikimit të vrazhdë me mungesë të dashurisë. (Dashuria- të lutem mos lexo; ajo dashuri si afekt i budallakisë së pubertetit).

A është problemi i Inteligjences, Nderdijes apo Vetedijes se pamoralshme une nuk e di.

Kur me vizitoi një American Sufi nga Vermonti (USA), i cili po e ndiqte kursin e teozofisë, i thash se, koha po i shkon kot, ndersa Zoti po betohet në kohën. Kujto Suren e Kur›anit ... Vel asr ine›el-insani le fi husr ... pasha kohën, me të vërtetë njeriu është në humbje ...Dhe i tregova se në Indi ekzistojne tri shkolla të kërkimit, Karma, Bhakta dhe Xhana d.m.th., shkolla e Karmës apo veprimit, shkolla e Bhaktës apo dashurisë dhe shkolla e Xhanës apo diturisë. Dhe të trija shkolla kanë dhënë mjështër

të fortë të disciplinave të njohjes së vetës dhe Perendisë. Dhe, nëse neve na duhet urgjentisht diçka, atëherë ajo është shkolla e Bhaktes, që Ramakrishna të na udhezoj, Rabia el Adawia të na udhëzoj, Mansur Hallajj të na udhëzoj, Maister Eckhart të na udhëzoj, por edhe Valtezar Grazian, Erasmi i Roterdamit, Saadi, Attar, e pastaj pse jo edhe Wivekananda, Khut Hoomi, Meher Baba, Osho Rajneesh, Pir Ziya Inayat Khan, Murat Yagan, të cilët janë rebeluar nga turma dhe kanë luluar, sikur që lulja rebelohet nga dega dhe lulon duke liruar parfumin e saj, (Është ky një varg nga «Shumesi e padukshme»). Ndërsa këta ishin shërbyesit më të mëdhenjë të humanizmit.

Natyrisht çdogjë e ka çmimin e vetë dhe kjo do ta ketë çmimin e vetë, i cili ka me u pagu shtrenjtë. Sepse gjuha e gjatë është shenjë e injorantit, jo e elokuentit. Hazreti Ali thotë: «me rritjen e dijes, gjuha shkurtohet». Kjo është një zhveshje e domosdoshme, si mëllef për këto ndjenja të rudhosura kot. Dhe une e di, e veçmas kur ma rrëfeu Rumiu misterin e çmimit, i cili më tha pëshpëritshëm: «Nëse e qet kalin në pazar të pulave, ke me e shit me çmim të pulës». Por ekziston një dhembshuri prej një plaku të pyjeve të gjelberta, i cili shikon me një dioptri tjetër, ama krejt tjetër në gjërat, të cilat po janë duke u ndodhur tek ne. A është edhe kjo e mundur? Nëse po, atëherë aferin entitetit kosmik me manifestim të dukshëm vetëm me thjështësi. Prandaj e kuptoj çmimin dhe e di pasojën. Ndërsa këtë po ta ilustroj me një SUFI urtësi :

"**Askush nuk ka mësuar nga unë mjeshtrinë e gjuajtjes me shtizë, e që nga unë nuk e ka bërë shënjestrën**".

Kur jemi tek çmimi atëherë po e vë edhe këtë, jo si dekorim, por si komplementaritet, dhe jo pse unë nuk mund të them diç të ngjashme, por, sepse nëse unë e them këtë Shqip, nuk do të pranohet. Sepse, ne nuk pranojmë asgjë çka vjen nga vetja. Vallë a jemi ne si dreri myshk (Moschus Moschiferus) i poezisë së Kabirit dhe Tagorës, të cilët duhet të thehemi për ta njohur se, ajo erandje po vika prej vetë neve. Prandaj, sa për të mirën e të gjithëve, po e vë edhe këtë Sufi urtësi:

Dy mjeshtër Sufi bisedonin dhe njëri prej tyre,

SIMAB tha: Do ta shes librin e urtësisë për njëqindë dukat, e disa për këtë do të thonë se është i lirë.

JUNUS MARMAR iu pergjigj: Ndërsa unë do ta jap çelësin e të të kuptuarit të tij, por askush nuk do ta marrë, madje edhe falas.

Kjo jep një parashenjë, se është më mirë me hesht se me fol. Zatën edhe çdohere ka qenë kështu, por papjekuria e bën nganjëherë të vetën, sikur edhe unë timen. Edhe nëse thuhet diçka, atëherë mos të zhvishet si lëvozhgë e hidhët.

Ata që e shtrydhin rrushin, fitojnë mushtin, ata që kane durim të presin nga mushti, fitojnë verën, ata që e pinë, kënaqen, ndërsa unë nuk jam Khajami. Prandaj me mbetet uthulla e atyre që, nuk dijne verën ta ruajn.

Pra vazhdoj të them për të satën herë:

"Eja të ta rrefej misterin e përditshmërisë.
Nata ta zhvesh trupin bëhesh si mejit
Dita ta zhvesh qenien bëhesh si nefrit
Eja të ta rrëfej dashurinë e engjellit për njerinë."

E çka do të ndodhte nëse e kisha thënë krejt çka këtu fshihet? Natyrisht do ta kishte shijen e portokallit të shtrydhur.

POEZIA ËSHTË KRIJESË NAIVE

MILAZIM KRASNIQI: "DRITË DHE KUJTIME"
BOTUES: ARBËRIA, TIRANË 2007
(RECENSION)

Poezia është një krijesë naïve
Po s'u kyç në gëzhojë
Si kërmill
Derisa ata të përhënshmit
Të vijnë sërish në vete

Dilemën e parë, që e pata gjatë leximit të këtij libri ishte edhe klimaksi, të cilin e arriti Milazim Krasniqi në këto vargje, e ajo është se ka arritur ta shkruaj heshtjen e lexuesit, ka arritur të më shtyej të mendoj se, këto vargje unë i kisha në kokë. E njejta më ndodh sa herë që, e lexoj Rumiun dhe them po këtë edhe unë e përjetoj, apo Niçen…po këtë edhe unë e mendoj, por më bie ndërmend në rastin e Rumiut se, ai e ka shkruar para tetë shekujsh, Niçe para një shekulli, kurse Krasniqi, në dhjetë vite të fundit.

Dhe çka ka ndodhur në letësinë tonë, më së miri e pasqyron kjo revoltë e Krasniqit që, ta thurr artin e vet në tymnin kosmik (për konceptin e tymnit dhe thurrjes së fijeve, shih: Rene Guenon, në Simbolika e kryqit) dhe ta bëj një poezi naïve??? Unë e

kisha thënë: të virgjër e cullake nga stereotipet dhe matrikset, të cilët stampojnë serikisht vargjet, të cilat lamentojnë se, janë poezi, ose nga ato matrikse lindin, gufojnë fosile të gjalla të një periudhe ku lavdëroheshin lideri apo koncepti politik.

Milazim Krasniqi ka arritur që ta zhvesh poezinë e tij deri në cipën më të thellë, të qëndroj e virgjër para Zotit, e të mos ketë turp, se është e tillë. Që pastaj të reflektoj imazhe të një botë të formave të varura, të njohura në gjeografinë metafizike islame si: Alam al Mithal, apo të nivelit të tretë shpiurtëror, të trupit astral, sferës së yjeve të K.G. Jungut, botës imagjinative kodet e, së cilës i lexon kontempluesi i heshtur sokratik, i cili nuk dërdëllis, por krijon në heshtje si natyra (Shih: Plotini dhe OSHO)

Shëmbëllime të tilla korrespondojnë me analogji nga bota e dukshme: kumbullat, aromë ftoi apo emra të përveçshëm; Fadili, Ahmeti, Sefa, i cili është mësues, djalë etj., si personazhe pozitive.

Korespondencat shpirtërore dhe etike janë të dukshme në një gjuhë të çiltër, jo tendencioze, kulluese si; shkrirja e rrëshirës në vapë gushti.

Flet për Nënën- një temë kosmike e kondenzuar në disa vargje, flet për pendimin tek:

Fëmijët e diktaturës:

Ku të marr tash ditë tjera
Që ta përmirësoj gabimin
Kur nga halli s'kam kohë
As për të vdekur

Pastaj "Teatër me vetën"- është interpretim i përvojës së Krasniqit, e cila në vargun tim del si Kenobium i vetave të mia, pra flasim për të njejtin fenomen, por me refleksion dhe kreativitet, i cili dallon në nuanca.

Çdo definim i artit, e lë në vete një fjalë të kapërdirë, sepse folur me gjuhën letrare një rrjeshti të tillë artistik, asnjëherë nuk i vihet pika.

"*Poetët janë profetë të bukurisë, tronditjes dhe harmonisë; trininë, të cilën e njeh vetëm arti i dashurisë*"; thotë poeti boshnjak Shaban Sharenkapiq, në librin e tij "Kudilema".

Dhe natyrisht një poezi e këtillë, lind vetëm nga dashuria dhe pikon si mëshirë nga bujaria e Perëndisë.

PLAGË TË BUKURISË

ATHANASE VANTCHEV DE THRACY
(RECENSION)

Po të mos ishin Gjovalin Kola dhe Jeton Kelmendi; Athanase Vantchev de Thracy për mua do të ishte një njeri, i cili shkruan poezi vetëm për Francën apo vetëm për Bulgarinë, të cilat e përbëjnë identitetin e dukshëm human të poetit De Thracy, por me tej identiteti i tij është global dhe atë për shumë arsye dhe për këtë kam hise të flas me shumë ëndje,prandaj më duhet ta përsërisë vetveten për të satën herë, se rëndësia e përkthyesve, është gjithmonë, si rëndësia e urave, që na lidhin me një botë më pak të njohur. Puna e lodhshme e përkthimit pothuaj, asnjëherë nuk është shpërblyer, shpeshherë madje as duke i adresuar falënderime.

Shfrytëzoj këtë shkrim si rast i duhur që publikisht t'u falënderohem përkthyesve, me falënderimet të cilat i tejkalojnë lartësitë e reve të bardha.

Kur kihet parasysh se kulti i fjalës së shkruar jeton ende dhe me tej kulti i poezisë sado që perceptohet, se nuk ka lexues, kjo duket se është fazë kaluese, sepse De Thracy e dëshmon të kundërtën, e resurekton poezinë duke filluar nga antikiteti nëpër mesjetë e deri në kohën tonë, na inkurajon të mendojmë se nëse koha e profetëve ka mbaruar të përzgjedhurit e Zotit prej eoneve të lashta e deri më sot duket se nuk janë kush tjetër pos poetëve.

Thellësisht i preokupuar me konceptet, të cilat janë problematike, që nga gjeneza e njeriut; vdekja, jeta, dashuria, bukuria, arti, De Thracy na shpalos një muslin të ndjeshëm dhe sensual e spektral të fjalëve filigranike të përzgjedhura me kujdes, dedikime të përzgjedhura me kujdes, motiveve të përzgjedhura me kujdes dhe finesë të veçantë. Nga antikiteti letrar Epikuri dhe Lukreci, nëpërmjet mesjetës i kthehet Solomon Ibn Gabriolit, Juda Ha Levi dhe traditës mistike hebreje, tek Mevlana Rumiu, Nazim Hikmet dhe Ahmed Shawki, Wilhelm Heinrich Wackenroder, Paul Verlaine dhe Novalis, etj. Sakaq dëshmon më shumë thënien e poetit persian Saadi Shirazi, ...kur të përzihesh me lule e merr aromën e tyre. Ja se De Thracy e bënë këtë në mënyrën e vetë origjinale dhe për mua si poet e herë herë kritik, më kthen tek hyjnorja dhe se, vërtetë edhe pas Khalil Gibranit transcendentalja vibron në të dy kahet e botës.

Derisa Munir Mezyed, palestinezi i kthehet Rumanisë që të krijoj poezi, e cila e pason hyjnoren e Gibranit, De Thracy nga Bullgaria në Francë e bart peshën subtile nëpër netët pa gjumë dhe punë të palodhshme në një trajtë universale duke mos e mohuar kulturën Lindore e as Perëndimore por duke e konsideruar atë si begatshmëri dhe duke e bartur flakadanin e urtësisë dhe poezisë Evropiane.

Fjalët, të cilat unë i radhis në këtë shkrim, janë refleks i vetëm një libri, i cili porsi bletë grumbullon nektarin nga shumë lule dhe nuk di nga cila dhe nga sa lule ka mbledhur nektar për ta prodhuar një bulë mjaltë, nëse kështu më lejohet t'i parafrazoj Upanisadat e urta Induse.

Himnet dhe epitafet e De Thracy kanë një ndjeshmëri të rrallë artistike dhe thellësi estetike, veçmas epitafi:

EPITAF PËR ATHANASE DE THRACY-IN

O njerëz të Francës, rrëzë kësaj peme të njomë
Fle gjumin e ëmbël dhe të përjetshëm
Athanase de Thracy,
Më i dhembshuri dhe më i dashuruari

I poetëve të Francës.
Me patos të thellë në këtë segment:
FJALË KOPSHTARIE TË NJË TË PADUKSHMI

Për Alfonso Gatto

Më mësoni lutje të vjetra dhe himne kishtare të përshpirtshme,
Fjalët me aromë temjani Arabie,
Formula që sjellin besimin,
Ekuacionet melodioze të organos,
Teoremat mugulluese
Të ujrave të tokës dhe të qiellit!

Se në tërësi i dedikohet poezisë, De Thracy pohon në vargje me ndjeshmëri prej artisti të madh në epigrafin:

LULE SHËNGJERGJI

"Frumentum Christi sum..."
"Unë jam nga brumi i Krishtit"

Kalimtar, këtu prehet Athanase-i
Vesën e mëngjesit ka për qefin,
E për varr zambakët në luginë -
Jeta e tij qe një poemë,
Poemë që do të mbetet në përjetësi!

Poetit japonez Sugakawa Yoko-si kushton haiku duke i kënduar pleqërisë:
Një gjethe e verdhë bie
prej plepit-
një lot e përcjell,
jam plakur!

Poetit ndër më të mëdhenjtë persian; Abul Qasim Hassan ibn Ahmad 'Unsuri Balkhi i kushton këtë poezi:

Flauti i barit derdh shpirtin e tij të mahnitur
Mbi qepallat ngjyrë blu gjysmë të mbyllura.
Princi im! Çfarë mbetet nga parfumi luksoz i shënimeve,
Të letrave të pashkruara, të fjalëve të pashprehura?

Se bota është e bukurë në gjithë tërësinë e sajë më së miri e përshkruan e ndërton dhe e mbindërton poeti me sensualitetin engjëllor duke e zbritur hyjnoren nga katet e larta qiellore dhe duke e transmetuar në letër, e tani edhe në formën elektronike.



Athanase Vantchev de Thracy

Athanase Vantchev de Thracy është pa dyshim njëri nga poetët më të mëdhenj bashkëkohorë francezë. I lindur më 3 janar 1940, në Haskovo të Bullgarisë.

Athanase Vantchev de Thracy është autor i 32 përmbledhjeve me poezi (të shkruara në varg klasik dhe të lirë), ku ai përdor gjithë spektrin e prozodisë : epopenë, odën, sonetin, bukoliket, idilet, pastoralet, baladat, elegjitë, rondon, satirën, himin, epigramin, epitafin etj. Ai ka publikuar gjithashtu një numër monografish si dhe punimin e doktoraturës, *Simbolika e dritës në poezinë e Paul Verlaine*-it. Në bullgarisht, ai shkruan një studim për shkrimtarin epikurian Petronin, të mbiquajtur Petronius Arbiter elegantiaru, i preferuari i perandorit Neron, autor i romanit klasik Satirikoni, si dhe një studim në gjuhën ruse me titullin *Poetika dhe metafizika në veprën e Dostojevskit*.

Duke qenë një njohës shumë i mirë i antikitetit, Athanase Vantchev de Thracy ka shkruar mjaft artikuj për poezinë greke e latine. Kurse gjatë qëndrimit të tij prej dy vjetësh në Tunizi, ai boton njëra pas tjetrës tri vepra kushtuar dy qytezave punike tuniziane : *Monastir-Ruspina – ana e tejdukshme, El-Djem-Thysdrus – e fejuara e kaltërsisë* dhe *Mozaikët e qytetit të Thysdrus*-it. Ai studion për shumë vite me radhë islamin dhe vendet e Lindjes si Sirinë, Turqinë, Libanin, Arabinë Saudite, Jordaninë, Irakun, Egjiptin, Marokun, Tunizinë, Mauritaninë dhe Taxhikistanin, ku kalon edhe një pjesë të jetës së tij. Në këtë periudhë, ai përshtat në gjuhën frënge veprën historike të Mustafa Tlass-it, *Zenobie, mbretëresha e Palmyre*-s.

Ai qëndroi gjithashtu dy vjet në Rusi (1993-1994) për të studiuar poezinë ruse. Përkthyes i një plejade të tërë poetësh, Athanase Vantchev de Thracy është nderuar me shumë çmime letrare kombëtare e ndërkombëtare, midis të cilëve me Çmimin e Madh Ndërkombëtar të Poezisë Solenzara. Ai është laureat i Akademisë Franceze, anëtar i Akademisë Evropiane të Shkencave, Arteve dhe të Letërsisë, Docteur honoris causa i Universitetit të Veliko Tarnovo-s, në Bullgari, laureat i Ministrisë së

Punëve të Jashtmë të Francës, anëtar i P.E.N Club-it francez, i Shoqatës së Shkrimtarëve francezë si dhe i Shtëpisë së Shkrimtarëve dhe të Letërsisë në Francë. Poezitë e tij janë përkthyer në shumë gjuhë të huaja.

Është anëtarë i Akademisë së Shkencave të Brazilit dhe Bullgarisë dhe Ambasador i Lëvizjes Poetët Botëror, Poetas Del Mundo për Evropën.

Vepra poetike

Flakërime (1970), Hije e marrëzi (1971), Polyhymnia (1981), Libri i transparencave (1981), Orë e Stinë (1981), Ti, Virgjëreshë e zjarrit (1985), ribotuar më 2001 dhe 2002, Oaz, fytyrë drite (1986), Strofa pentakorde (1986), Animula vagula, blandula (1986), Sonetet e Damaskut (1987), Elozh dritës (1987), Libër për oktavat (1987), Leptis-Minor (sonete romane), Përmbi Fjalët (1988), Anamnezë (1991), ribotim i zgjeruar(2006), Vetmia e Tridhjetë (1992), Trallisje, pasuar nga Shkëlqimet (1992), Këngë homofonike (1997), Zëra të bukur antikë (2000), Befas, një drithërimë engjëllore (2000), Momente përjetësie (2001), Anale dhe përshpirtje (2002),Epopteia (Soditje sublime) 2003, Elegji (2003), Ora e Nëntë (2004), Mëshirë, o Zot! (2005), Kështu bëhen njerëzit (2006), Dhe deti kthehej në këngë (2007), Vizione zemre (2008), Edhe njëherë për poezinë hyjnore (2009).

EDHE LEXIMI ËSHTË BËRË PROFESION...

NAIME BEQIRAJ "NJOMJA E FIKUT"
(RECENSION)

Librat e bukur lexohen edhe pas shumë vitesh dhe ndoshta më shumë dhe më mirë dhe më me ëndje...

Dikur libri i sapodalë lexohej nga kritikët për ta vlerësuar apo nxirë në rast guximi.

Pakëz më vonë se dikur, garoheshe për të shkruar për librin, ku tymni i ndërthurur qëllimi- klani- grupi i interesit- honorari, qëndiseshin me emrin e kritikut.

Sot, leximi është shndërruar në profesion dhe atë të papaguar, por të kushtueshëm, lexohet nga pasioni për librin pa dalluar a segreguar atë, në aspektin gjinor apo të zhanrit.

Poezia ende frymon, madje fort. Libri duhet të jetë vërtet i shkëlqyer dhe cytës që të më detyroj të shkruaj për të.

Pas suksesit të Profetit, Khalil Gibran është pyetur për sa kohë e pat shkruar librin, dhe përgjigja e tij ishte; për 20 vjet...e kam sjellë nga B'shara e Libanit në Amerikë. Nga Libani ku erëmon cedri.

Edhe Naime Beqiraj sikur e ka ndërprerë heshtjen poetike dhe nuk shkruan poezi gjinore, feministe, por poezia e këtillë është androgjinike dhe na e sjell qysh në titull Fikun për, të cilin kam shkruar dikur me ëndje, një bimë Biblike dhe Kur'anore, e cila lulëzon nga brendia dhe shfaq mrekullinë e sajë.



Ai duhet të piqet mirë, të pëlcas e të shfaqet si rozetë. Një vrojtim të këtillë e do libri "Njomja e fikut", i Naime Beqirajt. Ndryshe ky libër nuk lexohet.

Lexohet pa gjini, si shpirti, si jeta, si rruga drejtë dashurisë. Ajo thotë:

"Perëndia është Dashuri". Kjo Perëndi e lexuesit dhe e autores në të njëjtën kohë, por kjo; autorja na e kumton me krejt kuvetin prej artisteje, me krejt aftësinë prej mjeshtri, me krejt mallimin prej një vajze, e cila ndjek rrugën, hapat në rrugëtimin e gjatë nga kërkimi estetik drejt amshimit, aty ku kërkon troha oksigjeni nga Babai dhe nostalgjia për aromën e bukës së gatuar nga duart e Nënës.

Ai/ Ajo që lexon këto vargje e asnjë tejzë e zëmrës nuk i dridhet, druaj se vuan nga abstinenca totale e zemrës apo atë e ka por aq të ngurtësuar më të fortë se graniti dhe të paluhatshme.

Emocioni pëlcet pikërisht si fiku i pjekur dhe ky është misioni i poezisë, të pëlcas si fiku i pjekur në degë, të pëlcas nga origjinaliteti, harmonia dhe balanci dhe përfundimisht mjeshtëria e artikulimit të të gjitha këtyre.

Prapë zgjedhjen e përcakton shija.

Prapë zgjidhjen e dhuron Dashuria sepse, cito:" Perëndia është Dashuri"

INTERVISTË

1. Z. Shehu, ju ushtroni shumë profesione në art, megjithëatë mireni edhe me poezi. Poezia është art, që nuk konsumohet shumë as në Kosovë dhe as në Evropë; çka mundë të na thoni ju për poezinë ?

Gjithmonë ka qenë dhe ashtu do të mbetet…Poezia fillimisht duhet thënë se duhet të krijohet nga aristokratët, sepse si tek ne, ashtu edhe në mbarë botën, nuk kemi institucione të mirëfillta të cilat do ta subvenciononinpoezinë. Kjo ndoshta edhe është edhe më mirë, sepse do të ndodhte kudo në botë, ashtu si ndodh tek ne, që secili të shkruaj dhe askush të mos e lexoj atë.

Kriza, të cilën po e përjetojmë ne tani, po flas për krizën e konsumit të poezisë, ka ekzistuar në çdo kohë dhe ne nuk jemi përjashtim. Dikur kanë ekzistuar poetët e oborreve mbretërore, të cilët janë paguar nga mbretërit, mecenët apo vakëfet dhe fondacionet. Kjo tani nuk ekziston. Janë botues të vegjël ata, që e mbajnë të gjallë këtë art. Këtu gjithmonë flas për poezinë e botuar në letër,kurse mundësia e botimit të vetëm disa kopjeve reprodukon kuazi- poetë, të cilët sjellin më shumë dëm se dobi, dhe në fund vetë këta poetë pendohen se kanë shpenzuar mjete, që kanë botuar duke kuptuar se poezinë e tij, nuk e lexon askush dhe ajo përfundon tek shitësit e gështenjave për fishekë apo në byrektore mos t'u digjen petë të yndyrosura të byrekëve.

Nëse dikush dëshiron të krijoj fat/ karrierë nga poezia dhe mendon, se do të jetoj nga ajo; po ju them troç, se kjo nuk është e pamundur.

Shpesh kam thënë se: "**Poezia nuk mësohet nga njeriu, ajo është dhunti e Perëndisë dhe vjen nga mëshira e tij**". Po, që se kemi poezi të këtillë dhe po që se jemi në gjendje ta identifikojmë një poezi të tillë, atëherë këtë duhet ta stimulojmë dhe përkrahim.

Unë nuk jetoj nga poezia, por për të. Krijoj poezinë vetëm se kam cytje të brendshme shpirtërore, njohuri në artin letrar dhe njohuritë tjera humane, pastaj edhe pasionin, elemente këto, të cilat duhen doemos, që të krijohet një poezi, të cilën po ashtu do ta lexojnë pak njerëz, por ajo pakicë e lumtur e cila di ç`është poezia, dhe si e sa e begaton ajo shpirtin njerëzor, artin dhe kulturën e një kombi.

2. Librat e tua janë përkthyera në shumë gjuhë të ndryshme, ndërsa në Maqedonisht ka ndonjë dhe sa je prezent në publikun e Maqedonisë tek shqiptarët?

Ndonjëherë futesha në siklet të madh përse nuk ka libra të mi prezent, aty ku ka shqiptarë, dhe këtë për faktin se shkruaja për shqiptarët, jo ato elozhe dhe apologji për djepin shqiptar, flamurin, kombin, gjakun, strofullin e ku ta di unë. Shkruaja për shpirtin dhe për atë që e fsheh çdo shqiptarë. Madje në librin NIBIRU kam shprehur se është pasqyrë e zezë, ku njeriu e lexon atë libër i dallon të gjitha të zezat e veta dhe frikësohet nga vetvetja. Është poezi vet- reflektuese, e cila ashtu si e begaton artin tonë të të shkruarit, po ashtu identifikon edhe tiparet e kombit dhe të psikologjisë personale të individit. Të krijohet një poezi e atillë është bajagi si zor, sepse ta shkruash të heshturën e vetë, e cila doemos reflekton edhe të heshturën e lexuesit; nuk është lehtë.

Tani nuk e kam atë problem, pasi që më lexojnë njerëz nga mbarë bota në më se se 20 gjuhë të botës, meqenëse shqiptarët

kanë dëshirë të vetë-gënjehen, e jo të përballen me vërtetësinë aktuale dhe me realitetin e vetë shpirtëror.

Kujtoj se në vitin 2007, shtëpia botuese LOGOS-A, e Shkupit, e ka botuar një libër timin, përmbledhjen me poezi, KUN, poezi të lirikës shpirtërore.

3. Ushtroni dhe profesionin e kaligrafisë; çka saktësisht është ky art dhe në sa vende ke marr pjesë me kaligrafi ?

Krahas poezisë, merrem edhe me artin aplikativ/ figurative, si pikturë, relief dhe kaligrafi. Më rehat jam në kaligrafi, në bukurshkrim, ku krijoj poezi, e cila buron drejtpërsëdrejti nga ai frymëzim poetik.

Për mua Kaligrafia është kristalizimi i fluidit poetik, një proces materializues i shpirtërores. Një transformim nga fjala fluide, shpirtërore në atë figurative, të shkruar dhe pikturuar bukur, që kënaq shpirtin dhe syrin.

4.Ndërkohë ushtroni detyrën e ambasadorit për Poezinë shqipe në Lëvizjen Poetët Botëror, ku përfaqësoni dhe gjuhën shqipe, normalisht këtu përfaqëson dhe shqiptarët e Maqedonisë, cilët poete nga Maqedonia i ke prezantuar jashtë vendit ?

Vetëm Radije Hoxhën, e cila oscilon mes Kosovës dhe Maqedonisë. Të tjerët nuk i njoh, proporcionalisht si ata nuk më njohin mua. As i kam lexuar e as më lexojnë. Pikë!!! Kjo nuk vlen vetëm për poetët shqiptarë të Maqedonisë, por për të gjithë poetë arrogant dhe të këtillë ka mjaftë.

Ekzistojnë disa manifestime letrare në Maqedoni, dhe asnjëherë nuk marrë ftesë, derisa në anën tjetër botën e kam shëtitur nëpër festivale dhe simpoziume shkencore.

E di se do të dukem arrogant, por njëherë e për gjithmonë njerëzit/ lexuesit le të mësohen me realitetin në medie. Le të mësojnë se ky është realiteti, dhe kush më mohon mua do të jetë i mohuar (Sic!).

5. Çka mund të thoni për prezantimetetua jashtëvendit që keni marr, sa ka qenë e vështirëdhe si ju kanë pritur ?

Çdo prezantim i imi para dhe pas pavarësisë së Kosovës ka qenë dinjitoz, jam prezantuar si Shqiptar, Kosovar dhe asnjëherë nuk jam mohuar. Nuk ka qenë asnjëherë vështirë, sepse njerëzit jashtë kufijve tonë mental, kanë kureshtje të dinë, se çka po krijomë ne, pavarësisht, se neve na duket, se nuk na përfillin. Natyrisht nuk përfillet jo- vlera. Me ka ndodhur që t'i fascinoj njerëzit; me dashamirësi më të madhe janë afruar për të më uruar, me ka ndodhur po ashtu edhe t'i kompleksoj dhe janë përpjekur, që të zvogëlojnë fuqinë e fjalës Shqipe dhe këtë natyrisht asnjëherë nuk e kam lejuar.

Zakonisht më presin jashtëzakonisht mirë. Fundja në Perëndim, njerëzit janë më individualistë dhe çmojnë individualitetin, dhe unikalitetin e poezisë përkatëse, ata nuk gjeneralizojnë.

6. Na thoni për librat që keni botuar dhe sa janë të lexuara ?

Kam botuar NUN më 1996- përmbledhje me poezi mistike, Shumësi e padukshme 2000- prozë transcendentale poetike, Nektarina 2004- Roman epik transcendental, Elemental 2006, KUN 2007- përmbledhje e lirikave shpirtërore, Dismantle of Hate 2010, (ose Çmontimi i urrejtjes botuar në Londër) dhe Crystaline Echoes 2011, (Jehona të kristalta e botuar në Portugali.

Se, sa janë të lexuara nuk mund të mas, e di se asnjëri nuk është në raftet e librarive të Kosovës.

7. Së fundi keni botuar librin në gjuhën angleze " Crystalline Echoes "a do të thotë kjo për ju ?

Asgjë të veçantë, tani më jam mësuar, që të botoj jashtë, sepse nuk është hera e parë. Në proces janë edhe disa libra që të botohen në Bejrut, Stamboll, Paris, Romë, andaj krejt këtë e konsideroj si proces kreativ dhe nuk guxoj të ndalem. Doemos duhet ta largoj një libër nga unë që t'i krijoj hapësirë tjetrit, të radhës.

8. Ku është Kosova me art në krahasim me vendet tjera ?

Kudo dhe kurdo që dal jashtë flas për poezinë e veçanërisht pikturën e Kosovës dhe shqiptare në përgjithësi. Nuk jemi fare larg askujt, kemi artistë të jashtëzakonshëm, ekziston abstenimi për vlerësimin e vetvetes, flas Institucionalisht. Ndoshta do të duhet të bëhej një projekt mbarëkombëtarë, por i përkthyer në gjuhën kuptueshme, për botën, që atje të dihet, se çka posedojmë.

Me shumë kënaqësi jashtë i përmend: Muslim Mulliqin, Xhevdet Xhafën, Rexhep Ferrin, Zake Prelvukajn, Nehat Beqirin, Sislej Xhafën, Artan Balajn, Adrian Pacin, Sokol Beqirin; në artet vizuale, ndërsa në artin letrar: Azem Shkrelin, Teki Dervishin, Daut Demakun, Ali Podrimen, Basri Çapriqin, Ilire Zajmin, Visar Zhitin, Ervin Hatibin, Luljeta Lleshanakun, Luan Starovën etj.

9. Cilët janë poetët shqiptarë që i vlersoni më shumë?

Nuk dua të gabohem me asnjërin, ne kemi poetë të shkëlqyeshëm, por të flas të heshturën time, unë po guxoj të them se lirika shpirtërore e bejtexhinjve, gegnishtja e kulluar e Gjergj Fishtës, hermetizmi i Martin Camajt, Beat-i i Xhevdet Bajrajt, janë të dallueshme, por secili në vete bart copëza të mozaikut identitar shqiptar dhe kjo buqetë më pëlqen jashtëzakonisht shumë.

17.03.2011, Prishtinë

Fexhrije Zylfiu
Zhurnal Plus, Maqedoni

INTERVISTË
ME SHKRIMTARIN FAHREDIN SHEHU

Z. Shehu, jeni shkrimtar i botuar i përkthyer në disa vende të botës, ndërsa në Kosovë krijimtaria juaj nuk është shumë e njohur. Si e shpjegoni këtë ?

Që nga fillimi i krijimtarisë sime e deri sot; janë botuar 5 libra, poezi, prozë poetike, roman dhe shumë artikuj, ese dhe kolumne në gazetat tona. Sa i përket librave dy të parë "NUN" dhe "Shumësi e padukshme", janë botuar si botim autori, kurse romani "Nektarina"- (Rozafa 2004), "Elemental 99"- (Qendra për mendim pozitiv 2006) dhe "KUN"- (Logos- A Shkup, 2007), kam përcjellur vetëm impulsin tim kreativ dhe fare nuk jam bezdisur nëse kjo do të pranohet tek lexuesi dhe ndodhi, që kam lexues të caktuar dhe të besueshëm, por të paktë, të cilët nëse dëshirojnë të gjejnë frymëzim dhe njohuri, të cilat në gjuhën shqipe janë të pakta, atëherë dinë ku të orientohen. Këtë po e them me plot bindje, sepse tek "Shumësia e padukshme", për herë të parë në gjuhën shqipe, në formën artistike janë paraqitur njohuri rreth religjionit hebrenj dhe ky libër është vetëm pjesa e parë e tetralogjisë, e cila do të vazhdoj më Krishterimin dhe Islamin, që të përmbyllet me Misticizmat e tri feve të Abrahamit.

Kam parasysh, se lexuesi ynë një kohë të gjatë ka bërë pauzë dhe fatkeqësisht ky trend po vazhdon, unë e arsyetoj pse nuk kri-

jimtaria ime nuk është e njohur dhe jo vetëm kaq, arsyeja tjetër është se unë kultivoj artin letrar, i cili fare pak është i njohur e ai është Letërsia transcendentale, ku parimi kryesor është dashuria ndaj të gjitha krijesave dhe kontributi i secilit është i nevojshëm, prandaj më i miri në këtë bashkësi është ai, i cili më së shumti kontribuon asaj.

Qëllimi im është që ta përçoj këtë mesazh primordial nga lashtësia e deri më sot, por me një gjuhë të pastër sa artistike po aq edhe shkencore me qëllim, që të krijoj një trajtë më origjinale për kohën në, të cilën jetojmë dhe më tej. Andaj kujtoj se ky është shkaku, pse në Botë jam më i pranishëm se sa tek ne dhe nuk dua ta fajësoj askënd, sepse ne si popull kemi kaluar nëpër trazira të shumta dhe tek duhet të krijohet një kulturë e re e leximit pakëz më ndryshe nga ajo tradicionale. Tani kemi edhe mediumet tjera ku arti mund të plasohet e kështu me radhë, dhe unë këtë po e shfrytëzoj shumë mirë.

Krijimtaria juaj është risidhe shkrimi mbi mistiken pothuajse i palëruar në letërsinë shqipe.Nga cilët poetë jeni ndikuar ?

Vërtet është risi dhe sa herë filloj një Project të ri së pari kujtoj mos po i humbas edhe ata pak lexues të besueshëm, që e presin ndonjë libër të ri. Misticizmi tek ne ka qenë i pranishëm tek Naim Frashëri dhe tek bejtexhinjtë, por dallimi është se, unë nuk kufizohem vetëm në trashëgimin Islame, por zgjerohem në atë botërore duke shfrytëzuar teknologjinë e re dhe si pasoj edhe vokabularin e ri. Përkitazi me vokabularin, shpesh has në probleme dhe kam shkruar më herët se "…**Neve na mungon vokabulari tokësor për çështjet qiellore**." Andaj më duhet një kohë bukur e gjatë, që ta farkëtoj ndonjë fjalë të re, e cila do të korrespondonte me vizionin apo manifestimin shpirtëror, i cili më paraqitet. Latinët e kanë një thënie **Nihil Humani ame allienum puto**,- asgjë njerëzore për mua nuk është e huaj që unë e kultivoj me shumë sukses në kontekstin e trashëgimisë shpirtërore. Kjo ndoshta është arsyeja, pse pranoj me qindra le-

tra nga mbarë bota, pavarësisht prej prapavisë fetare, që e ka një lexues jashtë Ballkanit.

Secili, që thotë se nuk është i ndikuar nga askush vetëm se gënjen, në këtë kontekst nuk mund ta zbulojmë ujin e nxehtë dhe shkrimtarët si Danilo Kish apo Martin Camaj shumë me herët kanë shkruar për Palimpsestin. Njëlloj edhe sot, kjo është e pashmangshme. Nëse jemi tek emrat unë me kënaqësi e kujtoj Danten, Miltonin, William Blake, Henry Thoroeau, të cilët po ashtu ishin të ndikuar nga ndikimi im primar e ata janë poetët Sufi si: Saadi, Rumi, Hafiz, Al Ma'ari, Kabir, e deri tek Khalil Gibran, të cilin e mbaj si fillimin e artit Teurgjik, sepse ai me mjeshtri të madhe ka ditur, që në formë poetike ta transmetoj frymëzimin e tij në tymnin e trashëgimisë shpirtërore Abrahamike.

Nga ana ime, konsideroj, se për të qenë origjinal, konceptin botërisht të njohur duhet ta përpunosh në një trajtë të vetën dhe kjo arrihet vetëm më dije dhe inspirim si dy këmbë me, të cilat shkohet përpara. Me një vathë në veshë mund të ecësh, por veç me një këpucë assesi.

Në romanin tuaj të fundit që do të shoh së shpejti dritën e botimit, poeti Ali Podrimja në recensionin e tij shkruan, se me këtë libër hapni portat e reja të artikulimit, që vështirë se do ti hapin të tjerët. Cilat janë ato porta ?

Ali Podrimja është kulmi i poezisë bashkëkohore shqiptare, andaj duhet të kihet parasysh, se ai nuk flet pa parë, pa ditur dhe pa përjetuar vargun apo prozën e dikujt. Kur ai thotë, se hap portën, të cilën të tjerët nuk do ta hapin, flet për të përtejmen, për shpirtëroren dhe depërtimin tim të thellë në atë dimension, gjë që nuk ka ndodhur, por shpresoj se do të ndodh në të ardhmen e letërsisë sonë. Ky është dimensioni ynë, të cilin jashtë arealit tonë ballanik nuk e kanë të njohur të tjerët, andaj janë shumë të interesuar. Për ne kanë ditur këtë letërsi, të cilën e kemi dhe po që se u ofrohet diçka më e ndryshme, atëherë ata zbulojnë edhe

një element interesant dhe tipar të kombit tonë. Dhe kjo më bën krenar.

Ndër të tjera ushtroni edhe pozitën e ambasadorit tëAsociacionit Poetët e Botës (Poetas del Mundo) për Shqipëri. Sa do të ndikojë përfaqësimi juaj në këtë asociacion, për afirmimin e letërsisë suaj por erdhe shkrimtarëve të tjerë mbarëshqiptar?

Lëvizja poetët botëror (Poetas del Mundo) e ka historikun e vetë. Dhe ata organizohen dhe botojnë antologji të poezisë nga e gjithë bota. Secili kontinent e ka nga një ambasador, të cilit i përgjigjen ambasadorët e vendeve të atij kontinenti dhe ka një bashkëpunim të jashtëzakonshëm.

Nga ana ime unë kam prezantuar disa shkrimtarë dhe poetë të të dy gjinive dhe shumë shpejt do të punojmë në përpilimin e antologjisë shumë gjuhësore të poetëve, të cilët unë i kam në atë rreth.

Si e vlerësoni ju proveniencën letrare në Kosovë?

Unë nuk jam kritik letrar, por nëse flasim për shijen nuk më pëlqen aspak ajo çka krijohet tek ne aktualisht. Jo ajo letërsi e plejadës se mjeshtërve si Azem Shkreli, Mirko Gashi, Ali Podrimja, Xhevdet Bajraj etj. Këtë e them me shumë kompetencë, sepse kam udhëtuar mjaftë edhe jashtë Kosovës dhe kam parë, se ka shumë që shkruajnë, poezia çdokund lexohet pak, por ka edhe shumë pak cilësi, sikur i ka ikur koha poezisë, kjo është përshtypja e parë, por nëse pakëz më shumë hulumtohet gjithsesi se ka talent.

Ne kemi mungesë të revistave cilësore letrare dhe nuk duhet të kënaqemi vetëm me një, e cila është shumë cilësore, sado që ajo nuk është ekskluzivisht letrare,. Flas për revistën MM të Qendrës Gani Bobi.

Përveç letërsisëmerreni edheme forma të tjera të artit. Sa arrin të shpreh veten Fahredin Shehu në kaligrafi dhe artet tjera plastike?

Çdo kund në art ndjehem komod. Pavarësisht a shkruaj prozë, poezi, ese, pikturë, kaligrafi, qeramikë.

E gjithë kjo varet nga çasti, nga frymëzimi dhe nga gjendja shpirtërore.

Si artist i gjithanshëm, a ndihemi më i realizuar si shkrimtar apo kaligrafist ?

Tek unë ndodh procesi involutiv jo ai evolutiv, prandaj në të dy konsideroj se jam i përgjegjshëm, kompetent dhe i realizuar, sado që në art nuk ka të realizuar. Shpesh më sillet ndërmend Salvador Dali, i cili ka thëne: Picasso është gjeni, por unë jam Salvador Dali.

Për mua është me rëndësi balanci, i cili ka qenë credo i Buddhas, Aristotelit, Muhamedit, Constantin Brancusit.

Unë flas për harmoni dhe balanc intelektual dhe artistik, profan dhe sakral, moral dhe amoral, kosmik dhe mikrokosmik, ndërsa në epistemologji dalloj Egsoterinë, Mezzoterinë dhe Ezoterinë. Në krijimtari dalloj Zanatin, Artin, Teurgjinë dhe Revelatën. Dhe kur të gjitha këto balancohen atëherë mund të flasim për harmoni, për arritje dhe për sukses.

E veçanta e kaligrafisë sime prapë është Impulsi kreativ, gjendja shpirtërore dhe kaligrafi bëhet jo iluminacion i vargjeve të librave të shenjtë, që ka shumë nëpër botë, jo bukurshkrimi i vargjeve të huaja, por bukurshkrimi i vargjeve të mia, të cilat lindin në çastin kreativ, në momentin kur kap kallamin, brushën apo cilindo mjet tjetër.

Po numërojmë orët e fundit të vitit 2010. Çfarë detyrash i ka vënë vetes Fahredin Shehu për vitin e ardhshëm?

Veç jam i rezervuar nga botuesit e huaj, së pari përmbledhja me poezi "Çmontimi i urrejtjes",e cila do të botohet në Stamboll, pastaj përmbledhja me poezi "Lakmus" në Beograd, Ro-

mani “Hojet”, në Prishtinë, Stamboll, Londër. Në antologjinë e Poetas del Mundo në Paris, dhe 19 botime të cikleve të mia të poezisë në Francë, Botimi i ciklit me poezi në Sarajevske Sveske (fletoret e Sarajevës.

Disa simpoziume dhe takime letrare si Stamboll, Kajro, Teheran, New Delhi.

Ilire Zajmi- Rugova
Tirana Observer
Info Globi

INTERVISTË

Ambasador i poezisë shqipe...

Shkrimtari i lidhur me traditën ezoterike të Orientit dhe Oksidentit, Fahredin Shehu u lind në vitin 1972 në qytetin e Rahovecit. Studimet universitare dhe pas universitare, në Universitetin e Prishtinës, në Orientalistikë dhe Letërsi. Ndërsa është autor i shtatë librave me përmbajtje të lartë artistike dhe shumë botimeve në gazeta e revista, të cilat shumica prej tyre janë të përkthyera në shumë gjuhë të botës. Është Ambasador i Poetëve për Shqipëri "Poetas del Mundo", Santiago de Chile, Anëtar i Asociacionit Botëror të Poetëve, Greqi, Drejtor Ekzekutiv i Qendrës për promovimin e dialogut ndërkulturor "OXOR", Anëtar i Këshillit të librit dhe Botimeve pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Anëtar i PEN Qendrës së Kosovës. Është i përkthyer në, më se 20 gjuhë të botës dhe poezitë e tij janë të botuara në Antologji botërore, revista letrare, kulturore dhe shkencore si Mobius Magazine në New York, Istanbul Literary Review në Stamboll, World Poets Quarterly në Pekin dhe World Living Poets Lexicon financuar nga UNESCO, po ashtu në Pekin, Kinë, Auillrelle në Bruksel, RAL,M Magazine në Paris, Gray Scale në Nigeri, Në Antologjnë Spanjolle, Brazil, Kil, Poerugali etj,,shumë Antologji...; nga Festivali i Poezisë në Lodeve, France, Strugë, Balkan Poets në Beograd e kështu me

radhë. Ka kumtuar shumë referate në shumë kongrese botërore lidhur me Filozofi, Letërsi dhe Misticizëm, si në Kajro, Tehran, Qom, Isfahan, Bruksel, Shkup, Stamboll, Çanakkale etj. Mbi të gjitha është Baba i dy fëmijëve të mrekullueshëm, Tamarës dhe Reisit.

Do ti shtonit edhe diçka këtij prezantimi?

Po do të shtoj edhe diçka, që duhet të potencohet për ta respektuar lexuesin tuaj. Kam ekspozuar kaligrafi në Kajro dhe shkruaj veshtrime estetike për Artin pamor. Jam i katalogizuar në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, Shqipërisë, Kroacisë, Serbisë, dhe Egjiptit.

Arti i kaligrafisë dhe poezia mistike shpirtërore janë pothuajse të panjohura në Kosovë, ndërsa Ju konsideroheni mjeshtër i këtyre dy fushave. Si arrini ti kultivoni paralelisht të dyja?

Shumë natyralisht. Flas për traditën shpirtërore të trashëguar, kujtoj se para më se 300 vitesh stërgjyshi im ka shkruar poezi mistike, po ashtu jam ritur në Rahovec, ku ka disa tradita mistike, andaj në këtë garë mendimesh dhe doktrinash, mendësia e njerëzëve dallon nga ato të rajoneve tjera të kosovës. E gjithë kjo ka ndikuar në formimin tim shpirtëror dhe me hulumtime të metëjme, lexime të shumëta, observimet dhe kontemplacionet, sigurisht, se krijohet një mundësi për kultivimin e një arti më të veçantë. Ndoshta ka ndikuar edhe trashëgimia e lashtë ilire e kultivimit të hardhisë së rrushit ku kemi fjalë ilire, të cilat nuk përdoren në trevat tjera. Në një vend ku kultivohet hardhia, dhe ku është ditur të përgatiten produktet e ndryshme nga kjo kulturë, pastaj edhe preparatet kosmetike, e shumë e shumë zeje tjera sigurisht, se ndikon në formimin e një mendësie dhe vetëdije më të qytetëruar. Shpesh edhe nga metodologjia e kultivimit të hardhisë kam bërë analogji edhe me poezinë, se një poezi që të jetë më cilësore, nuk duhet të ngarkohet me fjalë, figuracione, motive, etj. Një lloj si një lastar i hardhisë, i cili për të dhënë frutin më

cilësor të rrushit, duhet të shartohet, kitet, lihet në gixhë, apo heret nga tepricat, madje edhe të largohen kokrra nga kalaveshi, që kokrrat tjera të jenë më të mëdha, më të shijëshme etj. Prandaj kur këtë e aplikoj në Poezinë time, ajo ndodh, që të absorbohet aq mirë sa, që njerëzit e përvetësojnë dhe shpesh citojnë madje pa ma përmendur emrin, një varg u bëhet pjesë e vokabularit më tej edhe të diskursit të përditshëm. Lidhur me Kaligrafinë po them se edhe ajo rrjedh në mënyrë fluide nga shpirtënia ime. Poezinë, të cilën dua ta krijoj në një moment kur më paraqitet një vizion, unë e transformoj në pikturë, duke e kristalizuar në poezi, andaj kam thënë se Kaligrafia për mua është kristalizimi i fluidit kreativ poetik. Krahas frymëzimit, dijes dhe observimit duhet edhe një dozë bajagi e madhe e mbëltimit të Hyjnorës dhe Pasioni që të krijohet një Poezi apo madje edhe një Kaligrafi dhe kjo në mënyrë paralele.

Njiheni si ekspert i letërsisë transcendentale dhe hulumtues i trashëgimisë shpirtërore botërore. Çfarë do të thotë për ju kjo eksperiencë dhe ku fshihet misteri i shpirtërores?

Kjo temë është aq e gjerë dhe aq komplekse, sa që duhet një hapsirë shumë e madhe për t'u elaboruar dhe më vonë për t'u kuptuar. Unë do të përpiqëm, që sa më thjeshtë dhe më qartë të spjegoj nesë e arrij këtë, në vetëm disa fjalë.

Kam studiuar mjaftë dhe në të gjitha traditat shpirtërore kam gjetur esencën e misterit shpirtëror. Prandaj asgjë njerëzore nuk është e huaj për mua, është një thënie latine *Nilil Humani ame alienum puto*. Flas në kontekstin e vërtetësisë shpirtërore.

Gjithësesi është një përvojë interesante duke pasur parasysh kohën dhe vendin në, të cilin po jetojmë, pastaj trendi i dinamikës jetësore, zhvillimi teknik e teknologjik etj.

Unë konsideroj, se misteri i shpirtërores fshihet në quintesëncën njerëzore, Njeriu është e vetmja krijesë e Zotit, e cila e ka vullnetin e lirë dhe ka aftësi të vendim marrjes, ka aftësinë e krijimit dhe rikrijimit, ka aftësin e të folurit dhe kjo ndoshta është kryevepra e evolucionit madje edhe të involucionit human. Unë

konsideroj, se është fjala, diskursi, fenomen më i abuzuar nga vet njeriu. Këtu qëndron Gënjeshtra dhe Plagjiatura. Një matematikan më pat pyetur, leht e keni ju shkrimtar, me fjalë mund të thoni çka të doni, por në matematikë 1+1 është 2. Po kjo është vetëmnjë pjesë e së vërtetës, por sado që dikush thotë, që e ka mendjen praktike, është ateist apo materialist, matematikan dhe ithtar i shkencave ekzakte, ai prap flet me grema dhe fjalë e jo me numra e formula matematikore. Madje kur flasim për ekzaktësinë matematikore, unë nuk e ndal asnjë matematikan ta mas (+, -) infinitivin apo ta imagjinoj një numër, sepse e dijmë se ka numër imagjinar. Nëse ai ka të drejtë ta imagjinoj një numër atëherë unë kam drejtë po ashtu të imagjinoj se ka Zot, dhë të besoj e krijoj gjërat e bukura, sepse Zoti është i bukur dhe e do bukurinë.

Shkenca ende duhet të emancipohet që të kuptoj kuintesencën e realitetit kosmik. Ashtu si nga Ligji i Njutnit është mbi ndërtuar ligji i fizikës kuantike dhe asnjëra e as tjetra nuk mohohen, por jetojnë në simbiozë. Për këtë duhet implikuar Inteligjëncën intuitive, e cila duhet të emancipohet nga Inteligjenca aktive e deri tek niveli i Inteligjëncës së Adeptit.

Na flisni pak më shumë rreth botimeve tuaja. Çfarë kanë të përbashkët dhe çfarë i dallon me njëra tjetrën?

Oqeani i shpirtërores është shumë më i madh dhe më i gjerë, se Oqeanet, të cilat ne mund t'i shohim apo masim. Prandaj unë kam shumë hapësirë për të krijuar dhe secili botim dallon njëri nga tjetri, sepse edhe unë psikologjikisht, mentalisht dhe shpirtërisht jamë në një meditim aktiv e dinamik dhe në evolucion permanent, andaj edhe mund të vërehen nuancat; natyrisht për ata, të cilët i dalljnë mirë ngjyrat dhe nuk janë të ftohur, por erëmojnë parfumin e këtij lloji të vargut.

E përbashkët është platforma shpirtërore e paeksploruar dhe refleksionet e kësaj platforme, të cilat kanë emanacionet e veta në rastin tim, në trajtë të fjalës së shkruar, poezi, prozë, apo fjalës së pikturuar, qëndisur, gravuar, në trajtë të kaligrafisë.

Dallimi është në senzibilitet, në çastin "Tash" dhe "Këtu", etj.

E veçanta e krijimtarisë suaj është se, i thërrisni poezisë transcendentale, mistike, e jo asaj epiko-lirike siç jemi mësuar t'i dëgjojmë rëndom. Është ky fakti që veprat tuaja janë më të njohura jashtë vendit se sa në Kosovë, apo...?

Po, pikërisht kjo. Në botë emrat si nga Lindja ashtu edhe nga Perëndimi, janë të njohur, tek ne këto janë të panjohur andaj kultivimi i një poezie/ arti të tillë tek në krijon refuzim. Dua të them se realiteti im është shumë ngjyrësh, shumë dimensional, dhe shumë lëndor, unë nuk shoh bardh e zi, por është paleta e gjerë e ngjyrave, ngjyrave bazë dhe nuancave, madje dalloj edhe humnerën e cipës dhe sipërisë, bazën mesin thë kulmin, si tek parfumi simfonikisht i kompozuar, ku ka esencën bazë, esencat e mesit dhe esencat sipëore. Prandaj themi, se një parfum është cilësor, ai që i ka këto shtresa dhe nuanca. Një poezi e tillë e cila ka shtresa dhe nuanca, ku implikohet dashuria ndaj të gjitha krijesave të Perëndise, ku matematikisht përdoret secila fjalë dhe asaj i kushtohet vendi dhe hapësira adekuate sa që shndërohet në simbol dhe ikonë.

Tek ne kurrë nuk është përkthyer poezia e Solomon Ibn Gabriolit, Henry Thorreu, Upanisada, poezia e Galibiut, Enuma Elish, poezia e Hafizit, poezia e Alistair Crowley, Imrul Qaisi, Libri tibetan i të vdekurve, Kebra Nagast e Etiopisë, e shumë e shumë të tjerë,prandaj edhe lëngon formimi shpirtëror dhe intelektual tek artistët tanë. Fatkeqësisht poezia është shndërruar në estradë dhe këtu përfundon.

Çfarë i bën të veçantë botimet tuaja dhe çfarë shtrirje territoriale kanë arritur ato deri tani - ku janë botuar dhe lexuar?

E veçanta kryesore është origjinaliteti, përkatësia etnike, formimi intelektual shumë dimensional, meditimi, që të gjithe këto ndikojnë në gjithë këtë veçanti. Një krijesë komplekse për dallim nga amebat janë shumë qelizore andaj sinergjia e të gjitha këtyre krijon harmoninë dhe unitetin në llojllojshmëri.

Kur jemi tek origjinaliteti them, se duhet të jesh vetja jo sikur pula e dekoruar me puplat e palloit. Por llojllojshmërinë e

ngjyrave të puplave tuaja duhet ta arrish vetë e vetë të bëhesh palloi. Kur jemi tek palloi unë kam bërë një poezi të mrekullueshme, të cilën e ka përkthyer akademiku francez Athanase Vantchev de Thracy, në gjuhën Frënge dhe botuar në mëse 20 revista elektronike frankofone nga kritiku dhe botuesi francez Marc Galan. Është fjala për poezinë "Palloi i bardhë", ku flas për puplat, bardhësinë dhe se si ai transfomohet dhe fiton ngjyrat e mrekullueshme të puplave të tij.

Ai që ka lexuar librin tim "Shumësi e padukshme", e di për çka e kam fjalën. Madje kam krijuar edhe poezi të nivelit nano; nano/ poezi, kur vetëm titulli dhe një fjalë e vetme apo grafikon krijon tek lexuesi portal të ri kontemplacioni.

Gjeografikisht mund të thëm se kanë shtrirje interkontinentale, në Lindjen e largët Mongoli, Kinë, Indi, pastaj në Turqi, në Evropë, në Amerikën Veriore dhe Jugore, në Afrikë.

Sipas jush, sa përkon me realitetin thënia: "Individi është ai që e çon botën përpara"?

Po është individi ai që e ka çuar botën përpara, prej Steve Jobs, nëpërmjet Anjshtanjit, Galileos, Van Ghog, Da Vinci, Amenhotep, Bhudda, e deri tek Adami dhe vet Adam Kadmon, është individi ai i cili fillimisht ka qenë i përbuzur për idetë revolucionare, **që më pastaj nga po këta të paemancipuar, përbuzës permanent, janë mbëltuar si Hyjni. Jezuin e gozhduan, Muhamedin e përzunë nga Mekka, Giordano Brunon e dogjën**.

Krijimtarinë e shikoni si një rrugë drejtë karrierës, apo nevojë shpirtërore?

Jam shumë rehat në këtë pikëpamje. Më kohë i kam dalluar këto të dyjat dhe për secilën e jap nga një tas të peshores, të majtin dhe të djathtin. Vetë fakti se nuk jam në asnjë antologji të kosovës dhe të shqipërisë, gjë më krijon satisfakcion të veçantë, është dëshmi se nuk po krojoj karijerë me shkrimet dhe librat e mi. Nuk shkruaj për sot, as për pas dhjetë vitesh. Kritikja me e madhe letrare e Serbisë Liljana Shop në Beograd ka thënë: "*kjo*

është fjala e përhershmërisë, këto nuk janë vargje, të cilat do të lexohen sot, por në të ardhmen".

Unë punoj ashtu që, poezia ime siç lexohet sot nga disa pas disa shekujsh do të lexohet me të njejtën freski, si Haiku i Issa dhe Basho, apo Kasida e Imrul Qaisit, Masnaëi e Rumiut, apo Rubaira e Khajamit. Sepse ka imazh, figurë stilistike, metër dhe ritëm, i cili është kardiak dhe i cili e përcjell vetëm impulsin kosmik kreativ dhe ky reflekton në qenësinë time, e cila më vonë ato i përçon në fjalë.

"...Neve na mungon vokabulari tokësor për çështje qiellore". Është motoja e juaj e preferuar. Çfarë dëshironi të thoni me këtë fjali?

Vetëm të vërtetën, asgjë më shumë. Kjo thënie tek unë ka eruptuar ka një kohë të gjatë. Tek romani "Nektarina", të cilin e kam punuar plot 4 vjet, për shembull, kur kam dashur ta përshkruaj personalitetin e Jezuit, nuk kam gjetur fjalë adekuate, prandaj është dashur ta farkoj vetë, kur një krijesë e Zotit si Jezui, në tërësi e shuan epshin dhe arrin nivelin e engjëllit, pra shuarja totale e libidos, unë kam gjetur një fjalë për, të cilën kam shkruar edhe një poezi, e ajo fjalë është "Angeloid", një entitet gjysmë njeri gjysmë engjëll.

Tevona, për përshkrimin e vizioneve dhe të përsiatjeve të mia më mungon vokabulari, nuk kam fjalë dhe në fjalorët e gjuhës shqipe nuk ka fjalë, që do ta përshkruaja saktë atë, që shoh dhe po këtë kur dua t'ua transmetoj të tjerëve. Të gjithë të tjerët, që hasin në këtë problematikë, përdorin analogji, por larg është analogjia nga realiteti, një fëmije nuk mund t'i flasësh për kënaqësinë gjatë aktit seksual, por i thua se është sikur çokollata, apo ndonjë kënaqësi, që ai e ka të njohur dhe më të përaftërt. E sa larg është akti seksual prej kënaqësive të fëmijës para pubertetit e dimë ne të rriturit. Edhe në Zhvillimin shpirtëror, deri tek arritja e Matanoia-s, respektivisht pjekurisë shpirtërore, doemos duhet të përdoret analogjia, me diçka më të përafërt për t'u receptuar më lehtë një fenomen i tillë.

Kur'ani është përplot me analogji, aty thuhet, se në botën tjetër do të ketë verë nga, e cila nuk dhëmb koka dhe nuk të deh, apo qumësht, që nuk prishet, apo mjaltë me bollëk, po çka i duhet shirtit vera, mjalta apo qumështi. Drita ushqehet vetem me dritë dhe asgjë nuk humb nga vetvetja.

A keni diçka të veçantë që dëshironi ti thoni lexuesve tuaj?

Po. Kam. Madje. Shumë. Por. Do. Të. Ndalem. Në. Vetëm. Disa. Pika.

Me qëllim kam vënë pikë mbas secilës fjalë, që lexuesi të ndalet dhe të lexoj me kujdes. Në këtë mënyrë krijoj edhe efekt psikologjik edhe gjatë leximit. Kam paragraf të caktuar në roman, apo edhe strofë të tërë të artikuluar në këtë mënyrë, sepse në mënyrë instinktive lexuesi mbas secilës pikë, me inercion edhe lexon më ngadal.

Lexuesit i them atë që i kam thënë vetvetes, që nga vetëdijësimi im i parë për ekzistencën time, **Shkenca, Morali dhe Dashuria** janë peri virtual tribojësh, i cili duhet të lidhet në konop e të pështillet në një litar të fortë, që të të lidh për hyjnorën, për zhvillimin vertikal të psikologjisë personale, për sukses horizontal në jetën e shkurtë në këtë planet.

Për këtë litar, dua ta shoh të mbajtur fort, secilin lexues timin.

Albana Haxhimustafa - Murseli
IMEDICA - Prishtinë

ALBEDO

Është drita e hënës, e cila porsi një pasqyrë e reflekton bukurinë e diellit. Për ata, të cilët lexojnë me ëndje, po u premtojnë se, do ta përfundoj shpejt së shkruari një libër të posaçëm, të cilin ia kushtoj hënës dhe vetëm asaj.

E bukur është hëna dhe çdoherë ka qenë frymëzim për ata, të cilët kanë ditur me dasht, jo vetëm njeriun, por çdogjë që, feksja e saj kaplon. Të gjithëve na është e njohur ndikimi i hënës në tokë (baticat dhe zbaticat), madje mjekët e kujdesshëm i shmangen operacioneve të komplikuara kirurgjike, në ditët kur hëna është e plotë, sepse rritet shtypja e gjakut dhe gjakderdhja gjatë prerjeve është më e madhe. Dhe atë çka asnjëherë nuk kam dashur ta them është se, kur hëna është e plotë, shikojeni pak dhe do ta shihni një portret njeriu (nga krateret e saj), një portret, i cili dallon dukshëm nga ai, të cilin e bëri karikaturisti danez. Asnjëherë nuk kam guxuar të shkruaj për Muhamedin, sepse çdoherë kam menduar që ai, i cili shkruan për Muhamedin ose është trim, i mençur ose tepër qyqar, e injorant.

Nuk ka dyshim se Muhamedi ka qenë një mashkull i bukur me shtat mesatar, me flokë të gjata deri në mesbrinjë, e të prerë në formë të germës "V", njeri, i cili nga kjo botë donte femra dhe perfume (Moschus), ndërsa rrefuzoi postin e mbretit kur Ebu Sufiani, djali i tij i axhës, ia ofroi vetëm për ta lë misionin e tij, kurse Muhamedi iu përgjigj: "po të ma jepni diellin në dorën

e djathtë dhe hënën në të majtën, unë nuk largohem nga rruga ime".

Njeriu, i cili në atë kohë dinte t'i laj dhëmbët me misëak, e t'i ngjyros flokë të thinjura, i cili përdorte antimon si mascara, për të përforcuar të pamurit, sepse efekti adstrigent i antimonit e tërheq indin e kapakëve të syrit dhe shikimi është më i mirë, njeriu, i cili njihte metalet dhe u lejoi meshkujve të përdorin argjendin (element i hënës në alkimi) dhe u ndaloi mbjatjen e arit (element i diellit në alkimi), për ta krijuar balancin e elementeve në trupin e njeriut etj., etj., etj.

Krejt këtë llaf e bëra, vetëm për ta ilustruar në pika të shkurta dhe shumë fragmentare, Pejgamberin e Islamit dhe për ta nisur një muhabet rreth rrëmujës, e cila u krijua me një karikaturë provokative. Karikaturisti danez me atë ka dashur ndoshta ta artikuloj lirinë e shprehjes???!!! Ashtu si janë bërë shumë karikatura për Jezu Krishtin dhe nuk ka patur reagim të ashpër, ndoshta i nxitur nga urrejtja dhe shpirtvogëlsia apo, është paguar nga fundamentalistët hebrej, sepse shumë danez tani shkojnë e punojnë në Kibutze në Izrael dhe atje konvertojnë në Judaizëm, e ky deshi të bëhet më katolik se Papa, me hebrej se hebrejët, ndërsa miku im hebrej, avokat nga Londra më thotë dhe unë i besoj se, hebrenjtë nuk kanë problem me Islamin dhe nuk gjen një hebrej që fyen Muhamedin, hebrenjët kanë probleme me Palestinezët dhe ky problem është shumë i lashtë- biblik.

Të gjithë mendojnë se Amerika është aleat më i madh i Izraelit, por gabohen. Ishte Perandoria Osmane, e cila çdoherë ka mbrojtur hebrenjtë dhe Turqia bashkëkohore, e cila madje edhe kryeministrin Ismail Cem- hebre e kishte në krye. Shih Encyclopaedia Judaica, si flet për pozitën e hebrenjëve në Perandorinë Osmane.

Ndoshta artisti danez ka eksperimentuarpër të parë se çfarë rrëmuje mund të krijoj dhe të cilën e krijoi me sukses më të madh se ai gjermani Armin diçka, i cili mas pari e hëngri penisin e partnerit të tij homoseksual, e pastaj edhe pjesë tjera të trupit dhe gjyqi gjerman nuk kishte ligj/nen, me, të cilin

mund ta ndëshkonte kanibalin, sepse viktima ishte vullnetare. Dhe mjaftë rreth tij!!!

Të shohim se, çka bëjnë këta injorantë, të cilët vetës i thonë vetës musliman. (Kupto Islam d.m.th, nënshtrim vullnetit të Perendisë, e jo Militarizëm).

I gjithë reagimi i botës islame për një karikaturë të pavlerë, më duket se është refleks i stagnimit qytetërues dhe nuk ka të bëj asgjë me kredon Islame.

Asnjë njeri nuk mund ta mohoj misionin e Muhamedit në këtë botë, e as ta cënoj integritetin e tij.

Ishte ai Muhamedi, i cili tha se, me e vlefshme është ngjyra e dijetarit se, sa gjaku i luftëtarit. Ishte ai Muhamedi, i cili tha:… nuk është me mua ai, i cili bie në gjumë i ngopur, ndërsa komshiun nuk e zë gjumi nga uria, ishte ai Muhamedi i cili tha: lufta me armikun e vogël (pabesimtarët) mbaroi, tash na pret lufta me armikun më të madh, me Egon. Ky është Xhihadi i madh.

Thjesht habitem si, nuk morrën lekcion nga Salman Rushdie dhe Taslima Nasreen.Po, nuk morrën, sepse nuk i kanë lexuar.

Dhe tani vërtet duket se, do të realizohet profecia e Hantingtonit për përplasjen e qytetërimeve. Na mungon vetëm Irani të bëhet me bombën atomike.

Më befason fakti, kush u dha këtyre të drejtën ta mbrojnë Muhamedin kur vetë nuk janë në gjendje të mbrohen nga injoranca.

Si kishte me reagu Muhamedi po të ishte i gjallë?

Natyrshëm. Kishte me u sjell si: Zen mjeshtri Suzuki…I tregon Miguel Serrano Herman Hess-it se, si një amerikan paska harxhuar aq energji në fyerje dhe ka shkruar një libër kundër Suzukit, kurse Suzuki as një fjalë të vetme nuk kishte thënë. Hesse i përgjigjet Serranos; po, sepse Suzuki është aq i lartë sa, që fyerja e amerikanit nuk mbërriti deri te ai.

Kështu kishte me u sjell edhe Muhamedi. Një segment nga jeta e tij na mëson bukur…kalonte Muhamedi me mikun e tij në rrugë i takon një mushrik (politeist arab), duke e fyer si: ti je më

i shëmtuar, ti je i lig etj., kurse, Muhamedi i thotë ; ashtu është. Miku i Muhamedit reagoi dhe i tha; ti je dritë e Perendisë, ti je më i miri etj. Po i tha Muhamedi. Miku mnbeti i habitur. Muhamedi i tha: Unë jam si pasqyrë, reflektoj ashtu çfarë je ti, atë e sheh në mua.

Ja ky është efekti i Albedos dhe më duket se, çdo reagim tjetër do të ishte i dëmshëm.

Lindja ka mjaftë naftë, pak flakë aty duhet, Perëndimi e ka flakën dhe duhet me pas kujdes si po e përdor se, Vallahi shkum krejt, ndërsa ne që jemi në mes a thua ore kemi mjaft ujë për ta shuar gjithë këtë?

Dhe po me vjen disi keq që, ende po vlen ajo që në vitin 1992 e pata shkruar në librin tim të parë- MENDIMET MË SHKOJNË NË PAKUFI E ÇDOHERË MBETEM NË MES.

(Ky është shkrimi rreth karikaturave të Muhammedit a.s. në Danimarkë dhe vende tjera Evropiane. Shkurt, 2006.)

777

Sot është 07.07.07. dhe në gjuhën kabalistike kjo do të thoshte: 777 ose numri i fatit. Librin 777 të Alistair Crowley kur e lexova herën e parë, para luftës në Kosovë, u tmerrova sa më mungonte dija për ato koncepte, të cilat Alistair Crowley i kishte përpunuar në vitet 40-ta, të shekullit XX. Në këtë libër Crowley në mënyrë shumë lucide ma spjegoi atë që, dija ndryshe nga Kur'ani, është fjala për Esma-ul Husna ose 99 emra të bukur të Allahut dhe për Teëhidin (njëshmërinë e Allahut) dhe aty pohon se, koncepti i Teëhidit është i kapshëm vetëm për intelektin e Adeptit, kurse Crowley atëbotë ishte adept i vërtetë.

Në lidhje me kategorizimin e Intelekteve shih: Ibn Sina (Avicenna), në librin, "Tre dijetar Islam", të shkruar nga Seyyed Hossein Nasr, si cikël i ligjeratave për studentët e Universitetit të Harëardit.

Në të vërtet Intelekti i adeptit është kulmi, të cilin mund ta arrijë vetëdija njerëzore, vetëdija e Homo Sapiensit. Ky është niveli më i lartë i vetëdijes, i cili mund të arrihet me punë dhe angazhim personal dhe ky zhvillim vertikal, shkon në relacion: prej tokës kah qielli, respektivisht prej njeriut kah Zoti dhe ky nivel, është më i ulët se ai, i të dërguarve, Pejgamberëve të Zotit, i cili po ashtu shkon në relacion vertikal, por në drejtim të kundërt, pra prej qiellit kah toka d.m.th. prej Zotit kah njeriu. 777 nga Alistair Crowley

E dijmë se Tesla, Enstein, Bertrand Russel, Kant, përfaqësojnë kulmin e intelektit material dhe nga momenti kur, logjika e tyre kapërcen në besimin në Zot, atëherë sipas Ibn Sinas, ky nivel definohet si Intelekt Aktiv. Këtu duket qartë se, flasim për gjenitë, qofshin ata të dijes logjike apo të asaj intuitive. Një përjashtim prej këtyre mund të rradhitet një gjeni si Andy Warhol me inteligjencë IQ 60, ndërsa me kreativitet gjenial.

Kthehemi tek 07. 07. 07. dhe çka mund të presin shqiptarët nga kjo ditë, dhe nga ky vit. Gjënë e vetme që, mund ta bëjnë është ta shqyejnë edhe një fletë të kalendarit, sepse me kohë i kanë ngulfatur adeptët e vetë dhe po i ngulfasin adeptët potencial.

A do të na sjell neve fat kjo ditë, mbetet të shihet, gjasat janë JO definitive, sepse për ta arritur pjekurinë duhet shumë punë. Nëse për Kabalistët 777 do të thotë fat, për ne, të cilët nuk kemi definuar madje as identitetin tonë kombëtar e shpirtnor, vështirë që, mund t'i gjindet domethënia. Croëley në librin 777 në mënyrë sistematike përmbledh të gjitha sistemet, simbolet, konceptet esoterike, ndërsa ne ende nuk kemi një libër me simbole egsoterike.

Ky vit nuk do të përsëritet kurrë më, ndërsa datës 07. 07. 07., do t'i vëmë edhe një X- shkoi dhe kjo ditë…pëëëëëëët… ra si gjethi i tetorit.

FILOHUMANUSI

Lëkura ime është hartë për leximin e rrugëve të vuajtjes, për lumturinë e krijesave, të cilat vetën e quajnë njerëz. Lexues të një topografie të këtillë dermale, nuk janë në mesin e mjekëve të lëkurës, dermatolog si i thoni ju, por janë lexues të aurës, e cila emiton nuancat e ylberta, të një përvoje unike për lexuesuit e dhimbjes.

Në aurë lexohet dhimbja e shpirtit, ndërsa në lëkurë dhimbja e trupit.

Një diskurs i këtillë, mund të aplikohet vetëm nga ai, i cili në asnjë mënyrë nuk iu lejon që t'ia vjedhin qëllimin, ndërsa qëllimi është që, të bëhet vullneti, sikur dielli e thotë vetën si strofën më të bukur në pikë të ditës në korrik.

Ata që, kanë pikturuar me çaj ata e kuptojnë se, këto rreshta assesi nuk janë në rradhën e shtyllave gazetarore, kolumne si i thonë llafazanët, sepse ndoshta nuk e kanë ndonjë fjalë tjetër.

Egzistojnë kujtimet, të cilat si çelës i ndryshkur dëshirojnë për herë të fundit, t'u plotësojnë dëshirën tonë, për ta kapërcyer këtë kllaposje.

Poashtu ekzistojnë edhe ato që defionohen si kujtime e që mezi janë. Këto nuk mund të vijnë në rradhë e ta shfaqin vetën ashtu si, i bëjnë kujtimet që, si shkumë shumëbojëshe demonstrojnë nevojën dhe tregojnë më shumë se, sa ato artikulojnë tendencën e vetë.

Ato nuk zgjohen të ejten për ta ditur se kjo është ditë e JAVA-sdhe aty ka diçka që, bëhet e lumtur vetën kur të përqafon sikur, atëherë nëna e bënte, askerin (lexo: ushtarin) dhe e ledhaton në qafë si, pëllumbin e vetë. Nëse kjo ditë të kalon pa dhënë atë që, të tjerët kanë humbur dhe me çka engjëjtë shpërlahen e ne koti e quajmë DASHURIA (vetëm e quajmë, nuk e bëjmë) atëherë jo e enjte-ja, por e tërë java dhe e tërë JAVA shkojnë huq.

Ajo që, më parë kisha dashur ta mësoj dikë, është ta mësoj si të dëgjoj. Ekziston alfabeti i Morzeut, alfabeti i Elbasanit, alfabeti Pictish, Ogham, Runik, Hebrej, Arab, Cirilik, Kinez, Sanskrit etj., por, nuk ekziston një alfabet, i cili do ta mësonte njeriun që, të dëgjojë. As mësohet kjo në shkollë, as në rrugë, as në familje e, as në shoqëri.

Nëse gjëja e parë që, kisha dashur t'i mësoj njerëzit, është të dëgjuarit, atëherë problemet në komunikim nuk do të ishin PROBLEME, por problemet ngadal do të shuheshin, sikur mjegulla në diell dhe ngadal PROBLEMI, do të vinte deri tek P, si germë e parë, e cila shumë lëhtë mund t'i reprodukonte, si fenksi nga pluhuri i vetë edhe mbetjen tjetër të trupit si PHILO-HUMANUS.

Po që se, kjo do të realizohej, atëhere secili qëllim do të ishte i orientuar në shërbim të njeriut e si, i këtillë edhe në shërbim të Zotit. Shih tek Muhamedi " **Të gjitha krijesat e Zotit janë një familje, më i miri prej jush është ai, i cili bën më së shumëti i sjell të mira kësaj familjeje**".- Për këtë shih tek NUN, nga Fahredin Shehu.

Nëse kësaj energjie do t'i jepej një kahje e duhur, atëherë nuk do të kishim me çka të ballafaqohemi (kjo kështu na duket), sepse, duke u ballafaquar me këto, ne humbim atë që, me të vërtetë kishte qenë dashur të ballafaqohemi, sepse kjo botë nuk është vetëm ajo pamje që e njohim si reale; është edhe diçka që ne e dijmë, por nuk i vëmë re, sikur luga në gotën gjysmë të mbushur me ujë, na duket se është e thyer, por nuk e çajmë kokën për këtë iluzion, është sikur nuk vëmë re, gurin e veshkës, i cili shtresohet dhe granulohet si perle nga rëra që, e formon

Margaritana Margaritiphera, është sikur mungesa e vetëdijes për oksigjenin O2 dhe daha më shumëO3

Njeriu çdogjë mund të jap, pos frymës ndërsa, Zoti ta jep edhe këtë prandaj falënderim Atij = ELHAMDULILLAH.

OCCIDENT- ORIENT

Nëse për Rabindranath Thagore: "**Lindja dhe Perëndimi janë në kërkim permanent, heret ose vonë ata do të takohen**», për Fahredin Shehun, Lindja dhe Perendimi janë takuar në Kosovë/Ballkan qysh moti. Nga vështrimi kulturor/fetar, Ballkani është kompozicion i komplikuar, por në një plan më të përgjithëshëm e veçmas në Kosovë kemi të bëjmë me Arianet me frymë Semite.

Meqenëse kuptojmë se, Islami dhe Krishterimi (Katolik dhe Orthodhoks) na kanë ardhur nga Lindja. Nga aspekti i Filozofisë së Religjioneve, si Islami ashtu edhe Krishterizmi, bëjnë pjesë në grupin e religjioneve të Perëndimit, prandaj ata që në Kosovë vetën e konsiderojnë më Perëndimor, le të gjejnë satisfakcion në këtë të fundit. Mirëpo e verteta është që realiteti i ri, i krijuar në Kosovë pas luftës pësoi ndryshime në mentalitetin e kosovarëve duke i bërë pjesë të botës, pjesë të procesit të globalizimit, nën bajrakun Amerikan.

Derisa Italianet i kthehen Sloë food-it, si rebelim ndaj trendit të Fast Food-it, ne në Kosovë i kombinojmë, duke krijuar një hermafroditizëm shprehish, ku pas vetem disa vitesh, shqiptari nuk do ta dalloj shqiptarin, por të gjithë do të duken Humanoid apo Mezokrijesa në kontekstin kulturor.

Ai/Ajo që e lexoi librin **Shumesi e Padukshme**, e botuar më 2000 si botim atelieu, ka mundur të vërej se, autori manifestimet planktonike kulturore (Shih Bela Hamvasz, Ode shekullit

të Njëzet, ku ai te flet bukur për planktonin), i definon si; POPULLACION KETMANESH, ku serbët me të drejtë e rimojnë "prodao veru za veceru"- e shiti fenë për një darkë. E kujt i dhemb orientimi fetar. Nga perspektiva e zogut, askujt nuk i dhemb, por nga perspektiva e bretkocës natyrisht, po.

Meqenëse orientimi fetar (Mos ta harrojme se po flasim për kulturën) tani po ngjyroset ndryshe, shpirti tëe vie në hundë kur fenomenet e ngritjes së Katedraleve në emër të popullit po manifestohen si fillet e autoqefalisë katolike, diçka, që vëllezërit orthodhoks kaherë e kanë bërë, e nëse flet kundër bëhesh jotolerant, e deri fundamentalist. Në anën tjetër, ngitja e një kulture Vahabite në një ambient të gabuar për këtë defile (Kosova), krijon distancë dhe animozitet dhe në vend që t'i kontriboj tranzicionit kulturor, ajo e kthen në një kulturë ekuatoriale të para disa shekujve. Nikolla i Kuzës, Raimond Llully, mësuan arabisht, kur e morrën rrugën e misionarëve në vendet e Maghrebit.

Çuditërisht Arabet nuk mësojnë shqip, për të na dhënë ders në gjuhën shqipe, por duan që të na arabizojnë, duke mos ditur se, këtu kishte musliman shumë para se, ata e kuptuan këtë. E po që se, u kërkove që të të ndihmojnë me e botu një libër të poezisë arabe, ata e refuzojnë.

Në emër të Allahut dhe të Jehovës, me shekuj bëhen mutilacionet në gjenitaliet e meshkujve e rrallë edhe të femrave (Circumcision-i dhe Clitoridectomy-a), e që, një gjë e tillë nuk gjindet në librat e shenjtë, ne duhet të rrimë duarkryq dhe të jetojmë në Virtual Reality dhe në mënyrë pasive observojmë ndrrimin e slajdeve, të cilat; Jean Baudrillard i kishte definuar si **Simulacria**, ndërsa Fahredin Shehu i definon si **Realistia**. E neve natyrisht na nevojiten kodet për ta deshifruar **Simulacria**-n dhe **Realistia**-n.

Kërkimi i Sufizmit të vërtetë dhe rrugëve spirituale jashtë Kosovës nuk është problem i rënde, por ta kërkosh Sufizmin në Drenice (si do ta besh këtë, kur atje nuk ke tradite fetare, e lere më mistike), apo traditën e Buddhas dhe Shankarës në Prishtine

(kur kjo tek po na zbulohet), me duket se, diçka këtu nuk përputhet.

slami në Kosovë dhe Ballkan është përhapur, fal misionarëve musliman Sufi, ashtu si përhapet urrejtja ndaj Islamit, fal injorantëve, të cilët nga zbrazëtira ateiste e komunizmit, më lehtë e pranojnë zbrazetirën e Nirvanë se sa Islamin, e fare duke mos e kuptuar se Nirvana në Islam është FANA, jo si zbrazëtirë, por si Unifikim kur ti nuk ekziston, zhdukja e tërësishme e Egos, si ang. Surrenderence (ju lutem më ndihmoni, nëse ma përktheni këtë fjalë saktë Shqip).

Problemi qëndron se, Fahredin Shehut nuk i besoni, po që se këtë e kishte thënë Iulius Evola, Rene Guenon, Dragosh Kalajiq, Henry Corbin, Seyyed Hossein Nasr, Martin Lings, William Chittik, Annemaie Schimmel, Fritjof Schoun, Ananda C. Coomarasëamy, Gurdijeff, Alister Crowley, Osho Rajneesh apo Colmen Barks etj., do të kishit besuar më shumë dhe më lehtë.

Nëse sot dikush në Kosovë me flet se, dëgjon muzikën Sufi apo lexon nga urtësia e tyre, nuk duhet kuptuar se, kjo i përket asaj tradite kulturore, e cila është kultivuar që nga misionarët e parë Sufi, por është ndikim nga Perëndimi dhe e kuptojmë se, si Perëndimi po na e zbulon një atribut, të cilin kaherë e paskemi braktisur, Jam Cool, nëse e dëgjoj Mercan Deden, sepse Peter Murphy bashkpunon me ta, apo Nusrat Fateh Ali Khan, vetëm se, Peter Gabriel dhe te tjerët punuan me të. Kjo me vjen njëlloj, sikur Ibn Sina (Avicenna), Lindja Islamedhe Ibn Rushdi (Averroes) Perëndimi Islam- Spanja Maure, Perëndimit ia zbuluan Aristotelin dhe Platonin, sepse fal përkthimeve dhe komentimeve të tyre, ne i njohim grekët si kontributor më të mëdhenjë të kristalizimit të kulturës Perëndimore, e cila deri atëherë ishte në fazën elementale e lere më ta arrij surfuzionin.

E mos të flasim për Pitagorën, i cili ishte nxënës i priftërinjeve Egjiptas, që u depilua derisa u bë si femija dhe u bë synet si adult, për të hyrë në tempull, e për të mësuar nga ata. Për ta sjellur Teoremën, të cilën Egjiptasit e kishin huazuar nga Babilonasit. Pastaj, mos të flasim për ndikimin e gjenisë hebreje në

kulturën greke etj etj. Me rëndësi është të dëgjohet muzika dhe ne të gjindet ajo hyjnore.

Njëherë e patën pyetur RUMI- un (një Mulla i thjeshtë) *Po parafrazoj*:

"Si ke thënë ti që kur e dëgjon muzikën, e dëgjon kërcëllimen e hapjes së derës së parajsës, kurse unë nuk e dua kërcëllimen e derës." RUMI- u përgjigj**: "Çështja qëndron aty se, unë e dëgjoj derën derisa ajo hapet ndërsa ti e dëgjon kur ajo të mbyllet."**

Nëse e kërkon të renë dhe kënaqesh tek Marylin Manson, atygjen elementin e vet satanik dhe kjo nuk duhet gjykuar si diçka e mbrapshtë, sepse orientimet fetare janë të lira ndërsa, Marylin Manson nuk është gjë tjetër, pos i radhës që ta thotë/ekspozoj orientimin satanik, sikur dikush para mijëra vitesh e themeloi fenë Yezidi (lexo: Mishaf Resh), për ta adhuruar Palloin apo Melik Taus, si simboli i Shaitanit. Pra, ata janë adhurues të demonit. Përparsia e Mansonit është që ai/ajo, satanikën e vet, e ekspozon në krahasim nga shumica, e cila satanikën e vet, **e fsheh si paranë apo si mekatin**, siç kishte më u shpreh Milorad Pavicq, autor i Fjalorit Khazar dhe i shumë librave tjerë, shumëtë mirë.

Sërish me mbetet t›i rikthehem bejtit (dyvargëshit) të bejtexhiut të njohur nga Rahoveci; Shejh Hilmi Maliqit, më të njohur si, Shejh Mala i Rahovecit, *po parafrazoj*:

"Ço›u pej gjumit more vëlla
hakkun n›dash me e pa...

Ndërsa, Khalil Gibran, një poet arabo/amerikan nga Libani, me prejardhje Maronite (katolik Arab), poet shumë i dashur për mua, në një komunikim të tij engjëllor, dikush i tha, (*Po parafrazoj*):,

"Nëse e takon një rob duke fjetur, mos e zgjo, se ndoshta ëndrron lirinë, kurse Gibrani iu përgjigj:

Nëse e takoj një rob, unë do ta zgjoj dhe t›i flas për lirinë".

Unë do të vazhdoj t›i shikoj slajdet, ndërsa ju merni pjesë aktive në to.

Edhe një herë para se "TË BËJ"

TAMARA ËSHTË E ÇUDITËSHME EDHE SI EMËR EDHE SI FEMËR…

Kështu fillon një shkrim, i cili paralajmëron epokën e krijimtarisë teurgjike të artit teurgjik.

Për Teurgjinë ka folur shumë Siriani; Iamblichus (A.D. 250-325), pas Plotinit, Neoplatonist më i shquar, në Theurghia ose Misteret e Egjiptit. Gjurmët e Iamblichus- it hasen në legjendën e krishtetrë (ndër krishterët e parë të presekutuar nga paganizmi romak), për banorët e shpellës si dhe në Kur'an, ndërsa dramaturgu Teufik Al Hakim e përpunoi si: BANORËT E SHPËLLËS.

Për Teurgjinë në trajtë Noetike ka spekulauar edhe filozofi rus hebre i kristianizuar ortodoks, Nikolai Berdyaev.

Atë që, Piet Mondrian arriti ta artikuloj si rezultat i Quiet-izmit protestant, mjeshtrit e Zen-it arritën ta bëjnë më kontemplacion, pjesë të jetës së përditëshme. Në kërkim të paraleleve Lindje-Perendim hasim Paul Klee dhe Bokuyu, të pikturarit fëmijëror, niveli i pastërtisëekspresive fëmijërore, pastaj Jackson Pollock dhe teknika Osmane enjohur si; EBRU, Mauritz Kornelius Escher dhe Ararbeskat, dëshirën (etjen aristike) e Kanadezit Bryan Adams e plotëson Japonezja Mariko Mori në videoprojektin CLOUD NUMBER NINE etj.

Nuk kam se si ta tejkaloj Jean Baudrillard-in , por tani të mospajtohemmë qëllimkreativ. Ai tha: "Arti ka vdekur, jo në mungesë të artit, por pse e ka për së tepërmi". Unë them: "Arti

ka vdekur, sepse duhet t'ia lëshoj vendin Teurgjisë" pastaj them: "Arti nuk vdes ai transformohet, sikur Sufi thënia: "**Kur një kokërr gruri bie në tokë, ajo lind një kalli me shumë kokërra tjera**". E këtillë është natyra Noetike e Artit Teurgjik. A nuk kanë thënë alkimistët se… Njëri duhet të vdes, për të lindur tjetri. Shih shëmbullin në naturë, druri BANIAN rritet në Indi dhe kur njëri arrin klimaksin në rritje, fillojnë nga rrënjët të zgjohet një filizë e re.

Natura kreative nuk duron tipat e Shaka Zullu, prijësit afrikan, i cili do ta vras të birin nga frika se, kur të rritet do t'ia zë fronin e tij. Natyra kreative nuk e duron këtë. Vetëm atyre, që u mungon inispirimi dhe kreativiteti, frikohen nga fëmijët, nga ata që krijojnë ndoshta jo, më mirë, por më ndryshe nga paraardhësit e tyre. BHAMAHA (VII-VII), poet Indian thotë: "Njohja e poetikës pak vlen, nëse mungon dhuntia poetike. Njohja e poetikës nga ai, që nuk ka dhunti, është njëlloj si bujaria për të varfërin, mjeshtria luftarake për frikacakun dhe më shumë se kjo. As është mëka e as ndëshkuese mos me qenë poet, por të jesh poet i keq është e batrabartë me vdekje".

Derisa, Shaka Zullu deshi ta vras foshnjën, mbreti i Judesë Davidi, shpesh këshillohej nga fëmiu 7 vjeçar Sollomoni, i cili më vonë do të bëhet mbret, jo vetëm i njerëzve, por edhe i xhindëve, Luciferit, Belzebubit, Astarotit etj.

Arti nuk do të vdes, por do të emancipohet në Teurgji, ashtu si Homo Erectus është emancipuar në Homo Sapiens, Homo Sapiens në Homo Gnosticus, ndërsa Homo Gnosticus, në Androgin (për Androgin më mirë shih tek **Scientia Sacra II**, nga Bela Hamëasz), në qenie njerëzore me trajta më sublime engjëllore, të cilën unë e definoj si **ANGELOID**, si njeri i angjelizuar, fillimin e teurgjisë, vetëm një shkallë më poshtë Profetit.

Të kthehemi tek Tamara. Unë nuk kam takuar këtu një vajzë muslimane me emrin Tamara, që në përkthim nga arabishtja do të thotë HURMA. Këtë frut Muhamedi e përshkroi si, frut me shije shumë të ëmbël dhe me farë shumë të idhët. Hurma është koncentrat energjetik, për ekzistencë biologjike, plotë sheqerna,

lipide dhe substancë të çmueshme diellore. Ja përse Muhamedi e preferonte dhe vetëm me 3 hurma shpesh e kalonte ditën. Fruti i hurmës në qumësht është afrodiziak i fortë dhe jep fuqi të madhe.

Emri Tamara më shumë haste tek Serbët se sa tek Shqiptarët (fare). Ja përse, Tamara e shkrimit tim është e çuditëshmë si emër. Ajo krahas kësaj është e çuditëshme edhe si femër, sepse mban një sy të kuq në anën e majtë të fytyrës dhe frymën e një epoke mitike, në përlen e Amberit në veshin e djathtë. Ajo është në kërkim të fëmijës, që duhet të lindet më dy sy të kuq. E ajo është plotësisht e vetëdijshme se, ai fëmi është anëtar kierarkisë së fshehtë spirituale, ata njohësit e fjalës, (LOGOS), polet (QUTB).

Ekzistojnë pra njerëzit që janë si Tamara, plotë ëmbëlsi, por me farë shumë të hidhët, dhe të tjerët, thellë në baltë; si rrënjë Lotusi, që tek vonë hapin lulen e bukur dhe ruajnë diamnatin në zemër. OMA MANI PEDME HUM.

Njerëzit, që punojnë sikur rënjët dhe kanë domethënien vetëm, nëse janë nën tokë, sepse ashtu më së miri e përmbushun misionin e vetë, është edhe Ostad Elahi, mjeshtër Sufi refuzoi, që të incizoj krijimtarinë e tij, për t'u shmangur publicitetit dhe kënaqjes së egos nëpërmjet tij. Kështu kemi vetëm një këngë të incizuar nga nxënësit e tij, prej krejt jetes së tij mbi 80-vjeçare. Kënga natyrisht është incizuar pas vdekjes së mjeshtrit. Sipas tij; "Nëse dikush koncentrohet në rregullat dhe teknikat gjatë initerpretimit, kjo cilësi nuk mund të arrihet. Ajo arrihet vetëm, kur pushon së menduari për ato dhe bëhesh plotësisht i tretur ne vetvete, tek atëherë mund të arrihenkëto rezultate". Fjala është për përvojën shpirtërore nëpërmjet muzikës.

Ndërsa për Ostad Elahi, Yehudi Menuhin ka thënë: "Muzika e Ostad Elahit është shumë e ndjeshme, shumë intensive, por gjithashtu shumë precize dhe shumë e pastër. Vështirë u besoj veshëve të mi, (…) Kurrë nuk kam dëgjuar diçka të ngjashme. Kurrë nuk kam qenë kaq i imresionuar". (cituar sipas Peter

Pannke në edicionin muzikor, ECHOS DU PARADIS, SUFI SOUL).

Iamblichus flet për Teurgjinë, Nikolai Beryaev spekulon për të. Mjaftë është folur. Unë do të flas vetëm edhe njëherë pas kësaj para se, t'ua prezentoj Teurgjinë në trajtë letrare të titilluar NEKTATRINA.

Shkruhemi/lexohemi deri atëherë

IDIORITMIK URBAN

Ebu Hanifa i takon grupit të Taabiinëve, gjenerata e njerëzve, të cilët patën rast të takohen me shoket e Muhamedit, gjenerata e dytë e muslimanëve. Ai e mbron identitetin e gruas duke thënë se, gruaja është shumë e vlefshme dhe ajo është si perle në guacë, prandaj si e tillë, ajo duhet ta mbulojë trupin dhe perlën e saj duhet ta gjejë vetëm ai fatlum, i cili legjitimisht martohet me të.

Hapja e debateve rreth stilit të veshjes është shenjë se, tek ne nuk ka kulturë të debatimit, prandaj është marrë të diskutohet për një trivialitet, i cili nuk na mundon vetëm ne.

Në vitin 2001 vizitova Hamburger Kunsthalle dhe e pash një grua hinduse shumë elegante, natyrisht e veshur me Sari (stili Bengali). Çuditërisht Sari, ruan elegancën edhe pas shumë shekujsh dhe artikulon bukurinë e trupit dhe madhështinë e qenies GRUA. Kjo është ajo vlerë, të cilën Lindja heshtëshem na e prezenton. Derisa në Perëndim jo çdo vit, por çdo sezonë prezentohen sfilatat e modës, cila më e mirë, e cila më e shëmtuar. Yves Saint Laurent, Dior, Mbretresha e punck-ut, Vivien Westwood, avangarda angleze Husein Chalayan dhe Alexander Mc Queen etj., nuk janë në gjendje apo nuk donë të bëjnë kreacione, të cilat sikur Sari, do të ishin në trend me qindra vjete, mos ta humbin elegancene vete.Sot shijet kanë ndryshuar dhe ajo çka me iritoi ishte se, miku me, të cilin isha ne galerinë e Hamburgut për atë grua me Sari me tha: Das is kunst –ajo është art, duke aluduar

në veshjen e sajë. Une u pajtova, por pajtimi ynë ishte i trajtave të ndryshme. Nëpër rrugët e Hamburgut lëvizin lirshëm edhe hebrenjët me jarmulka- kapele shumë e vogël e kokës, ndërsa miku kur e pa një grua turke, e veshur elegante me shami dhe veshje ngjyre Khaki, ai reaagoi duke e ndjer veten si të ofenduar me pamjen e saj. Ndërsa ajo dukej për mrekulli dhe sipas asaj me siguri ajo ishte mënyra e më e mirë e veshjes. Është hipokrizi, nëse Sari nga Lindja është Kunst, ndërsa Shamia, po ashtu nga Lindja, është ofenduese. Trivialiteti rreth stilit të veshjes është një preokupim i ulët dhe veçmas për ne, të cilët kemi shumë probleme të pazgjidhura në vend që të ballafaqohemi me emancipimin shpirteror dhe tejkalimin e stereotipeve të këtilla, ne i debatojmë stilet e veshjes.

Le të vishen si te donë, por le të veprojnë si duhet

Në vend të kësaj, përzemersisht e kisha përshendetur atë, i cili do të më lajmëronte se, tek ne është themeluar ndonjë klub i librit, ku njerëzit krahas që, kanë mundësi të furnizohen me libra, të cilët më parë nuk paten mundesi, ata edhe do t'i diskutonin ato, asnjeri pa e demonstruar fodullinë e vetë se, si ai/ajo është më i ditur dhe ka lexuar më shumë, por komunikimi të jetë infra-mezo-ultra sonic, me tendencë kreative, sepse neve çdoherë na ka munguar një profet, i cili shpirterisht do të na bashkonte. Meqenëse ne nukjetojmë në kohën e profetëve, sepse koha e profetëve ka mbaruar, ne mund të funksionojmë si mentor, mos me thënë guru, rabi apo shejh.

Gjermanët për shembull kanë qenë shpirtërisht, çdoherë në safari për profetë. Atje lindi Estetika si rezultat i kesaj tendencë të ndërdijshme. Të spekulohet për artin, është baraz, si të spekulohet për dashurinë. Arti/Dashuria duhet të bëhet, e jo te folet.

Hegeli ka shkruar dengjefaqesh për artin dhe të bukurën dhe shkon deri te ekstremi tjeter; Rozenkranci (arti i të shëmtuarit) dhe ende asgjë nuk kuptohet prej kesaj. Kisha thënë se, arti është njëra nga rruget, njëra nga veturat që të çojnë deri tek destina-

cioni i vetënjohjes. Si i tillë e kërkon kismetin apo ajo e Karl Gustav Jungut, Sinkronicitetin.

Kështu në pritje të profetit, Karl Marxi ndoshta, mendoi, se është Mesiah, por kur e kuptoi të kundërtën, atëherë nga mllefi, e i armatosur me njohuri sataniste, sepse në komshillëk kishte një sekt aktiv, ai vendosi ta kthejkursin dhe në vend që të jetë ateist, ai filloi ta urrej Zotin, duke shkruar (lexo vjershën EMANUELE- Zoti bashk me ne, e cila me metoda egzorciste të leximit mbrapsht, kthehet në ELEUNAME , kur ai i gjuhet qiellit me copëza yjesh.

Se si në Lindje nuk folet për artin, por ai behet, më së miri mund të ilustrohet me thënien e Swami Govindës, se çdogjë është muzikëdhe manifestohet vallja kreative e Shiva Nataraj, i cili gjatë vallezimit të tij, krijon vibrime kosmike gjatë, të cilave në mënyrë permanente, krijohen krijesa të ndryshme dhe zënë vend në Univers.

Apo shembulli i qilimave unikat Persian ashtu, që zanati e tejkalon vetën dhe bëhet art, sikur që, arti duhet ta tejkaloj vetën dhe ta arrij shkallën e Teurgjisë, ndersa Teurgjia të prêt sikur uji, piken e vlimit, e të sublimohet në avull kosmik e të bëhet profeci, me qëllim, që të kaloj nëpër të gjitha shkallët e Metamorfozes; nga veza në pupë, nga pupa në flutur, nga flutura në shpirt të pastër, e të tretur në esencën e tij, ta tejkaloj Nirvanën, e ta arrijë Samadhin, gjendjen e ekzistences së vetëdijes për asgjënë dhe çdogjënë në të njejtën kohë.

Si ta arrijme këtë?

Natyrisht këtë nuk mund ta arrijmë me nepotizëm dhe ta zgjidhim çështjen me të njëjtin mentalitet me, të cilin është krijuar ai problem (Anjshtanji).Ai tha… edhe pse ekzistojnë katedra të matematikës në çdo kënd të botës, janë vetëm 5-6 njerëz me, të cilët mund të flas për matematikën.

Komunikimi dhe mënyra e komunikimit është shumë me rëndësi, sepse po nuk e pate këtë mundësi, humb kontaktin me auditoriumin,publikun, si filloi ta bëj Picasso.

Ndërsa Abu Hamid Muhamed Al Ghazali thotë: Transmetimi i përvojës shpirtërore me fjalë është shumë i vështirë…, sepse për sfera të pazbuluara, ne nuk kemi koncepte të qarta, sepse janë të panjohura, jemi në mungesë të vokabularit tokësor për çeshtje qiellore. Prandaj në mënyrë simboloke janë transmetuar këto dhe është krijuar një diversitet konceptesh dhe qëndrimesh për të njejtën çështje. Mentalitetit primitiv është dashur t'i demonstrohet me figurë për t'u bindur dhe gjeniu antik e pikturon Zotin me shumë duar; Shiva në Indi apo me kokë shakulli- Anubis në Egjipt, e deri tek demonstrimet e muxhizave-mrekullive nga Musa– ndan Nilin, Isa shëron trupin, Muhamedi-shëron shpirtin.

Ghazali pastaj vazhdon …**është vështirë të thuhet me fjalë dhe vjen sikur t'i tregosh fëmijës para pubertetit për kënaqësinë në sex. Atij nuk mund t'i tregosh, sepse ai këtë dot nuk kupton, sepse asnjëherë nuk e përjetoi**. Pra duhet të gjesh një symbol që atë e asocon në diçka të mirë, që ai e përjetoi. Si ëmbëlsirën për shembull. Sa për t›i dhen iden,e ne të gjithë e dimë sa larg është kënaqësia në sex, me kënaqësinë me ëmbëlsirë. Tek kur ai rritet dhe përjeton, e kupton se sa ndryshe është dhe sa vështirë për t'u spjeguar. E merre ti me mend çfare mund kanë pasur ata- Profetët- për të na e trensmetuar porosinë qiellore, e cila kur përcillet tek mentaliteti jo i rafinuar, vullgarizohet ashtu si është vullgarizuar njohuria e Alister Crowley-t në satanizëm, e Nietzsche-s në fashizem, e Muhamedit në fundamentalizëm, e Bahaullahut në globalizëm, koncepti i Androginit në hermafroditizem, Arti në zanat, Ismail Kadare në patriotizëm të striptizuar etj. Mëkat! Vërtet gjynah.

Si të veprojmë?

Meqenëse nuk i duam standardet dhe nuk ka standard për këtë atëherë më së miri është të jemi vëzhgues dhe me kontemplacion dhe kuietizëm të kuptojmë vendin dhe rolin tonë në këtë univers. E tërë rrjedha e evolucionit të koncepteve dhe të shijes për artin, arrihet të paralelizohen Dadaizmi –Perëndim me Koan-in – Lindja e larget. Ikonat, Lindja krishtere me impreg-

nimin e dëshirës në Master piece dhe është mjafte me rëndësi te observohet nga këndi neutral se një produktkreativ a është precipitat i përvojës shpirtërore apo esencë parfumi e nxjerrur pas shumë mundimesh, si selekcionimi më i mirë për balancimin e qenies sonë.

ZGJOHU!

Në vitin 2001 me ra hise me e taku Andrasz Krahl, një hungarez me prejardhje herreje, i cili jeton në Amsterdam. Bisedat tona ishin të ndryshme nga se, kishim interesime të njëjta për gjëra të ndryshme. Kur ra llafi për Gerschom Scholem dhe librin e tij The major trends in Jewish Mysticism,kopien e, të cilit e pata dikur para se Sasa Radosavljeviq nga Piroti, i cili jetoi në shtëpinë time gjatë bombardimeve të NATO-s, i dogji mbi 2000 vepra origjinale të esoterisë, si Lindore po ashtu edhe asaj Perëndimore së bashku me doreshkriet Osmane të vjetra mbi 200 vjet.

Anrdasz Krahl e thuri si perin dybojësh, befasinë dhe kënaqësinë e tij se, një kosovar po diskuton pos,për Scholem edhe për Ibn Gabriolin, Juda Ha Levi, Moshe Maimonid, Isak Bashevis Singer e deri te Ionesko, Varhol dhe satira e Efraim Kishonit, njëlloj sikur unë e thura befasinë, kënaqësinë dhe dëshpërimin si fenomen tredimensional, kur e takova Zonjën Karmit Zysman, e cila fliste shqipën rrjedhshëm, i bënte disa punë, të cilat unë i admiroj dhe i flet edhe nja djetë gjuhë tjera"I ri je " më tha ajo, dhe "...je në rrugë të mirë"

Në reminiscencat e mia shpesh analizoj takimin e Ibn Rushdit (Averroës) 90 vjeçar me Ibn Arabi 19 vjeçar dhe muhabetin e tyre që ata e patën atëbotë. Averroës tha: "...atë, që unë e kam mësuar me mendje, ti i ke pa me sy të shpirtit. Atë që unë di ti i sheh dhe jam i lumtur që jetoj në periudhën tëndë."

Ndodhi që, pas më shumë se 8 muaj nga Amsterdami më erdhi kopia e librit të Gerschom Scholemit prej Andrasz Krahl edhe pse, për kohën derisa shoqëroheshim bashkë në Kosovë, kurrë më nuk folëm për Scholem- in.

Në një situatë tjetër Bret Massey, hebre nga Toronto po ashtu u befasua kur i shkëmbyem muzikat. Ai ma dha Ravi Shankar dhe Ali Farkature, ndërsa unë i dhash Sabri Brothers nga Tradita Qawali e sufive të Pakistanit dhe një kompilacion nga Satwa music përfshirë Oliver Shanti , Rick Waekman etj. Kur më tregoi se, ai rrjedh nga familja Maznikar dhe për t'u dukur më perendimor familja e tij vendosi të quhen; Massey. Unë u befasova dhe i tregova se, në fshatin Brod, në regjionin e Prizrenit jeton një koloni muslimanësh të famijes Maznikar. Ai mbeti pa frymë dhe nuk e kuptonte dot këtë. Unë i tregova po ashtu se jam në gjendje ta njohtoj me Z. Maznikar nga Brodi, i cili dikur më furnizonte me libra nga Bosnia, si "Fetve", nga Husein Djozo, Hallalli dhe Harrami nga Jusuf Al Kardavi etj.

Qëllimin e pata t'i tregoj për supozimin tim se, këta Maznikar janë Khazarët, të cilët u asimiluan pasi që, Svyatoslavi rus, më 969 definitivisht e mundi mbretërinë treshekullore Khazare. Për Khazarët shih tek Juda Halevi në Sefer Ha Cuzari, tek Millorad Paviq në Fjalori Hazard dhe më gjerë në American Center for Khazar Studies, www.khazaria.com.

Rabi Hisdai Ibn Shaprut ishte mjek në oborrin e Khalifit spanjoll Abd Al Rrahman III (912-961) dhe të birit të tij Hakam II (961-967). Ibn Shaprut kur e zbuloi se një fis turk komplet, konvertoi ne Judaizëm ai vendosi që më 960 t'i dërgoj një letër mbreti Khazar; Khaganit Joseph Ibn Aaron Turku.

Ibn Shaprut shkruan…**kur dëgjova se ekziston shteti Turku, u inkurajova, duart m'u përforcuan dhe shpresa m'u konfirmua. Për këtë shkak jam përkulur dhe i jam lutur Zotit të Qiellit**.

Hisdai ibn Shaprut ishte i lumtur sepse krishterët nuk mund të thonin se, hebrenjtë janë pa shtet, si ndëshkim për shkak se e refuzuan Jezusin.



Harta e mbretërisë ku shtriheshin Khazarët

Ishte ajo kohë e rëndë në mesjetë, kur muslimanët ashtu edhe hebrenjët shikoheshin me sy të keq nga të krishterët, derisa erdhi tek fundi kur dëbohen 600.000 hebrenj Safard nga Spanja dhe Spanja Maure (Islame) e humb fuqinë dhe superfuqinë kulturore dhe politike në shek XV.

E di Zoti apo edhe njeriu se shega i ka 613 kokërra të kuqe, aq sa ka 613 Mitzvot (urdhëresa) në Torah, këtë tek vonë e zbulova,çdoherë e kam ditur duke e trashiguar diturinë sufi se, shega është symbol i pëlleshmërisë, gjinëve, symbol i femrës, në Kur'an përmendet si; **Rumman**. Nuk ishte e rastit që, Martini ynë i madh (Camaj) në romanin **Djella**, fillon me shegën dhe thotë "… vetëm shega e pjekur pëlcet".

Derisa mua më përcillte çdoherë thënia e Muhamedit… Shega iu pastron nga sheitani dhe aspiratat djallëzore për 40 ditë", ndërsa Hz Ali thotë: "Drita e Allahut është në zemrat e atyre që han shega".

Po ashtu në traditë Islame është përcjellur se, ngrënia e shegës rrit inteligjencën, pastron gjakun, dëbon sheqerin në gjak, rregullon menstruacionet tek femrat dhe ai, i cili i ha vetëm tri shega

në vit është i siguruar nga Oftalmia (pezmatim i rëndë i syve dhe konjuktivës).

Muslimanët po ashtu dinë, e veçmas vëllazeria e pastër e enciklopedistëve të Basrës, shek. X-XI , më të njohur si Ikhwan As Saffah se, hëna i ka 28 faza, aq sa ka unaza në boshtin kurizor, alfabeti arab i ka 28 germa, aq sa ka edhe pejgamber, të cilët janë më të shquar në Kur'an.

Ka kohë që më ngacmon pyetja intime, e cila tash gufoi si kërkesë për të çelur e liruar aromën e këndëshme e ajo është: Sa musliman ka në Kosovë? Çka është Identiteti Islam? A ka art Islam? A ka Kulturë Islame në Kosovë? A ka Sufi në Kosovë?

Nëse Vassily Kandinsky (shih " Mbi frymoren në art") nuk heziton të flas se tani arti duhet ta marr dimensionin sakral, Nikolai Berdyaev po ashtu, pse ne duhet të heshtim?

Më kishte kënaqur nëse do të dilte një përmbledhje poetike me Himne Perendisë, apo një ekspozitë artistike pikturash sakrale. Me qejf i kisha parë të ekspozuara në Galerinë e arteve të Kosovës, Ikonat, të cilat i punojnë Nëna Makarija dhe motrat e zellshme të Manastirit Sokolica në Mitrovicën veriore etj.

Nëse zgjidhet heshtja si mjet për ta demonstruar nivelin emancipues atëherë ajo bëhet aq e dëmshmesa edhe llomotitija e rutinuar. Heshtja mund të praktikohet si mjet në praktikën mistike, ashtu bëri pejgamberi Zekerija në moshë të shtyer para se të lind Jahjau (John babtisti). Heshtja 40 ditëshe e Muhamedit në shpellën Hira, heshtja e sanyasinëve (idioritmikëve) të pyjeve Induse shkrimtarëve të Upanishadave, ashtu bëri në kohën tonë Pyotr Damianovitch Ouspensky, autori i Tertium Organum. Por, krahasimi i heshtjes sonë me heshtjen e këtyre që, unë çdoherë me nderë i permend, është njëlloj si krahasimi i bisedës së parashkollorit me të akademikut .

Se sa më e rëndësishme është vepra se llafi, na e dëshmoi Nëna Tereze me nje fuqi dhe inspirim hyjnor. Na dëshmoi se si një trup i vogël njeriu, mund të bëj vepra madhështore se, si mjetet materiale mund të transformohen në pajisje të dobishme për shërim shppirtëror.

Teologu numër një në Kosovë, Z. Nexhat Ibrahimi nga Prizreni i ka bërë shërbim të madh lexuesit kosovar, me përkthimin nga boshnjakishtja të librit të Henry Corbi-it " Historia e filozofisë islame". Se si Corbin nuk frikohet të flas për Islamin është demonstruar në një libar aq lucid, pa orientalizma të Ernest Renanit apo të Darko Tanaskoviqit, por më tëpër në frymën e Luis Massignon, Miguel Assin Palacios, Annemaire Schiemmel, Eve De Vitral Meyerovitch, Henry Loust etj.

Hezitimi për të folur për Islamin nuk vjen nga mosnjohje e tij në Kosovë, por nga mosnjohja e atyre, që e sulmojnë Islamin. Islamin e sulmojnë apo e mohojnë vetëm ata që nuk e njohin. Vetëm ata, të cilët nuk e njohin raportin e besimit të tyre (nuk them fesë së tyre), me vetvetën dhe tendencën e tyre. Islami është i keqkuptuar apo i keqinterpretuar për qëllime të ndryshme, prandaj këto sjellin efekte në të shumtën e rasteve, negative. Çdo njohje parciale, sjell deri tek keqkuptimet.Islami është mënyrë e jetës dhe si i tillë është mjaftë kompleks.

Të kuptuarit e Islamit si formë jetësore, si tërësi Integrale me dimension profane, si kulturë, edukim, ligj, me dimensionin sakral– lutjet, bëmirësia solidariteti, me dimensionin mistik, shmangie nga Hipokrizia, praktikë mistike-heshtje, agjërim, lutje vullnetare, zikir etj. Është të kuptuarit më të drejtë, ndërsa të praktikuarit të të gjitha këtyre, njeriun e transformon nga qenie, thjesht; biologjike, në qenie sublime, shpirtërore.

Pasojat e mungesës së edukatës shpirtërore janë evidene. Si mund një njeri të hesht apo t'i mbyll sytë për disa fenomene të cilat po ndodhin në këtë kohë.

Në vend të kësaj ne po trajnohemi nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare në disa vlera, të cilat rrinë të fjetura diku në qoshqet e dimensioneve të shumëta brenda kompleksit NJERI, e tek më vonë rikujtohemi se asgjë për ne nuk është e re. Kjo ndodh sikur, në mesditë e kujtojmë ëndrrën e parë vetëm para disa çastesh të zgjimit në agim.

ANI...

Kur J. J. Frazer e shkroi librin "The golden Bough"- (Dega e artë), ai u konsiderua autoritet, si një studim nga studiuesi seroiz i antropologjisë, i religjionit dhe magjisë. Këtij mund t'i rrij ball, vetëm enciklopedia e madhe e religjioneve të Mircea Eliades.

Vishtulli i bradhë (viscum album) apo si e quan Frezeri: "**The golden bough**", ose dega a artë, ka një simbolikë të veçantë. Është një bimë, e cila jeton si parazit në lisin e bungut, ndërsa konsiderhej si bimë e zgjedhur nga perendite sepse jeton as në qiell e as në tokë.Në rastin Frazer mund të konkludojmë se ai posedonte kapacitet të lartë guxim dhe argumentin e fortë shkencor.

Revelatat, pastaj, veprat kapitale, të cilave i takon edhe DEGA E ARTË, gjithnjë e më shumë më duket se janë shkruar dikur dhe koha e tyre ka perenduar. Kjo më shtyen të mendoj në trajtën si muzika gjermane perfundoi me emrat: Bach, Bethoven, Mozart, piktura italiane me emrat Michelangelo, Da Vinci, muzika angleze me Queen, Pink Floyd, David Bowie, moda franceze me emratChristian Dior, Yves Saint Laurent, Givanchy, etj.

Kreativiteti i njeriut asnjëherë nuk guxon të ndalet tek emrat, e as tek veprat e tyre, pornga ato të kaloj më tej, përndryshe gjeniu global nuk do të këtë më çka të thotë. Nësë Zoti krijojn vazhdimisht atëherë edhe ne jemi dëshmitarë se, njeriu është duke evoluar dhe duke ndryshuar duke krijuar, prandaj të ndalemi tek emrat dhe veprat, është gabim.

Në vend të kësaj mund t'i konceptojmë gjërat duke u thelluarkah burimi i tyre, sepse ajo çka është thënën në librat, atë çka kanë krijuar talëntët dhe gjenitë, janë përgjigje e kohës. E krejtë tjëtër është nëse njerëzit e të njëjtës kohë nuk qenë në gjendje ta absorbojnë atë çka u është ofruar.

Ne mahnitemi me atë çka një grup njerëzish, janë në gjendje të bëjnë zakonisht. Ata bëjnë atë që, ne vdektarë të rëndomtë nuk jemi në gjendje ta bëjmë. Këta njerëz në i quajmë Talentë. Aftësia e Talentit që, ta thotë paaftsinë tonë për ta artikuluar dëshirën tonë, shpeshherë emërtohet si hyjnore, kurse paaftësia e talentit për ta thënë dëshirën e vetë,përmbushet me aftësinë e gjeniut. Gjeniu (për gjeniun, shih Schopenhauer dhe me mirë Otto Weininger), e thotë atë që, talenti nuk është në gjendje ta thotë. E çka thuhet inspirimi i gjeniut a është ai hyjnor dheçfarë është mikrokimia e komosit NJERI.Sot nevojat janë të ndryshme nga ato kur emrat e mëdhenjë dhe veprat e mëdha ishin krijuar.

Trajtës së gabuar të të menduarit se një komb e thotë atë kur është në element të plotë ashtu, si qe cekur për muzikën angleze, pikturën italiane, modën franceze, muzikën gjermane etj., i kundërvihet argumenti se edhe sot po të njëjtit krijojnë, por vazhdimisht duke korresponduar me kohën dhe nevojat që, lindin në atë kohë. Ajo çka u përmend mund të konsiderohet si konvencionale dhe çdo e re refuzohet si jo e denjë, jo e vlefshme e pakrahasueshme me parapraken etj. Por, Al Ghazali thotë "*gjërat më së shpeshti refuzohen nga mosnjohja dhe injoranca jonë*" ndërsa Bertrand Russel thotë, pothuaj të njëjtën: … *Idetë më të mëdha në botë në fillim i janë nënshtruar injorimit e deri tek blasfemia*…"

Asgjë më pak nuk kanë thënë Babilonasit, Egjiptasit, Hindusët e lashtë, kur ishte koha e tyre dhe kur këtë rast ua ofroi momenti kosmik, po ashtu edhe Aztekët, Inket, Maya-t lanë gjurmë, të cilat në mënyrë permanente na e përkujtojnë gjenin e kreativitetit human. Përparësinë e tyre e shoh se, gjurmët identifikohen si kolektive dhe tepër rrallë identifikohet individi. Në

të kundërtën në epokën tonë vëhet në pah emri i përveçshëm. Individi, veta e parë njejës (egoiste apo jo ?).

Një shembull për ilustrim është grupi i (9-shës esotherike, i cili ekzistonte ne kohën e Buddhas dhe sot ekziston, emrat e, të cilëve ishin dhe janë të panjohura. Grupi ishte i të njejtit nivel të krijimtarisë kosmike, por atë e artikuluan Buda-n. Secili prej tyre ka funkcion të ndryshëm në grup.

Në traditën Islame po ashtu ekziston grupi ezoterik, i cili kryen funksionet e veta në këtë kosmos. Ata janë të njohur si Rigal- al Gajb- apo njerëzit e fshehtë.

Kierarkia e njerëzve të fshehtë, të cilët i kryejnë detyrat e tyre kosmike në ketë botë. Emrat e tyre askujt nuk i janë të njohura, as identiteti. Ata veprojnë si rrënja. Marrin mushtin e tokës për të dhënë lule dhe frute. Nesë mendojmë individualisht atherë e tërë kjo që u tha më lart bie në ujë. Por, vetëm nëse mendojmë një integrim në stilin e bletëve, atëherë mentaliteti automatikisht ndryshon. Në këtë raport duhet secili të filloj nga vetvëvetja.

Ekzison një sferë/dimension /domen, i cili është i përbashkët për të gjithë ne. Ai është domeni i ËNDRRËS. Gjuha e ëndrrës është piktografike. Ajo është bota e simboleve apo sipas Sufi terminologjisë **Bota e formave të varura**, (shih tek Suhrawardi **URTËSIA E PËRNDRITJES**).

Për një çast po bashkohemi me realitetin kolektiv, si e emërtoi Karl Gustav Jungu. Për një çast e takon realitetin, i cili nuk të lë të mendosh se ke jetuar një jetë, e cila konsiderohet reale ashtu si gjendja e mjeshtrit Tao, kur ishte flutur dhe nuk i kujtohej se ishte Njeri dhe kur u kthye si njeri dhe nuk u kujtua se ishte flutur. Një ëndërr e thellë, e cila nuk kujtohet dhe një realitet i thellë, i cili nuk kujton atë që takoi në ëndërr .

Ekzistojnë çastet kur na duket se edhe njëherë i kemi përjetuar. E vërteta mund të jetë se, ato i pamë në realitetin ëndërror. Dhe realiteti ëndërror duhet të lexohet me alfabetin ëndërror për t'iu shmangur keqinterpretimeve dhe keqkuptimeve. Realiteti ëndërror duhet të deshifrohet, duhet të gjindet kodi për leximin e tyre.

Nuk mund të shkrujamë me alfabet hebraik gjuhën japoneze apo me alfabet arab gjuhën latine. Me çka jemi ballafaquar në histori është poezia e divanit në periudhën osmane apo poezia e bejtexhinjeve tek shqiptarët. Është shkruar arabisht gjuha turke dhe gjuha shqipe. Është shkruar arabisht gjuha hebreje, rasti Maimonid në Spanjën Maure. Por, të gjitha këto kishin funkcionin e vetë.

Gjuha perse shfrytëzon alfabet arab. Aty janë bërë adaptimet për ta lehtësuar komunikimin. Po ashtu ndodhin adaptimet gjatë tentimit të interpretimit të realitetit ëndërror.

Pata shkruar diku se **… neve na mungon vokabulari tokësor për çështje qiellore**.

MOS MA PRISH KËNAQËSINË TIME !

Tekst koncentrat për mendjet e kulluara
dhe amëzat kreative

Kur bie bora, qielli hapet dhe sikur ajo qetësi, në vete përmban copëza imazhesh, që sajojnë mozaikun e qetë, një idilë dimiri të qetë që, ma evokon fotografinë e njohur të Werner Bischofit; "Një idilë dimri Japonez", që zhvillohet si top mendafshi në erë për të fërfëritur.

Një qetësi e tilë ZEN-i, këtu pothuaj nuk është e mundur, jo për shkak të komunikacionit rrugor, por atij komunikativ ndërnjerëzor. Në një qetësi të këtillë, kontepmloja dikur dhe aroma e rrëshirës së pishave, krijonte harmoninë dhe balancin dhe impregnonte secilën pore të qenies, me fuqinë shëruese arkaike para se, të krijohej amberi, i cili në vizionet tonaduket gurë i çmuar, ndërsa muzika e psaltrit dhe tingujt e vibratos së Kyrilee Loo, më çonin për një çast në tajgat e largëta. Atëherë si i çmendur, lexoja Romain Rolandin për jetën dhe veprën e Ramakrishnës dhe Swami Vivekanandës. Pas shumë vitesh sërish u përlota duke e lexuar një libër dhe prej atij momentit zemra ime u bë sarkofagu i fshehtësive të thuaja dhe qan në çdo dhembshuri. Qan edhe kur i afrohet dikush, vocërrak t'i thuash, për ta shfaqur arrogancën e vetë. Qan edhe kur dëshiron t'i zgjoj të fjeturit si DUENDE-n e errët, ta demonstroj kreativitetin e vetë.

Lumi i ndodhive po kullon rrjedhshëm, e semipermeabiliteti jonë, lejon perceptimin e uniformitetit dhe kështu në mënyrë

zinxhirore krijon planktonin e kreaturave me trup njeriu dhe frymë të huazuar. Derisa vibrojmë dëshirën, si mantrën më përkushtim të pavetëdijshëm, e kuqja lë vurratat demonike dhe krijon të thatin në lukth. Psikologët këtë ia mbathin ambiciozitetit. Çekët kanë farkuar fjalën Psikotronika, si fenomen i ndikimit të energjisë në materie.

Hapu si trëndafil dhe si libri JETA E FSHEHTË E BIMËVE nga Peter Tompkins dhe Christopher Bird dhe liro parfumin ta erëmojmë të gjithë, pastaj eja ta kalojmë pragun e ylbertë.

Kriza e të menduarit më kaploi kaherë dhe derisa të tjerët e luanin shahun në katror nëpër çajtore duke kulluar politikën, më mirë se burrshteti, unë luaja shah në kub me elementalin sublim, i cili u shfaq tek "Shumesi e Padukshme". Ndërsa në ELEMENTAL 99, e demonstroi veskun si hurijat e Jannat al firdeus-it të përshkruara në Kur'an. Qysh atëherë klitha: **Mendimet më shkojnë në pakufi e çdoherë mbetem në mes**. Dhe kjo u botua në "NUN", librin tim më të dashur.E mere ti me mend, sa kohë ka kaluar prej Sokratit dhe dialogëve të tij, mjeshtrisë së argumentimit të njohur të tij, derisa Edward de Bono prezenton pas më shumë se 2000 vitësh, metodën e të menduarit paralel. Metoda e gjashtë kapelave të mendimit. (Shih Edëard de Bono-Six thinking Hats).

E gjith kjo më ngjan në revolucionin e pomologjisë së Luther Burbankut. Sot kur njerëzit mendojnë se, çdo gjë është thënë dhe revolucionet i takojnë së kaluarës. Për këtë tip të të menduarit, më me ëndje e kisha rrëfyer ndodhinë e Bagdadit; metropolë e mesjetës, kur ai numëronte 2000 000 banor, prodhonte lëtër, përkthente Yogasutrën e Patanjalit dhe komentonte Aristotelin dhe mos ta zgjas më.

Ky tregim Sufi ndodhi kur po ky Bagdad ishte i ngopur me shkencë dhe më të dëgjuar se nga Gilani i Persisë po vjen dijetari i madh Abdul Kadir Gejlani, dijetarët e Bagdadit i mbushën dy qypa të mëdhenjë më ujë për t'i treguar Gejlanit se ardhja e tij është e tëpërt dhe se Bagdadi është i mbushur plot më të tillët, sikur këta qypa më ujë. Ishte dimër dhe trëndafilat nuk çelin

atëhërë por me kretivitetin kosmik të njohur si Keramet, Gejlani nxjerri trëndafilin dhe e vuri në njërin nga ato qypa me ujë. Kur këtë e panë dijetarët e Bagdadit, iu përkulën dhe vrapuan t'i hapin dyert viganit të shkencës kosmike.

Kisha vështirësi ta pranoj këtë, njëlloj sikur që kisha vështirë ta absorboj konceptin hindus të MAYA-s (kjo botë është iluzore), të Hasan El Basriut "*kjo botë është tregu ku blehet bota tjetër*, të konceptit të Ibn Arabiut, pastaj të Danilo Kishit dhe krejt kështu derisa erdha tek Steven Hawking, i cili e thotë të ngjashmen.Steven Haëking është ai, i cili e ushqen etjen tonë për dije, sikur në vdektarë të rëndomtë që i ushqejmë krimbat e dheut, ku do të shkojmë me një materie të sofistikuar nga mishi e gjaku e fryma si; *engjëlli me flatra do të fluturoj dhe ajo çka mendja nuk kupton, ajo do të bëhet*... thotë RUMIU, në Metamorfozën e tij.

Pas këtij (Hawkingut) më lëhtë e kam ta kuptioj citologun e njohur nga New Jersey, Dr. Howard Miller, i cili pohon se, *çdo qenie e gjallë ka njëlloj vetëdije qelizor*e.

Sidoqoftë vi deri tek momenti kur më kollaj e kam më engjëjt se, me njerëzit, sepse këta të fundit mësohen më një ritëm dhe i kaplon inercioni e ky okupon dhe bëhet kënaqësi. Pastaj çka do që shfaqet në vijim duket si prishje e rehatisë dhe bie si; "Mos ma prish kënaqësinë time". "Kjo është bota me, të cilën jam mësuar dhe në Kosovë asgjë e re."

Shkruar në Prizren-Rahovec
28. 10. 2003 – 10. 11. 2003

PO

Mishkin Kalam e bërri një kaligrafi të mrekullueshme, por ajo që do ta vulos simbolikën e Bahaizmit do të jetë talisman, i cili do të emitoj vibrime të vetëdijes kosmike, të sjellur për të qetësuar plagët e njerëzimit dhe për ta përndritur injorancën globale

Nuk ka dyshime, se po ata, që shndërohen në pluhur për ta emituar këtë përndritje kosmike si kishte thënë Nietzsche … **krijojnë parajsën për të tjerë, për të gjetur në ferrin e vetë**… tash zgjohu si fitimtar.

A janë këta artistë apo diç më shumë, unë i kam humbur matësit real, sepse në këtë moskomunikim mes krijuesëve nuk mund ndryshe ta definoj, pos si; stad më i ulët të involucionit shpirtëror. Dhe nuk është e kot pse, në ELEMENTAL 99, kam shkruar, se krijuesi është si frut i mushmullës, ai duhet të kalbet për ta fituar shijen e vërtetë. Kështu si rast më i freskët i ndodhi Danilo Kishit. Tash injorantët atë e ngrisin në kupë të qiellit.

Problemi qëndron në orientim të gabuar të energjisë shpirtërore. Është tragjike që, krijuesit akoma mendojnë në sistemin e argumentimit, në sistemin e Sokratit.

Më shumë harxhohet energji për të polemizuar dhe kush kujt ia ngul se sa që, ajo energji të orientohet, për ta ndërtuar një mrekulli (kjo neve na duket mrekulli, përndryshe është rutinë) prej punë të përbashkët …**çohuni djema shaloni atin**… Dy aka-

demi të shkencave asnjë Enciklopedi. Në Serbi pesë shtëpi botuese nëntë enciklopedi. Për madhësinë gjykoni vetë.

Problemi tjetër qëndron në autoritetin. Kush ka autoritet të majftueshëm për t'ia dhënë të drejtën e të qenit krijues. Së paku tash është lehtë kur bonjakët (lexo: botuesit individual), duhet të bredhin rrugëve të botës, për ta gjetur fatin e ditës dhe kështu shpesh arrijnë sukses derisa; pjelltoret (lexo: shtëpitë botuese zhdanovite) përkujdesen për fëmijët e oborreve, të cilët të izoluar nga bota reale (kjo e jona, e imagjinatës) shpesh përfundojnë në fosile të gjalla si, mostër për të vepruar më ndryshe se ata u çofshim falë… ARTI ËSHTË SI QIELLI DHE KA VEND PËR SECLIN YLLL TË BËJ DRITË , këtë fjali po u jap hedije.

Për të krijuar ka mjaftë hapsirë. O ku jeni ju, të cilët doni ta begatoni këtë botë. Më për shtati më kishte shkuar, po të nanjihnin si SUPERNOVA dhe bombë kulturore se sa, bombë demografike.

Me rëndësi është të kuptohen rregullat krijuese, kritika, tendenca positive, mungesa e ndjenjës për emër se sa të polemizohet rreth … kush merr më shumë nga Ministria, e kush i vjedh honoraret e autorëve, e pastaj kush boton raporte për administratën e kulturës në mungesë të atyre që e bëjnë atë, apo kush kujt darkën ia shtron për ta majmur si quranin e Bajramit.

Kush nuk i kupton rregullat e lojës/kësaj loje, le të del prej qarkut, le të zhytet në ujë për t'ia ditur kimetin anijes. Nuk ka të drejtë askush ta përzë dikë, por ka obligim ta mentoroj për t'i ndihmuar që ta kaloj edhe një tundim e ai është tejkalimi i gjendjes elementare në po këtë lojë të keqkuptuar.

Nuk isha dashur që ky shkrim të nivelizohet me polemikat dhe argumentet dhe kritika si, kemi zakon t'i lexojmë nëpër revista dhe rubrikat për kulturë të gazetave tona ditore, por më shumë ky shkrim të kuptohet si çortim i elementit nënë, të aspektit prindëror të qenies sime.

Kur ma bëri një portret baca Xhelosh Gjokaj, më nxiti t'i them vargun **FSHEHTËSIA IME NË DRITË ËSHTË E FSHEHUR ATY KU AS TERRI DOT NUK E ZBULON**, shpirti lotë më kulloi. Por, kur poleminzuan Shkëlzen Maliqi me Au-

rel Plasarin, klitha **OHHHH… ZOT MËSHIROI SE NUK E DINË SE ÇKA BËJNË**. Dhe më dolën disa lot, por dallimi i këtyre lotëve me lotët e mëparmë ishte shumë shuuuumë shuuuuuuuumë i madh. Ato dalloheshin në peshë, nuanca transparence, elektrizim dhe rrezatim të ndryshëm.

Derisa atje larg shumë larg në Angli, njerëzit komunikojnë (Steven Hawking), me yje vrimat e zeza, kohën ireale dhe mundësinë e udhëtimit nëpër kosmos, jo në këtë mënyrë si bëhet tash, por me anë të korridorëve të kosmosit, unë mendova për mundësinë e transmisionit të trupit e për shpirtin mos të flas (njëlloj si Mi'raxh i Muhamedit), këtu ne ballafaqohemi me trivialitetet se kush kujt do t'ia gjuaj peshn e mëkatit si topthin e pingpongut.

Përkundër mëkati ynë është shumë, shumë më i rëndë, shumë, shumë më i madh se sa është i mundur një transmision i materies, dëshmohet me barierat e qëndrimit tonë ndaj saj. Materia është e rëndë dhe element ndoshta më vulgar i shkëndijes kosmike, ashtu sikur edhe logjika jonë, prandaj nëse mendohet në atë logjikë edhe një lëvizje e tillë e materies do të jetë jo e mundëshme.

Këtu lind një pyëtje tjetër.Koha e profetëve ka mbaruar (logjikë e ulët. A thua kreativiteti i Perendisë mori fund?) Ndërsa në anën tjetër gjithnjë e më shumë thuhet se, nuk ka fund kreativitetit njerëzor. Nëse Zoti paska përfunduar së krijuari, e njeriu e mori timonin e kreativitetit, unë pres që Kaosi të renditet sipas qejfit të njeriut pastaj vaj halli për fotonet, tahionet për kuasarët, fluskat kosmike, për vrimat e zeza dhe marrë në tërësi, vaj halli për xhindët dhe melekët, shejtanët, arkangjelët dhe serafinët. Bota është e larme.Zoti krijon pandërprerë. Njeriu poashtu në nivelin e vetë. Zoti krijon edhe nëpërmjet njeriut, por njeriu këtë nuk e merr vesh.

As nuk ka përfunduar kreativiteti i Zotit e as i njeriut
Pastaj
Unë
Them
poezia është dhunti e perendisë dhe vjen nga mëshira e tij.

KINVAT

Sot të shkruash për Iluzionin e fillimit (Genesis) dhe të fundit (Apocalypsis) do të ishte shtresim mbishtresim, sepse prej legjendave biblike (lexo: Bibla dhe me tej, Legjendat Biblike të Zenon Kosodovskit), e deri tek Jean Baudrillard, flitet për fundin, apokalpsin dhe fundin e ekzistencës së qenies njerëzore e deri te krejt kosomosit. Dhe krijimi i palimpsesteve të tilla, do të ishte i tepërt. Kjo na jep te kuptojmë se, jemi duke e jetuar apokalipsin.

Diku në Orient mësojnë për çastin **tash**, i cili duhet të përjetohet për t'u njohur e vërteta dhe shkojnë më tej se, kjo ekzistëncë është iluzore, e njohur si **Maya** apo **Hayal**. Mirëpo, ende nuk ekzston diçkaqë, do të emrëtohej si **Iluzioni i Mesit**. Procesi i dezintegrimit ka filluar kaherë dhe ndëritmet ngriten mbi të shkatruarën. *Asgjë nuk lind pa vdekur njëherë*, thonë Alkimistët. Që po e hap një kapitull krejt tjetër.

Krejt varret sa dhe si kush e dëgjon këngën e gjelit. Momentin kur fillon dita e re. Kur të devotshmit zgjohen dhe e fillojnë ditën me lutje. Kështu shpresoi edhe Sokrati pasi që, e piu opiumin kërkoi që, të prejnë gjelin kurban për Eskulapin, sepse është liruar nga jeta është liruar nag apokalipsa. Ai gjel, i cili simbolizon ZGJIMIN. Ai, i cili këndon para muezint dhe ai, i cili këndoi tre herë para se e tradhëtuan Isaun thuhet në Ingjil.

Ai gjel, i cili nodhet në kulmet e shtëpive dhe kumanoreve, ai gjel simboli francez ai gjel, i cili këndon dhe është zgjimi vet.

Kur këndon **Paroderes** (gjeli) në Avesta, thuhet: zgjohu dhe lutu, sepse do të vi demoni **BUSHJASTA**, demoni i gjumit (aspekti i errët femëror, si Kalli në Indi dhe Jin në Kinë), i cili do t'iu mashtroj duke iu thënë ; fle se koha jote ende nuk ka ardhur.

Ajo çka po ndodh veç na ka vënë në gjum, ëndrrat nuk kujtohen më, si dikur, imagjinata po thonë se ka dehidruar dhe zgjimi është i vetmi që, do të na vë në rrjedhë. Edhe Antony de Melo shkroi për zgjimin dhe më duket se, prej shkatërrimit të urrave, epoka e re ka përfunduar dhe po jetojmë veç me një urrë.

Ishin dikur 9 urra të njohura si 9 KINVAT-e sipas Avestës, tetë u shkatërruan mbeti vetëm një. Vetëm KINVAT apo Sirati Qupru. Urë e vetme nëpër të cilën kalojnë shpirtërat prej kësaj bote në botën tjetër. Kush janë ata që i shkatërruan këto urra?

Mungesa e zgjimit është pasojë se, deri tani nuk është shkruar doktrina e Iluzionit të mesit, kujtesa e TASH dhe kujtesa e UNË. Kujtesa për ekzistencën me emrat e rrejshme dhe kujtesa e vetës në çastin kur të tjerët ekzistojnë pa dëshirën tënde, pa vetëdijen tëndë që, lirojnë sekrecinoiet dhe moshuset e trupit të tyre që, lirojnë vibrime të ndryshme, me ndikime të ndryshme. Kujtesa e germave sakrale të natyrës, tingulli i rramjes së gjethit, jeta dyjavore e mizës; një evolucion i tërë, vallja erotike e kumrive gjatë bombardimit, plasaritja e ndjenjës dhe ambigjiniteti i lules së bukur, oksigjeni i liruar nga stomat e gjetheve dhe mikrostruktura e qelizave të Zigotit, poret e djersës në papilat dermale dhe kodi i tyre unik, gjenialiteti i bletës dhe frymëzimi i gjelit, fshehtësia lules së fikut dhe kështjella prej balte e grenjzës, vetëdija ndërmolekulare e metaleve dhe kujtesa e ujit.

Dhe kështu derisa shfletoj natyrën vibroj njërin nga atributet e Zotit JA HAJJ (O i gjallë- njëri nga 99 emrat e bukur ESMAUL HUSNA), ku; krijohen 9 urra te reja, 9 KINVAT-e dhe në botën materiale, kështu shpirti i madh rrymon nëntëfish (thonë Egjiptasit) dhe kthen vetën i ngjyrosur me ngjyrë të diellte duke mos qenë në gjendje ta sheh shuarjen e diellit. Edhe ky po na u soska, medet!

NJË HESYCHIA E THYER

(Letër e hapur Maks Velos)

z. Velo
E dashtuna Shypni

Milorad Paviq është njëri nga shkrimtarët më të mirë të Ballkanit, të kohës sonë. Kur e pyetën gazetarët sa çka është, ai u përgjigj se është Bizantin, kurse secili që, e ka lexuar Paviq-in e di se ai është Serb. Shumë më tepër kam mësuar nga Paviq-i rreth krishterimit ortodoks se, sa nga vet Bibla e dr. Lujo Bakotiq-it.

Njeriu është ajo çka ndjen, por krejt mjeshtria qëndron aty se si e artikulon atë ndjesi.

E filluat me division dhe do ta mbaroni ashtu. OK.

Në vitin 1997 me keni dëshpëruar shumë, dogjët bibliotekën më të vjetër në Ballkan, shkatërruat bimët në Institutin botanik, tash më trego kush është primitiv. Kundra, në asnjëherë nuk kemi djeg libra, neve na i kanë djegur, ata të afërmit tu. Vetëm të të rikujtoj se bashkë-fetarët tu ma dogjën bibliotekën familjare dhe ata hynë me këpuca (çizme), njëlloj si ti, normalisht se, nuk merrni abdest dhe nuk i lani këmbët, çorrapëve u vie era, prandaj nuk i zbathni këpucët. Me ato këpuca hyni në WC me të njëjtat në dhomë, prandaj bakteriet bëjnë dasëm. Tani më trego kush është primitiv.

Z. Velo, me heqjen e vellos suaj gufoi racizmi, ksenophobia dhe Islamofobia, këto janë fenomene, të cilat Evropa i ka

tejkaluar dhe e mban në mend si mostër se, si nuk duhet vepruar. Unë kam pritur se me heqjen e vellos do të gufoj AGAPE në vend të kseneophobia-s, prandaj ky më vjen si dëshpërim i dytë, i cili ma theu HESYCHIA-n, heshtjen time kontemplative. Por e perdori zhargonin ortodoks që të më kuptosh më mirë se po të të shkruaja në Geg do të thoshe se nuk më kupton.

Dije se, Kosova do të mbetet e mjerë nëse ti nuk vjen dhe betohesh për këtë?????!!!. Aferin.

Një gjë dua ta vë në pah, ju jeni në gjendje të votoni në rast referendumi për unitet me Kosovën. Nuk e di a ke fëmijë por jam shumë i bindur se, pas disa vitesh i biri/e bija jote do të vi në Kosovë për t'iu afruar Evropës.

Prap kujtoj, nuk ke faj ti…a e di çka thotë bashkëfetari yt nga Veriu i Ballkanit, Z. Nenad Çanak, ai thotë se, në Vojvodinë thonë që …kungulli, i cili është rritur në hije nuk është për përdorim. Prandaj toni si na flisni ju neve, primitivëve të Kosovës, na është shumë i njohur.

Në vitet 1987-88 Rilindja e Prishtinës e botoi Profeti-in e Khalil Gibranit. Ne dhe 4.000.000 Amerikanë, të cilët e lexuam atë libër gjithmonë kemi ditur se, Khalil Gibrani është arab i Libanit, krishter Maronit dhe asnjëherë nuk jemi frikuar se, vetëm që është Khalil (lexo: Halil), mos ta lexojmë vetëm se, është nga Orienti, së është Arab, apo se është i krishterë, larg qoftë!

Ne këtë e bejmë, sepse duam, E duam shumë Shqipërinë dhe Fahredin Shehu ka shkruar kaherë…ai që është mësuar të dojë, vështirë e ka të ç'mësohet. Madje edhe atëherë kur na cilësoni si primitiv.

Nuk njoh arsyen pse ti dhe komandanti yt dezerter i demokracis që, po lindte në Shqipëri, ju keni mësy kaq Perandorisë Osmane, çfarë është ky falëndërim? Nuk kuptoj pse keni kundër Turqisë dhe krejt Orientit, kur ne Mekken e kemi në Arabi e ju në Stamboll. Ai sulltan i keq, nuk i përzeu të krishterët, ai nuk e dogji Patrikanën e Konstantionopojës, por i pranoi Safardët kur Ferdinandi dhe Isabella… a-ha…. nga Evropa, i dëbuan nga

Spanja. Tani në Spanjë për çdo vit shënohet dëbimi i muslimanëve dhe hebrenjëve, jo me festë, si kishe bërë ti, por me lament duke, kuptuar pas 500 vitesh se çka dhe sa kanë humbur.

Tregoma ti një shtet ortodoks ku ka vend të shënjtë Islam, Tregoma një shtet ortodoks ku kryeministri është Hebre, (Turqia), rasti i koptit Butros Gali në Egjipt, apo Tarik Azizi në Irak, po edhe në vet Shqipërinë tënde.

Ajo që të flen zemra në Greqi duhet të mirresh veshë vetë me vetvetën dhe ke mundësi me zgjedh, ja me Shqiptarë ja me Grek. Ngutu sa nuk e ke vonë. Por, ne në Kosovë prapë kemi me ju dasht, ashtu jemi mësuar dhe vështirë është të ç'mësohemi.

Krejt po më duket se komandanti i juaj deserter do të kthehet me i mbledh si gjenerali i tij në libër, eshtrat e fosileve të gjalla të stalinizmit, të cilin jo Evropa, por vet Rusia e ka flakur vaktile, e t'iu çoj në Francë apo në Kubë, tek Fidel Kastro, por mos harroni se edhe në Francë komunistat nuk janë si ju. Aty ka 8.000.000 musliman dhe ata kanë të drejtë me votu.

E ti mos kij frikë prej Shqiptarëve musliman nga Shqipëria apo nga Kosova, ata po e dëshmojnë tolerancën dhe dashamirësinë e vëllazërisë. Paramendo po të ishin ata pakicë 7-8 % si ju, çka ju kishte ndodh larg koftë, paj supozoj se u kishte ndodh njësoj si Çamëve në Greqi, por në vend të Sarandës, ju i kishit deportu me gomona (ato skafe si i thoni ju atje), në Qipro për me hy më lehtë në Turqi.

Tash më trego të lutem kush është primitiv?

Thjesht pyetem nga vjen i gjithë ky helm? Po ta bëje një analizë gjaku (për çka duket se ke nevojë), jam i bindur se mjeku zor që, kishte me gjetë gjak në venat tua, shumë vner, shumë helm, shumë urrejtje. Zot ndihmo.

Tash po të flas pakëz për Prishtinën, të cilën e ke huç me e njoft (Qosja është nga Mali i Zi, jo nga Kosova, prandaj qenke gabu). Po kjo është ajo Prishtina primitive, e cila kishte shkallë lëvizëse (lift), shumë para se ju ta vëni në gjygj Nexhmije Hoxhën se, pinte kafe me llokum (ne llokumin e prodhonim në familje,

krahas atyre që i prodhonin fabrikat) dhe e gjithë ajo maskaradë prej gjykimi të një gruaje ndoshta të pafajshme.

Tash po e kuptoj se Enver Hoxha e paska pas të drejtë se,ai më shumë dhe më mirë ju ka njoftë se, sa iluzioni ynë për shtetin amë, të cilin jeni duke e shkatërruar ju. Ne shkërdhata e Kosovës, e cila ju do, ne primitivët.

Po kjo është Kosova/Prishtina primitive, e cila kishte dhe ka Rock, kur ju dëgjonit Adriano Celentanon dhe fluskat e ndryshme italiane, Prishtina, e cila ka Grange, e cila ka Hip hop, ka kisha, xhamia, teqe, ka këngëtarë, piktorë, shkrimtarë, arkitekt, inxhinierë, politikanë. Ne të këtillët përherë primitiv. Ne, të cilët nuk mbjellim hashash.

Ne, të cilët nuk kemi urrejtjen për Veriun, e duam shumë Shkodrën e duam shumë Kukësin, e duam shumë edhe Jugun. Ne primitivët, të cilët kemi njerëz edhe si ti, por nuk i urrejmë, thjeshtë kemi lirinë shpirtërore dhe e respektojmë atitudën e secilit.

Ne, të cilët jemi mësuar të duam dhe vështirë e kemi të ç'mesohemi.

Sa për informatë z. Velo, Evropa është krishtere por, jo Xenophob-e e raciste, Jo më! Ka qenë dikur dhe më duket se ti nuk po jeton në SOT, por në DIKUR. Ora diku t'u paska ndal. Me siguri në kohën e ikonave.

Nëse nuk keni lexuar- ju këshilloj ta bëni këtë duke u nisur nga:

- Simbolika e kryqit nga Rene Guenon
- Scientia Sacra nga Bela Hamvasz
- Domethënia e krijimtarisë nga Nikolai Berdjaev
- 777 nga Alister Crowley
- Six thinking hats nga Edward De Bono
- Meeting with remarkable man nga G. I.Gurdijeff
- Simulacrum nga Jean Baudrillard
- Cink nga David Albahar
- Bukvica nga Shaban Sharenkapiq

Të gjithë këta autorë janë nga Evropa dhe shumica prej tyre janë të krishterë.

- Po... mirë është të lexosh edhe :
- The seals of wisdom nga Ibn Arabi
- Sefer ha Kuzari nga Juda Ha Levi
- Picatrix nga Maslama Al Magriti
- Talhis kitab al- maqulat (Komenti i veprës së Aristotelit, Kategoritë) nga Ibn Rushd

Dhe krejt në fund

- Nektarina nga Fahredin Shehu

Të gjithë këta janë nga Evropa, por janë; musliman, sufi dhe hebrej.

Edhe këtë fytyrë e ka Evropa mos harro.

Ndërsa unë do të vazhdoj së lexuari Xhelaluddin Rumin, sepse kështu më pëlqen.

Me tonin që ju flisni z. Velo mendoj se vendin e keni në Gjykatën e Hagës, sepse tone të këtilla Evropa i ka dëgjuar në Nyrenberg.

Kurse mediat në Shqipëri që e paskan zbuluar ujin e nxehtë (liria e shprehjes), po kush e di çfarë tendence fshihet aty, u duhet një pauzë, që të reflektojnë në disa pika:

Argat të kujt janë;

Liria e shprehjes nuk është gjuha e urrejtjes, këto dallojnë shumë, liria e shprehjes shpesh është kufizim i përdorimit të gjuhës së urrejtjes;

Islami nuk ka ardh sot në Kosovë;

Evropa nuk është armike e Islamit dhe anasjelltas;

Muslimanët kanë më shumë të drejta në Londër se në Tiranë;

Ejani në Kosovë dhe mësojeni tolerancën dhe dashurinë;

Lexojeni Biblën më shpesh për ta kuptuar Kur'anin si duhet.

Ndërsa ne Kosovarët primitiv, organizojmë përvjetorin e lindjes së Kadaresë, e kritikojmë Kadarenë dhe Qosjen kur nuk

e qëllojnë. Këtë unë e kuptoj së pari si, liri shpirtërore, e pastaj si liri të shprehjes.

Në vendet demokratike liria e shprehjes d.m.th. shpeshherë kufizim i përdorimit të gjuhës së urrejtjes,

Nëse SHEKULLI e ka pas qëllimin e nxitjes së urrejtjes, me standarde Evropiane monitoruesit e mediave i ndëshkojnë mediat e tilla, e nëse SHEKULLI nuk e ka kuptuar se 2.000.000 kosovarë ofendohen pa pikë arsye dhe këtë e konsideron liri të shprehjes, atëherë po ju them se, reostatin e vlerave e keni të prishur, apo fare nuk e keni.

Pres nga SHEKULLI që në mënyrë publike t'u kërkoj falje Kosovarëve, se këtu ka edhe turq, serb, boshnjak, romë, ashkali, boshnjak, goran, çerkez, hebrenj.

Të dua Shypni.

Kyrie Eleyson

MUNDANE IGNORANT

Nuk ekziston një botë, e cila jeton pa reminiscencat e veta madje edhe ato janë serike. Një Amenhotep e kishte Egjipti dhe një Leonardo Da Vinci, Italia, një Aristofan, Greqia dhe një Niçe e kishte Gjermania.

Aristofani e futi veten mes Eskilit dhe Euripidit tek Bretkocat e tij dhe udhëtimin nëpër Had, ndërsa Niçe mes Apollonikës dhe Dionizianës derisa ky udhëtonte nëpër ferrin e vetë.

Pastaj një Viliem Blejk në Perëndim dhe Një Kahlil Gibran në Lindje, një Buda në Lindje në kërkim të balancit dhe një Aristotel në Perendim, një Muhamed në Lindje, një konstantin Brankusi në Perendim dhe një NUN në mes me moton MENDIMET MË SHKOJNË NË PAKUFI E ÇDOHERË MBETEM NË MES.

Nuk është krejt e rastit pse SHUMËSI E PADUKSHME dekorohet apo thënë më saktë reflektohet piktura ONE e Xhekson Pollokut. Kur në një EXPO njëri e komentoi këtë pikturë… Kjo pikturë nuk ka as fillim e as mbarim…(duke e e komentuar këtë si dobësi), Polloku u përgjigj …Unë do të jem mëse i lumtur nëse e kam arritur që piktura ime të mos këtë as fillim e as mbarim. Një komunikim tjetër që i shkon në tributë kësaj, është biseda e një Mullai me Sufiun e njohur RUMI:… a je ti Rumiu, i cili ka thënë se muzika është kërcëllima e hapjes së derës së Parajsore?…Rumi u përgjigj …Po

…Për mua është tingulli i derës së Fërrit …-tha Mullai, ndërsa Rumi iu drejtua:

…Unë po e ndjej kur porta hapet, kurse ti po e ndjen kur ajo mbyllet.

Njëlloj, si Vivien Vestvud nuk gjen art në një prodigy si Aleksander Mekuin në krecionet e tij të modës.

Nga i gjithë ky muahbet vërehet se, po flitet për Supertemporalitetin dhe po ashtu nuk është e rastit që Fahredin Shehu në SHUMËSI E PADUKSHME foli edhe për Supertemporalitetin në një libër që nuk ka brum letrar. E mos të flasim për NEKTARINA, e cila pëlcet nga origjinaliteti sikur lëkura e shegës së pjekur e Martin Camajt dhe si pëlcet folikuli i grafit, ashtu si në mënyrë më lucide ma spjegoi Boshkoviqi në Anatominë e tij, atëherë kur kisha vetëm trimbëdhjet vjet, kur nuk më dilte bol leximi i anatomisë së klasës së shtatë, mua ende MUNDANE IGNORANT.

Në vitin 1999 e përfundova ELEMENTAL 99 një libër me tregime, kam shkruar…MANI I PJEKUR BIE VET…Unë mbeta gjallë nga lufta e tmershme dhe kuptova se, ende nuk u poqa si mani. Tani kur më shkohet ne gjum, duke kultivuar iluzionin se jam pjekur, më vërtitet në gjuhë, mendje dhe shpirt motoja e SARMOUNI-ve"...amal misazad yak zaati shirin/ puna prodhon esencë të ëmbël". Dhe e sjell si rrathet tibetane duke e mbajtur të gjallë një botë të quajtur NUN. Prandaj anonimi i shenjtë e kishte të drejtë kur tha: "**Religjioni është për njerëzit, të cilët i kanë frikë ferrit, ndërsa Urtësia është për atë që kaluan nëpër ferr**".

Për të kaluar nëpër ferrin, i cili i ka shpaluar vellot e armaçit të zezë tek ne, doemos vetëm duhet ta shoh si një dizajner i entitetit psikomorf. Njëfarë kërkimi për të arritur maspari shkallën e Homo Quadratus, mesjetar dhe medituesit dinamik të Osho-s, e pastaj ta shtrydh në torkullin diellor. Mushti, i cili më vonë do të kaloj në surfuzion dhe kristal letrar. NUN-i flet për kristalin letrar kosovar e jo për një brum, të cilin kot e kërkon shkrimtari ynë.

Ndërsa NUN jam UNË (Ego) fuqi kosmike me dy simbole e gjysmë. Manifestimi nukleik kosmik i cifruar për MUNDANE IGNORANT dhe për të ftohurit, të cilët me hundë të flamosur natyrisht, që nuk mund ta erandin parfumin e trëndafilit të bardhë.

Korrik 2006

OMOFAGIA JONË

o ju që m'i knoni bejtet e mia
koft i knaqun i Madhnushmi
se koha nuk ju shkon kot
e melekët ju bajn hije

Prap ra zari n'sofrën teme e po vazhdoj këtë sohbet që e pata nis për dashni e cilla njiher kur t'mësohet zahmet asht m'u ç'mësue.

Krejt ket vakt e shfrytzova me vujet prej vajeve t'insanit, i cilli nuk po e merr vesh guhën e dashnisë. Shpesh pyetjeve tona xhevapin s'un ia gjeja. Allahile po kini nge me ndigjue dërdëllisjet e t'dështumëve e s'po kini vakt me u kthy kah kibla e vet, kah zemra e vet? A hiq s'po ju dhimbset zemra e juaj të cillën e ka kapuar hërxha.

I pata dhan disa nasihate ma herët, por hiq s'po di sa kanë tingllue në veshët tuaj. Më dëgjoni madje njeherë, ke nji shkrim qi e pata bo ma herët dhe s'po di sa ka bo punë ai shkrim.

KUR FJALËN TEME VËTH NË VESH S'E VË
NË TË ÇORTOJ, RRI URTË, MOS NXIR ZË

Thuhet në Gjylistan të Saadi Shirazit

Dhe u pata betu se kom me ju tregue krejt çka baballarët nuk ju kanë tregue, nuk ju kanë tregue as mësuesit, as priftat, as hoxhallarët. Sa mirë asht me kon i ri e mos me e shikue botën me sy. Dikur asht knue

Qeshu rini qeshu bota asht e jote

Un po ju thom Çohu rini, çohu se botën po ta vjedhin, e tevona mos t'bohet s'kena ditë, s'kena pa, s'kena ndi, çohu rini, cohu se botën po ta vjerdhin, mos po bohet vajto rini, vajto se botën ta kanë vjedh a 'jeni tue e ndi erën e mykut a naftaline, n'letërsinë tonë, a s'jeni tue i pa hajal n'vend t'insanit, a s'jeni tue e dëgjue zanin e vjedhun q'ui ban zhurmë n'Kosovë, a s'jeni tue e pa xhepin bosh, kur e qet dorën n' to, e prek komën, a s'jeni tue e pa gjijtë e nanave nuk kanë tamël për evladët e tyne, a s'jeni tue e pa ushtrin pa silah, mësusin pa nxans, nxansa pa libra, gra pa burra n'dyshek, njerz me ma shum gishta n'kom e n'dor sa sa libra që i kan lexue, a s'jeni tue e pa hanën plot e zemrën bosh prej dashnie, a s'jeni tue e ndi ezanin e xhamia bosh, a s'jeni tue e ndi kumonën e kisha e plotë me muzikantë e daullxhi, a s'jeni tue gjet vetën n'krejt kët pisllëk apo jeni mësue me to dhe tani po ju vjen hosh?

Mos thuni tevona Fahredin Shehun s'pe marrim vesh se, po shkrun për marsovca, dhe po mundohet me e qit shpirtin n'letër. Migjen Kelmendi asht belaxhi dhe po shtin fitne, Mehmet Kraja ka gjyzllëk t'zi dhe sheh veç zi, kurse Kadareja dhe Qosja po folin pa lidhje.

Lidheni kapak pash nderën se dikush asht kah ja u vjedh botën. Çohu rini, çohu se, botën po ta vjerdhin, shumë von e paskom kuptue sa e paskam drejt.

Por edhe nëse folni, folni si duhet, si burrat, ka boll ujë tevona gjuhën me e shpërla e me marr tahret, se nuk asht njajt si me e than fjalën mjalt si me e shijue ate, se kur e kan pyt Rumin, çka asht ashku, ai u përgjegj, Nëse bahesh si unë ke me e kuptue.

Sepse, cilsia e drunit t'djegjes dihet pasi që e kallim ate. Sepse unë muj me durue dhe e di me e bo kët, unë muj edhe me shujt

dhe e di me e bo këtë. Bile jam idhnue dhe kam pyet, kush ma vodhi heshtjen?

Jo nuk jan pleqët por jeni ju. Lirisht thoni; nijeti asht i mire por nisa asht e gabume. Ani e di se i njof gabimet e mia dhe i njoh gabimet e jueja, m'nihmoni pra me me i përmirësue.

A e ke pa mashtrimin me sy se, si po e lun rolin e melaqit, a e keni pa dallimin, i cilli hesht si i nemun, a e keni pa hidhnimin e pa za me tërbimin në gjumin dimnor, a e keni pa dashnin të cillës vetëm emnin ia kujtojmë ? ku janë pleqët të cillët dikur jepnin nasihate, pse po shujnë e nuk po u ngrehin veshët dhe nuk I a dhezin shpullë qafe atyne që i kanë lazdrue?

Ni send e di sagllam, se kjo boll ka zgat, ni send e di se rinia asht n'lloq, por edhe ni send e di që është aty po shkëlqen

Xhevahiri edhe në sqoll të bjerë
Është i vyer si ngaherë, kurse
Pluhuri, edhe në qiell të vej
Vleftë do mos gjejë
Nga Gjylistani i Saadi Shirazit

Kush ka sy mundet me pa shkëlqimin dhe po shoh se krejt ata që shohin po e hajnë mishin e njomë të këtij shkëlqimi.

Dikur n'Spanjë u takuan Ibn Rushdi i njioftun si Averoës dhe Ibn Arabi i njoftun si Doctor Maximus. Ibn Rushdi ishte 90 vjeçar, kurse Ibn Arabi 19 vjeçar.

Kur u takuan, njani tha PO e tjetri JO. Pastaj Ibn Rushdi i tha babës së Ibna Arabit; jam shumë i lumtun që po jetoj n'zaman t'ktij djaloshi, Çka unë di, ai sheh.

Kjo ka ndodh n'Spanjë, kjo ka mujt me ndodh n'Kinë, kjo ka mujt me ndodh n'Judea, kjo ka mujt me ndodh n'Egjipt, kjo ka mujt me ndodh n'Angli ja Amerik, por n'Kosovë kurrë nuk ka ndodh dhe kam frikë që s'ka me ndodh kurrë.

Të gjith e dini pse.

Pa dal nga antika e organizimit shoqnor fisnor, pa i ndrrue tabijatet e mushrikëve (pabesimtarëve), pa e ndërpre tavafin rreth

nefsit t'vet, pa e qit kantarin e vetës para se me i mat gjynahet e tjetrit, kjo s'ka me ndodh kurrë.

Dhe krejt kjo çka asht kah na ndodh, asht barrë, të cillën duhet me e durue, sepse s'kena nijet me u ndrrue. Dikush pas neve ka me shkrue qitape t'cillat kanë me i përdor fëmijët e tyne për me i tregue t'keqen, para se me e bo ata vetë, kanë me e perdor si mostër se si nuk duhet me bo, për me e parandalue të keqen dhe zor që kanë me besue se, paska qenë e mundshme nji jetë kësisoji, kanë me u gërdit vetëm prej idesë se me na kanë diçka të përbashkët, si gjakun dhe farën. Ata kanë me thon: unë jam arrë edhe fryt edhe farë.

Duke e pa diellin se po shkëlqen ndryshe, duke e shijue thelbin, e duke fol për Omega 3, dhe duke ditë se hajnë dhe folin për Juglans Regia, demek, arra.

RUNE

Runet kanë disa varianta të shkrimit dhe secila variantë konsiderohet shkrim i fiseve veriore antike germane. Origjina e tyre ka karakter magjik. Sikur tek secili populll i lashtë edhe tek fiset germane, Runet qenë të gravuara në armë stoli, epitafe, dru etj.

Domethënia e tyre ka burim nga rrënja e vjetër germane RU dhe ajo gotike RUNA. Por, e gjithë kjo thuhet se ka prejardhje nga Norvegjia dhe ka domethënien e fjalës magjike, ndërsa prej më se 4000 mbishkrimeve 2500 vinë nga Suedia. Kurse fjala e vjetër germane RUNAR ka dy domethënie njëra d.m.th. FSHEHTËSI ndërsa tjetra PËSHPËRITJE. Kurse shenja e alfabetit runik quhet SIGIL.

Forma e runeve është arkaike dhe drejtvizore, e përshtatshme për t'u gravuar në sipërfaqe të forta, dru, metal, gur etj.

Sipas një legjende zoti VOTAN ose ODIN i shënoi runet e para. Një kohë ai ishte i varur për këmbë në drurin e shenjtë YGGDRASIL ku kaloi nëntë ditë e nëntë net pa ushqim e ujë. Derisa qëndroi kështu, u inspirua dhe i formuloi Runet. Zoti ODIN është mbrojtës i heronjëve dhe zoti suprem i urtësisë mistike. Me anë të runeve ai është mbrojtur prej armiqëve duke i mbajtur në distancë. ODIN-i i përdorte edhe për nekromanci.

Kjo qe interpretimi i legjendës, ndërsa URUNEN ose personat të cilët parashikojnë me rune, thonë se; kanë prejardhje

parahistorike dhe jo vetëm të fiseve germane, por edhe të shkrimeve tjera dhe alfbeteve të Mediteranit si ai Fenikas.

Sipas ENCYCLOPAEDIA BRITANNICA, një autoritet shkencor në, të cilin çdoherë bazohem, thuhet se këto mendime janë të bazuara në bazë raciale dhe politike.

Disa shkenctarë pohojnë se, alfabeti grek i shek. VI para Krishtit është prototip i runeve. Disa shkenctarë tjerë eminent, thonë se alfabeti latin është burim për rune.

Teoria e pranueshme sipas autoriteteve të ENCYCLOPAEDIA BRITANNICA dhe që, është e përkrahur nga shumë shkenctarë eminent është se, runet derivojnë nga alfabeti verior Etrur. Në këtë rast kuptojmë se vinë nga shekulli II para Krishtit ose pakëz më vonë.

Alfabeti Etrur ishte lidhje në mes alfabetit grek dhe atij latin. Shumica e emrave për germa si, a, be, ce, de, për latinët sikur edhe alpha, beta, gama, për grekët janë huazuar nga etrurët përfundon ENCYCLOPAEDIA BRITANNICA.

Në provincën Gotland të Suedisë është gjetur një nga gurët më të vjetër, i cili daton që nga shek V dhe është i njohur si KYLVER STONE.

Në vitet 1900 deri 1933, interpretimet magjike të runeve qenë të adaptuara nga okultistët Gjerman çka këto rune i identifikuan me nacionalizëm. Shefat e grupit të ashpër antisemit të themeluar më 1912 emrat e tyre i shkruan të cifruara në rune.

Sistemet NEW AGE tani runet i përdorin për divinacion dhe meditim.

Shumica e arkeologëvebesojnë se shoqëritë e evropës Veriore runet i përdornin për magji dhe komunikime profane si epitafe, shenja të pronësisë, emrat, mesazhe të shkurta e deri te grafitet.

Vikingët i përdornin më së shumëti për epitafe, gurë memorial për të vdekur. Në disa vende runet konsideroheshin pagane (aty ku krishterimi ishte i plotfuqishëm), ndërsa në disa vende ishin të bekuara nga kasha. Në Anglinë Anglo-Saxone (shek V), për shembull, gurët memorial me rune filluan të manifestohen vetëm në kohërat krishtere.

Përdorimi

Runet varirojnë në formë dhe numër. Alfabeti german bazë për përdorim të suksesshëm përmban 24 plus një të zbrazët. Në fillim të shekullit IX në Northumbria dhe Anglo-Saxonët e rritën numrin në 33, ndërsa Vikingët e zvogluan në 16.

Deshifrimi i runeve është shumë i vështirë. Runologët e parë çdogjë që, nuk mund ta deshifronin e konsideronin magjike, sepse siç është veç e njohur rune do të thotë: FSHEHTËSI E PËSHPËRITUR ose MISTER.

Sikurse alfabeti latin edhe alfabeti runik, në fillim është përdorur kundër demonëve dhe nuk ka dyshim thonë runologët se, ato e kishin atë fuqi dhe fshehtësi, sepse ishin sekrete për shkak se vetëm një numër tepër i vogël njerëzish të shkathtë dinin t'i punojnë dhe kuptojnë ato.

Secila rune e ka emrin e vet kuptimplot, formë dhe tingull origjinal. Ishin të inkorporuara në poezi, inspirime dhe divinacion por kurrë nuk u zhvilluan deri nivel të gjuhës.

Përdoreshin për nevoja të ndryshme si ato sakrale e deri tek më praktike profane.

Çdoherë patën funkcionin e ritualit dhe u aplikuan për parashikime, evokim të fuqive më të ngritura, të cilat mund të ndikojnë në jetat dhe fatet e

njerëzve. Ekzistonin të yshtura runike që ndikonin në ndrrimin e motit, batica dhe zbatica, të korrura, dashuri, shërime, pëlleshmëri, lindje dhe vdekje.

Runet ishin të punuara në amulete, kupa për pije, shigjeta luftarake, patundshmëri dhe anije.

Përmentalitetin antik gurët, degët dhe çdogjë natyrore ishin të gjallë dhe si të tillë, ruajnë sekretin jetësor prandaj vendosja e runeve në to kishte efekt.Kësaj i shtoheshin edhe pigmentet e ndryshme e deri tek sekretet nga trupi i njeriut për ta fuqizuar dhe ngritur efektin.

Anastasia Blechschmidt, runologe, e cila i përdor runet për njëzete pesë vjet me rradhë thotë:" Runet janë mjet për t'i kuptu-

ar pyetjet jetësore. Runet nuk parashohin ardhmërinë, por bëjnë lidhje me hyjnoren dhe fuqitë tona të ndërdijes"


Disa nga tipet e runeve të përdorura nëpër histori

Janë një mori alfabetesh Runikedisa prej, të cilave do t'i prezentoj:

- Futhark i lashtë
- Runet gotike
- Futhark Anglo-Sakson
- Futhark i ri
- Székely Rovásírás Runet hungareze
- Orkhon - Runet turke
- Cirth (alfabeti i ngjashëm me rune nga Tolkien)

Futhark i lashtë


Futhark i lashtë mendohet se, është versioni më i lashtë i alfabetiti Runik dhe qe përdorur nga pjesët e Evropës të banuara nga fiset Germane, duke përfshirë Skandinavinë. Supozohet se versionet tjera janë zhvilluar nga ky tip i lashtë



Anglo-Saxon Futhark

Një numër i konsiderueshën i germave ishin të shtuara alfabetit Runik për ta shkruar Anglo-Saxon/Old English ose anglishten e vjetër anglo-saksone. Runet qenë të sjellura në Britani në shekullin V nga Anglezët, Saxonët, Jutët dhe Frisianët

(bashkarisht të njohur si Anglo-Saxons), dhe u përdorën deri në shekullin XI.



Futhark i ri

Futhark i ri ose " Runet Normale ", gradualisht të evoluara nga Futhark i lashtë për një periudhë të konsiderueshme kohore deri 800 pas Krishtit, fillimi i periudhës Vikinge. Ishte alfabeti kryesor në Norvegji, Suedi dheDanimarkë, gjatë periudhës vi-

kinge, por qe i zëvendësuar me alfabetin latin kah viti 1200, si rezultat i krishterizimit të Skandinavisë.

Më poshtë i prezentojmë tri versione të ndryshme të alfabetiti të zhvilluar në Danimarkë, Suedi dhe Norvegji.

Futhark Danez



Suedezo -Norvegjez/ Degë-shkurt / Rök Rune




Futhark Norvegjez




Futhark Mesjetar (I latinizuar)

Pas kristianizimit të Skandinavisë, alfabeti Runik ishte latinizuar dhe ishte përdorur më së shumëti për dekorime deri më 1850.



Alfabeti ogham




ALFABETI ETRUR

Alfabeti Arkaik Etruskan (VII-V para Krishtit)



Alfabeti Neo-Etruskan (shekulli IV-III para Krishtit)



Alfabeti i Elbasanit



CREDENDO VIDES

Fillimi i Vitit të Ri nuk e di, sa do të ndikoj me pompezitetin e vetë në tërë këtë tollovi në këtë qytet, që mezi është.

Iljazin, profesore takova të dëshpëruar, se nuk e gjeti kioskun e hapur për ta marr shtypin, por skajshmërisht të lumtur më buzëqeshje vetanake, se më sheh dhe empatikisht e ndajmë dëshprimin e njejtë.

Ndjej, se njerëzit këtu, veç e kanë kuptuar, se distanca e krijuar dhe komunikimi i zorshëm me mua si medium, nuk u shkon për dore. E si mundet kur na ndajnë eone evolucioni në sferën shpirtërore. Ata po ashtu e kuptojnë, se një zog me krih të lënduar nga vetë ata, është shëruar dhe u fluturoi si pelegrini me mendje të kthimit. E ku ta di metamorfozat në vazhdim në çka mund të më metamorfozojnë.

A jam dritë e njëjtë kur e ndrroj ngjyrën nëpër prizmë tënd, haber nuk kam, prandaj përgjigjes i them lamtumirën e merituar.

Tundimet e reja vijnë njëpasnjë dhe është hera e infinittë, që jam pishman se u bëra njeri. Tash më kujtohet se mua askush nuk më pyeti prandaj edhe këtë duhet ta duroj.

Njëri nga tundimet e fundit është edhe biseda me Gallatën një mik të ri SUFI nga Amerika. Gallata në vete ruan frymën e kërkuesit apo më të njohur, hebreu endës, dervish ravgues, endacakun e Kahlil Gibranit apo Shën Gjergjin pagan. Duke i tejkaluar të gjitha këto emërtime Djali i Salvador Dalit (Geopoliticus Child), vërtet dëshmon një qasje të re të ngrohtësisë

globale, të rezatimit të Caritasit global. Bota është një vazhdojmë ta përsërisim mantrën e të urtëve të vërtetë.

Gallata dëshiron ta demonstroj daljen e shpirtit nga trupi kur vibrohet emri me i madh i Perendisë. Për mua është akoma EL-HAMDULLILAH dhe ky dua që të pushoj në zemër dhe ta shuaj etjen vulkanike të saj. Unë isha ai fakir kur gëzohesha, kur kënaqesha duke shikuar dy maca duke kërcyer nga muri në mur, e zemra ime digjej në prush, si këmbët e fakirit, ndërsa shpirti i tërë në halle të rënda me pyetjen e Shekspirit "të jem apo të mos jem". Ishte luftë iu kujtohet ndoshta viti 1999, kur NATO e bombardonte Serbinë, ndërsa Serbia neve gjakun na e shtrydhte.

Miku im Gallata,, dëshiron këtë ta kuptoj derisa unë dua t'i them, që shijen e dardhës e di vetëm ai që është nën dardhë. E kam fjalën për kënaqësinë e njohjes. Kështu më thonë ata, të cilët lirojnë parfumin e trëndafilit të bardhë. Vërtet tek vonëkuptova kur çelën lulet e kajsive dhe të kumbullave të egra. Unë atëbotë klitha: Kjo është koha e frymëzimit. Kjo është aromë origjinale dhe asnjë bimë nuk e ka këtë aromë. Ishte kjo të kuptuarit e vetëm një pjese të realitetit. Zoti nuk luan boxhoz tha Anjshtanji; Zoti krijon, ne veprojmë them unë, sërish.

Me Gallatën akoma nuk jemi takuar, ndërsa komunikimi ynë, veç e ka marr hovin e rërës nga klepsidra dhe derdhet me mendje të përsëritjes deri në destinacion tjetër. Ai me siguri do të jetë jashtë këtij dimensioni të zakonshëm.

Fahredin Shehu po vazhdon ta shtrydh rrushin e dielltë në torkullin kosmik dhe kokrrat e para veç janë pjekur në Tamara. Tamara prap po vazhdon jetën e saj përtej pragut të ylbertë, ndërsa këtu kohëpaskohe, reflekton bukurinë e saj, të buzëqeshur, prore. Ka kohë që po e lus Fahredin Shehun ta gatuaj këtë verë, ta pimë mushtin e shtrydhur nga torkulli kosmik, por ai përsërit CREDENDO VIDES (kush beson, sheh) dhe kalon heshtshim, duke pritur stinën e vetë, si NEKTARINA, të piqet zemrat të na i zbut.

IMBROGLIO

Sot evokoj kujtimet, si shpirtërat e padukshëm të sferave kosmike për kohërat, që kalonin së bashku me këngën e Swami Govindës …"Çdogjë është melodi", e dëgjuam ne këtë apo jo?

Ishte viti 1988 kur nje mik, Bekim Hoxha nga parku botanik i Zagrebit, ma solli një filizë Ginko. Atëbotë mësoja mjeshtrinë e fitoterapisë, marrëzisht lexoja, Jeta e fshehtë e bimëve- nga Peter Tompkins dhe Christopher Bird, mjekësinë tradicionale tibetane, së bashku me Librin Tibetan të të vdekurve, edicioni i Lamës Namkhai Norbu, i cili ligjëroi për Bhardo Thodrol në Institutin Universitar të Orientalistikës në Napoli të Italisë, pastaj sistemin Vatha, Pitha dhe Kapha të Ayurvedës Induse, farmakopenë tradicionale kineze të Li She Chen-it, për Zojën e Megjugories dhe Sai Babën, për Sri Qinmoy dhe produktivitetin astronomik artistik të tij, për Zen tregimet në edicionin e Vladislav Bajac, Budizmin e Çedomil Veljaçiqit dhe diskurset e Meher Babës, Rrugën e katërt- të Gurdijjeffit dhe Fragmentet e mësimit të panjohur- të Ouspensky-t, Simbolikën e Kryqit- të Rene Guenonit dhe Shamanizmin- e Mircea Eliades, I Ching në përkthim të Richard Wilhem dhe Teozofinë e Madam Blawatsky-t, e Rudolf Steiner-it, Hermetizmin- e Franz Bardonit dhe De Occulta Philosophia- të Agrippa Von Netesheim, Njeriu dhe simbolet e tij- nga Karl Gustav Jung dhe Kultin e Dagonit nga Lovecraft etj. etj. etj.

Zbulova se Gynko (Gynko Biloba) japonisht, Kajsi e argjendtë, është bimë, e cila i përjetoi pisllëqet njerëzore të shekullit XX, bombën atomike në Hiroshima dheështë bima, e cila daton, që nga periudha gjeologjike e akullit. Për ndikimin mjekësor mos të flas, më me rëndësi është, që e rrit kapacitetin e memories, nëse përgatitët si çaj dhe në atë kohë KRKA e Sllovenisë përpunoi kapsula BILOBIL për kurrimin e sëmundjeve të trurit. Gjethet e Ginkos janë të gjelbërta dhe të freskëta dhe ka nervaturë dikotomike, që është karakteristikë e lashtësisë evolutive të saj dhe që, e dallon nga gjethet tjera. Prandaj nuk është e rastit, se në kopertinën e NUN-it, librit tim të parë me poezi është gjethi i Ginkos me vesë gjithnjë i freskët dhe germa arabe NUN, e cila është ajeti i parë i Sures Kalem (pendë) dhe është symbol i diturisë dhe sipas Xhefr sistemit (sistemi numerologjik arab i germave, i cili ndikoi në zhvillimin e sistemit numerologjik hebrej të kultivuar nga Kabalistët), e ka vlerën numerike 50 dhe po aq poezi i ka edhe përmbledhja poetike NUN.

Ata, të cilët nuk e kanë lexuar NUN-in dha ata, të cilët këtë e kanë, ndoshta nuk e dinë këtë fakt. Të gjithë këta të nderuar zatën e dijnë se ndodhemi për të satën herë në një situatë, të cilës prapë, emrin dot nuk ia gjejmë.

Ramazani edhe Bajrami ikën dhe sërish gjej myslimanët, të cilët shumë pak japin dashuri jo vetëm për jomyslimanë, por edhe mes veti. Ndoshta frikohen për vetveten, se nuk do t'u mbetet asgjë, dhe nuk kanë kohë as të mendojnë e lere më t'iu japin dashurinë të tjerëve. Kështu i kanë frikësuar hoxhallarët, të cilët në hytbe u flasin atyre vetëm për flakën e xhehenemit dhe për zukatin, që duhet dhënë. Pastaj shpesh citojnë ajetin e Kur'anit …Zoti nuk do ta ndryshoj gjendjen e një populli, derisa ai popull nuk e ndryshon veten.

Sa kemi ndryshuar dhe si kemi ndryshuar?

Është paradoksale se si Bashkësia Islame e Maqedonisë nuk gjen një vend për një doktor shkencash, derisa Akademia e Shkencës e Maqedonisë e bënë këtë.

Tash unë pyes; kush kujt i është armik? E djali, fjalën e kam për Numan Jusuf, ka doktoruar në Aspektin edukativ të veprës së Ibn Rushdit ose më i njohur në botën perendimore si Averroës. Ibn Rushd ishtë përkthyes dhe komentues i Aristotelit dhe Platonit. Falë këtij, Aristoteli është ruajtur për periudhën sipas Oswald Spengler-it, Faustiane, sepse nga arabishtja janë përkthyer në latinisht dhe tani ne i lexojmë në shumë gjuhë të botës.

Edhe një paradoks tjetër është se Numani miku im, më tregoi që shkrimet e Averoës-it (Ibn Rushd-it) i paska gjetur vetëm e vetëm tek njëfarë Musa (Kopt-egjiptian i krishterë) dhe se në Universitetin e famshëm të Kajros, Al Azhar nuk gjeti asgjë nga shkrimet e Ibn Rushd-it. Dhe jo vetëm në Al-Azhar, por askund tjetër.

Për çfarë Homo Sapiens mund të flasim. Ndoshta vetëm për Homo Amoralis.

I gjithë ky kompozicion ndodhish, na sjell para vetit një manifestim civilizues si një Imbroglio i një shfaqjeje teatrale e përsëritshme. Alen Ginsberg flet për kokëpulën, Kahlil Gibran flet për vrasësin e Giordano Brunos dhe Imam Aliut, ndërsa ne heshtim për vrasësit e potencialit tonë intelektual. Nuk është ky Imbroglio një manifestim, një fenomen i papreshedencë, as është katharsis i epitelit të oksiduar të indit civilizues. Çka mund të thuhet pas kësaj?

SEMAJA, SEMAZENI, VALLJA RITUALE, EZOTERIZMI DHE ARTI I RUMIUT

Vepra e Xhelaluddin Rumiut, paraqet akt kreativ dhe më shumë se kaq, udhë për njohje dhe më shumë se njohje, art dhe me shumë se art, andaj vetëm ballafaqimi sipërfaqësor me gjithë teurgjinë e tij, nuk do të mjaftonte dhe për ketë, ai vetë e argumenton me metaforën e shkumës dhe oqeanit, apo me thenien...mos pyet kush jam dhe nga vi, por më mirë merr atë që kam në duar...dhe vertetë atë që ai ka në duar paraqet gjurmën më të manifestueshme të vulave engjëllore, ose materializimin e qiellores në tokësoren.

Akti i Semasë si përpjekje e hyrjes në orbitën engjëllore, do të merr një pjesë bukur të madhe të këtij punimi.

Semazeni, domethënia, roli dhe performansa e semasë- valles rituale , si dhe muzika si pjesë komplementare e semasë.

Tre nivele të njohjes; Egsoteria, Mesoteria dhe Esoteria në veprën e Rrumiut si dhe dinamika e meditimit si kontrapunkt, si kategori e katërt, e plotësisë së Fenomenit RUMI, dhe si kategori e tretë e Estetikës së Fahredin Shehut.

Kategorizimi i tij në radhën e gjenive parashtron pyetjen; a i takon ai kësaj kategorie? Radhitja e tij ne rreshtin e profetëve, prapë nuk e arrin nivelin e tyre dhe për këtë do të flas më shumë në pjesën e fundit mbi artin e tij.

Semaja

Është fjalë arabe, që e ka kuptimin e dëgjimit, shqyrtimit; dhe ka përdorim të gjerë në gjuhët persiane dhe turke, por edhe në gjuhët tjera perëndimore, që e identifikojnë si praktikë SUFI per se, për t'ureferuar valles rituale të zhvilluar nga Xhelaludin Rumi[4].

Semaja është Meditim Dinamik[5] par excellence, si koncept i zhvilluar nga Sri Bhagwan Rajneesh- OSHO, dhe pikërisht ky i fundit e inkorporoi në programin e rregullt të meditimit të mëngjesit, në "OSHO Commune", në Poona, Indi. Poashtu edhe G.I Gurdijeff6, është inspiruar nga Rumiu me vallëzimin sakral të tij të njohur si "Qarqet Oum"

Kur flasim për meditimin,, para se gjithash aludojmë në mendimin e thellë gjë që është në kundërshtim të meditimit si praktikë. Meditimi është gjendje mentale pa-mendim dhe klimaksi në meditim arrihet, kur shuhen të gjitha mendimet. Kështu që, Semaja është mjet shumë i përshtatshëm për ta arritur atë gjendje të pa-mendimit.

Këtu kemi të bëjmë më zhvillimin e inteligjencës intuitive, andaj instrumenti në këtë praktikë, i cili përdoret për ta sofistikuar këtë teknikë është arti muzikor, i cili nxit qendrat energjetike, në Tesavvuf të njohura si Lataif[7], deri në shkallë të Fanasë, apo tretjes në esencën e Perëndisë. Rumi i kushton një poezi të tërë në kuadër të Mesnevisë së tij, kallamit, Ney-it, i cili përdoret për t'i zgjuarkëto qendra energjetike, të cilat janë po ashtu prezentë në traditat esoterike të Kaballës hebreje, traditës Kineze dhe Vedës Hinduse.

---

4 I lindur në Balkh të Persisë tani Afganistan më 30 shtator, 1207– 17 dhjetor, 1273

5 Meditimi Dinamik është koncept i teknikës meditative të zhvilluar dhe parkatikuar nga Sri Bhagwan Rajneesh-OSHO, (11 dhjetor, 1931- 19 janar, 1990)

6 Georgije Ivanovich Gurdijeff, Neognostik bashkëkohor Armen, i lindur ne Aleksandropol 13 janar 1866-tetor 1949

7 Latifat-an-Nafsi, Latifat-Al-Qalbi, Latifat- ar- Ruhi, Latifat-as Sirri, Latifat- al Khafi, Latifat-al- Akhfa; të derivuara nga Kur'ani nga: Nafs, Kalb, Sirr, Khafi dhe Akhfa, reprezentojnë organe psikospirituale, ose aftësi suprasenzuale apo suprasenzibile.

Krahas veshmbathjes së caktuar, muzikës dhe gatishmërisë së të inicuarëve, gjatë semasë edhe parfumi[8], luan rolin e rëndësishëm, i cili po ashtu ndikon në gjendjen psikofizike të njeriut.

Simbolika e semasë-valles rituale- çdo moment dhe çdo element i Semasë, ai koncert shpirtëror, përmban simbolikë[9]. Semaja është manifestim i lëvizjes së trupave qiellor, ku Shejhu, ose udhëheqësi i Semasë, mentori; simbolizon diellin ose aksin e sistemit dinamik të Galaktikës, kurse dervishët, të iniciuarit, në lëvizje rrethore, simbolizojnë planetët, pra kemi të bëjmë me një valle kozmike, për unifikim me kozmosin.

Koka e Semazenit10, mbështetet në 23˚, njëlloj si aksi i planetit të Tokës, dhe kjo ndihmon që lëngu i veshit të mos tundet e të humbet baraspesha. Një këmbë mbahet në lidhje me tokën, me gravitetin, dhe vija vertikale e padukshme, nga veshi deri te këmba, e mban fort semazenin, që të mos bjerë.

Pastaj edhe duart e kanë funksionin e vetë; ku shuplakat janë të kthyera njëra kah toka e tjetra kah qielli. Njëra është për diellin e tjetra për hënën dhe e gjithë kjo e përcjellur me muzikë të kompozuar enkas për Sema, shpeshherë e shoqëruar me vokale. Kjo muzikë nuk është qëllim por mjet-Lift për kapërcim nga një gjendje që ne e cilësojmë si normale në një gjendje të ekzaltuar mentale.

Rumiu11 për Semanë thotë:
Shoh ujërat që vrushkullojnë nga gurrat e tyre
Degët, lisat që vallëzojnë si penduesit
Gjethet që me duar rrahin si muzikantë
(Mathnawi, IV, 3265-3268)

8 Në këtë rast parfumi i Jaseminit, esenca e preferuar e Xhelaludinm Rumiut dhe Hz. Isas a.s.

9 Shih; Rumi i Sufizam, nga Eve De Vitray Meyerovitch, Kaderjsko Bedevijska Tekija, Sarajevo, 1995, faqe 43

10 I inicuari i cili bën Semanë

11 Shih; Rumi i Sufizam, nga Eve De Vitray Meyerovitch, Kaderjsko Bedevijska Tekija, Sarajevo, 1995, faqe 44

Kurse për lëvizjen[12] thotë:
Gjithçka lëviz
Të dashuruarit bien në përroin e dashurisë
Në përroin më ujë hyjnie
Që kanë zgjedhur

Dhe qajnë
Dhe rënkojnë
E si gurë mulliri në qiell
Dhe s'rijnë dot një çast të heshtur

Dashuri ...
Dashuri ...
Ti ke mbushur universin me furtunë.

Zemra ime për natë kërkon një yll
Ta bëj të mos pushoj një çast
Si unë.

Semaja zhvillohet me semazenë të veshur me të bardha, që simbolizon mbulesën, Qefinin e kufomave. Ata janë mbuluar edhe me një kaftan të zi dhe të gjerë, të cilat paraqesin varrin, kurse në kokë mbajnë kapela- Sikke, të larta nga qoha (leshi i përpunuar), që simbolizojnë gurin e varrit. Shejhu hyn në mes dhe është lidhja mes tokës dhe qiellit. Semazenët pasojnë duke formuar tri rrathë (hallka), në Semahane (vendi ku zhvillohet Semaja), që simbolizojnë tre etapa të afrimit me Zotin; etapa e diturisë, etapa e zbulimit (keshf) dhe më në fund etapa e unifikimit (Vusul) duke u përshëndetur me Shejhun në mes, i cili qëndron në tepihun e kuq. Semazenët e flakin kaftanin e zi duke e larguar kështu shtresën trupore të vdekshme për t'u rilindur. Ata nga Shejhu kërkojnë lejen për nisjen e Semasë, e pastaj ngadalë fillojnë t'i hapin duart si krahë në fillim me lëvizje rre-

12 Molana Xhelaludin Mohamed Molavi RUMI, Mbrëmë i pështpërita një ylli…, Fondacioni Saadi Shirazi, Tiranë, 2002, faqe 35

thore të ngadalshme gjithnjë duke i shpejtuar. Dora e djathtë e pranon energjinë kozmike-mëshirën kurse e majta e kthyer kah toka për ta dhuruar këtë mëshirë, e cila ka kaluar nëpër zemrat e tyre d.m.th. pasi që, e kanë ngrohur me dashurinë e tyre.

E gjithë kjo, është e përcjellur me muzikë në fillim të me Kudum- daulle, që janë simbol i burisë së ditës së Gjykimit dhe me Ney. Hallka është formuar me dy gjysmë harqe ku njëra përfaqëson mbylljen e shpirtit në pranga të materies, kurse tjetra harkun e ngritjes kah Zoti. Pas rrotullimit të katërt valles i bashkëngjitet edhe Shejhu. Semaja simbolizon sistemin planetar, ku Shejhu është dielli, kurse semazenët janë planetët. Kur Shejhu nis të bëj Semanë fillon muzika e Ney- it që paraqet finalizimin e unifikimit. Kur Shejhu kthehet në vendin e vetë, Semaja ndërpritet dhe nis këndimi i Kur'anit, si përgjigje e Zotit për Semazenët. Më në fund është përshëndetja dhe përmendja e Zotit "HU", sepse vetëm Atij i drejtohet ky adhurim.

Për melodinë e Ney- it Rumi thotë; E kam pyetur Ney- in përse qan, kurse Ney- i u përgjigj se, e kanë ndarë nga Neyistani ashtu që, nuk mund të jetoj pa qarë dhe pa klithur.

Qëllimi i Semasë, është arritja e unifikimit me Zotin (Vusul), nëpërmjet përkushtimit të thellë.

Semazeni

Është personi, i cili e ekzekuton apo praktikon Semanë, si teknikë mjaftë të ndërlikuar. Qëllimi i Semazenit është që, nëpërmjet Shejhut-mentorit kah, i cili orientohet, të arrijë unifikimin me Perëndinë. Lidhja apo raporti Murid13 dhe Murshid14, është e bazuar në përkushtim të plotë, dorëzim të plotë i cili e udhëheq një Murid 1001 netë në Tarikatin Mevlevi (me qëllim të përpunimit të egos deri tek shuarja e tij pas arritjes),

13 Nxënës, dervish, i inicuar apo në Radhën Dervishe të Mevlevinjëve të themeluar nga Rumiu, Semazen

14 Mësuesi, Mentori apo Shejhu, i cili udhëheq Semanë dhe shkollën e psikologjisë personale, Tarikatin.

para inicimit të mirëfilltë, i cili duhet të shërbej të gjithëve që janë në tekke, duke kryer punët nga më të ndryshmet.

Pastaj në praktikën e Semasë, Muridi duhet plotësisht t'i nënshtrohet urdhrave të Murshidit sepse ky e njeh nivelin shpirtëror dhe afinitetin e Muridit, andaj më së miri di ta udhëheq në këtë rrugë jo edhe aq të lehtë. Murshidi e udhëzon në të gjitha hapat e zhvillimit shpirtëror, sepse këtu kemi të bëjmë me një shkollë të veçantë të sofistikimit shpirtëror, me psikologji personale.

Tri nivele të njohjes; Egsoteria, Mesoteria dhe Esoteria[15]

Para se të hyjmë në veprën e Rumiut, do të ndalemi në spjegimin e shkurtë të tre kategorive epistemologjike, gnoseologjike apo në Islam kategori të Irfanit; Egsoteria, Mesoteria dhe Esoteria, respektivisht grupe njerëzish, që kategorizohen në këto lloje dijesh si *Ahl i Zahir*, *Ahl i Batin* dhe *Ahl i Keshf*. Gjuha me, të cilën ka folur Rumiu16 në veprat e tija dhe jo vetëm ai, por edhe Muhyuddin Ibn Arabi, Ibn Al Farid, Yunus Emre etj., e posaçërisht e Mensur Hallaxhit, ka qenë gjuha e niveleve epistemologjike, e cila shpesh ka hasur në keqkuptime, sikur rasti i Hallaxhit, ai edhe është ndëshkuar për thënien e tij të famshme *Enne el Hakk*- Unë jam E vërteta, Unë jam Zoti, në gjendje të ekzaltuar, kur egoja e tij është shkrirë në esencën e Perendisë (Fana Fillah) që për Zahir (këndvështrimin e Sheriatit) paraqet Shirk (idiolatri, përshkrimi ortak Zotit), ndërsa në gjuhën e Batinit (të të fshehtës), paraqet ndjenjën e arritjes në Fanna(shuarje).

15 Për më shumë shih: Mouravieff, Boris,Gnosis, Exoteric Cycle: Study and Commentaries on the Esoteric Tradition of Eastern Orthodoxy (Vol 1) pastaj; Mouravieff, Boris, Gnosis: The Mesoteric Cycle (Book 2) dhe Mouravieff, Boris, Gnosis Book Three, the Esoteric Cycle: Study and Commentaries on the Esoteric Tradition of Eastern Orthodoxy (Gnosis)

16 Rumiu, ofron poezi për ata që e dojnë poezinë, argëton me rrëfime për ata që i dojnë rrëfimet dhe stimulon Intelektin për ata, që e çmojnë një përvojë të tillë thotë Idries Shah në librin The Way of the Sufi,Arkana, Pengiun Group, 1990, faqe 110.

Vepra e Rumiut shquhet me nivele të kuptimit apo "Oktava", si ishte shprehur; G. I Gurdijjef në veprën "Në kërkim të mrekullisë- Fragmente nga mësimet e panjohura", të Pyotr Damyanovich Ouspensky[17], dhe është e kapshme si për fëmijën duke i lexuar ato si rrëfime, ashtu edhe për një studiues ordiner egzoterik, i cili e studion materien e veprës së Rumiut(niveli i egzoterisë), për ata të frymëzuar me artin letrar, si vepër letrare (niveli mesoterik) dhe për ata që, janë në rrugë Tariqqa, të cilët kërkojnë domethënien e thellë dhe rrugën e rafinimit shpirtëror nëpërmjet Mesnevisë së Rumiut, veçanërisht në vëllimin e saj të tretë dhe të katërt[18] (niveli i ezoterisë). Kështu Rumiu krijon një sintezë të mrekullueshme të kategorive të ndryshme të njohjes dhe praktikës, "Në të Shpirtnia, Racionalizmi dhe Etika universale, kanë gjetur një sintezë të shëndoshë"[19]

Që në fillim të këtij punimi është cekur puna e OSHO-s dhe *Meditimit Dinamik*, i cili kryekëput buron nga teknika e Semasë dhe punës së Rumiut. Këtu Meditimi dinamik që, është koncept bashkëkohor për Semanë, është kontrapunkt në relacion të muzikës, veprimit dhe mosveprimit, respektivisht gjetjes së Zeros Absolute, në qenien e individit. Një kompozicion i tillë simfonik i akteve kreative, paraqet kontrapunkt, i cili e rrumbullakon PUNËN e Rumiut, e përbërë prej:

- aktit të shkrimit artistiko- sakral, transcendental, Terurgjik, (veprimtaria letrare);
- aktit të muzikës sakrale, (koncepti i NEY-it);
- aktit të meditimit (Semaja), dhe;
- përçimit të impulsit kozmik nga qiellorja kah tokësorja, nëpërmjet Ashk-ut (dashurisë), pra, të krejt fenomenit RUMI.

17 I lindur 4 mars 1878- 2 tetor 1947, Matematikan dhe epistemolog rus, nxënës i Gurdijeffit

18 Për më shumë shih në; Matnavi I Ma'navi, Book III & IV, Maulana Jalalu-'d-din Muhammad Rumi, abridged and Translated by E.H. Whinefield, 1898

19 Khalifah, Abdul Hakim, Jalal Al Din Rumi, The History of Muslim Philosophy, Vol. II ed. M.M. Sharif,kapitulli XLII, Pjesa 3, The Sufis, Otto Harrosowitz, Weisbaden 1963, faqe 838

Kur jemi tek impulsi kozmik[20], flas për transformimin e energjisë hyjnore në vijën vertikale, në raportin e tokësor, për mbërritjen në nivelin më të lartë; atë të adeptit, Evlijaut (nga Wali; mik i Zotit), që është një nivel nën Profet dhe shkon nga toka kah qielli, ndërsa në raport me Profetin shkon nga qielli kah toka, dhe bëjmë dallim mes Ilham-it (inspirimit) dhe Ëahj-it (Revelatës, shpalljes, zbulesës), të cilat në Estetikën e NUN-it[21] kategorizohen në nivelet Zanati, Arti,Teurgjia dhe Revelata.

Në këtë mënyrë dinamika në meditim, Semaja, deri tek arritja e pikës Zero absolute me meditimin e heshtur, për ta arritur heshtjen absolute, Zikr-i Hafi[22], Zeron absolute, janë dy skaje respektivisht dy modele të ndryshme të të njëjtit qëllim, sepse Meditim d.m.th. Mos- bërje.

Në disa shkrime të më hershme kam potencuar se...Na mungon *vokabulari tokësor për çështje qiellore*, dhe pikërisht këtë Rumiu e konsumon më së miri nëpërmjet poezisë, e cila jep lirinë për shprehjen e të panjohurës, të të përtejmes, e cila mbërthen në vete misteret e niveleve epistemologjike dhe ato intuitive, të të menduarit lateral23, logjik dhe gnoseologjik.

Arti i Rumiut

Arti i Rumiut ka mbet monumental si për kah përmbajtja ashtu edhe për kah vëllimi dhe esenca. Radhitet ndër poetët më prominent i të gjitha kohërave në fushën e transcendentales, si në Lindje ashtu edhe në Perëndim, e sa i përket Islamit, nuk ka libër të shkruar mbi Sufizmin e mos të zë ndonjë vend të konsiderueshëm edhe vepra e Rumiut, që nga koha e tij e deri më sot dhe do të vazhdoj kështu.

---

20 Meher Baba, Mistik bashkëkohor Indo- Persian (i lindur 25 shkurt 1894 - 31 janar 1969), shih:Discourses, Meher Baba, Sheriar Press, 1995

21 Fahredin Shehu, Estetika e NUN-it, perspektiva e estetikës teurgjike dhe nivelet e krijimtarisë, studim i pabotuar

22 Zikri në heshtje, forma gjenerale e meditimit, si përfaqësues më reprezentativ Nakshibendinjët dhe meditimi i Zen Budizmit.

23 Shih: Lateral Thinking, nga Edward De Bono, Penguin Books, 1990

Veprat e Rumiut[24] janë të begatshme, cilësoredhe unikale dhe kanë qenë e janë të pranuara nëpër të gjitha cepet e botës. Fillimisht janë komente nga baza Kur'anore, e deri tek veprat e Senait, Attarit, Ibn Arabit të shprehura në mënyrë poetike, me një origjinalitet të shquar.

Vepra e tij më e madhe poetike me mbi tridhjetë e gjashtëmijë vargje, është *Diwani Shemsi Tabriz*, kryesisht Gazele ose lirika, ku shpreh relacione të veçanta me Shemsi Tabrizin dhe dashurinë e tyre hyjnore, si dhe roli i Shemsi Tabrizit në krijimin e kësaj vepre gjigante.

Vepra tjetër padyshim më e popullarizuar është vepra voluminoze *Mathnawi- i Ma'nawi*[25], e cila është shkruar vite me radhë; rreth dymbëdhjetë vjet dhe nuk është e përfunduar. Është shkruar me kërkesën e Husamedin Qelebiut dhe përbëhet prej mbi njëzetegjashtë mijë vargje. Vepra ka karakter didaktik, si udhëzim për zhvillimin shpirtëror, që i konsumon edhe rrëfimet tradicionale, për t'i shfrytëzuar ato për nevojat e të iniciuarit. Poeti persian Xhami shkuan se, Mathnawi është Kur'ani në gjuhën Persiane.Mathnawi është përkthyer në shumë gjuhë botërore në Perëndim e bënë të njohur Whinfield, Profesor R. A. Nicholson, A. J. Arberry, Annemarie Schiemmel, Eve De Vitray Meyerovitch, Camille dhe Kabir Helminski, parafrazimet e Coleman Barks26 etj. Në gjuhën boshnjake dy vëllime të para me koment, janë përkthyer nga Fejzullah Haxhibajriq, ndërsa vëllimet tjera janë përkthime nga anglishtja nga përkthimi iE.H. Whinfield.

Vepra e tretë poetike është *Ruba'iyyat*, e cila nuk arriti të popullarizohet si Divani dhe Mathnawi. Sërish publikut Perendimor ja sjell përkthimi i A.J. Arberry.

---

24 Për më gjerë shih; Jalal al Din Rumi, Supreme Persian Poet and Sage, nga Seyyed Hoseein Nasr; botuar nga Këshilli i lartë i Kulturës dhe Artit, Teheran, 1974.

25 Për veprën e Rumiut flet edhe Idries Shah në librin The Way of the Sufi, ribotim, Arkana, Pengiun Group, 1990, faqe 110.

26 Shih; The Illustrated Rumi; A treasury of Wisdom from the Poet of the Soul, përkthimet e reja nga Philip Dunn, Manuela Dunn Mascetti dhe R. A. Nicholson, Harper San Francisco, 2000.

Vepra në prozë *Fihi ma Fihi* është vepër, e cila shfaq diskurset më intime në aspekte të ndryshme të jetës shpirtërore dhe personalitetit të tij, që nuk është prezentë në veprat e tij poetike. Janë ligjëratat e përmbledhura nga i biri i tij dhe Muridët.

Makatib është vepra tjetër në pozë, e cila është përmbledhje e letrave të Rumiut, dërguar miqëve si Salah al Din Zarkub. Këtu zbulohen aspekte të jetës intime të Rumiut

Vepra *Majalis-i sab'ah* është poashtu në prozë, e cila është e përbërë prej predikimeve dhe leksioneve të dhëna në Dergah[27]. Predikimet janë më shumë këshilla dhe dallohen në stil dhe kualifikim në, të cilin janë ligjëruar.

Ndikimi i Rumiut në punën dhe veprën e shumë artistëve është shumë i dukshëm edhe sot dhe jo vetëm në letërsi, studime, prezantime artistike të Semasë, por edhe në muzikë, shërben si frymëzim permanent. Në letërsi ndjehet fort ndikimi i tij tek Muhamed Iqbal dhe Khalil Gibran, në pikturë tek Mahmud Farschian, Esrafil Sirche në kaligrafi, Maurice Bejart në balet, ndërsa në Muzikë, ndikimi i tij është i shumëfishtë,duke filluar nga trashëgimia e kulturës Sufi në Turqi me emrat si: Omar Faruk Tekbilek, Ercan Irmak, Kudsi Erguner, Kani Karaca, Ahmet Ozhan pastaj, në Iran Shahram Nazeri, Shahram Shiva, Muhamed Eghbal, në Izrael; Noa, e deri tek fuzioni i muzikës Sufi me muzikën elektronike të Mercan Dedes[28].

Kur jemi tek Mercan Dede, i cili kryekëput e demonstron inspirimin e tij në veprën e Rumiut, kemi të bëjmë me një talent të jashtëzakonshëm, i cili prezanton artin e tij duke u dëshmuarsi në instrumente folklorike ashtu edhe me ato elektronike duke bërë kështu një unifikim të tradicionales me kontemporanen dhe duke qenë pionier në përpjekjet e tij më fisnike për para se gjithash krijimin e harmonisë në kohën e frikës dhe dhunës në botë dhe në këtë mënyrë duke e promovuar Rumiun tek publiku bashkëkohor Perëndimor ndoshta më shumë se Profesor

27 Vend i izoluar për meditim dhe shërbesat fetare, Tekke

28 DJ Allen Arkin, më i njohur si Mercan Dede, kompozitor, producent dhe multi-instrumentist turk. Më shumë për të në http://www.mercandede.com/md/EN/index.html

Nicholson, Arrbery, Annemarie Shchiemmel, Eve De Vitray Meyerovich, Coleman Barks etj. me studimet, përkthimet dhe performimet e tyre. Mercan Dede shpesh e citon Rumiun: *nëse je çdo kund nuk je askund, nëse je diku, je çdoku dhe çdoku-ja ime është zemra ime*, përfundon Dede.

Tetëqindë vjet pas Rumiut, vepra e tij vazhdon të jetë gurrë e pashuar në, të cilën shuajnë dhe do ta shuajnë etjen kërkues të shumtë të rrugës hyjnore, qoftë nëpërmjet Artit, Besimit apo Shkencës.

Konkluzioni

Në epistemologjinë sakrale Induse, ekzistojnë tre drejtime apo shkolla të mendimit; shkolla e Karmës apo Veprimit, shkolla e Xhanës apo Diturisë, dhe shkolla e Bhaktës apo Dashurisë, për të arritur deri tek njohja dhe afrimi me Perëndinë.

Në Sufizëm të gjitha këto shkolla janë të unifikuara në aktin e shenjtë të quajtur jeta dhe krejt në fund Sufizmi përfundon në ASHK, dashuri apo sipas kategorizimit Indus, në Bhakta.

Prej shumë etiketimeve (natyrisht pozitive) që, i behën Rumiut, si artist i madh, si profet, si i shenjtë, konsideroj se më së miri Ai vet e definoi vetën në poezinë e tij **Njeriu i Zotit**[29]:

Njeriu i Zotit është:
i gëzuar pa pirë verë
Dhe i ngopur pa ngrënë mish,
I çuditur për gjithçka
Dhe që s'pyet për bimish

Njeriu i Zotit është
Vetë mbreti nën orën-dervish

Ësht' thesari nën rrënoja
S' ësht' prej dheu, nuk ësht' prej ere

29 Molana Xhelaludin Mohamed Molavi RUMI, Mbrëmë i pështërita një ylli…, Fondacioni Saadi Shirazi, Tiranë, 2002, faqe 137.

S' ësht' prej zjarri, s'ësht' prej uji
Ësht vetë deti zemërgjerë

Njeriu i Zotit është
Hëna e bahçes në pranverë

Njeriu i Zotit
Bëhet i mençur prej së vërtetës.

Bibliografia:

- Rajneesh, Osho, «Meditation»: The Art and Ecstasy, Osho Intl, 1992
- Meyerovitch, Eve De Vitray, «Rumi i Sufizam», Kaderjsko- Bedevijska Tekija, 1995.
- Lahi, Riza, «Molana Xhelaludin Mohamed Molavi RUMI»: Mbrëmë i pëshpërita një ylli…, Fondacioni Saadi Shirazi, 2002
- Mouravieff, Boris, "Gnosis: Exoteric Cycle: Study and Commentaries on the Esoteric Tradition of Eastern Orthodoxy" (Vol 1) Agora Books, 1990.
- Mouravieff, Boris, "Gnosis: The Mesoteric Cycle" (Book 2), Agora Books,1992.
- Mouravieff, Boris, "Gnosis: Book Three, the Esoteric Cycle": Study and Commentaries on the Esoteric Tradition of Eastern Orthodoxy (Gnosis), Praxis Institute Press,1993.
- Shah, Idries, «The Way of the Sufi», Arkana, Pengiun Group, 1990.
- Ouspensky, P.D., «In Search of the Miraculous: Fragments of an Unknown Teaching», Harvest/HBJ Book, 2001.
- Dunn, Philip, Mascetti, Dunn Manuela, Nicholson, R. A.. «The Illustrated Rumi»: A treasury of Wisdom from the Poet of the Soul, Harper San Francisco, 2000.

- Khalifah, Abdul Hakim, «The History of Muslim Philosophy»: Vol. II ed. M.M. Sharif, Otto Harrosowitz, Weisbaden, 1963.
- Whinefield, E.H., abridged and Translated, «Matnavi I Ma'navi»: Book III & IV, Maulana Jalalu-'d-din Muhammad Rumi, 1898, burim në Web dhe New Age Books, 2004.
- Nicholson, R.A. «The Mathnaëi of Jalaluddin Rumi»: Six Volumes, E.J.W. Gibb Memorial Trust New Series, 1925.
- Baba, Meher, «Discourses», Sheriar Press, 1995.
- Shehu, Fahredin, "Estetika e NUN-it": Perspektiva e estetikës teurgjike dhe nivelet e krijimtarisë, studim i pabotuar.
- De Bono, Edward, Lateral Thinking, Penguin Books, 1990
- Burimet elektronike nga WEB të shfrytëzuara për këtë ekspoze:
- http://www.semazen.net/eng/sp.php?id=3&page_id=1&menu_id=id3
- http://www.dar-al-masnavi.org/
- http://www.sacred-texts.com/isl/masnavi/
- http://www.britannica.com/eb/topic-369314/Mathnawi-of-Jalaluddin-Rumi
- http://libraries.theeuropeanlibrary.org/Turkey/treasures_en.xml
- http://www.whirlingdervishes.org/whirlingdervishes.htm
- http://www.mevlana.net/sema.htm
- http://www.mevlana.org/
- http://www.khamush.com/
- http://www.omphaloskepsis.com/collection/

STANDARDI EVROPIAN???

Në kohën kur Michael Steiner ishte PSSP (Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm) të Kombeve të Bashkuara, popullata kosovare, e cila atëherë sikur edhe sot ende nuk i ka të shëruara plagët e luftës, u njoftua me disa standarde, të cilat dosido duhet të përmbusheshin për t'u integruar në shoqërinë e qytetëruar evropiane?

Kjo i ngjante sikur kërkohej foshnja nga virgjëresha. Standardi para Statutit të pa definuar (ende) të Kosovës.

Këtu sillen njerëzit të cilët me urrejtje patologjike torturojnë njerëz vendor e, të cilët janë në kuazi- struktura të qytetëruara të Evropës në Kosovë, rasti i Stefan Loreni-it, zyrtarit të EULEX-it. Por, për këtë psikopat do të flasim në një rast tjetër.

Paraqitja e monedhës, si kanë dëshirë të i thonë këtu, bankënotës, Euro, kosovarët e pranuan me shumë entuziazëm, gjoja se integrimin në Evropë do të jetë i shpejtë dhe sa më shumë që, kjo monedhë përdoret aq më shumë popullata varfërohet.

Dygjuhësia nëpër institucione, nëpër shenja të komunikacionit, në pjesë të banuara me shqiptarë ishte standard i aplikuar, në pjesën serbe; aspak. Në Malishevë për shembull ka mbishkrime të lokaliteteve në gjuhën shqipe dhe serbe por jo edhe në Hoqë të madhe të Rahovecit, e as ne Leposaviq.

Koordinimi i fshehtë i bankave për ta përcaktuar kuotën e interesit për shkaktë riskut të madh ende vazhdon ta shtrydh popullatën deri në neveri, tevona edhe kompanitë e sigurimeve

kosovare me policat e tyre të famshme, janë tema të dhimbshme të realitetit të ri në Kosovë. Për të gjitha këto studentët në të ardhmen do të punojnë temat Master dhe këtë druaj jo me mënyrën e si e bëjnë tani. Të gjitha këto janë pjesë e një standardi të ç'standardizuar dhe që të gjitha këto në dëm të popullatës.

Në vendet evropiane edhe niveli i interesit bankar është i rregulluar me kushtetutë, përkundrazi në Kosovë bankat të koordinuara mirë arsyetohen se niveli i riskut është i madh andaj edhe interesi është shumë i lartë, por interesant në secilën Bankë prezentë është i njëjtë, ndoshta me dallime super- minimale.

Se sa Standardi evropian është i standardizuar kjo varret nga shteti në shtet. Derisa kroatëve u kërkohet respektimi i pakicës serbe Turqisë respektimi i pakicës Kurdë, Spanjës, Greqisë dhe Serbisë kjo aspak nuk i kërkohet, sepse pothuaj këto shtete nuk kanë asnjë pakicë, vërejmë se duhet që, sytë të mbyllen, veshët, goja dhe të thyhet lapsi dhe askush mos të shkruaj asgjë.

Problemi artificialisht i krijuar financiar nga grekët, e ngarkon Evropën me miliarda euro e, sa Greqia kontribuon në Evropë është baras me kontributin francez kundër Nazizmit që, pos Anglisë dhe Amerikës pas luftës së dytë botërore, Franca të jetë prapë faktor që, të përcaktoj fatet e popujve të vegjël të Ballkanit.

Po të ndalen ekspertët e t'i analizojnë të gjitha këto, do të publikoheshin raportet voluminoze sa do të gogësinin bibliotekat evropiane, ashtu siç bëjnë me raportet për të drejtat e njeriut ku harxhohen milionat dhe priten drunjtë të gjorë për letër, për rezultatet kot.

Në Kosovë standardi është kuptuar vetëm përmbushja e apetitit serb, këtu si përmbushje e obligimeve ndaj komuniteteve posaçërisht serb, obligimet evropiane, të cilat kushtëzojnë secilin hap të mëtutjeshëm.

Nuk flitet kurrë për të drejtat e pakicave fetare, gjinore etj., sikur ne nuk i kemi këto problemedhe sikur këta njerëz nuk ekzistojnë.

Pakica kosovare si kategori e njerëzve me nevoja të veçanta për shembull, është e diskriminuar në çdo aspekt.

Asnjë arkitekti nuk i shkon ndërmend se standardi duhet të plotësohet edhe në këtë rrafsh.

Nuk ka Universitet, hotel, bibliotekë, institucion në Kosovë, i cili i plotëson kushtet për studentë, respektivisht punëtor dhe njerëz tjerë me aftësi të kufizuara si thuhet padrejtë këtu, i cili krijon kushtet minimale për këtë kategori njerëzish.

Komisionet për akreditimin e Universiteteve as që e vërejnë këtë fenomen. Kjo dëshmon për mungesë të vetëdijes së tyre, sepse as ne vendet e tyre nuk kanë kushte për njerëz me nevoja të veçanta dhe se, situata fare më mirë nuk është edhe në vendet nga ata vinë.

Po ashtukjo tregon se janë mjaftë të dinjitetshëm (?), sepse nuk kërkojnë në Kosovë, atë që nuk e kanë në vendin e tyre gjë që, nëse është kështu është paksa e befasishme.

Kur flasim për lirinë fetare, imazhi nuk është aspak më premtues. Jo vetëm në Kosovë, por edhe në tërë Ballkanin.

Si trajtohen të burgosurit? A ka liri fetare në burgje? A ka radikalizëm fetar nëpër burgje? A respektohet dinjiteti i të burgosurit? Çka ha i burgosuri turk në Bullgari? Çka ha i burgosuri shqiptar në Serbi? Si e bën iftarin i burgosuri në Kosovë? A i feston Pashkët, i burgosur në Kosovë?

Kur të gjitha këto pyetje do të vijnë në pyetësorin e BE-së ku do të ketë pika edhe për këto standarde, si do të përgjigjet Lidershipi politik i Kosovës?

Madje edhe në mediumin e vetëm publik RTK, ka njerëz me nevoja të veçanta dhe ata kanë kushte minimale për të kryer punën e tyre dhe mungesë e plotë e sensibilizimit të popullatës për këtë kategori të njerëzve.Në një shoqëri ku ka individë, të cilët mendojnë për të tjerët, këta janë të ndëshkuar me anatemim. Në Kroaci për shembull, respektimi i pakicave etnike, fetare, gjinore jo vetëm se është në letër, në legjislacion, por ka hyrë në institucion që, d.m.th. se ka dal nga niveli i Shoqërisë civile, ata vrapojnë, sepse duan ta arrijnë fazën e dytë të bisedimeve për integrim në EU, tek ne mbetet në nivelin shumë të ulët madje as të arti-

kuluar si dhe sa duhet nga ana e shoqërisë civile fillimisht, e mos të flasim për nivelin qeveritar.

Në një shoqëri ku mediet janë të ngulfatur dhe të vet-ngulfaturme ose pa dashje, dhe me një shoqëri civile të brishtë ku bëhet garë si cili më shpejt do të bëhet këshilltarë i ndonjë ministri apo presidenti që, ndërrohet orë e çast, Demokracia vihet në pikëpyetje.

Ngjashëm si Standardi ambiguoz i Evropës, i cili për dikë është nënë e për dikë njerkë.

Qesh e plas...ja se ndryshe s'bënë

"TË PRITURAT E KOMUNITETEVE SHQIPTARE DHE SERB NË KOSOVË NGA BISEDIMET MES BEOGRADIT DHE PRISHTINËS– A JEMI AFËR NORMALIZIMIT TË MARRËDHËNIEVE"

(KONFERENCA RAJONALE E ORGANIZUAR NGA SHOQËRIA CIVILE NGA SERBIA DHE KOSOVA, NË MBËSHTETJE TË FRIEDRICH EBERT SCHTIFTUNG)

Në mars të këtij viti, filluan bisedimet e para, që nga ndarja e Kosovës nga Serbia. Kështu thuhet në shumë medie ndërkombëtare. Pa dashur të futem në të dhënat historike, që dallojnë nga të dyja anët, kujtoj se, pas shpërbërjes së Jugosllavisë, ku edhe Kosova dhe Vojvodina ishin pjesë konstituive, dhe pas luftës në ish Jugosllavi, që nga Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, për të përfunduar në Kosovë, Shqiptarët nuk patën mundësi tjetër, e cila do të ofronte madje një element për të bashkëjetuar nën një çati me një shtet, i cili po ashtu, ishte në shpërbërje; Serbia dhe Mali i Zi.

Problemet e grumbulluara me vite i vuajnë të dy kombet dhe tani, në përpjekjen për t'iu bashkangjitur Evropës; Kosova dhe Serbia ballafaqohen me sfida të ngjashme drejt forcimit të demokracive të veta; privatizimi, investimet e huaja, papunësia, liria

e medieve, rritja e efikasitetit në luftën kundër krimit të organizuar, tregtia e lirë etj., janë vetëm disa nga sfidat, të cilat duhet të tejkalohen, duke i shtuar kësaj edhe kërkesën e Bashkësisë Evropiane dhe zërat se, anëtarësimi në BE është "Proces", që, pra si çdo proces ka rrjedhën dhe kohën, andaj edhe ky ka kritere dhe rrethana,të cilat dallojnë nga vendi në vend.

Në kohën kur Michael Steiner ishte PSSP (Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm) të Kombeve të Bashkuara, popullata kosovare, e cila atëherë, sikur edhe sot ende nuk i ka të shëruara plagët e luftës, u njoftua me disa standarde, të cilat dosido duhet të përmbusheshin për t'u integruar në shoqërinë e qytetëruar evropiane?

Kjo i ngjante sikur kërkohej foshnja nga virgjëresha. Standardi para Statutit të pa definuar (ende) të Kosovës.

Dygjuhësia nëpër institucione, nëpër shenja të komunikacionit, në pjesë të banuara me shqiptarë ishte standard i aplikuar, në pjesën serbe aspak. Në Malishevë për shembull ka mbishkrime të lokaliteteve në gjuhën shqipe dhe serbe, por jo edhe në Hoqë të madhe të Rahovecit, e as ne Leposaviq.

Kjo sigurisht kërkohet edhe nga Kroacia, Maqedonia, nga Serbia, por në Kosovë është perceptuar krejtësisht ndryshe, dhe kur vjen, nëse vjen në një të ardhme të afërt apo të largët, pyetësori i BE-së?, do të dihet më qartë se, çka kërkon Evropa nga popuj të katandisur të Ballkanit.

Ajo çka mund të kuptohet nga Mediet vendore, rajonale dhe ndërkombëtare është se, si tërësi, bisedimet/ negociatat janë jo transparente dhe nuk e kanë kohën e kufizuar, për dallim nga ato në Ramboulliet dhe Ahtisarit, kur janë ditur koha, qëllimi etj.

Kjo shkakton huti, anksiozitet dhe dyshim se, do të ketë fund të mbar. Flas për palën shqiptare, sepse ekipi negociator, apo ekipi i bisedimeve është improvizuar shumë shpejt, dhe tek tani me emërimin e Ilir Dedaj, këshilltar i Presidentes Jahjaga, po plotësohet, dhe kjo nga aspekti kadrovik. Se çka ka në përmbajtje shumë pak dihet?

Krijuesit e opinioneve dhe analistë të pavarur, të cilët janë shumë pak në Kosovë e perceptojnë një rrezik, i cili është në rritje. Pas deklaratës së Zv. Kryeministres, Edita Tahirit se janë pajtuar që t'i marrin kopjet e librave kadastral, librave amë dhe dokumentacionit tjetër, sepse ashtu paska vepruar edhe Kroacia dhe Bosnja,disa jo publikisht reaguan duke thënë se: marrja e kopjeve të librave kadastralë dhe librave amë, është njëlloj si blerja e bonbonierës më imazhin e Mona Lizës, pra nuk duhet të shkohet në Luvër, që të shihet Mona Liza. Sidoqoftë, kjo edhe ashtu mbetet vështirësi, sepse Kosovari duhet të shkoj në Ambasadën Franceze në Shkup, për vizë.

Bisedimet, gjithsesi, krijojnë bazën për ndërveprime të mëtejme, në planin rajonal duke ndikuar në bashkëveprim rajonal, marrëdhënie të mira fqinjësore si kushte për PROCES, ndërveprimin e të dy shoqërive, komunikimi i grupeve të ndryshme, - OJQ-ve, Medieve, por edhe biznesit etj. Prandaj edhe thuhet se është proces.

Ajo çka është karakteristike për Ballkanin është se, këta popuj nuk dinë të merren veshë mes veti, por çdoherë duhet një palë e tretë në këtë rast i dërguar i Znj. Ashton, Z. Robert Kuper, dhe përfaqësues nga SHBA.

Serbia synon statusin e kandidatit në BE dhe për këtë, duhet komunikim dhe përmirësim i marrëdhënieve më fqinjët. Në këtë rast edhe me Kosovën, të cilën e trajton si entitet dhe është kategorike, kundër pranimit të pavarësisë së Kosovës.

Pala serbe ka kërkuar që edhe UNMIK të jetë prezent në negociata/ bisedime mes Serbisë dhe Kosovës, për shkak se UNMIK është nënshkrues i Marrëveshjes së CEFTA-s. Kryenegociatori serb; Borislav Stefanoviq përgjigjet se, nuk merret me terminologji dhe i përgjigjet Zanierit, Shefit të UNMIK-ut në Kosovë, deklaratës së Zanierit,se "gjithnjë e më pak problematike për Serbinë do të jetë pranimi i pavarësisë së Kosovës, pas arritjes së marrëveshjes për çështje teknike, duke thënë se "nuk do të jetë fare problematike, sepse nuk do të ketë pranim". Pala serbe është shumë e qartë. Ajo vrapon ta vizitoj Prishtinën,

duke shkuar në vend të ngjarjes dhe duke dhënë mesazhin e vetë; Kosovës, Bashkësisë Evropiane, SHBA-ve dhe botës.

Borislav Stefanoviq: Jemi afër zgjidhjeve

"Zgjidhja për problemet praktike të banorëve të Kosovës është më afër se kurrë më parë pas rundit të parë të bisedimeve", ka thënë Stefanoviq.

Më pastaj edhe:

"Prishtina po kalon nëpër një proces të zhvillimit historik, në një mënyrë duke e mbitheksuar shtetësinë dhe sovranitetin e vet, ndërsa ne jemi një vend që tashmë ka kaluar nëpër këtë, kështu që ne i kuptojmë, por e kemi qëndrimin tone. Fakti se ne po bisedojmë nuk do të thotë në asnjë mënyrë se po përgatitemi ta njohim Kosovën"

Pjesë të të dy shoqërive janë kundër, demonstratat e NAPREDNJACI, para Presidencës së Serbisë, dhe Demonstratat e VETVENDOSJES, këto ditë nga pala shqiptare janë pjesë e shprehjes demokratike, por në rastin e Ballkanit ato shpesh shndërrohen në tragjike.

Përderisa palët janë duke negociuar, zërat që vijnë nga përfaqësues të ndryshëm ndërkombëtar në Kosovë si deklarata e fundit të Ambasadorit Francez Fitou, janë inkurajuese për Kosovën:

"Sa më shpejt që i vijë fundi pavarësisë së mbikëqyrur, aq më mirë. Duhet që në mënyrë të menjëhershme kosovarët t'i marrin çështjet në duart e veta. Nëse kjo merr kohë, le të merr kohë, por procesi për t'i dhënë fund pavarësisë së mbikëqyrur duhet të filloj menjëherë"

Kësaj i paraprin raporti i Grupit Ndërkombëtar të krizave ICG ku thuhet se, Kosova ka sovranitet të dyfishtë duke vënë theksin në Veri/ Mitrovicë,si dhe reagimi i Reagimi i KMDLNJ: EULEX me standarde të dyfishta, pikërisht lidhur me paaftësinë dhe mos efikasitetin e EULEX, dhe kompetencave të përziera. Në reagim thuhet:

"Sa herë që ky mision ka ndërmarrë aksione arrestimesh apo ndërhyrjesh në drejtësi është arsyetuar me kompetencat ekzekutive që ka në sundimin e ligjit. Pyetja që tani shtron KMDLNJ është se; deri ku shtrihet këto kompetenca ekzekutive? Dhe se pse këto kompetenca zbatohen thuaja ekskluzivisht në bazë të parimit etnik?"

Pak sa kuptohet nga Mediet, dhe nga vetë negociatorët. Mediet raportojnë vetëm bisedimet/ takimet e negociatorëve me ndonjë diplomat të huaj ku nxirren aksidentalisht nga ndonjë detaj i dobishëm për opinionistët dhe për popullin. Një rast të këtillë e kishim nga takimi i zëvendëskryeministres Edita Tahirit me ambasadorin Austriak, Johan Brieger. Ajo tha:

"Në dialogun e filluar teknik do të adresohen vetëm çështje praktike dhe në asnjë formë nuk do të diskutohet çështja e pavarësisë së Kosovës, sovranitetit, integritetit territorial dhe rregullimit të brendshëm shtetëror të Republikës së Kosovës"[30], ka thënë Tahiri.

Lidhur me tendencat e të dyja palëve për Zërin e Amerikës, VOA, Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga thotë:

"Kosova dhe Serbia, zgjidhje evropiane". Se nëpër çfarë duhet të kalojnë të dyja palët, dihet shumë pak.

Opinionistët si: Ulpiana Lama "Jo koncesione, jo status special" me fjalimin e mbajtur në USIP (Instituti Amerikan i Paqes),pastaj debati i organizuar nga BIRN, ku mblodhi përfaqësues nga Komuniteti shqiptar dhe Serb, në përbërje Edita Tahiri, Augustin Palokaj, Natasha Kandiq dhe Sllobodan Petroviq (Zv. Kryeministër), shpalosën elemente dhe fakte më pakëz të njohura për opinionin kosovar. Kështu ndodh në një shoqëri ku mungon transparenca dhe liria e medieve.

Në një shoqëri ku mediet janë të ngulfatur dhe të vet-ngulfaturme ose pa dashje, dhe me një shoqëri civile të brishtë ku bëhet garë si; cili më shpejt do të bëhet këshilltarë i ndonjë ministri apo presidenti që ndërrohet orë e çast, Demokracia vihet në pikëpyetje. Nëse në një shoqëri nuk ka demokraci të mirëfilltë

30

është e natyrshme të rritet anksioziteti, pasiguria, dëshpërimi dhe rezignimi.

Janë për t'u lavdëruar iniciativat e grupeve të ndryshme njerëzish si: botimi i antologjisë së poezisë Shqipe në Serbi dhe të prozës Serbe në Kosovë, me ndihmën e Tradukki, ku bashkëpunuan Sasha Iliq dhe Jeton Neziraj si dhe bashkëpunimi i AGPK ku, dërgon disa gazetar, që të punojnë në mediet serbe si dhe pranimi i gazetarëve Serb, që të punojë në Mediet e Kosovës.

Pas këtyre bisedimeve, që nuk dihet sa do të zgjasin, duket se, pala serbe di çka pret, ndërsa palës kosovare ende nuk i premtohet asgjë. Serbia ka marrëveshje kontraktuare me BE, kurse Kosova jo, sepse disa shtete/ pesë sosh nuk e njohin Kosovë. Kjo shkakton probleme të mëtejme, mirëpo analistët e kujdesshëm kanë indikacione se kjo gjendje mund të tejkalohet pas angazhimit të Z. Ashton që pesë shtete, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën duhet ta bëjnë këtë në pako, pastaj angazhimi i Tanja Fajon dhe Ulrike Lunaçek, japin shpresa që Kosova mos të mbetet e izoluar nga Integrimet Evropiane, të cilin e ka synim primar tash pas pavarësisë.

Se sa do të normalizohen marrëdhëniet mes dy palëve varret nga Bashkësia ndërkombëtare, sa trysni do t'i bëj të dyja palëve dhe sa Serbët dhe Kosovarët e kuptojnë rëndësinë dhe seriozitetin e procesit nëpër, të cilin kanë hyrë.

Të gjeturat:

Pranimi i dokumentacionit kosovar duhet të jetë faza e parë e normalizimit të marrëdhënieve;

Liria e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave me qëllim të zhvillimit të biznesit rajonal dhe tregtisë së lirë;

Lufta e përbashkët kundër krimit të organizuar;

Pranimi i Diplomave Universitare të Kosovës nga ana e Serbisë dhe shkëmbimet Studentore;

Hapja e Katedrës së Sllavistikës në UP;

Respektimi i pakicës Shqiptare në Preshevë dhe Bujanovc, në kontekstin etnik, kulturor dhe fetar në raporte proporcionale;

Demokratizimi i vërtetë i Serbisë dhe pranimi i një realiteti të ri në Ballkan;

Zvogëlimi i papunësisë në Serbi dhe Kosovë

Konkluzion:

Duke qenë, se Kosova në pothuaj secilën sferë është në fazën eksperimentale dhe mungesa e legjislacionit adekuat ndikon dukshëm drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve, kufizimet e ndryshme na rrafshin ndërkombëtar, mospranimi nga shumë shtete, raporti jo i mirë më fqinjin e parë Serbinë etj., krijojnë vështirësi të shumta, konsiderohet se bisedimet janë në interes për të dyja palët.

Pritjet e Kosovarëve në këtë rast, janë të konsiderueshme, pavarësisht se ekziston një dozë e shprehur e skepticizmit dhe frikës.

Pikëpamjet e shprehura në këtë prezantim, posaçërisht të gjeturat duhet të shikohen me dioptri të dyfishtë, sepse konsideromë që, këto janë elemente kryesore dhe themelore për tejkalimin e barrierave me, të cilat ballafaqohen të dy vende, në procesin e Integrimit Evropian.

MARTESA DHE FOLEJA FAMILJARE SIPAS FETHULLAH GYLENIT

Duke pas parasysh problemet nëpër, të cilat po kalon secila familje me ndërrimin egjeneratave, e veçmas në shoqëritë gjatë tranzicionit, si kjo e jona, dallojmë fenomene, të cilat tek disa krijojnë shqetësime për humbjen e vlerave tradicionale morale apo etnike. Në këtë aspekt libri i Fethullah Gylen, është një objekt interesant studimor, lidhur me çështjen ku, spikat elementet themelore për një familje, shoqëri, etj., gjë që fillon nga familja, kurse familja nis me martesën e shëndoshë.

Do të shtjellojmë edhe elementet tjera të këtij libri si ai; moral, pedagogjik, artistik si përbërës të rëndësishëm në krijimin e personalitetit dhe psikologjisë së shëndoshë personale.

Posaçërisht do të ndalemi në formësimin e karakterit të fëmijës, Martesa dhe foleja familjare, Prindërit dhe roli i tyre në edukim dhe arsimimi, edukata dhe i riu e kështu me radhë.

Në tri katër dekada të fundit, emri i Fethullah Gylen[31] përfaqëson një sinonim global të përçuesit të mesazhit të paqes dhe tolerancës, përtej kufijve të origjinës së tij. Jo vetëm të mesazhit, thënë më saktë; por edhe të punës praktike në terren.

I dëshmuar në letërsi dhe këtu kemi parasysh që nga Poezia e deri tek librat domethënës mistiko-filozofik,asociacioneve, kolegjeve, universiteteve etj.

31 Predikues, Shkrimtar, Edukator, Humanist,i lindur më 1941 në fshatin Koruxhuk, në qytezën Hasankale (Pasinler) në rrethit të Erzurumit në Turqi.

E gjithë kjo ka kontribuar që të manifestohet qenësia paqësore e Islamit, jo si kundërpërgjigje ndaj akteve terroriste në emër të Islamit, por si demonstrim i drejtpërdrejt dhe më reprezentativ i shtyllës themelore të Islamit, mesazhit kur'anor, i cili rrjedh nga burimi hyjnor. Dhe si i tillë assesi nuk është i orientuar kundër Humanizmit, por shkon përtej, respektivisht përfshirë edhe krijesat tjera; mineralet, bimët, shtazët, xhinët, demonët, engjëjt, por këto janë tema të gjera, gjithsesi të nevojshme për trajtim, e që, nuk i përket këtij elaborimi.

Duke identifikuar edukimin si shtyllë parësore dhe të patjetërsueshme, jo vetëm të nivelit pedagogjik, por edhe të atij andragogjik, Gylen përthekon, pothuaj të gjitha disiplinat e Islamit, veçmas ato, të cilat kanë të bëjnë me mirëqenien humane dhe atë në nivel global, si dhe duke i vënë në praktikë, idetë e mendimtarit të madh Bediuzzaman Said Nursi[32].

Përkitazi me këtë, ne zgjodhëm një nga shumë librat e tij të dobishëm; "Nga fara te Lisi", i cili paraqet një program të jashtëzakonshëm pedagogjik, i cili vë në shënjestër Familjen si burim të parë dhe themelor për edukim të mirëfilltë dhe ku, artikulohet qartë distinkcioni Edukim dhe Arsimim, posaçërisht Martesa si fill i krijimit të familjes.

Familja33 për Gylen paraqet celulën e parë dhe më komplementare të një entiteti, kombi dhe shoqërie globale andaj edhe mesazhet e derivuara nga Kur'ani, që për Myslimanët, e veçmas për Gylen, artikulohen si mesazhe me origjinë divine, vihen në pah, në mënyrë kongruente me ekzegezën e Gylen për fenomenin Edukim.

Nuk janë lënë anash as mesazhet profetike e as të dijetarëve, të cilat e përbëjnë tërësinë dhe kompaktësinë e mësimit të Gylen.

---

32 Bediuzzaman Said Nursi, i lindur në Nurë, Provinca Bitlis, në Anadollinë lindore, 1878- 1960, më i njohur si komentator i Kur'anit, në mbi 6000 faqe.

33 *Foleja familjare e themeluar qysh në krye mbi parime të shëndosha e ku sundon lumturia materiale- shpirtërore, është guri themelor më i shëndoshë i ekzistencës si komb dhe një shkollë e bekuar ku përgatiten individë të virtytshëm e të vlefshëm...*",Nga fara tek lisi", fq. 159.

Ne posaçërisht duam ta artikulojmë mjeshtërinë, thjeshtësinë dhe qartësinë e të shkruarit, veçmas implikimin e inteligjencës emocionale të artikuluar në trajtë të poetike, pra Gylen nuk e lë anash artin, në këtë rast, artin e të shkruarit të bukur, poezinë; jo vetëm për ta fuqizuar strukturën semantike të librit, por për ta artikuluar artin si element shumë të rëndësishëm në formimin e karakterit të gjeneratës së ardhshme, (gjë që i takon psikologjisë personale), për të pasur një personalitet integral, të pajisur me moral të pastër, edukim, arsimim, me qëllim që të kemi një shoqëri të shëndoshë dhe këtu vetvetiu nënkuptohet edhe mirëqenie të gjithëmbarshme.

Martesa

Pjesa e parë dhe pothuaj themelore e librit; "Nga fara te Lisi", i dedikohet Martesës, ku elaboron rëndësinë e elementeve më të shëndosha dhe komplementare, të cilat duhet të përmbaj një institucion kaq i rëndësishëm human, si: Edukata familjare, Rëndësia e folesë familjare, Synimi përfundimtar i martesës, Kushtet e martesës, vlerat e prindërve e kështu me radhë.

"Martesa", merret si pikënisje e ndërtimit të një familjeje të re. Gylen vë në pah, rëndësinë e saj, që nga fillimi i procesit të unifikimit të njerëzve për ndërtimin e një foleje të re. Ai kërkon nga individi, që fillimisht të bëhet analiza e nevojshme me qëllim, që të evitohen komplikime të mëtejme dhe siç shprehet ai artistikisht:

Tërheq vërejtjen për analizën e nevojshme para martesës, sepse sipas tij (cit.)- "*kur të vij puna në prag të ndarjes, nuk kanë për të vlejtur as kriteret më të mençura*"[34]

"...të shpëtohet foleja familjare nga zjarri me sa më pak dëme; e rëndësishme është të mos futen në familje elementët me rrezik zjarri!..."[35]

34 "Nga fara te lisi", fq. 156.
35 "Nga fara te lisi",fq. 157.

Sipas Gylen, rëndësia e folesë familjare ndikon në ndërtimin e qëndrueshëm, të karakterit të qëndrueshëm dhe edukimin e qëndrueshëm të fëmijës. Ai thotë; *"Po që se familja nuk është ngritur në parime edukative, as shoqëria nuk mund të mendohet të jetë me edukatë"* dhe më tej: *"...suksesi në folenë familjare është etapa e parë e suksesit në jetën e përgjithshme"*.

Gylen në këtë libër assesi nuk mund të dal jashtë kontekstit Islam, dhe ai nuk heziton të citoj shpesh ajetet Kur'anore, por edhe Hadithet[36] e Profetit të Islamit, Muhamedit. Por edhe vet ai nuk përpiqet t'i ik kësaj, dhe në frymën e analogjisë, shpesh përdor edhe metaforë dhe fjalor artistik, më qëllim që, në mënyrë sa më të përafërt ta demonstroj qëllimin dhe përkushtimin e tij në këtë material, i cili doemos akëcilit, që i bie në dorë, do ta vërej se Arti është pjesë e pandashme dhe komplementare e Edukimit të fëmijës, krahas: Moralit, Shkencës, Fesë, etj.

Martesa dhe foleja familjare

Foleja familjare është gjithçka që mund t'i ofrohet fillimisht fëmijës, andaj ajo duhet t'i ofroj kushte, por edhe detyrime brezit të ardhshëm.

Po ashtu kështillon që foleja familjare duhet të ofroj një edukim dhe përgatitje për kohën që vjen, sepse koha në të cilën janë zhvilluar dhe rritur prindërit domosdo dallon nga koha në të cilën rriten dhe zhvillohen breza të rinj dhe me këtë edhe kërkon metoda të reja (për kohën tjetër në perspektivë), në ngritjen dhe edukimin e tyre.

Gylen në detaje shpjegon kushtet e martesës duke u bazuar kryekëput në Traditën Islame dhe përcaktime të shkollave Juridike Islame dhe definon, cilat janë: Martesat e detyrueshme, Martesat e domosdoshme, Martesa (traditë) profetike, Martesa e

36 Hadith, Tradita gojore e Profetit të Islamit, Muhamedit, për dallim nga Tradita e praktikës së tij, e cila është e njohur si Sunnah.

ndalueshme, Martesa e papëlqyeshme dhe krejt në fund Martesa e zakonshme.

Ne nuk do t'i hyjmë detajeve të shpjegimit të këtyre kushteve, sepse ato janë të prezantuar qartë dhe shkëlqyeshëm në librin: "Nga fara te Lisi", por në vend të kësaj po parafrazojmë mendimin lucid të autorit:"*Familja nuk është uzinë për prodhimin e fëmijëve, por pjesa më jetësore e shoqërisë dhe embrioni i parë i kombit*".- për të pasur në konsideratë vlerën, të cilën i jep fëmijës dhe më të mirën që mund t'i jepet fëmijës, është Edukata.

Fëmija

"Ç'vlerë ka fara për vazhdimësinë e llojit dhe brezit të një peme, po atë vlerë ka edhe fëmija për vazhdimësinë e llojit dhe brezit të njeriut. Kombet që i lënë pas dore fëmijët, janë të dënuar të shemben, kurse kombet që i braktisin ata në duar të huaja e në ndikimin e kulturave të huaja, janë të dënuar të humbin origjinën!..."

Gylen sikur shkruan për problemet me, të cilat po ballafaqohet shoqëria jonë, e cila ka pas mungesë të gjatë të edukimit, në radhë të parë të atij moral dhe fetar. Ai më tutje vazhdon se edukimi fetar i fëmijës (ku i kushton një pjesë bukur të rëndësishme të librit), kapitullin IV, lidhur me mësimin e fëmijëve qysh nga mosha e vogël, për vlerat e xhamisë, mënjanimi i dyshimeve, mënyra e edukimit të fëmijës me shembuj konkret e ofruar nga ana e prindërve, respektivisht; kryerja e rregullt e adhurimeve të detyrueshme,tregimi me qëndrim ose komunikimi pa fjalë, dhembshuria, autoriteti, edukata e të folurit masa në bujari dhe dhembshuri, shpërblimi i duhur, pastaj respekti ndaj Kur'anit, ndjenja e nderimit të simboleve të shenjta etj., ndikojnë që të kihet një shoqëri a komb të shëndoshë, dhe thotë:

"Përgjegjësit e të keqes që duket në brezat e sotëm në një pjesë administratorësh dhe shqetësimeve të hequra si komb, janë elementet sunduese të tridhjetë vjetëve më parë. Edhe fatkeqësitë apo vlerat e një çerek shekulli më vonë do t'u përkasin atyre që e kanë në dorë arsimimin dhe edukimin e brezave të sotëm"

Prindërit

"Njeriu quhet se e respekton Zotin po aq sa i respekton edhe prindërit. Kush s'ka respekt për ta, s'ka respekt as për Zotin..."

Obligimet e prindërve ndaj fëmijës janë të shumta dhe Gylen ndër to si më të rëndësishme i radhit pjesëmarrjen e të dy prindërve në ngritjen dhe mirëqenien familjare; obligimet e gruas, detyrat ndaj fëmijës, përgatitja e mjedisit të edukimit, ushqimi i fëmijës më gjërat e fituara në rrugë të ndershme, mbrojtja nga sulmet e ndryshme, e veçmas ato mediale; Televizori në shtëpi dhe rregullimi i ndjekjes së tij, edukimi në të folurit e bukur, autoriteti i prindit e shumë ë shumë të tjerë.

Prindërit duhet tua mësojnë fëmijëve, që të jenë mirënjohës dhe të falënderojnë duke, e sjellë shembull nga Kur'ani: "Po që se falënderoni, edhe Unë jua shtoj të mirat; po që se tregoheni mosmirënjohës, ndëshkimi im është shumë i rëndë"37

Meqë mbi supet e prindërve që kur njeriu filloj të ekzistoj e deri kur të zhvillohet është barrë e prindërve pavarësisht nënës apo babait, është e pamundur thotë Gylen, që të përcaktohet thellësia e dhembshurisë apo madje edhe kufiri i shqetësimeve që heqin ata. Andaj respekti ndaj tyre duhet t'u mësohet fëmijëve jo vetëm si detyrim njerëzor, por edhe si një detyrë, e cila doemos duhet kryer.

Edukata dhe i riu

"*Ata që kërkojnë të japin orakull mbi të ardhmen e një kombi, po t'i hedhin sytë edukatës së dhënë të rinjve, kanë për të dhënë një orakull qindpërqind të saktë!..*"[38]

PjesaVI e librit "Nga fara tek lisi", i dedikohet shtjellimit krahasimtar të edukatës kur'anore dhe asaj jashtëkur'anore.

37 Kur'an, Sure Ibrahim, 14/ 7.

38 "Nga fara tek lisi", fq. 162.

Lidhur me edukatën kur'anore39 ai shprehet se një nxënës i tillë është njeri, krijesë, rob i Zotit, është modest, i butë i urtë, por edhe i vyer dhe i vendosur që të mos i përulet askujt veç Zotit dhe nuk është mizor, dhunues, i ashpër, i egër, egoist.

Ne edukimin jashtëkur'anor ai dallon tipin Faraonik40, i cili po ashtu ndahet në dy kategori: Faraonizmi i fuqishëm, i cili, duke qenë i tillë, është ekspansiv, dhunues, mizor dhe egoist; dhe forma e dytë: Faraonizmi i dobët, i mjerë, i pafuqishëm, i cili, duke qenë i tillë, është i ulët e banal sa t'u puth këmbët të tjerëve.

Dhe, derisa në tipin e parë të edukimit, pra edukatën kur'anore nxënësi mëton të arrij vetëm pëlqimin e Zotit, në tipin e dytë të edukimit vërejmë se, Egoja vihet në plan të parë dhe nxënësi mëton të arrij çdo gjë dhe me çdo kusht për ta kënaqur Egon, pavarësisht prej imoralitetit apo të mizorisë të cilën e aplikon.

"*Mësimet që u jepet më pak rëndësi, në një kohë që janë më të rëndësishëm, janë kultura kombëtare dhe edukata kombëtare. Po që se një ditë do të kthehemi për ta vënë në shfrytëzim këtë rrugë, do të kemi marr vendimin më të qëlluar për përparimin e kombit*"[41].

Duke u shprehur në këtë mënyrë, Gylen potencon ndjesinë, identitetin kombëtar, që duhet kultivuar qysh në moshë të vogël duke i ofruar brezit të ri një edukatë adekuate kombëtare dhe kulturë kombëtare.

Ai po ashtu identifikon faktin se gjatë edukimit nuk duhet të ketë imponim dhe përmend rastin e poetit arab Imrul Kajsi, i cili nuk pati bërë shkollë, apo të Anjshtanjit, i cili ikte nga shkolla apo edhe Njutoni, i cili pati marrë notë të dobët në Matematikë.

Këtë e argumenton se, njerëz të këtillë kanë mendime tjera dhe nuk i përfillin elementet konvencionale të arsimimit, por që, në histori gjithsesikanë lënë gjurmë të pashlyer.

39 Ibid. fq. 148

40 Me Faraonizëm nuk nënkuptohet se kemi fjalën për mbretërit e Egjiptit antik, por për figurën e përgjithësuar faraonike si simbol i gjithçkaje të keqe dhe të ulët. Ibid. fq. 145.

41 Ibid. fq. 161

Konkluzioni:

Duke lexuar veprën e Gylenit; themi cilëndo vepër, kemi parasysh një opus të frymëzuar nga burimi hyjnor që në epistemologjinë islame është e definuar qartë si Ilham42 , që shkon deri në nivelin e robit të Zotit, mikut të Tij (vali) dhe Vahj43, e cila i takon të dërguarve të Zotit, respektivisht; Profetëve.

Për ta shtrirë mesazhin e tij në të gjitha cepat e librit, Gylen përdor përvojat e të zgjedhurve të Zotit, Poetëve, përvojat e tij dhe na shfaq krejt në fund, një tërësi letrare, studimore, shkencore në dobi të secilës familje, kombi, shoqërie e deri tek niveli global.

Në këtë vështrim, përpjekja ishte që të spikaten elementet themelore në librin "Nga Fara te lisi", veçanërisht duke u fokusuar në rëndësinë e Martesës dhe rolin e familjes në procesin e edukimit të brezave të rinj.

"Nga Fara te lisi" është një libër, i cili paraqet një nga thesaret e shumta, të cilat na i zbulon Gylen dhe si i tillë; libri do të duhej të ishte jo në raftete secilës familje, por në xhepin e secilit, që di shkrim e lexim, sepse pos që, është i dobishëm për brezat e rinj, ai është edhe udhëzues i shkëlqyer edhe për prindër në mënyrë që, me krijimin e folesë së shëndoshë familjare, detyrim i ardhshëm pos, të ushqyerit, veshmbathjes etj., është edhe edukimi i mirëfilltë, që sipas Gylen mbetet edukimi Kur'anor.

42 Ar. Frymëzim, Inspirim.
43 Ar. Shpallje, Zbulesë.

LETËRSIA (PËRKTHIMI) DHE ARTI - URË LIDHËSE MIDIS KULTURAVE

Mësuam se shkrimi dhe roli i tij, janë pjesë e pandashme e interakcionit ndër- njerëzor dhe definimi i letërsisë dhe roli i sajë përgjatë historisë, po ashtu tregoi rëndësinë, në jetën e qytetëruar.

Që nga kohët e lashta, letërsia luajti rolin e përçimit të mesazhit dhe trashëgimisë së një kulture të caktuar.

Prej piktogrameve e deri te alfabeti fonetik fenikas, por edhe më pas, letërsia përcillte mesazhin sakral, që atëherë nuk kishte ndarje, por çdo gjë ishte e lidhur me natyrën, Zotin dhe fenomenet, të cilat kanë ndërtuar, e më pas zhvilluar mendësinë e kulturës së caktuar njerëzore. Më pas evoluar deri në fazat e më vonshme të segregacionit në; Sakrale dhe Profane.

Nëse çdo gjë të shkruar e konsiderojmë letërsi, atëherë vetës do t'i mundësojmë më lehtë punën për ta rezymuar një fenomen njerëzor pa, të cilin vështirë se, do të mund të paramendohej evoluimi deri në këtë shkallë.

Fillimisht letërsia ishte për një pakicë kultivuese dhe tjetrën absorbuese. Kemi parasysh kufizimet në procesin arsimor, për shkak se shumica ishte analfabete, në kuptimin e sotëm të fjalës.

Kur flasim për hieroglifët e Egjiptit antik kemi parasysh se piktogramet e krijuara dhe absorbuara nga një pakicë e caktuar, sublimonin një mendësi unike konceptuale nëpërmjet, të cilave përcillej mesazhi. Në këtë mënyrë duke u pajtuar me Jacques

Derrida,(Mbi gramatologjinë), sepse kemi parasysh që, jo mungesa e mendësisë për të krijuar një alfabet, por transcendimi i një alfabeti nga fonema, në piktogram, e bënë më unik gjeniun antik egjiptas. Ngjashëm me këtë është edhe alfabeti kinez.

Pa dashur të zbresim në analizën e alfabetit, që edhe nuk është temë e kësaj kumtese, bëjmë një lëvizje kah letërsia, domethënia dhe roli i sajë si pronësi e intelektuale e entitetit njeri.

Dy lloje themelore të letërsisë

Dallojmë dy lloje themelore të letërsisë; letërsinë gojore dhe letërsinë e shkruar.

Njeriu antik për ta ruajtur këtë dhunti, ka qenë dashur ta memorizoj fjalën e frymëzuar në atë mënyrë që, të mos zhduket kjo pasuri.

Në letërsinë arabe dallojmë letërsinë gojore deri në shekullin V të erës sonë dhe mund vetëm të hamendemi sa është humbur gjatë këtij shtegtimi.

Për t'i ikur këtij fenomeni Muhamedi A.S. ka urdhëruar, që të shkruhen fjalët e memorizuara të shpalljes së Kur'anit dhe fillimisht ato shkruheshin në gurë, fletë palme, eshtra të devesë dhe në pergamenë, sepse arabët dhe gjithë të tjerët, pos Kinezëve, deri vonë nuk dinin për letrën, në kohën e Al Birunit44, i cili e sjell dhe nëpërmjet tij, deri në Evropë.

Një shembull tjetër mund të sjellim nga trashëgimia tibetane. "Libri Tibetan i të Vdekurve", plot 2000 vjet është përcjell gojarisht, derisa Evdard Vens mori ta përkthej në gjuhën angleze dhe t'i ofroj botës një tjetër thesar shpirtëror.

Pastaj letërsia është kombinuar me këngë dhe kënduar. Janë të njohura modele të ndryshme si himne, balada etj., të cilat janë kënduar dhe përcjell mesazhin.

Ozanët turq, fillimisht, kanë kënduar këngë nga vendi në vend, baladat e tyre, të cilat më vonë me vazhdimin e aktiviteteve të tyre, kanë përhapur Islamin duke kënduar Ilahitë e Ahmet

44 Dijetar Islam i shek X, në Kath, Khvarezm, Uzbekistan, dikur Persia.

Jeseviut dhe Junus Emres, kështu duke përcjell dhe përhapur Islamin me një metodologji të shkëlqyeshme.

Letërsia e shkruar

Për dallim nga ajo gojore, kjo letërsi ka kontribuar në zhvillimin kulturor, mental dhe qytetërues të një grupi njerëzor fillimisht, e pastaj nëpërmjet përkthimit është përcjell tek kulturat tjera.

Sumerët e lashtë kanë zbuluar shkrimin kunjor duke e shtypur me shkop argjilën e lagur, e cila më vonë është pjekur, kështu për ta ruajtur mesazhin.

Papirusi, pergamena, po ashtu, janë mediume para letrës, të cilat kanë ruajtur fjalën e shkruar.

Në kohën tonë kemi mediume të sofistikuara si; silikoni dhe disqet harduerike, të cilat e ruajnë informacionin.

Ka qenë dashur të kaloj një kohë e gjatë, që të arrihet deri në këtë stad zhvillimor.

"Epi i Gilgameshit", i shkruar në pllaka argjile, Torah në lëkurë/ pergamenë, Mesnevija në letër, deri tek librat e shumëllojshëm elektronik, të cilat në vokabularin kibernetik janë të njohur si E-Book, si forma dhe mjete me, të cilat përcillet mesazhi i shkruesit.

Falë letërsisë së shkruar dhe përkthimit të sajë vetëdija globale është evoluar në stadin aktual të zhvillimit, i cili është dinamik dhe mëton të avancohet më tej.

Roli i përkthimit

Nuk ka dyshim se roli i përkthimit është i pazëvendësueshëm në ndërtimin e një shoqërie bashkëkohore, të qytetëruar dhe me vlera.

Nga historia kemi mësuar për shembullin e një Institucioni mesjetar Spanjoll, të njohur si Convivencia apo Bashkëjetesa, ku Myslimanët, të Krishterët dhe Hebrenjtë, kanë punuar bash-

karisht, në përkthimin e veprave arabe, greke, hebreje, në gjuhën latine.

Falë Ibn Rushdit45 ne tani e njohim veprën e Aristotelit, falë Nikollas së Kuzës, Rajmond Llull, Majkëll Skot, të cilët kanë folur arabisht dhe përkthyer vepra origjinale dhe ato të përkthyera arabe, të cilat arabët i kanë përkthyer nga gjuhët hinduse, perse, kineze etj.

Hebrenjtë e Spanjës si: Moshe Majmonid, Sollomon Ibn Gabriol, Bahja Ibn Pakuda, kanë shkruar arabisht, por edhe hebraisht me alfabet arab, si postulatet e fesë herreje të shkruara nga Majomonidi, e mos të flasim për ndikimin e filozofisë Islame e veçmas Sufinjëve, në filozofinë mesjetare herreje dhe të krishtere. Si shembull po përmend Ibn Pakudën dhe Albertin e madh etj.

Jesuiti Athanasius Kircher[46], ka qenë njohës i mirë i gjuhëve orientale dhe shumë nga hieroglifet, janë deshifruar nga ai.

Assesi nuk duhet harruar shkollën e Aleksandrisë, e cila dha kontribut të jashtëzakonshëm në formimin e një filozofie dhe mendësie të re.

Në kohën bashkëkohore njohim kontributin e Tomas Merton për jetën monastike dhe eremite të etërve të shkretëtirës së Egjiptit Kopt.

RichardWilhelm na ofron Librin e ndryshimeve, në Kinë të njohur si "Ji Jing", Sir Wallis Budge me librat Egjiptas, Sirian dhe Etiopian, si; Libri Egjiptian i të vdekurve, Kebra Nagast e Etiopisë e kështu me rradhë.

Falë Mit'hat Hoxhës ne kemi Mesnevinë e Xhelaludin Rumiut në gjuhën shqipe. Përkthimet dhe botimet e Asociacionit biblik Watchtower në SHBA etj.

Nëse flasim për përkthimet letrare, të beletristikës, per se, konkludojmë po ashtu se, roli i përkthimit është i pakapërcyeshëm, në mungesë të njohjes së gjuhës origjinale me, të cilën është shkruar vepra.

45 Gjeniu polymath i Kordoba-së, Andaluzia, Spanja e sotme, Shek. XII.

46 Dijetari Jesiut (1602–1680), Gjerman

Leximi i Gunther Grassit në Gjermanisht, Shekspirit në Anglisht, apo Firdusit në Persisht, sigurisht se, krijojmë një përshtypje unike, prandaj në këtë kontekst edhe përkthimi e mbulon këtë zbrazëtirë.

Pothuaj, asnjëherë nuk është potencuar roli dhe rëndësia e përkthyeseve.

Pra është nevojë imediate, që të përkthehen librat e sipër cekur e të botohen në gjuhën shqipe, gjë që do të na afronte me popuj tjerë dhe ngritte nivelin intelektual, moral shkencor dhe artistik

Veprat letrare pothuaj se, më mirë na afrojnë me një kulturë të caktuar, se sa elementet themelore të asaj kulture si librat e shenjtë apo filozofia mund ta ofrojnë.

Vepra Nata e errët e shpirtit nga Shën Gjoni i Kryqit, të afron më shumë me shpirtninë e krishterë se sa vet Bibla, nga Milorad Paviq mësohet më shumë rreth krishterimit orthodhoks se sa nga përkthimet e Biblës së Dr. Lujo Bakotiq, nga vepra letrare e Isak Bashevis Singer kuptohet më shumë për hebraizmin dhe kulturën hebreje se sa nga vet Torah.

Arti

Arti ka shumë disiplina dhe shpesh thuhet se nuk ka kufinjë. Por gjithsesi arti është pjesë e trashëgimisë së caktuar kulturore dhe me mesazhin, që ai përcjell, arrin përmasa universale dhe bëhet pjesë e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore botërore.

Krahas të gjitha transformimeve nëpër epoka të ndryshme historike, arti letrar mbetet i pazëvendësueshëm.

Piktura dhe skulptura po ashtu me kodin e vet komunikues, bartin shpirtin e një epoke dhe artikulimin artistik universal.

Muzika si arti më abstrakt, komunikon me një gjuhë të pagjuhë, universale dhe po aq primordiale.

Filozofi francez i kohës sonë Zhan Bodrijar, pohoi se ne po jetojmë në kohën e imazheve.

Kur jemi te imazhet, filmi si art paraqet komunikimin masiv artistik më të avancuar ku Letërsia (skenari), Teatri (drama),

Muzika (kolona muzikore e sfondit të filmit) dhe filozofia e artit (Estetika), harmonizohen në mënyrë të përkryer.

Holivudi si mjet i komunikimit masiv artistik,globalizoi kulturën amerikane më mirë se librat e Allen Ginsberg, John Updike apo Dan Brown njëlloj si filmat e Abbas Kiarostamit e dokumentojnë psikologjinë e Iranit të sotëm, me mirë se ku e di sa studime, anale, statistika Iraniane.

Skluptura e Mikelangjelos, Piktura e Pikasos, Haiku poezia e Bashos Romani i Gistave Floberit, Disenji i modës i Christian Dior-it, Arkitektura e Zaha Hadid, Fotografia e Gjon Milit, Këndimi i Maria Callas apo Oum Kalthum; janë të gjitha dëshmitë, vulat e kohës, të cilat tejkalojnë përmasat e kulturave të tyre origjinale.

Vallja & Baleti

Vallëzimi bashkëkohor ka prejardhjen sakrale, njëlloj si teatri. Shpesh dëgjojmë për lëvizje teatrale, elementin teatral tek Mesha apo vallja e dervishëve Mevlevi, sepse në modelin tonë mendor, çdoherë ekziston kronologjia nga tash, kah e kaluara dhe nga tash kah e ardhmja, kur flasim për vizione, tendenca, emancipim, integrim, fenomenet, të cilat i takojnë vijës horizontale evolutive, për dallim nga fenomenet involutive si; transcendimi, sublimimi, vet- realizimi, të cilët përcjellin vijën vertikale të involucionit; nga brendia kah lartësia.

Në këtë mënyrë ekspozimi i veprave artistike, organizimi i bienaleve, frekuentimi nëpër muze dhe turizmi kulturor në përgjithësi, tryezat e rrumbullakëta, seminaret e ndryshme,janë aktivitete, të cilat afrojnë kulturat.

Meqë ende jemi tek imazhet Mediet elektronike janë kontribuues të jashtëzakonshëm në afrimin dhe njohjen e kulturave të ndryshme, kontribuojnë në zhdukjen e paragjykimeve dhe barrierave etj.

Konkluzion

Në këtë kumtesë u përpoqëm të identifikojmë vlerat, të kontribuojmë, në zbardhjen e ca fakteve të rëndësishme, të vëmë dritë në ca fenomene të pa artikuluara përkitazi me temën.

Gjatë hulumtimeve tona identifikuam disa çështje për, të cilat sa më shpejtduhet të ndermirën masat adekuate dhe të vihet në lëvizje i gjithë arsenali dhe potenciali intelektual, moral, kreativ, financiar etj.

Gjetjet:

Të themelohet instituti i përkthimit;

Të hapen Qendra me Galeri për ekspozimin e vlerave të ndryshme kulturore, ekspozimin e veprave artistike,shkëmbime kulturore etj.;

Promovimi i turizmit kulturor;

Organizimi më i shpeshtë i konferencave, tryezave të rrumbullakëta, simpoziumeve dhe kongreseve më qëllim të avancimit të kulturës së debatit;

Implikimi më i madh i Institucioneve politike, akademike dhe artistike me qëllim të kultivimit të frymës së dialogut dhe tolerancës;

Implikimi më i madh i medieve në sensibilizimin dhe promovimin e frymës së dialogut

Ngritja e një uebfaqeje

KRAHËT E THYER
(RECENSION)

Xhubran Halil Xhubran
Titulli në origjinal:
قرّسكتملا قحنجألا
Përktheu nga arabishtja:
MA Jahja Hondozi

Jo se vepra e Xhubranit është e panjohur në tërësi për një pjesë të lexuesve, veçmas në radhët e atyre, të cilët vetë shkruajnë, por kritika jonë, asnjëherë nuk ka dhënë një vështrim domethënës, për këtë autor botëror, kundruall përkthimit të pakët, për një shpërndarje më masive të veprës së tij. Kjo, ndoshta për shkak të paragjykimeve të shumta, por edhe se veprat e tij kanë një ndjeshmëri më mistike, andaj nënkuptohet, meqë neve na mungojnë njerëz me përgatitje të tillë.

Kujtojmë se, vepra e Xhubranit është e përkthyer në Shqip: Nehat S. Hoxha Rilindja, "Jezusi, biri i njeriut", Kuvendi françeskan Gjakovë, në përkthim të P. Lorenci, "Profeti", Toena, Tiranë, në përkthimin e M. Rakipaj, gjë që mund të duket pak, krahasuar me rëndësinë, të cilën e ka opusi i tij, si letrar ashtu edhe ai aplikativ, sepse vetëm Profeti është përkthyer në mbi dyzet gjuhë botërore dhe konsiderohet libri i katërt në botë për kah përhapja dhe lexueshmëria, ndërsa, ai si poet konsiderohet, pas Shekspirit dhe Lao Tze-s, poeti i tretë më i lexuar i të gjitha kohërave, andaj

konkludimi se asnjëherë nuk është bë analiza e duhur e veprës së tij, është shumë i drejtë.

Dr. Suheil Bushrui nga Instituti për hulumtimin e veprës së Xhubranit, pranë Universiteti Maryland në SHBA, ka përgatitur një libër të jashtëzakonshëm në mbi 372 faqe lidhur me veprën e Xhubranit, respektivisht biografinë e plotë të tij dhe libri titullohet"Kahlil Gibran, Man and Poet"[47]. Shpesh edhe emri i tij është shkruar si Khalil, Kahlil dhe tek ne; Halil dhe dallimet mes Gibran dhe Xhubran, kurse emri i plote i tij është Xhubran Halil Xhubran. Gjë që sugjerohet për ta kuptuar më mirë lëvizjen e tij nga lindja në SHBA, përkrahjen që e gjen nga Znj. Marry Elizabeth Haskel, pastaj edhe përkrahja nga një mike tjetër Barbara Young, e cila i kushton një libër të tërë biografik, This Man from Lebanon[48], jeta e tij dyvjeçare në Paris në klasën e artistit të famshëm Auguste Rodin, ndikimet e filozofisë së William Blake dhe Friedrich Nietzsche, në njërën anëdhe nga Ibn Sina, Ibn Rushd, Al Ghazali në anën tjetër, e kompletoi tendencën e tij artistike dhe filozofike, e kështu me radhë.

Veprat e Xhubranit, të cilat karakterizohen me begati leksiku, ndjeshmëri transcendentale dhe lirikë të artikuluar në mënyrë të çiltër, gjë që kjo e fundit e popullarizoi shumë, (sepse flet me gjuhën e popullit), janë mesazhe sa artistike- shpirtërore po aq edhe të kësaj bote, deri te ato politike. Veprat e tij janë si vijon:

Nimfat e luginës, 1906, Shpirtrat rebelë, 1908, Krahët e thyer, 1912, Lot dhe buzëqeshje, 1914, Procesione, 1919, Stuhitë, 1920, janë shkruar në gjuhën arabe, kurse: I marri, 1918, Paraardhësi,1920,Profeti,1923, Rëra dhe shkuma,1926,Mbretëria e imagjinatës, 1927, Jezusi, biri i njeriut, 1928, Zotët e tokës, 1931, Endacaku, 1932) dhe Kopshti i profetit, 1933, janë veprat e tij të shkruara në gjuhën Angleze.

Vepra *Krahët e thyer* është novelë autobiografike, e cila flet për dashurinë e parë të autorit. Ajo është rrëfim romantik i një djaloshi

47 Halil Xhubran, Njeri dhe Poet.

48 Ky njeri nga Libani, 1945

dhe një vajze, të cilët i lidh dashuria platonike, (larg nga kënaqësitë fizike).

Heroi i romanit është një djalosh 18 vjeçar, i cili rrëfen tregimin e dashurisë së tij, si një ndjenjë e shenjtë dhe e papërsëritur, të cilën e përjetoi në lidhje me një vajzë, Selma Kerame.Kjo vajzë, ndërkaq, fejohet dhe martohet me një person tjetër të pasur, duke iu nënshtruar kështu pa vullnetin e saj, ligjeve dhe traditave të kohës. Autori flet në vetën e parë.

Vepra është edhe një tregim ku autori nëpërmjet fatit të heroinës,akuzon shoqërinë patriarkale, viktimë e së cilës ishte Selma Kerame.

Meqë një recension si ky nuk lejon që të hyhet në detaje për të analizuar së paku një vepër të tij ashtu si e meriton ajo, konsiderojmë se, përkthimi i M.A. Jahja Hondozit i veprës **Krahët e thyer**, botuar më 1912, është më se i mirëseardhur për lexuesin tonë, gjithmonë duke pas parasysh se neve në përgjithësi na mungojnë përkthimet letrare dhe përkthimi i kësaj vepre duhet të paraqes eveniment të rëndësishëm kulturor, posaçërisht në Kosovë. E mos të flasim për vështirësitë, të cilat i has përkthyesi gjatë punës së tij andaj vetëm ai, i cili merret me përkthime e veçmas me përkthimin e poezisë e kupton vështirësinë dhe "frikën e të shkruarit", siç thotë Jacques Derrida, respektivisht kapërcimi në një territor të ri të pazbuluar.

Lexuesit tonë i ofrohet një libër, i cili e zbulon një botë krejt të re letrare, filozofike dhe shpirtërore.

Personalisht, sa herë kam lexuar një rresht të Xhubranit, në gjuhën Kroate, Serbe Angleze, Shqipe etj., sikur çdoherë më ka prekur gishti suptil i rrezes së ndritshme të shpirtit të Xhubranit, dhe asnjëherë nuk më ka lënë indiferent dhe konkuldoj; "**Secili që ka ndjeshmërinë e një fëmije, assesi nuk mund e të mos i dridhet zemra, nga fjala e shkruar në këtë mënyrë dhe e cila, guron nga kroi hyjnor**".

Ne, nuk mjafton vetëm ta falënderojmë përkthyesin për punën e lodhshme, por duhet ta promovojmë në këtë mënyrë një lloj të tillë të artit, i cili më (falë këtij përkthimi), nuk është larg nesh.

MEHMET AKIF ERSOY
SI VLERË E PËRBASHKËT

(Kumtesë)

Mehmet Âkif Ersoy- I lindur në vitin 1873 dhe vdiq më 27 dhjetor në Stamboll, ishte Poet turk, Shkrimtar, anëtar parlamenti dhe autor i Himnit kombëtar Turk.

I lindur si Mehmet Rakif nga babai İpekli Tahir Efendi, nga Peja e sotme e Kosovës dhe nëna Uzbeke nga Buhara, Znj. Emine Şerife Hanım. Shkollohet në Fatih Merkez Rüştiyesi dhe shkollën e vetërinës e përfundoi në Mülkiye Baytar Mektebi 1893.

Ligjërues i Historisë dhe Letërsisë në disa universitete. Njohës i mirë i Kur'anit dhe Hadithit.

Është autor i Himinit kombëtar Turk, autor i shumë poezive të përmbledhura, veprat *Safahat* (Fletët, 1911), *Süleymaniye Kürsüsünde* (Në fronin e Sulejmanijes, 1912), *Hakkın Sesleri* (Zërat e Perëndisë, 1913), *Fatih Kürsüsünde* (Në fronin e Fatihut, 1914), *Hatıralar* (*Memoaret*, 1917), *Asım* (*Asım*, 1924), *Gölgeler* (Hijet, 1933).

Hutbe- Fjalime: *Kastamonu Nasrullah Kürsüsü'nde* (në fronin e Kastamonu Nasrullah, 1921), *Kur'an'dan Ayet ve Hadisler* (Fjali nga Kur'ani dhe Hadithi, 1944).

Isha i obliguar t'i bëj ca rreshta lidhur me biografinë dhe veprën e shkruar të Mehmet Akif Ersoy, për disa arsye të çu-

ditëshme, sa do që në një tubim të këtillë duket se është e tepërt të prezantohen shënimet biografike të një figure poliedrike çfarë ishte Mehmet Akifi.

Kam më shumë gishtrinjë në duar se sa njerëz që njohin veprimtarinë e tij, këtu tek ne pavarësisht se edhe në Kosovë ka Kolegje, të cilat mbajnë emrin e tij dhe së fundmi edhe shtëpia botuese Logos-A në Shkup bëri një botim dinjitoz të vepërs *Safahat* (Fletë). Kur e them këtë, nuk kam parasysh nxënësin/ studentin Ksosovar, i cili është dekapituar njga një thesar i dijes, i cili vjen nga provenienca Islame, madje edhe Bejtexhinjtë, mezi janë të prezantuar në kurrikulumin e edukimit fillor, të mesëm dhe universitar e mos të flas për autorë tjerë, të cilët edhe fizikisht nuk kanë jetuar në Kosovë/ Shqpiëri dhe mbarë trojet shqiptare, por elitën intelektuale, Akademinë e shkencave Mediet etj., por faktin se, përpos Orientalistëve të Kosovës, të cilët njohin Yahya Bej Dukagjinin, Prishtineli Mesihin, Mehmet Akif Ersojin etj, Intelektuali Kosovar nuk njeh të vetin, siç njohin intelektualët e popujve tjerë po e zëmë Hebrenjë; Kulturën, Letërsinë dhe kontributin e shkrimtarëve dhe veprimtarëve: Ladino, Yiddish, Mizrahi, Safardi, Ashekanzi, Sabra etj., apo atë më bashkëkohore Amerikane. Por, meqë, kjo temë hap një debat tjetër intelektual dhe unë po e lë me kaq.

Intelektuali ynë ka deficit Identiteti në shumë aspekte, e posaçrisht në elementin Islam. Një mosnjohje e këtillë po na hakmerret me shekuj, një vetmohim i këtillë është i dëmshëm deri në shuarje.

Në një recension, që kam bërë për një poete të shquar kosovare, e cila më doli, instinktivisht pa e ditur se është bija e famliljes se Mehmet Akif Ersojit nga ana e nënës, Znj. Naime Beqiraj nga Peja, kam shkruar se: "Edhe leximi është bërë profesion", sepse në kohët tona njerëzit më shumë shkruajnë se, sa lexojnë dhe po të ndodhte e kundërta nuk do të na ndodhte ky tëhuajsim. Kur e them këtë, e kam fjalën për leximin e trashigimisë letrare, e cila pavarësisht se ka qenë përdhunshëm e larguar nga ne, tani duhet

të jetë pjesë identitare e një kombi të lashtë, siç është kombi shqpitarë.

Derisa në Turqi, emri i Mehmet Akif Ersoy konsiderohet lartë, në Kosovë e Shqipëri njerëzit dinë jashtëzakonisht pak. Në përiudhën në, të cilën jetonte Ersoy, u konsiderua, së bashku me Recaizade Mahmut Ekrem, Abdülhak Hamit Tarhan dhe Cenap Şahabettin, intelektualë avangard të kohës, të cilët kanë kontribuar në formësimin e identitetit kombëtar të Republikës së re Turke, madje në hutbe të tij të njohur na Kastamonu Nasrullah Xhami, haptas ka shprehur kundërshtimnin e tij, lidhur me traktatin e Sèvres, në Francë, mes Italisë, Anglisë dhe Francës,të datës 10 gusht, 1920, ku forcat perëndimore e nënshkruan në Francë, për ndarjen e Perandorisë Osmane.

Mustafa Kemal Attaturku ka qenë adhurues i veprës së Ersoy dhe nga ai madje ka kërkuar që ta përkthej Kur'anin në Gjuhën Turke.

Ajo çka mund ta kënaq secilin shqiptarë, e veçanarisht Intelektualin, është fakti se Mehmet Akif Ersoy në Turqi sot, konsiderohet patriot, poet, njeri i devotshëm, por mbi të gjitha vlerë kombëtare Turke, dhe në secilën biografi të tij, qartë potencohet origjina e tij etnike, që për dallim nga Nëna Terezë, e cila me kontributin e jashtëzakonshëm të saj, në Indi, nuk çmohet për atë që ajo me të vërtetë ka bërë për atë popull, madje ka tendenca që t'ia mohojnë përkatësinë e saj etnike.

Unë konsideroj se Turqia, ia bën nderin e merituar figurës së Mehmet Akif Ersoy, me Universitet me emër të tij, një sërë kolegjësh me emrin e tij nëpër Turqi dhe në kohë të fundit edhe në Kosovë,madje dhe në banknotën Turke të 100 lirave, të viteve 1983–1989 është nderuar figura e Ersoy.

Ne po ashtu duhet të kemi parasyshë se, Kosova ka vetëm ca vite shtetësi dhe si e tillë nuk ka kapacitete që t'i nderoj figurat e veta kombëtare në mënyrë siç bëjnë shtetet me traditë shekullore. Por, ky panel duhet të shërbej si filesë e rëndësishme që të mendohet për një bustë të Mehmet Akif Ersoy në Pejë, në vendilindjen e prindërve të tij, si dhe futja e njësive edukative në

kurrikulume shkollore dhe universitare për t'u njohur më mirë jo vetëm me veprën e Ersoy, por edhe me figurat tjera komëbëtare, të cilat kanë kontribuar jo vetëm në Perandorinë Osmane, por edhe në Egjipt, Liban, Indi e gjithandej globit.

Konkluzion:

Figura madhështore e Mehmet Akif Ersoy është shembëlltyrë e një intelektuali avangard dhe njeriu të qytetëruar, i cili e jep kontributin e vet pavarësisht se, në cilën pjesë të botës ndodhet ai.

Ne vetëm mund të krenohemi, por a do të mjaftonte vetëm krenaria?, konsideroj se duhet të bëjmë diç më shumë lidhur me publikimin e veprimtarisë së Ersoy dhe nderimin e figurës së tij, në mënyrë më meritore. Nëse një gjë e tillë ka qenë e mundur në atë kohë kur ai jetonte, ajo duhet të jetë e mundur edhe sot, ku intelektualët e kohës sonë, do të mund të bashkëvepronin, për të krijuar një ambient, i cili do të kultivonte vlera të përbashkëta si morale, intelektuale, civilizuese etj.,poashtu edhe të njohjes së ndërsjell mes popujve të mëdhënjë dhe atyre më të vegjël dhe çka mund t'i bashkoj ato në këtë kontekst.

27. 12. 2011, Instituti "Yunus Emre", Prizren.

NJERËZIT

LLUKMAN

(NË DIALEKTIN GEGË)

Njihere e pata përmend Lukman Heqimin dhe hikmetin e tij të përmbledhun në tetë fjali, jo vetëm sa mos me e harrue, por edhe me e mësue rininë, që nuk e patën mymkunin me lexue për Lukmanin. Tetë fjali janë botue në numrat e ma hershëm t'JAVËS (shih shkrimin, Shpirti në Letër, ku Lukmani na drejtohet). Lukmani i urtë ka thanë (këte e kam konsumue në "SHUMËSI E PADUKSHME"), kam ndigjue çka kanë thanë 8000 profetë dhe prej tyne i kam mbajtë në mend 8 fjali, e ato janë:

KUR JE NË SHTËPI TË HUEJ, RUEJI SYTËKUR JE NË NDONJI TUBIM, RUEJE GJUHËNKUR JE TUE HANGËR, RUEJE FYTIN

KUR JE TUE U LUTË, RUEJE ZEMRËN

Dy gjana duhet gjithmonë me i harrue: NJI T'MIRË QË JA KE BA DIKUJT NJI T'KEQE QË TA KA BA DIKUSH

Dy gjana gjithmonë duhet me i mbajtë n'mend: VDEKJEN DHE ZOTIN

Emni i tij asht përmend n'disa mënyra si Lukman, Lokman, Luqman…krejt mvaret se kur dhe kush e ka përdorë. N'traditën Jahudi e Nasrani, Lokmani nuk përmendet aspak, kurse n'traditën Islame nami i tij po bahet barabar me ate të hazreti Sylejmanit.

Krejt çka asht thanë për te mbetet hajal, por ka edhe sende sahi t'cilat përmenden edhe n'Kur'anin e madhnueshëm, n'suren Lukman 31: 12, 13. Prej traditës arabe thuhet që Lukmani ka jetue n'vitin 1100 para hazreti Isas, ka qenë habesh (etiopian) i zi, me flokë të denduna, djali i Baurit, i cili ka qenë djali apo nipi i motrës së Jobit. Shumë shpesh Lukmanin e kanë përzi me Ezopin, i cili po ashtu ka qenë zezak, ka jetue 500 vjet mbas Lukmanit dhe i ka përdorë hikajet (fabulat) e Lukmanit, tue i përvetsue. Lukmani ka qenë i njoftun si njeri me ymër shumë t'gjatë, i cili llogaritte me shtatë ymre t'shqiponjës, që domethanë afro 560 vjet.

Ai kishte përpilue LIBRIN E ZI, ku pat mbledhë ilaçet për tana iletet dhe thonë se paska gjetë ilaçin kundër dekës, por, tevona takohet me Melaqin e dekës, Azrailin, n'urën Misis mbi lumin Xhejhan, ku ky e shtynë dhe i gjuen librin n'lum.

Nji tjetër rast përmendet, hikmeti i Lukmanit sa ishte taleb te hekimi i tij, i cili kish adet me provue secilin jemek e tevona e hante hekimi. Ishte nji pjepën, i cili kish nis me u kalbë dhe Lukmani si zakonisht e provon i pari dhe hiç nuk jepte xhevap, a thue se ish pjepën i ambël. Përkundra, ish kanë shumë i idhtë. Kur e provon hekimi i tij, habitet dhe e pyet Lukmanin, pse nuk dha ndonji isharet e me reagu për idhësinë e pjepnit? Lukmani i thotë: ...sa shumë ambëlsi kam shijue prej teje, si du me u trishtue me nji copë t'idhtë pjepni.

Ky temsil na difton ashiqare se, sa falënderues ishte Lukmani për ilmin, që e muer prej hekimit t'vet. Kimeti i shembullit të Lukmanit asht shumë i madh për ne, se jena ispat që asgja nuk po na shkon marë, jo se nuk jena t'aftë, po se nuk jena t'paçë në nijetin dhe n'ruhin tonë. Ka me kalue edhe nji kohë shumë e gatë derisa dalim prej gafletit dhe derisa e shprazim zemren tonë prej territ dhe e zbukurojmë ate, sepse Zoti asht Nur dhe e don dritën, sepse Zoti asht i bukur dhe e don bukurinë.

Fahredin Shehu ka shkrue: Ai qi mësohet me dashtë, Zahmet asht me u ç'mësue.

MAHMOUD FARSCHIAN

Mahmoud Farshchian, është emri i mjeshtrit më të madh të pikturës Iraniane. Piktura Iraniane ka kaluar nëpër disa etapa dhe ka arritur, që të jap një emër të njohur edhe përtej kufinjëve të Iranit. Prej Iluminacioneve të teksteve sakrale, kaligrafisë, motiveve florale në murale dhe arabeska në çdo cep të krijimtarisë figuratvie iraniane, Mahmoud Farshchian i transcendon të gjitha këto, duke u paraqitur si fenomen me mjeshtri të rrallë.



Motivet, personazhet, imagjinata figurative dhe abstrakcionit të reales janë të llojllojshme dhe të shumëta, duke u nisur nga temat e Iranit paraislam, periudhës së artë të letërsisë, veçanërisht asaj mistike, Elementit Shiit Islam, deri tek peisazhet fiktive, e bëjnë Mahmoud Farshchian një gjeni të sojit të vet.

Institucionet, Mbretëritë, Kolekcinarë dhe Galeri të ndryshme, posedojnë veprat e Mahmoud Farshchian, të cilin dallojnë në artin bashkëkohor, si të veçantë.

Vepra e Mahmoud Farshchian, frymon ekzakt në notën Orientale dhe është aq e dallueshme sa që, për atë që e njëh pu-

nën e tij e dallon njëlloj si dallohet në Perendim; Salvador Dali, apo Vincent Van Gogh, si tepër të veçantë dhe të dallueshëm në produktin perendimor.

Produkti vizuel perëndimor dallon nga ai lindor, i cili më shumë ishte i koncentruar në kaligrafi, peisazh dhe portret të një cilësie dhe koncepti diametralisht të ndryshëm nga ai perendimor. MeMahmoud Farshchian, piktura e Iranit fiton emër "Piktura Iraniane".

Sikurse me Hokusain; piktura Japoneze, me Van Delft, Rembrandt; ajo Flamane, apo Snanjollja me, Velasquez, apo Gjermania me Dyhrer, ajo Franceze me Lë Nen, Gaugin, Renoir etj., nëse veç filluam të flasim për piktura kombëtare.

Në këto relacione emrat e piktorëve perëndimor, prej Da Vinci e deri të Kandinsky e Pollock, piktura kombëtare Evropiane dhe më vonë ajo Amerikane, merr dimensione më të gjera dhe është pikturë e hemisferës horizontale Perendimore.

Mahmoud Farshchian me artin e tij, e afron Lindjen me Perendimin, e sjell atë në Perendim si Osho, Idries Shah, Gibran-Filozofi/Letërsi në mënyrën e tij të veçantë.

Piktura e tillë, Lindore, pothuaj asnjëherë nuk i është ofruar Perendimit në këtë mënyrë.

Biografia

Mahmoud Farshchian u lind në Isfahan më 24 janar, 1930. Babai i tij ishte tregëtar qilimash dhe ai, i cili i mbodhi djaloshit dashurinë për art. Mahmoud Farshchian, artin e ka studiuar tek Haxhi Mirza-Aga Emami dhe Isa Bahadori, për disa vite me rradhë. Pas marrjes së diplomës në Shkolën e lartë të Artit, në Isfahan ai shkoi në Evropë, ku studioi veprat e mjeshtërve të mëdhënjë Evropian të pikturës. Si rrjedhojë e kësaj, ai zhvilloi stilin e vet, inventiv artistik me thirrje universale.

Pas kthimit të tij në Iran, ai filloi të punoj në Institutin e Arteve të bukura në Teheran, që më vonë u bë Ministri e Artit dhe Kulturës ku u emërua drejtor i Departamentit të Artit Kombëtar dhe Profesor në Shkolën e Arteve të Bukura në Teheran.



Gjatë kësaj kohe u përhapën fjalët për artin e tij të veçantë edhe përtej kufinjëve të Iranit; Evropë, Amerikë, dhe vendet e Azisë, ku kishte ekspozuar në 57 ekspozita individuale dhe 86 ekspozita kolektive Europe, Amerikë dhe vendet Aziatike. Punimet e tij janë të ekspozuara në disa muze dhe kolekcione më të rëndësishme botërore. Është dekoruar me doktoratin (Grada e parë në Art) në artin Iranian dhe Islam nga Këshilli i lartë i Kulturës dhe Artit, si dhe më shumë se dhjetë çmime nga institucionet dhe qendrat kulturore.

I inauguruar në vitin 2001 «Muzeu i Mjeshtër Mahmoud Farshchian», është muze, i cili është dedukuar veprës së tij, i cili është i themeluar nga Fondacioni i Trashigimisë Kulturore në Kompleksin Kulturor Sa›dabad në Tehran.

Master Farshchain aktualisht jeton në New Jersey.

Për punën e Mjeshtrit Mahmoud Farshchianjanë botuar gjashtë libra dhe një numër tepër i madh artikujsh.

Librat

- Piktura dhe vizatime (1976)
- Pikturat e Mjeshtrit Farshchian në Shahnameh të Ferdowsi (1991)
- Pikturat e heronjëve të mëdhënjë tëShahnameh (1991)
- Mahmoud Farshchian Vëllimi II, Përzgjedhur nga UNESCO (1991)
- Pikturat e Mjeshtrit Farshchian në Diwanin e Hafez (2002)
- Pikturat e Mjeshtrit Farshchian në Rubaiyat të Omar Khayyam (2004)
- Mahmoud Farshchian Vëllimi III,Përzgjedhur nga UNESCO (2004)

Shpërblimet

- 2001 - GODIVA Chocolates, Përvjetori i 75-stë, SBA
- 2001 – Kush është Kush në shekullin 21, Cambridge, Angli
- 2000 – Intelektual të shquar të shekullit 21, Cambridge, Angli
- 1995 – Medalja e artë, Nderi më i madh
- 1987 – Palma e artë e Evropës
- 1985 - Oscar D›Italia, Statuja e artë.
- 1984 - Vessillo Europa Delle Arte, statuja e artë, Itali
- 1983 - Diploma Accadenu›co D›Europa, L'Accademia D›Europa, Itali
- 1983 - Diploma Maestro Di Pittura, II Seminario d›Arte Moderna, Itali
- 1982 - Diploma Di Merito, Universita Delle Arti, Itali
- 1980 - Academia Italia delle Arti e del Lavoro, medalja e artë.
- 1973 – Ministria e Kulturës dhe Artit , çmimi i parë, Iran
- 1958 – Festivali Ndërkombëtar i Artit, medalja e artë, Belgikë
- 1952 – Arti Ushatarak, medalja e artë, Iran.

- Është anëtarë i Academia Europea dhe Academia Italia Delle Arti e Del Lavoro.

Kolekcionarë të veprës së Mahmud Farshchian

- Mbretëresha Elizabeth e Anglisë
- Mbretëresha Juliana e Holandës
- Princi Agha Khan
- Lyndon Johnson, Ish President i SHBA
- Gjenerali Ernesto Geisel, ish President i Brazilit
- Princi i kurorëzuar Akihito i Japonisë
- Giuseppe Saragat, Ish President i Italisë
- Lal Bahadur Shastri, Ish Kryeministër i Indisë
- Senatori William Fullbright
- Profesor Arthur A. Pope
- Profesor Dr. Hossin Sadeghi, Zvicërr
- Ghassan Shaker
- Muzeu Nacional i Artit, Iran
- Muzeu i Artit Bashkëkohor, Iran
- Muzeu i Artit i Stambollit, Turqi
- Muzeu i Lahores, Pakistan
- Madison Corporation i Washington, D.C.
- Bob Guccione, New York
- Bohrer Collection, New Jersey
- Panes Collection, New Jersey

Mirënjohjet/medaliet

- Princi Phillip i Anglisë
- Giscard D›Estang, ish- Presidenti i Francës
- Ramzi Sanbar, New York
- Marshall Quen, Washington, D.C.
- Furnishing Systems Inc., New York
- Hilton Hotel, Tehran
- Qendra për Art dhe Kulturë, Tehran
- Ministria e Punëve të Jashtme të Turqisë, Ankara
- Line & Tone Co., New York

Galeria



Kënga e harmonisë



Sythi i mëngjesit



Fryma e fundit e Feniksit

MURAT YAGAN

Murat Yagan, i lindur më 16 dhjetor, 1915 në Abkhazi. Paraardhësit e tij kanë dal nga rajoni i Ashkhara-s, në Veri të Kavkazit mes maleve të Kavkazit, Detit të Zi dhe Detit Kaspik, për çka ai konsideron se, është pjesë e Abkazisë së madhe historike.



Familja e tij e la Kavkazin dhe migroi në Turqi. Babgjyshi i tij, Sat, kishte sjellur 15,000 njerëz në Turqi. Sat-i kishte tre vëllëzër me të vegjël, Gut, Tat dhe Asher. Tat-i shkoi në Egjipt dhe u vendosnë Kajro dhe u bë i njohur si, Mithad Pasha. Ai kishte një djal të mrekullueshëm, të cilin e emëroi Adley Pasha Yagan, i cili u shkollua dhe u bë Kryeministër i Egjiptit, në vitin 1920 dhe sërish në vitin 1926. Kur mbreti Faruk qe i detyryar të jap dorëheqje, busti i Adley Pashës mbeti vetëm në oborrin e muzeut.

Ende ekziston rruga Shar-i-Adley në Kajro.

Met ishte emri i babait të Murat Yagan, ndërsa klani Yagan ishte degë e familjes princërore Maan. Met ishte në pozitën e lartë të perandorit të fundit Otoman, ai mori anën e Turqëve të rinjë nën udhëheqjen e Kemal Ataturkut. Pas shpalljes së Re-

publikës Turke, në vitin 1923, babai i Muratit u bë deputet i Parlamentit të parë Turk nga provinca e Rumelisë, por në vitin 1926 dha dorëheqje për shkak të injorimit të të drtejtave kulturore, të pakicave etnike nga ana e qeverisë, veçanërisht minoriteteve të Kavkazit. Ai vdiç në vitin 1927 në funeralin e, të cilit ishte edhe Kemal Ataturku. Nëna e Met-it, ishte nga familja e prijësit të famshëm Ubykh; Haji-Berzek Kiarantukh. Ky prijës ka refuzuar që, Ubykhia të jetë e okupuar nga Rusët, kështu që, e mori tërë popullin e vet dhe migruan në Turqi.

Murat Yagan më dashuri i kujton mësuesit e tij, të cilët e edukuan fizikisht dhe shpirtërisht, sipas traditës Abkazo- Adygeje; Omar Beyaga, poet i famshëm dhe historian dhe Mustafa Butba, autorin e alfabetit Abkazian, të botuar ë Stamboll, në shekullin e kaluar. Murati po ashtu u jnoftua edhe me specialistin francez për Kavkazin; George Dumézil, të cilin Murati e gostiti për tre muaj, nëpër fshatra Abkaziane, Ubykh dhe Adyghe na Anadolli.

Murat Yagan ka filluar të shkruaj në moshë të re, por fatkeqësisht asgjë nuk ka mbetur, sepse ishin lënë në Stamboll, në shtëpinë e nënës, të cilat janë humbur. Ai e kujton vetëm një poemë në gjuhën Abkaziane, të cilën e shkroi në moshën 14 vjeçare.

Në fillim të vitit 1975, Murati filloi të ligjëroj një grupi të studentëve të tij, grupi, i cili shumë shpejt u zhvillua. Në vitin 1992, ata themeluan Fondacionin në Vernon qëllimi, i të cilëve ishte të dokumentojnë një traditë të lashtë gojore; Traditën Kebzeh dhe aty me mijëra inçizime nga, të cilat nxirren transkripte dhe përgatiten librat, që të mos humbet kjo traditë dhe që ajo të popullarizohet. Në Kanada dhe SHBA, janë mbi dyqindë dhe ata kanë grupe në Evropë dhe Izrael, udhëhequr nga Lisa Talesnik.

Murat Yagan, me gruan e tij, Maisie **Gogua-pha** nga fshati Abkazian i Turqisë, **Duzce,** jeton në Vernon, British Columbia, më i vjetër se 90 vjet, ende është i zënë me punë tjera edhepse u pensionuan nga drugdhendja.

Ahmsta Kebzeh, nga të huajt e njohur si Yoga e Kavkazit, është traditë e malorëve të Kavkazit, që tani është shumë vështirë

të gjindet mësimi në tërësi, por vetëm fragmente. Shumë vëllime të librave, mbulojnë vetëm pjesën intelektuale, ndërsa ajo aplikative duhet të kryhet me angazhim personal, si; mësimi i notit, instrumentit ose biqikletës. Ahmsta Kebzeh është shkencë e plotë, duke shfrytëzuar të gjitha kapacitetet humane dhe në tërësi.

Cirkazianët si, i quajnë në Perëndim janë, të ndarë në nëntëmbëdhjet fise të ndryshme dhe me gjuhë të ndryshme dhe Murat Yagan i takon fisit Abkaz. Kebzeh është karakteristikë e të gjitha fiseve dhe u takon të gjithëve, edhepse dallon në bazë të nivelit gjeografik, sa më lartë në male, aq më e pastër është tradita mijëvjeçare, dhe pasi që Murati është nga grupi i malorëve të lartë, të njohur si Abaza, ai në tërësi e transmeton Kebzen e këtij grupi.

Përmbajtja e Kebzeh

Kebzeh përbëhet nga tri nivele të mësimit dhe aplikimit:

Aleishwe

Kebzeh

Ahmsta Kebzeh

1. Aleishwe (*Etiquette*). Sjellja- mirësjellja ose niveli i edukimit, i cili rregullon rregullsinë shoqërore. Mund të defonihet si Etiquette ose mënyrë e sjelljes- normë e pashkruar të marëdhënieve ndërnjerëzore; parimet e përgjithëshme të jetës, punës, veshjes, shalimit të kalit, përshëndetjes, takimit me njerëz për herë të parë, rregullat ceremoniale si martesat, funeralet, vizitat me njëritjetrit etj.

2. Kebzeh (*Tradita, konceptet dhe parimet shoqërore)*. Niveli i edukimit, i cili rregullon dijet rreth administrimit. Shoqëria feudale e Kavkazit, në mënyrë strikte i ka rregulluar sistemin kastik në këto nivele: 1) Udhëheqësit, 2) Administratorët, 3) Fisnikët, 4) Njerëzit, 5) Shërbëtorët.

Disciplina e Kebzeh, i është dhënë klasës së Udhëheqësve. Ajo përbëhet prej të gjitha dijeve të nevojshme për këtë klasë, që në mënyrë sa më të mirë, të administrojnë funkcionet e veta në shoqëri.

Fëmija i lindur në këto klasa, merrë pjesë aktive, në të gjitha veprimet e shoqërishë ashtu që, e gjithë veprimtaria së bashku me trajnimin intelektual, bëhet në shërbim të tij dhe dija e tij rritet kur e merr pozitën në shoqëri.

3. Ahmsta Kebzeh (*Tradita e Elitës*). Këtë pjesë të Kebzeh, hulumtuesit perëndimor, që nga shekullii i XV, e kanë quajtur Yoga e Kavkazit. Mësimet dhe trajnimet e Ahmsta Kebzeh, u janë dhënë vetëm fëmijëve të klasës udhëheqëse, ose në raste të veçanta kushdo që, ishte në gjendje të zhvilluar humane ta pranoj, nga burimi i mësimit.

Segment/ kurikulumi i trajnimeve/mësimeve në Kebzeh Fonudation Canada

Jetë e plotë dhe kompletimi i njeriut
Kerko të drejtën e jetës dhe Kanaat
Ushtrime fizike
Urrejtja dhe falja
Lutja
Mesimet Kebzeh, Bazat e Sufizmit nga Malet e Kavkazit
Dashuria
Fenomeni i efektit kumulativ dhe ushtrimi i trupit të brendshëm 1, frymëmarrja dhe ngjyrat
Mbretëro dëshirën
Historia dhe tradita e Ahmsta Kebzeh
Komuniteti, Lidershipi dhe Sinergjia
Intelekti dhe Ego
Dituria
Vullneti
Seksualiteti dhe Shpirtnia
Ushtrimi i trupit të brendshëm 2, Meditimi
Jeta: Krijimi, evolucioni, ç'është Zoti?, elementare
Nivelet e vetëdijes
Kontemplacioni
Vendimet: Burimi Absolut

Fondacioni Kebzeh ka themeluar shtëpinë e vetë botuese; Kebzeh Publications, në Kanada, të cilët kanë botuar pesë librat e Murat Yagan:

"I Come From Behind Kaf Mountain[49]" (dy botime në Kanada dhe një në përgatitje për botim në Londër);

The Teachings of Kebzeh; The Abkhazian Book of Longevity and Well-Being[50],

Përkthimi i Muratit në gjuhën Angleze, të krijimeve poetike të dy mësuesëve të mëdhënjë Sufi,të mesjetës, Gaibi (Gaibi - The Gathering[51]) dhe Yunus Emre (I Wrapped Myself in Flesh and Bones I Appeared as Yunus[52]), dhe shumë broshura tjera.

Tani Murat Yagan punon në një libër, më të madh të tij, Libri i Ahmsta Kebzeh në, të cilin mësimi është paraqitur në formën më të plotë dhe më komplete.

49 Ang. Unë vij nga pas Malit Kaf. Tituj të librave nuk janë përkthyer në trupin e tekstit për shkak se lexuesi i interesuar, i cili lexon Anglisht të mund t'i gjej më lehtë në gjuhën në të cilën janë shkruar.

50 Mësimet Kebzeh: Libri Abkazian i jetëgjatësisë dhe mirëqenies

51 Ang. Kuvendi

52 Ang. E mbështolla vetën në mish dhe kocka dhe u manifestova si Yunus

LALEH BAKHTIAR

Biografia:

Laleh Mehree Bakhtiar, është e bija e nënës krishtere dhe babait mjek Iranian, të cilin e njoftoi si e rritur. Nëna e saj nuk ishte katolike, por e dërgoi në shkollën katolike dhe në moshën 8 vjeçare, Laleh Mehree Bakhtiar dëshiroi të bëhet katolike për çka nëna e saj nuk kishte asgjë kundër. Në moshën 24 vjeçare për herë të parë udhëtoi për Iran me ish burrin e sajë dhe katër fëmijë, duke mos ditur asnjë fjalë përsisht. Filloi të marrë orë të gjuhës Angleze në Universitetin e Teheranit. Mësimet e Kulturës dhe Qytetërimit Islam mori nga Seyyed Hossein Nasr. Ajo ka jetuar 9 vjet e rrethuar nga Xhaferit (Shia), të Iranit dhe e edukuar me mësimet Sufi, ajo përvetësoi edhe këndvështrimet Hanefi, Hanbeli, Maliki, dhe Shafi (Suni), në 15 vitet e fundit në Chicago, më miqët Maliki dhe Shafi. Laleh Mehree Bakhtiar e lindur më 29 korrik 1938, në New York City, SHBA është Iraniano-Amerikane, shkrimtare dhe përkthyese. Ajo ka përkthyer dhe punuar në më se 25 libra rreth Islamit, përfshirë edhe Kur'ani sublim, përkthimi në gjuhën Angleze i Kur'anit, që e bën femër të parë dhe Amerikane të parë, që e përkthen Kur'anin në gjuhën Angleze.

Puna e saj bazohet kryesisht në dialogun mes Muslimanëve dhe Jo-Muslimanëve. Ajo tani jeton në Chicago, që nga viti 2007. Ajo u bë Muslimane pasi që u martua me burrin e saj Musliman.

Kāfirūn ajo e përkthen si «ata të cilët janë mosmirënjohës» në vend të përkthimit të zakonshëm «jobesimtar» ose «I pafe.»

Disciplinat dhe fushat studimore të sajë janë: Psikologjia Konsultative, Studime Fetare.

Edukimi:

- Chatham College, Pittsburgh, PA , B. A. në Histori, 1960
- Boston University, Shkolla Juridike, 1961
- University of Pittsburgh,Shkolla Juridike, 1960-61
- Harvard University, College of Arts and Sciences, Student Special, 1962
- Tehran University, Kolexhi i Arteve she Shkencave, Studioi Islamin, Kulturën Islame dhe Qytetërimin, Gramatikën Arabe
- University of New Mexico, Kolexhi i Arteve dhe Shkencave, M. A. në Filozofi me përqëndrim në Studime të religionit, 1991
- Universitetin New Mexico, Kolexhi i edukimit dhe merr magistraturën në Psikologji këshilluese, në vitin 1991, po ashtu edhe Magjistraturën në
- Universitetin New Mexico, Kolexhi i edukimit dhe merr doktoratin në Psikologji Edukative në vitin 1994.

Përvoja Profesionale

- University of Chicago,Ligjëruese, Lutheran School of Theology
- Bordi i këshilltarëve, Qendra për Religjione dhe Media, Northwestern University, Chicago,IL
- Bordi i themeluesëve, Këshilli për Parlamentin e Religjineve Botërore, 2000-2001

- Kryetare e Instituti i Psiko-etikës tradicionale dhe udhërrëfyese, etj.

Librat:


- SUFI Shprehja e çështjes Mistike, Thames and Hudson; 1976
- Shoqërues të Muhamedit: ese mbi disa të cilët dëshmuan Mesazhin e Tij
- Vullneti i Zotit do të realizohet: Vëllimi 1: Psiko-etika tradicionale dhe Paradigma personale
- Vullneti i Zotit do të realizohet: Vëllimi 2: Doracaku i Shëruesit moral: Psikologjia e Kalorësisë shpirtërore
- Vullneti i Zotit do të realizohet: Vëllimi 3: shërimi moral nëpërmjet Emrave të më të Bukur: Praktika e Kalorësisë shpirtërore
- Sufi Femra Amerikane: Engjejtë në ndërtim
- Etika Islame: Seria e librave për edukim moral: Perspektiva ndërfetare, shkalla 1
- Etika Islame: Seria e librave për edukim moral: Perspektiva ndërfetare, shkalla 2
- Etika Islame: Seria e librave për edukim moral: Perspektiva ndërfetare, shkalla 3
- Al-Ghazzali Psikologjia e tij e Përpjekjes më të madhe

Bashkëautore:

- Ndjenja e Unitetit: Sufi Tradita në Arkitekturën Persiane University of Chicago Press, të drejtat e shituraABC International Group, Inc.
- Enciklopedia e Shoqëruesëve të Muhamedit dhe traditave që i përkisnin ABC International Group, Inc.
- Helena e Tusit: Odiseja e sajë nga Idaho në Iran ABC International Group
- Abol Ghassem i Tusit: Avantura epike e Abol Ghassem Bakhtiar, M.D. ABC International Group

KUDSI ERGUNER

Kudsi Erguner paraqet një emër të madh në skenën muzikore botërore. Në mes Parisit dhe Stambollit, deri në Indi, Pakistan, Afganistan ai depërton thellë në zemrat e dëgjuesëve të muzikës tradicionale botërore.



Është ndër instrumentistët më të shquar të NEY për, të cilin ai vet shprehet:

"*Flauta e kallamit e quajtur Ney, është instrument i privilegjuar i muzikës Sufi. I pavdekshëm në vargjet e poetit Sufi; Jallal ad-Din Rûmi, Neyi përfaqëson simbolin e shpirtit të ndarë nga Hyjnorja dhe mallimi për unifikim. Si i tillë është imazh i "Njeriut të Përkryer", dhe saktësisht demonstron atë që, mistiku shpreson të arrijë, një guaskë boshe e ringjallur nga fryma Hzjnore*".

Kudsi Erguner[53]

53 Intervistë me Kudsi Eguner, www.melbournefestival.com.au

I lindur në Diyarbakır, Turqi më 1952. Ai konsiderohet mjeshtër i madh i muzikës tradicionale të Mevlevi Sufi dhe është njëri nga instrumentistët më të mirë të ney-it Turk.

Qysh si fëmijë, me ta atin e tij; Ulvi Erguner, mori pjesë në Sema dhe ceremoni Sufi. Karierën e tij, e filloi në "Radio Istanbul", në vitin 1969. Për disa dekada me rradhë, ai studioi rrënjët e muzikës tradicionale Osmane, të cilën u transmetoi edhe të tjerëve, të cilën e ekzekutoi dhe incizoi.

Rrjedh nga familja me traditë muzikore. Babai i tij, Ulvi Erguner, dhe gjyshi i tij, Suleyman Erguner, ishin të njohur si instrumentist të shquar të Ney-it. Krahas prindërve ai mësoi edhe nga mjeshtrit e vjetër, të cilët ishin miqë familjar. Më vonë edhe vetë duke studiuar trashigiminë Sufi.

Në vitet e 70-ta, shkon në Paris për të studiuar Muzikologjinë dhe Arkitekturën dhe në të 80-tat, themelon Institutin Mevlana[54] për studim dhe ligjërim të muzikës klasike Osmane duke ,u kthyer deri në shëkullin XII.

Ai mori pjesë në filmin e Peter Brook "Meetings with Remarkable Men[55]" në 1978.

Krahas inçizimeve të tija me Kudsi Erguner Ansambël, ai poashtu bashkëpunoi me muzikantët më të shquar të kohës sonë, si Peter Gabriel (The Last Temptation Of Christ, muzika për filmin Tundimi i fundit i Krishtit), Jean Michel Jarre, Maurice Béjart, Peter Brook, George Aperghis, Didier Lockwood, me kantautren Italiane Alice dhe Michel Portal, muzikë filmash,pjesa teatrale"Mahabharata", dhe balete, "Le Voyage Nocturne" dhe "Neva", me Martin Scorsese dhe Marc Minkovski.

Ansambli i tij,Kudsi Erguner Ensemble, është formuar në vitin 1988, si "Fasi", me qëllim të ruajtjes së muzikës tradicionale të Perandorisë Osmane, të Shekullit XVI.

54 Pas hulumtimeve në Turqi kthehet në Parisdhe nëpërmjet një granti nga UNESCO, në 1980, Kudsi Erguner e themelon Institutin Mevlana.

55 Takimi me njerëz të shquar, filmi i bazuar në jetën dhe librin me të njejtin titull nga Georgije Ivanovich Gurdijjeff. Filmi është xhiruar në Afganistan.

Mes viteve 1986 dhe 1987, Kudsi Erguner një kohë bukur të gjatë kalon në Pakistan duke inçizuar dhe dokumentuar muzikat tradicionale për Radio France dhe France Musique.

Në vitin 1987, Kudsi Erguner shfaqi një koncert të Muzikës Klasike Osmane nëRoyal Albert Hall në Londër.

Diskografia[56]

- Meditation on the Ney
- Turqia: Art of the Ottoman Tanbur, 1989
- Sufi Music of Turkey, me Suleyman Erguner, Mahmoud Tabrizi Zadeh, Bruno Caillat, 1990
- The Turkish Ney, me Salih Dede, Suleyman Erguner, 1990
- Whirling Dervishes from Turkey, me Kemal Evren, Tugrul Inancer, Aram Kerovpyan, Muzzffereddîn Ozak, Hafiz Kemâl Ozmutlu, Mahmud Tabrîzîzade, 1991
- Gazel: Classical Sufi Music of the Ottoman Empire, me Husnu Anil, Aziz Bahriyeli, Yusuf Bilgin, Mehmet Emin Bitmez, Suleyman Erguner, Hasan Esen, Fevzi Misir, Walter Quintus, Kurt Renker, 1994
- Peshrev & Semai of Tanburi Djemil Bey, 1994
- L'Orient de L'Occident: Flamenco & Ottoman Sufi Music, me Yusuf Bilgin. Mehmet Emin Bitmez, Bruno Caillat, Pedro Soler, 1995
- Ottoman Classical Music, 1995
- The Sacred Flute of the Whirling Dervishes, 1996
- Works of Kemani Tatyos Efendi, me Husnu Anil, Mehmet Emin Bitmez, Suleyman Erguner, Necip Gulses, Dogan Hosses, Sükrü Kabaci, Baki Kemanci, 1996
- Vocal Masterpieces of Kemani Tatyos Efendi, me Husnu Anil, Suleyman Erguner, Necip Gulses, Dogan Hosses, Sükrü Kabaci, Baki Kemanci, 1996

56 Tituj të albumeve nuk janë përkthyer për shkak të ruajtjes së origjinalit, në rast se lexuesi kërkon të gjej këto albume

- Psalms of Yunus Emre, me Yusuf Bilgin, Bruno Caillat, 1997
- Chemins, me Pierre Rigopoulos, Martin Saint-Pierre, Derya Turkan, 1997
- Music from the Arabian Nights, me Bruno Caillat, Tabrizi Mahmoud Zadeh, 1999
- Ottomania, 1999
- Islam Blues, me Bruno Caillat, Renaud Garcia-Fons, Nguyên Lê, Derya Turkan, Mark Nausesf, Yunus Balcioglu, Halil Neciboglu,2001
- Taj Mahal, me Bruno Caillat, Sultan Khan, Fazal Qureshi, Derya Turkan, Ken Zukerman, 2001
- Gazing Point, me Markus Stockhausen dhe Mark Nauseef, 2003

FATIMA MOHAMED KADDUR[57]

Aështë Fatima Mohamed Kaddur, ringjallja e Spanjës Maure, apo ringjallja e Evropës, do të duhet të pritet që të shihet. A do të merr Convivnencia Spanjolle para 1497 (të debimit të Muslimanëve dhe Hebrenjëve nga Spanja), do të shohim sa do të jetë në gjendje Evropa ta pranoj këtë mënyrë të jetës. A ka mësuar Evropa nga gabimet e veta. Ne kemi mësuar sigurisht nga gabimet tona, ne mësojmë nga Evropa çka është fjala e lire; liria e shprehjes, menaxhimi i kohës, menaxhimi i stresit, menaxhimi i ndryshimit, zgjidhja e konfliktit, teknikat e negocimit, e shumë e shumë gjëra tjera. Tolerancën filluam ta mësojmë, si mësim stereotip, sepse ne këtë e kemi dëshmuar shekuj me rradhë. Evropa shumë vonë e kuptoi se, ne kemi tolerancë natyrale dhe me serbët ishim në luftë, si



(Foto: ©Bénedicte Salzes)

57 (Foto: ©Bénedicte Salzes) -http://www.cafebabel.com/eng/article/30385/fatima-mohamed-kaddur-muslim-politician-spain.html

populli kundër popullit e, jo feja kundër fesë. Dhe pikërisht hebrenjët janë ata, të cilët i spjeguan Evropës, situatën tonë.

Ajo që është më e çuditshme, jo vetëm për Muslimanët, por për të gjithë, është se, ajo është anëtare e një partie Spanjolle me trashigimi Katolike.

Fatima punon në Gines, një komunë në provincën e Sevillesë, me më pak se dymbëdhjetmijë banorë dhe anëtare e Partido popular (Partia Popullore). Fatima është 43 vjeçare dhe vjen nga Melilla me 45% të popullatës muslimane, një qytet autonom në bregun Maroken, i cili ra në duar të Spanjës, në vitin 1497, gjatë Reconquista (reokupimit) të mbretërve katolik. Partido Popular është parti e qendrës së djathtë, me trashigimi katolike. Madje, për shumë Spanjoll të tanishëm, konsiderohet parti opozitare raciste.

Ajo sqaron se, një pjesë e familjes së sajë është në Francë dhe ata jetojnë me parime Islame pa dhunë, d.m.th., atë askush nuk e ka detyruar të mbaj shami, as që, ajo do t'i detyroj vajzat e sajë; njëra 21 vjeçare, e tjetra 13 vjeçare, të mbajjnë shami, por kjo do të jetë zgjedhje personale. Ajo ka edhe një djal 19 vjeçar. Ajo dëshiron ta sfidoj edhe Sarcozy rreth kësaj çështje.

Ajo thotë se, partia e saj e ka përkrahur në kundërshtimn e sajë, ndaj Mariano Rajoy, i cili në shkurt 2008, vendosi disa restrikcione kundër mbajtjes së shamisë.

Ajo është kryetare rajonale e Afammer (asociacioni i grave dhe familjeve rurale), i cili fokusohet në mundësi të punësimit dhe parandalimit të dhunës gjinore.

Ajo udhëheq kursin në Universitetin e Telekomunikimit në Seville, mbi " Religjionin dhe Shoqërinë".

Në vitin 2010, do të ndërtohet xhamia e re në lagjen Cartuja 93, pas shatqindepesëdhjet vjet, kur xhamia e fundit në Seville u konvertua në kishë, Seville do të ketë sërish Xhami.

Xhamia nuk do të ndërtohet në lagjen Bermejales, siç ishte planifikuar më herët por në "Ujdhësën" e Cartuja, e cila është mes dy degëve të lumit Guadalquivir. Lokacioni është parku teknologjik, i cili u urbanizua për ekspozitën Univerzale të

Qytetit në vitin 1992. Aty janë të vendosura edhe shumë kompani, universitete, gazeta, qendra hulumtuese dhe zyre administrative. Në anën perendimore të zonës, kah sheshi Carlos III, xhamia do të ndërtohet në hapsirën prej 6000 metra katrorë. Ajo do të jetë qendër kulturore, krahas funkcionit original të saj për adhurim.

Asociacioni "Las Bermejales 2000", në emër të popullatës, ka kundërshtuar që, të ndërtohet kjo xhami, por Fatima dhe Emilio Gonzáles Ferrín- ekspert i Islamit në Universitetin e Seville-s, janë të bindur se, një kundërsthim i tillë, nuk është për shkak të Islamit si të tillë, por për shkak të dobishmërisë së lagjes në shfrytëzim.

LOREENA MC KENNITT

Shumë janë artiste, të cilat janë përpjekur që të bëjnë fusion të muzikës Perendimore me atë Lindore, por pak apo asnjë nuk arrinë ta artikulojnë në mënyrë kaq të harmonizuar, siç e bën Loreena Mc Kennitt.

Në këtë varg mund të rradhitet Sarah Brightman, Natacha Atlas, por Loreena Mc Kennitt, i jep një shije vërtetë specifike.

Marianne Magendorfer ka bërë një përpjekje briliante me Albumin Anatakarana, ku këndohet Gregoriançe, këngët mbi pelegrinazhet nëpër Spanjë, tek San Juan de la Cruz, këndimet e tempujve Tibetan dhe ato Sufi mesazhe të Pir Vilayat Khan.

Këndime të tilla të himneve sakrale të shëtisin nëpër hostori botërore, të trashëgimisë shpirtërore, të begatshme të saj.

Tek Loreena Mc Kennitt, mësojmë reciklim të Christams Carrol, Mjegullnaja të Avallonit, Shekspirin, Dikensin, që më pastaj të vazhdoj tek Safardi-t të Stambollit dhe Sufizmin e Kavkazit e frymëzuar nga Mjeshtritë e fundit të etërve të maleve të Abkhazisë; Murat Yagan, i fundit, i cili botës, në mënyrë gojore do t'i transmetoj traditën e lashtë; Ahmsta Kebzeh; traditë, e cila me gjenerata porsi Libri Tibetan i të Vdekurve është përcjellur gojarisht.

Loreena Mc Kennitt paraqet fenomenin muzikor botëror, duke ofruar alternativë për njerëzimin., Ajo jep model se si, Lindja dhe Perendimi mund të japin produkt të përbashkët qoftë në

Art, qoftë në Shkencë, qoftë edhe në Politikë kjo e fundit është mëse e domosdoshme dhe pikërisht këtë e kupton Obama.

Loreena Mc Kennitt, e ringjall lavdinë e Alhambrës, bën: The book of Secrets (Libri i mistereve- Albumi i saj), këndon lutjen e Dantes etj. Talenti i tillë dhe aftësia e saj e komunikimit me publikun, paraqet shkëlqimin e yllit të ndritshëm të saj.

Ajo këndon sakralen, mistaken, mitologjiken, letraren, duke i dhënë notën dhe vulën e saj. Ajo di të elektrizoj masën me zërin ledhatues dhe ton magjik të harpës së sajë, të cilët ndihmojnë në ekzaltimin e vetëdijes.

Më e përshtatshme për meditim, artistë dhe krijues të lodhur nga krijimtaria, por edhe stimuluese për të krijuar dhe më tej.

Biografia

Loreena Mc Kennitt lindi në Morden, Manitoba prej prindërve me prejardhje Irlandeze dhe Skoceze, Jack dhe Irene Mc Kennitt. Pastaj, u shpërngul në Stratford, Ontario në vitin 1981, ku ende jeton dhe vepron.

Duke e zhvilluar pasionin për muzikë Keltike, ajo mësoi të loz nëharpën kelte, që filloi të loz në këtë instrument nëpër lokale si:St. Lawrence Market në Toronto me qëllim që të fitoj para për ta publikuar albumin e parë.

Që nga publikimi i albumit An Ancient Muse 2006, Loreena McKennittnë mënyrë konzistente shkonte nëpër turne, në Evropë dhe SHBA, në prënverë 2007, nje turne më te gjerë ne Kanada dhe SHBA, në vjeshtë 2007, turneu i Evropës, pranverë 2008 dhe në verë, në Mesdhe duke u ndalur në Marok, Greqi, Turqi, Qipro, Izrael, Liban, Hungari dhe Itali.

Albumet

- Elemental (1985)
- To Drive the Cold Winter Away (1987)
- Parallel Dreams (1989)
- The Visit (1991)

- The Mask and Mirror (1994)
- The Book of Secrets (1997)
- An Ancient Muse (2006), album i nominuar për Grammy në vitin 2008.
- A Midwinter Night's Dream (2008)

Live Albume

- Live in Paris and Toronto (1999)
- Nights from the Alhambra (2007)

Singël

- "The Lady of Shalott" (1991)
- "All Souls Night" (1991)
- "Courtyard Lullaby" (1991)
- "Greensleeves" (1993)
- "The Bonny Swans" (1994)
- "Santiago" (1994)
- "The Dark Night of the Soul" (1994)
- "The Mystic's Dreams" (1995)
- "God Rest Ye Merry, Gentlemen" (1995)
- "The Mummers' Dance" (1997), Billboard Hot 100, Billboard Modern Rock
- "Marco Polo" (1998)
- "Caravanserai" (2006)
- "Penelope's Song" (2007)
- "The Seven Rejoices of Mary" (2008)
- "Noël Nouvelet!" (2008)

Video

- The Mummers' Dance (1997)
- The Bonny Swans
- Loreena McKennitt: Nights from the Alhambra (2007, koncerti Live në Spanjë

- A Moveable Musical Feast (2008, dokumentar i turneut në vitin 2007 në SHBA)
-



ZAHA HADID

Kreativiteti nuk njeh kufi të Lindjes dhe Perendimit. Zatën një përpjekje e afrimit të të dy poleve krijon stimul për temën time.



Zaha Hadid, emër i njohur në botën e Arkitekturës botërore, disenjit dhe të modës.

Në raport me gjenialitetin e sajë, janë ca përparësi, ajo është grua, një grua e Lindjes, më saktë, nga Bagdadi, është hiperkreative.

Nëse Oum Kalthoum është mbretëreshë e Orientit për muzikë, Laleh Bakhtiar mendimtare briliante, Zaha Hadid është individ, gjeniu, i së cilës i tejkalon epokat.

Sa gra arkitekte njeh historia?

Unë e njoh historinë e gruas avangarde, por unë njoh vetëm një grua, e vetmja grua orientale, e cila u shpërblye me çmimin

më prestigjioz që ipet në SHBA për arkitekturë: Pritzker Prize 200458.

Zaha Hadid e ndryshon reliefin e planetit, forma, koncepti, funkcionaliteti filozofia, që të gjithat mbajnë vulën e pashlyeshme, Zaha Hadid. Metropolet botërore, sikur po bëjnë garë se, cili më shpejtë do të ketë një nga kreacionet arkitektonike të Zaha Hadid.

Nuk kam kurrëfarë prirje për kultivimin e stereotipeve, por konsideroj që, po që se Zaha Hadid nuk do të kishte lëvizur nga Bagdadi në Londër, ajo do të mbetej një arkitekte, latente, sepse askush nuk do t'i mundësonte, që të evoloj kreativitetin dhe frymëzimin e t'i materializoj në këtë trajtë.

Një talent i tillë, prêt çastin e duhur që të orientohet. Fati i Zaha Hadid është se, kaloi nëpër duar mjeshtëror të prof. Rem Koolhaas dhe së bashku me Alvar Aalto, paraqesin një trekëndësh kreativ, i cili arkitekturën e transcendon në skulpturë masive, funkcionale, dhe mbi të gjitha estetike.

Vetëm po të vështrohet transformiim i kuartit Kartal në Stamboll, lë të kuptohet kush është Zaha Hadid, pastaj Salla e Operës në Abu Dabi, kuzhinat fantastike, trajta organike të objekteve etj.

Atë që dikush vetëm e imagjinon tjetri e vë në pikturë Zaha Hadid e materializon në katër dimensione.

Biografia:

Zaha Hadid lindi më 31 tetor, 1950 në Bagdad, Irak. Pasi që u diplomua në Matematikë në American University of Beirut, vazhdoi studimet në Arkitekturë në Architectural Association School of Architecture, në Londër. Pas diplomimit ajo punoi më profesorët e sajë, Rem Koolhaas dhe Elia Zenghelis në zyrën OMA ose Office for Metropolitan Architecture, duke u bërë partner në vitin 1977.

58 Nga Architecture Week, Architecture Week No. 187, 2004.0331, pN1.1.

Nëpërmjet Koolhaas ajo takoi inxhinerin Peter Rice, i cili i dha shumë përkrahje dhe inkurajim. Më 1980 ajo e themeloi studin e vet në Londër. Gjatë 80-tave ajo ligjëroi në Architectural Association.

Filloi fillimisht të ligjëroj në AA me bashkëpuntorët e OMA; Rem Koolhaas dhe Elia Zenghelis, pastaj edhe vet (1978 - 1984).

Që nga kjo kohë ajo mbante katedrën e Kenzo Tange, në shkollën e lartë të Disenjit në Harvard University, Katedrën e Sullivan në University of Chicago, shkolla e arkitekturës, Profesor visitor në Hochschule für bildende künste në Hamburg, në The Knolton school of architecture, Ohio etj.

Video

- *Një ditë me Zaha Hadid* 2004, 52 minuta. New York: Michael Blackwood Productions.

Shpërblimet

- 2001: Equerre d'argent Prize, special mention
- 2003: European Union Prize for Contemporary Architecture
- 2004: Pritzker Prize
- 2007: Thomas Jefferson Medal in Architecture

Ekspozitat

- 2007 - (29 qershor - 25 nëntor) - Design Museum, London
- 2006 - (1 qershor - 29 korrik) – Ma10 Mx Protetch Gallery, Chelsea, NYC
- 2006 - (3 June - 25 October) – Solomon R. Guggenheim Museum, New York
- 2003 - (4 maj - 17 gusht) - MAK - Museum für angewandte Kunst ose Muzeu i Arteve Aplikative (Vienna)


- 2002 - (10 maj -11 gushtt) Centro nazionale per le arti contemporanee, Roma
- 2001 - Kunstmuseum, Wolfsburg
- 2000 - British Pavilion në Venice Biennale
- 1997 - San Francisco MoMA
- 1995 - Graduate School of Design në Harvard University
- 1988 - Deconstructivist Architecture ekspozita në MoMA, New York
- 1985 - GA Gallery, Tokyo
- 1983 - Retrospective në Architectural Association, London
- 1978 - Guggenheim Museum, New York

Mobilie dhe enterier në:

- Bitar, London (1985)
- Moonsoon restaurant, Sapporo (1990)
- Temporary structures, Osaka (1990)
- Music video pavilion në Groningen (1990)
- A pavilion for 'blueprint' magazine, interbuild, Birmingham (1995)
- Z-scape për Sawaya & Moroni (2000)

Galeria






Qendra e Artit të Aplikuar në Abu Dhabi








Pamja e tashme e lagjës Kartal Stamboll






Dy pamje si e sheh Zaha Hadid këtë projekt



Projekti për qendrën tregtare Stamboll 2005/6

OSHO

Pas botimit të tre-katër librave të Oshos edhe në gjuhën shqipe, për çka duhet falënderuar përkthyesit dhe botuesit, kam borxh së paku ta bëj një introdukt për një fenomen njerëzor, mendimet e, të cilit përhapen në mbarë botën. Dhe, asnjërën nga këto përkthime nuk e lexova dhe nuk e njoh saktësinë e tyre, por thellë mendoj se Osho, nëse është përkthyer ashtu si është, vetëm me dashuri, atëherë nuk dyshoj, se përkthyesi ka dështuar ta përcjell mesazhin e mjeshtrit të madh të alkimisë së transformit të koshiencës.



Me Oshon ka kohë, që ballafaqohem (fundi i viteve 80-ta), dhe kryesisht janë botimet në gjuhën angleze, kroate, serbe dhe sa herë, që e kam lexuar, duket se është një person i ri, një autor tjetër me frymë të njejtë. Më gëzon fakti që lexuesi kosovar ka mundësinë të hapet dhe ta absorbojë një urtësi primordiale, e shprehur dhe e artikuluar për njeriun bashkëkohor. Ishte Meher Baba me "Discourse" dhe pikërisht ky Osho me "The Ultimate Alchemy", të cilët më shpëtuan gjatë luftës nga çmendia e bombave të NATOs, vrasjet mizore të fëmijëve shqiptarë, nga serbët dhe ushtria e organizuar jugosllave, nga kundërmimi i gjakut, pamjet e shiringave të hedhura, vëshëmbathjeve të përgjakura, etj. Fjala OSHO nuk është emër i personit, për të cilin flas.

Osho është titull më i lartë për mjeshtrit e Zen-it. Osho është term i derivuar nga Japonishtja antike dhe personi i parë, i cili e ka përdorur është EKA, i cili me Osho iu drejtua mësuesit të tij Bodhidharmës. "O" do të thotë dashuri dhe mirënjohje me respekt të thellë si dhe sinkronicitet dhe harmoni, ndërsa "OSHO" do të thotë ekspanzion multidimensional i koshiencës. Kurse emri i vërtetë i Oshos për të cilin flas është Sri Bhagëan Rajneesh.

Tek me 27 shkurt 1989 ithtarët e Oshos në mënyrë kolektive vendosën ta quajnë Osho Rajneesh. ZEMRA E ZBRAZËT, ËSHTË DERA E PËRHERSHMËRISË, ËSHTË LIDHJE MES TEJE DHE EKZISTENCËS, NUK ËSHTË DIÇKA JASHTË FIZIKËS APO MATERIALES OSE PSIKOLOGJIKE, ËSHTË DIÇKA PËRTEJ TË DYJAVE, DUKE I TRASHENDUAR TË DYJAT, ËSHTË DIVINITETI YT MBAJ NË MEND, ZEMRA E ZBRAZUR TË BËN BUDHA (TË PËRNDRITUR). Me një fjalim të këtillë, njeriu i këtillë vështirë që do ta gjente substratin për t'i mbjellur farët e tij, prandaj ndoshta kjo edhe është arsye pse në Kosovë nuk ka qendër për Multiversitetin e Oshos. Ka qendra të shumëta të Oshos në shumë vende të botës, ndërsa në territorin afër nesh më të njohura janë në Novi Sad, Sutomore, Kroaci dhe Slloveni.

Osho u lind më 11 dhjetor 1931 në Kuçevad, Madija Pradesh, Indi. Që në fëmijëri ishte rebel dhe çdoherë ka insistuar në përvojën personale të vërtetësisë, e jo në parim të verbër të dijes dhe besimit nga tjetrit. Ishte shpirt i pavarur. Thuhet se e përjetoi përndritjen në moshën 21 vjeçare.

Fillon të ligjerojë në Universitetin e Xhabalpurit, duke ligjëruar filozofinë. Fillon të udhëtojë nëpër Indi, duke i sfiduar besimet tradicionale dhe nxitur polemikat publike. Në mënyrë intensive lexonte çdo gjë që gjente. Kah fundi i viteve 60-ta filloi ta zhvillojë teknikën unike dhe tani të famshme, të MEDITIMIT

DINAMIK. Ai thotë se, njeriu bashkëkohor është i stërngarkuar me tradita të njohura të së kaluarës si, dhe me mërzinë e jetës moderne, kështu që, njeriu të kalojë procesin e thellë të pastrimit, parasë, të shpresojë se do ta zbulojë pa- koshiencën, gjendjen e relaksuar të meditimit."UNË JAM FILLIMI I NJË VETËDIJE TË RE FETARE", "POROSIA IME NUK ËSHTË AS DOKTRINË E AS FILOZOFI. NË TË VËRTETË POROSIA IME ËSHTË ALKIMI, SHKENCA E TRANSFORMIMIT". Osho vdiq më 19 janar 1990.

Komuna e tij e madhe në Poona të Indisë, është gjithnjë në rritje dhe po bëhet Qendra më e madhe botërore për zhvillim shpirtëror. Kjo qendër, tërheq njerëz nga mbarë bota, të cilët shkojnë për programe të ndryshme të meditimit, terapisë, kreative, zhvillim trupor, etj. Qëllimi është që njeriu bahskëkohor të lirohet nga prangat e ideologjive dhe sistemeve të ndryshme, të cilët po e ndajnë njerëzimin. Të krijohet qenia e re njerëzore, e cila jeton në harmoni më vetveten dhe rrethin. Aty ekziston Shkolla Osho e përqëndrimit dhe mjeshtrive luftarake të Zen-it, Shkolla Osho e arteve kreative, Osho akademia ndërkombëtare e shërimit, Osho akademia e meditimit, Osho Instituti i dashurisë dhe koshiencës, Osho shkolla e mjekësisë pulsative tibetane, Osho qendra për transformim, Osho klubi i meditimit; kohë e lirë kreative.

Ajo çka Oshon, e bën të veçantë për mua,është gjithanshmëria e tij në njohjen dhe aplikimin e urtësive më prominente

botërore,të trashigimisë shpirtërore botërore. Numëron afro 700 vepra të shkruara, ngjashëm si Al Ghazali, Ibn Arabi, Tesla. Kjo duket së është shifra e kreacioneve, të mendjeve fertile të njerëzimit. Osho shkruan për Meditimin, mjeshtërit budistë, mistikët Indian, për Kabirin- poet mistik, për Krishnën, Jezusin, për Sufizmin, Tantrën, Tao-n, Upanishadat, Mistikët perëndimor, Yogën, Zen-in dhe mistikët e Zen-it etj. Pikturat e Oshos kanë origjinalitet të spikatur. Librat që, unë i rekomandoj për lexim janë: Buddha zbrazëtia e zemrës; Alkimia supreme; Fara qiellore; Bash ashtu; Unë jam porta mistike; Rruga ime rruga e reve të bardha.

SHËNIME BIOGRAFIKE

Ulind në Rahovec në jugperëndim të Kosovë më 1972. Studimet universitare i kryen në Universitetin e Prishtinës, Studime Orientale.

Aktivisht merret me kaligrafi duke zbuluar teknika dhe mediume te reja për këtë lloj specifik të artit vizual.

Shkruan vështrime estetike për artin pamor.

Është ekspert i letërsisë transcendentale dhe hulumtues i trashëgimisë shpirtërore botërore.



Foto ©Bruno Fert[59], Paris

59 Bruno Fert, fitues i çmimitmë prestigjioz në botë World Press Photo

Librat e botuar:

- NUN- përmbledhje me poezi mistike, 1996 botim autori,
- SHUMËSI E PADUKSHME- Prozë poetike, 2000, botim autori
- NEKTARINA- Roman epik transcendental, 2004, sht. Botuese, Rozafa, Prishtinë projekt i Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sporteve të Kosovës
- ELEMENTAL 99- Tregime të shkurta poetike, 2006, Qendra për mendim pozitiv, Prishinë
- KUN- Përmbledhje me poezi të lirikës transcendentale, 2007, Sht. Botuese LOGOS-A, Shkup
- Libri elektronik, E-book, në gjuhën angleze, botuar nga Ronin Press, Londër, Angli
- Crystaline Echoes, Poezi, Libër dhe e-book, 2011, Corpos Editora- Madeira, Portugal
- Pleroma's dew. Poemë, Inner Child Press, 2012, New York SHBA
- BALKANS AND ISLAM: ENCOUNTER-TRANSFORMATION-DISCONTINUITY-CONTINUITY, Cambridge Scholars Publishing, Cambridge University Press, Cambridge, 2012, Mbretëria e Bashkuar
- Pleroma's dew, Inner Child Press, 2012, New York, USA

Punime shkencore

- Punime shkencore në: Institute for Balkan Studies, Tehran, Iran
- Punime shkencore në: Revista "Avicenna", Prishtinë, Kosovë

Botimet në gazeta dhe revista:

- Ese në të përditshmen ZERI, Prishtinë,
- Ese në të përditshmen LAJM, Prishtinë,
- Ese në të përditshmen GAZETAEXPRESS, Prishtinë,

- Ese në të përditshmen KOHA DITORE, Prishtinë
- Ese në të përditshmen ILIRIA POST, Prishtinë,
- Kolumne dhe ese në javoren JAVA, Prishtinë,
- Poezi në Revistën MM të Qendrës për studime humanistike GANI BOBI, Prishtinë
- Ese në revistën "Studime Orientale" të botuar nga Shoqata e Orientalistëve të Kosovës.
- Poezi në revistën STAV- Tuzla, Bosnie dhe Hercegovinë
- Poezi në Revistën ZIVOT- Sarajevë, Bosnie dhe Hercegovinë
- Poezi në revistën ULAZNICA- Zrenjanin, Vojvodinë
- Ese në revisten elektronike SEGURAWEB dhe Ars Poetica, Holandë
- Ese në revistën elektronike GAZETA START, Shqipëri
- Poezi në Istanbul Literary Review, Istanbul, Turqi,
- Poezi në MOBIUS Magazine, New York, SHBA
- THE WORLD POETS QUARTERLY (multilingual) VOLUME No. 58, Pekin, Kinë
- THE WORLD POETS YEARBOOK 2009, Pekin, Kinë
- Poezi në Sarajevske Sveske 2010, Sarajevo, Bosnia
- Poezi në Balkan writers, Beograd, Serbi
- Poezi nëPoetas del Mundo, Santiaogo de Chile
- Poezi në Mediterranean, Gotteborg, Suedi
- Poezi nëAquill Relle, Bruksel, Belgjikë
- Poezi nëPoem Hunter, SHBA
- Poezi nëWorld Poets Society, Athinë, Greqi
- Poezi nëAlb Poem, Shqipëri
- Poezi nëSoylesi Magazine, Istanbul, Turqi
- Poezi nëUra, Tiranë, Shqipëri
- Poezi nëUzina Marta, Brazil
- Poezi në Arabic and Davah, Hong Kong
- Poezi në Orientul Meu, Bukuresht, Rumani
- Poezi në Agonia, Bukuresht, Rumani
- Poezi dhe profil në Carty's Poetry Journal, Dublin, Irlandë

- Poezi nëMiddle East Online, Londër, Angli
- Poezi në anglisht në The Sound of Poetry Review, Argjentinë
- Poezi në Le Post, Paris, Francë,
- Poezi ne Aube, Paris, Francë
- Poezi në 24 Heurs, Zhenevë, Zvicërr
- Poezi nëTribune de Geneve, Zhenevë, Zvicërr
- Poezi dhe Kaligrafi në World Art Friends, Medeirra, Portugali
- Poezi në Le Chasseur Abstrait Review- Cintas, Revue d'Art, et litterature, Musique, Paris, Francë
- Poezi në Album Nocturno- Antologji, Salvador,
- Poezi në Carcinogenic Poetry, Brazil
- Poezi në Arte Poetica, Salvador,
- Poezi në Antologji të Fernando Sabido Sanchez, Madrid, Spanjë
- Poezi në Antologjinë botërore Poetas Siglo Venti uno, Editor, Fernando Sabido Sanchez, Madrid, Spanjë
- Poezi në CHECK POINT PETRY, Le Reti di Dedalus, Romë, Itali
- Poezi në Author India, Indi
- Poezi në Cinosargo, Arica, Kili
- Poezi në Antologjinë e Andres Morales, Kili
- Poezi nëGray Scale, Niger
- Poezi në Snow in Guinea Magazine, 13 º NUMBER OF LITERARY MAGAZINE
- LVII No. of 2nd etapa/01-07-2011
- Poezi në; La Granada, No. 2,Oslo, Norway
- Poezi në http://www.poemish.com/item/list/user/id/1653, USA
- Poezi në http://www.best-poems.net/fahredin_shehu/index.html, USA
- Artikuj në www.worldbulletin.com, Istanbul, Turqi
- Artikuj në www.newropeansmagazine.com, Strasbourg, Francë

- Librat në http://www.archive.org/search.php?query=creator%3A%22Fahredin%20Shehu%22, SHBA

Projektet:

- Tekste për albumin e ri të grupit Jericho
- Libri me Poezi KRAHU I SERAFIMIT- Në Tiranë
- Libri mbi trashëgimisë mistike Islame- SUFIZMI
- Dokumentari mbi identitetin e shqiptareve. Të intervistuar; Bernard Koushner, Ismail Kadare, Dom Lush Gjergji, Fahredin Shehu, Luan Starova etj. Financuar nga Universiteti i Sorbonës, Paris.

Pjesëmarrjet:

- Ekspozita e kaligrafive në Kajro, Egjipt, 2004;
- Takimet e 44-ta të poezisë, Sarajevë 2005;
- Kongresi mbi 600 vjetorin e Veprës së Abdurrahman Ibn Khaldunit, Kajro, Egjipt, 2006;
- Takimi për të drejtat e pakicave etnike, Parlamenti Evropian, Bruksel, 2006;
- Ekspozita e pikturave dhe e librave ne Ministrinë e kulturës së Egjiptit, Kajro, 2007;
- Debatet ne KTV, RTK, TV BESA;
- Pjesëmarrje në Kongresin me rastin e 800 vjetorit te poetit Persian Xhelaludin Rumi, organizuar nga UNESCO dhe Fondacion Saadi Shirazi, Tiranë.
- Pjesëmarrje ne Kongresin e 3th Ndërkombëtar Sheikh Tousi, Qom, Teheran, Mashhad, Iran
- Pjesëmarrje ne Konferencën rajonale për bashkëpunim, Kopaonik, Serbi
- Festivali i 14-të i Poezisë Voix de Metiterranee, Lodeve, Francë
- Festivali i poezisë- jubilar ne Struge, Maqedoni

- Konferenca Rajonale, PEN Qendra e Maqedonisë, Shkup, Maqedoni

- Debate në mediat Nacionale RTK, KTV, TV BESA, TV 21
- Profile artistike në "KULT", "AVENY" ne Transmetuesin Publik Televiziv RTK
- http://infoglobi.com/OPIN/artikulli/shkrimtari_qe_hap_porta_te_reja/
- I përkthyer në Anglisht, Frëngjisht, Italisht, Suedisht, Rumanisht, Serbisht, Kroatisht, Boshnjakisht, Maqedonisht, Turqisht, Arabisht, Gjuhë Rome, Persisht
- Librat e tij gjinden në Bibliotekën e Aleksandrisë, Alexandria, Egjipt,
- British Library, Londër, Mbretëria e Bashkuar,
- I katalogizuar në Bibliotekën Universitare dhe Kombëtare të Kosovës
- Në Bibliotekën Nacionale në Zagreb, Kroaci
- Në Bibliotekën Nacionale në Beograd, Serbi
- Ambasador i Poetëve për Shqipëri nga Lëvizja Poetët botëror "Poetas del Mundo", Santiago de Chile
- Anëtar i Asociacionit Botëror të Poetëve, Greqi
- Drejtor Ekzekutiv i Qendrës për promovimin e dialogut ndërkulturor "OXOR"
- Anëtar i Këshillit të librit dhe Botimeve pranë Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
- Anëtar i PEN Qendrës së Kosovës
- Punon në administratën e Radio Televizionit të Kosovës RTK